**Republika e Kosovës**

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

***Kuvendi Komunal Kaçanik***

*Skupština Opština Kaçanik - Municipality Assambly of Kaçanik*

# VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA PËR KOMUNËN E KAÇANIKUT



**Kaçanik, 2025**

PËRMBAJTJA


Parathënie....7

Vendim i kryetarit të Komunës për themelimin e Grupi Punues për hartimin e dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë ....8

**VLERËSIMI I RREZIQEVE SI PJESË PËRBËRËSE E MBROJTJES DHE SHPËTIMIT NË KOMUNËN E KAÇANIKUT**

Hyrje....10
Misioni dhe synimi i vlerësimit të rrezikshmërisë....11
Infrastruktura Ligjore....11

**KREU I-rë**

**PROFILI I KOMUNËS SË KAÇANIKUT**

**1.** Pozita, karakteristikat gjeografike dhe klimatike të komunës së Kaçanikut....12
1.1. Zona e përgjegjësisë( përkufizimi hapsinorë)....13
1.2. Sipërfaqja e përgjithshme ( e territorit) e komunës së Kaçanikut....13
1.3. Hidrografia-lumenjtë dhe liqenet....15

**Kreu i II**

**2.0. DEMOGRAFIA**
1.2. Kategoritë e banorëve të planifikuar për evakuim....19
1.3. Dendësia e popullsisë ....20
2.2.1.Shpërndarja e familjeve në bazë tëgrupeve etnike në komunën e Kaçanikut ....21
2.2.2.Të punësuarit dhe të pa punësuarit....22
2.3. Arsimimi....27
2.3.1.Identifikimi i rreziqeve ....31
2.3.2. Rekomandime ....31

**Kreu i III**

**3.0. TË MIRAT MATERIALE, KULTURORE DHE TË MJEDISIT**
3.1. Trashëgimia kulturore ....32
3.2. Parqet nacionale ....36
3.2.1. Parqet natyrore dhe rezervatet *(nëse ka)*....36
3.2.2. Sipërfaqet pyjore dhe diverziteti....36
3.2.3. Zonat e mbrojtura dhe trashëgimia natyrore....39

**3.3. Bujqësia**
3.3.1. Zonat e prodhimtarisë bujqësore....41
3.3.1.1. Zhvillimi bujqësor dhe rural....41
3.3.2. Ndikimi i prodhimitarisë bujqësore në ekonominë e Komunës....42
3.3.3. Kultivimi i bimëve një vjeçare (të korrat)....43
3.3.4. Kultivimi i kulturave bujqësore shumëvjeçare....45
3.4. Agrobiznesi....47
3.4.1. Fermat bujqësore....47
3.4.2. Turizmi ....48
3.4.3. Sektori privat / komuniteti i biznesit ....49
3.4.4. Shoqatat afariste ....50

**3.5. Objektet**


3.5.1. Objektet e banimit.....51
3.5.2. Objektet afariste.....53
3.5.3. Objektet sportive.....54
3.5.4. Objektet kulturore.....55


**3.6. Strehimoret dhe objektet për strehim**


3.6.1..Përcaktimi i lokacioneve ( zonave ) të grumbullimit në rast fatkeqësie.....55
3.6.2..Lokacioni i strehimoreve /titullari.....56
3.6.3. Kapacitetet.....57
3.6.4. Gjendja e tyre.....58


**3.7. Kapacitetet shëndetësore publike dhe private**


3.7.1. Institucionet Shëndetësore.....57
3.7.2. Kapacitetet humane shëndetësore.....62
3.7.3. Kapacitetet teknike reaguese në sektorin publik (QKMF/.....62
3.7.4. Kapacitetet mjekësore private:.....63
3.7.5. Detyrat e ekipeve për shërbime mjekësore në situata emergjente:.....63


## Kreui IV

.

**4.0. INFRASTRUKTURA TEKNOLOGJIKE DHE E TRAFIKUT**


4.1. Rrugët (rrjeti rrugor dhe qarkullimi).....64
4.1.1. Rrugët e nivelit kombëtar - Autostrada Prishtinë-Shkup.....64
4.1.2. Rrugët urbane.....64
4.1.3. Rrugët e nivelit komunal.....65
4.1.4. Rrugët në vendbanime lokale.....65
4.1.5. Siguria në trafik.....68
4.1.6. Burimet e rreziqeve (Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve në infrastrukturën rrugore.....69
4.2. Hekurudhat.....70
4.3. Aeroportet.....70
4.4. Urat dhe tunelet.....71
4.4.1. Urat.....71
4.4.2.Tunelet.....75
4.5. Largpërçuesit dhe trafo-stacionet.....76
4.6. Sistemet energjetike ( objektet dhe sistemet).....76
4.7. Sistemet e telekomunikimit.....77
4.7.1. Objektet dhe shërbimet (brenda komunës).....77
4.7.2. Personat juridik.....78
4.7.3. Qendrat telekomunikuese, transmetuese dhe repetitorët.....78
4.7.4. TV dhe radiostacionet.....78
4.8. Sistemet hidroteknike.....79
4.8.1. Objektet për furnizim me ujë.....79
4.8.2. Korporatat rajonale të ujërave ( KRU) dhe burimet alternative.....80
4.8.3. Sistemi i distribuimit të ujit për pije.....80
4.8.4. Monitorimi i ujërave për pije.....84
4.8.5. Ndotësit e mundshëm të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor.....85
4.8.6. Masat parandaluse ndaj ndotjes së ujit.....87
4.8.7. Rekomandimet.....87

4.9. Sistemet e shpërndarjes së gazit dhe naftës ....................................................88
4.9.1. Pompat e derivateve;....................................................................................88
4.9.2. Deponitë e derivateve/kapacitetet;.................................................................89

## Kreu i V

**5.0. OBJEKTET E RËNDËSISË SË VEÇANTË**
5.1. Objektet e sigurisë ( stacionet policore, qendrat operative rajonale etj.);.......................91
5.2. Objektet dhe hapësirat qeveritare ( shërbimet e administratës civile, shërbimet .publike);...........................................................................................................91
5.3. Shërbimet financiare/bankat, agjencitë e sigurimeve, shërbimet postare, etj................92
5.4. Objektet shkollore ;...........................................................................................92

## KREU VI-të

**6. 0. LLOJET E FATKEQËSIVE ..........................................................................93**
6.1. Intensiteti, llojet dhe ndikimet e veprimit të fatkeqësive natyrore në territorin e komunës së Kaçanikut.............................................................................................................94
6.2. Prioritizimi i fatkeqësive natyrore bazuar në matricën e rreziqeve (lista sipas prioriteteve);
6.3. Matrica e gjasave ...........................................................................................95
6.4. Rreziqet nga fatkeqësitë natyrore .........................................................................95
6.4.1. Vërshimet ........................................................................................................96
6.4.2.. Identifikimi i rreziqeve nga vërshimet;...............................................................96
6.4.3. Karakteristikat hidrografike dhe ndikimet e saj në paraqitjen e vërshimeve...............96
6.4.4. Historiku i vërshimeve ( koha, hot-spotet/pikat e nxehta);........................................97
6.4.5. Vendet (vendbanimet) më të atakuara nga vërshimet /pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara me numrin dhe strukturën e banorëve;...................................................97
6.4.6. Kushtet hidrometeorologjike...........................................................................98
6.4.7. Treguesit hidrologjik siç janë: lumenjtë, liqenet dhe rezervuarët të cilët mund të jenë shkaktarë të vërshimeve,...........................................................................................101
Masat parandaluese; ...........................................................................................102
Infrastruktura e ndërtuar për mbrojtje nga vërshimet në Komunën e Kaçanikut ...102
Rekomandime ...................................................................................................103
Hartëzimi i rreziqeve nga vërshimet;.....................................................................104
Skenari ............................................................................................................105

**6.5. ZJARRET**
6.5.1. Karakteristikat e terrenit dhe vatrave potenciale të zjarreve,.................................143
6.5.2. Kushtet klimatike, ...........................................................................................145
6.5.3.Zjarret fushore, malore, urbane, zjarret si pasojë e proceseve teknikoteknologjike ..146
6.5.4. Intenziteti, shpeshtësia e paraqitjes, kohë-zgjatja, ...............................................146
6.5.5. Sipërfaqet e përfshira .......................................................................................147
6.5.6..Treguesit statistikor të pasojave në periudhat kohore të zjarreve............................148
6.5.7. Mbrojtja nga zjarri në sektorin e ndërtimit ..........................................................149
Masat parandaluese; ...........................................................................................149
Rekomandime ...................................................................................................150
Hartëzimi i rreziqeve nga zjarret; ..........................................................................151
Skenari ............................................................................................................152

**6.6. TËRMETET**

6.6.1. Karakteristikat sizmike të zonave dhe rreziku sizmik;.............................................185
6.6.2. Vendbanimet e rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve;....................................186
6.6.3. Rrezikshmëria e zonave të caktuara;..............................................................................186
6.6.4. Shpeshtësia, intensiteti dhe epiqendra e tërmetit (dridhjeve); .................................187
6.6.5. Pasojat e tërmeteve sipas zonave sizmike ;.............................................................187
. 6.6.6. Informimi, senzibilizimi dhe trajnimi i popullatës në rast të tërmeteve ....................188
Masat parandaluese; ......................................................................................188
Harta e rreziqeve;..........................................................................................189
Skenari; ........................................................................................................191

**6.7. RRËSHQITJET DHE EROZIONET**

6.7.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonave potenciale të rrëshqitjes dhe erozioneve,..........213
6.7.2. Kushtet klimatike, intensitetin, shpeshtësinë e paraqitjes,..........................................213
6.7.3. Përshkrimi i strukturave gjeologjike të tokës (rrëshqitjet aktive dhe pasive);.............213
6.7.4. Sipërfaqet e përfshira;.........................................................................................215
6.7.5. Pasojat nga rrëshqitjet dhe erozionet;.......................................................................216
Masat parandaluese; ......................................................................................221
Harta e rreziqeve;..........................................................................................224
Skenari; ........................................................................................................225

**6.8. RESHJET E DËBORËS DHE NGRICAT**

6.8.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonave potenciale me të reshura të dendura të dëborës dhe ngricave, ..........................................................................................................242
6.8.2. Intensiteti i reshjeve, shpeshtësia e paraqitjes, temperaturat ekstreme, ....................242
6.8.3. Pasojat nga dëbora dhe ngrica .................................................................................243
Masat parandaluese; ......................................................................................243
Harta e rreziqeve; ..........................................................................................244

**6.9. BRESHËRI**

6.9.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale të prekura nga breshëri .....................245
6.9.2. Shpeshtësia e paraqitjes dhe muajt kritik ...............................................................,..245
6.9.3. Pasojat nga breshëri ...............................................................................................245
Harta e rreziqeve; ..........................................................................................247

**6.10. ORTEKËT**

6.10.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale.......................................................248
6.10.2. Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve..................248
6.10.3. Treguesit statistikor të pasojave nga ortekët...........................................................248
Masat parandaluese; ......................................................................................248
Harta e rreziqeve; ..........................................................................................249
Skenari .........................................................................................................250

**6.11. ERËRAT E FUQISHME DHE STUHITË**

6.11.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale.......................................................255
6.11.2. Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve.................255
6.11.3. Treguesit statistikor të pasojave nga erërat e fuqishme dhe stuhitë ........................255
Masat parandaluese; ......................................................................................257
Harta e rreziqeve; ..........................................................................................258

**6.12. THATËSIRAT**


6.12.1. Treguesit statistikor për mungesën e theksuar e të reshurave atmosferike.............259
6.12.2. Dëmet dhe pasojat ..........................................................................................259
6.12.3. Pasqyra e vendbanimeve/zonave të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve .....260
6.12.4. Rezervat ujore ( mbitokësore dhe nëntokësore); ................................................260
Masat parandaluese; ..........................................................................................261
Harta e rreziqeve; ..............................................................................................262
Skenari; .............................................................................................................263


.

**6.13. RREZIQET NGA EPIDEMITË DHE PANDEMITË**


6.13.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale.......................................................270
6.13.2. Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve..................270
6.13.3. Shkaktarët e paraqitjes së epidemisë, endemisë dhe pandemisë ..............................270
6.13.4. Sëmundjet ngjitëse...............................................................................................270
6.13.5. Pasojat nga epidemitë dhe pandemitë ....................................................................271
6.13.6. Epidemitë dhe pandemitë e bazuara në vlerësimet dhe analizat e shërbimeve kompetente kompetente:...........................................................................................271
6.13.7. Bartësit dhe përgjegjësit e aktiviteteve të rregullta dhe masat parandaluese ............273
Masat parandaluese; ..........................................................................................274
Harta e rreziqeve; ..............................................................................................275
Skenari; .............................................................................................................276


**KREU VII – të**

**7.0. FATKEQËSITË TJERA**


7.1.Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë tjera .............................................................285
7.1.1.Numrin, llojin dhe madhësinë e objekteve në të cilat deponohen, përdoren apo prodhohen materiet e rrezikshme;......................................................................................285
7.1.2. Numrin, llojin dhe cenueshmërinë e trafikut rrugor, hekurudhor dhe ajror;..............286
7.1.3. Llojin dhe sasinë e materieve të rrezikshme;.........................................................286
7.1.4. Distancën nga zonat e banuara;...........................................................................287
7.1.5. Përqendrimin e materieve të rrezikshme dhe të dëmshme .......................................288
7.1.6. Llojin dhe sasinë reale të materieve të rrezikshme dhe të dëmshme në qarkullim,....288
7.1.7. Rrjedhjen e materieve të rrezikshme dhe të dëmshme në vendet me rrezikshmëri të lartë/tubacionet, rrugët të cilat kalojnë nëpër vendet me specifika të veçanta...............288

7.2. VLERËSIMI PËR FATKEQËSITË NRKB......................................................................288

7.3. VLERËSIMI PËR RREZIQET NGA VEPRIMET LUFTARAKE DHE TERRORISTE;.289

7.4.VLERËSIMI DHE PASOJAT E INFRASTRUKTURËS KRITIKE................................289

7.5. STRUKTURAT PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE NDIHMË.....................................290
7.5.1. Kapacitetet forca dhe shërbimet e/ERE........................................................................290

**KREU VIII– të**

**8.0. VLERËSIMET PËRFUNDIMTARE – SPECIFIKE**

8.1.Vlerësimet përfundimtare bëhen për secilën masë të mbrojtjes ....................................296
8.1.2.Vlerësimet për strukturën dhe madhësinë e forcave për reagim emergjent , ..............296
8.2. KOSTOJA FINANCIARE E DOKUMENTIT TË VLERËSIMIT...............................296
8.2.1. Identifikimi dhe analizim i rreziqeve nga FNFT.......................................................297
8.2.2. Identifikimi i nevojave për resurset humane dhe teknike..........................................297
8.2.3. Identifikimi i nevojave për trajnim dhe aftësim profesional.......................................298
8.2.4. Zbatimi i akteve ligjore, nënligjore dhe monitorimi i tyre........................................298
8.2.5. Masat parandaluese për zvogëlimin e efekteve nga FNFT.........................................298
8.2.6. Hartimi i skenarit dhe ushtrimi, etj...........................................................................298

**9.0. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE ..................................................................................,...298**

**10. REKOMANDIME: ..............................................................................................298**

## PARATHËNIE

Dokumenti i Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera në Komunën e Kaçanikut, bazohet në Ligjin **Nr.04/L-027**, si dhe në Rregulloren (QRK)Nr.**25/2020** për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë.

Me këtë dokument identifikohen kërcënimet dhe rreziqet në Komunën e Kaçanikut si dhe bëhet vlerësimi i shkallës së rrezikshmërisë. Bazuar në këtë vlerësim, identifikohen mundësitë dhe nevojat për parandalimin, zvogëlimin (zbutjen) e rreziqeve, reagimin, rimëkëmbjen dhe evitimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Ky vlerësim shërben si bazament për hartimin e Planit Operativ Emergjent Lokale (POEL) si dhe planeve tjera lokale, me qëllim të mbrojtjes dhe shpëtimit të jetës së qytetarëve, të mirave materiale, mjedisit dhe trashëgimisë kulturore në Komunën e Kaçanikut

## THEMELIMI I GRUPIT PUNUES

Kryetari i Komunës së Kaçanikut, z.Besim Ilazi bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë brenda juridiksionit komunal, nxjerrë vendimin për themelimin e Grupit Punues, për hartimin /rishikimin e dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit

01Nr.104/02- 6753/23

Kaçanik, 15.03.2023

Në mbështetje të neneve 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 73 të Statutit të Komunës, pas propozimit të Drejtorisë së Emergjencave dhe Shërbimeve Publike, kryetari i komunës nxjerrë këtë:

# VENDIM

I. Themelohet Grupi Punues për rishikimin e dokumentit të Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, si dhe gjendjen emergjente në nivel komune.

Grupin Punues nga pika 1 e këtij vendimi e përbëjnë:

1. Bujar Bajra - zyrtarë i alarmimit dhe koordinimit emergjent,
2. Ylber Shehu - Komandant i NJPZSH-së ,
3. Naser Kuka - Inspektor i preventivës dhe mbrojtje nga zjarri,
4. Hajredin Shehu – inxhinier ndërtimi,
5. Jehona Hoxha Dervishi – zyrtare për planifikim urban, rural dhe ndërtim,
6. Kaltrina Çaka- Guri – zyrtare ligjore,
7. Bujar Dullovi - Inspektor mjedisor,
8. Fatlume Guri Selimi, - zyrtare e lartë për komunikim me publikun,
9. Arditë Shehu, - zyrtare për mbrojtje të mjedisit,

**II.** Grupi punues obligohet ta përgatis dokumentin e vlerësimit të rrezikshmërisë të këtij vendimi dhe dokumentet tjera përcjellëse, ashtu siç kërkohet me legjislacionin përkatës në fuqi.

**III.** Grupi punues obligohet që menjëherë të filloj punën për rishikimin e dokumentit të Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, dhe të veprojë sipas **nenit 17 pika 7** e Rregullores (QRK) Nr.25/2020 për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë.

**IV.** Grupi punues punën e vet, e bën në përputhje të plotë me Ligjin Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, Rregullore (QRK) Nr.25/2020 për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë, Ligji Nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri, Ligji Nr. 04/-L-049 për Zjarrëfikje dhe Shpëtim, duke pasur parasysh nevojat dhe specifikat e komunës së Kaçanikut.

**V.** Për punën e vet grupi punues raporton dhe koordinohet me drejtorin e Drejtorisë së Emergjencave dhe Shërbimeve Publike.

**VI.** Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike.

**VII.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Me këtë vendim njoftohen:*

*1.Ramadush Osmani, drejtor i DESHP,*
*2.Grupi punues dhe*
*3. Arkivi*

Besim Ilazi

Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK
REPUBLIKA KOSOVA

# VLERËSIMI I RREZIQEVE SI PJESË PËRBËRËSE E MBROJTJES DHE SHPËTIMIT NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

## HYRJE

Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (FNFT) të shkaktuara nga dukuritë natyrore apo nga faktori njeri mund të rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve, të mirat materiale dhe trashëgiminë kulturore. Dukuritë dhe fenomenet, qofshin ato natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri, manifestohen me rreziqe dhe paraqesin sfida me të cilat ballafaqohet njerëzimi, prandaj vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërmarrja e masave, veprimeve dhe aktiviteteve për parandalimin e tyre është një nga prioritetet e Komunës së Kaçanikut

**"Vlerësimi i rrezikshmërisë nënkupton analizën sasiore dhe cilësore të fatkeqësive të shkaktuara nga fenomenet natyrore, proceset teknologjike dhe rrethanat e caktuara tjera për dukuritë e mundshme nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera"**

-Fatkeqësitë nuk zgjedhin kohën as vendin se ku do të ndodhin. Andaj të gjithë jemi të kërcënuar nga rreziqet e ndryshme që i kërcënojnë interesat e sigurisë në çdo kohë dhe në çdo vend.
Si çdo pjesë e Kosovës edhe komuna e Kaçanikut mund të ballafaqohet me fatkeqësitë natyrore.

- Bazuar në historikun e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, Komuna e Kaçanikut në të kaluarën ka pasur shkatërrime dhe humbje të jetës së njerëzve, të mirave materiale, trashëgimisë kulturore dhe ambientit. Me qëllim të ngritjes së vetëdijes qytetare, ngritjes së kapaciteteve për mbrojtje dhe shpëtim, masave parandaluese, zhvillimin e programeve për një jetë më kualitative dhe më të sigurt, hartohet dokumenti i vlerësimit të rrezikshmërisë.

- Rreziku nga fatkeqësitë natyrore ndër të tjera paraqet një përjetim të humbjes apo dëmit i cili mund të shfaqet në cilin do vend dhe në çfarëdo kohë, intensiteti i të cilit mund të jetë i kufizuar apo me përmasa tragjike, prandaj, parandalimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera nënkupton zvogëlimin/lehtësimin e rreziqeve, masat parandaluese, ngritjen e nivelit të gatishmërisë dhe kapaciteteve të nevojshme, për të ndërmarrë veprimet e duhura në situata emergjente.

Ky dokument është bazë për hartimin e planeve të reagimit emergjent, planeve operative dhe planeve tjera sipas legjislacionit në fuqi.

Komuna e Kaçanikut, bazuar në misionin, detyrat, përgjegjësitë si dhe në Rregulloren (QRK) Nr. 25/2020 për Metodologjinë e Hartimit të **Vlerësimit të Rrezikshmërisë** në bashkëpunim me institucionet qendrore, lokale, OJQ-të, si dhe palët tjera të interesit, ka hartuar draft/dokumentin: Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, përmes të cilës synon identifikimin, vlerësimin dhe ndërmarrjen e masave parandaluese dhe zbutjen-zvogëlimin e tyre.

Komuna e Kaçanikut është përgjegjëse për organizimin e Mbrojtjes dhe Shpëtimit nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera në kufijtë territorial të përgjegjësisë së saj, si pjesë e sistemit unik të emergjencave civile në Kosovë i cili përmban planifikimin, organizimin, aftësimin, koordinimin, realizimin, mbikëqyrjen dhe financimin e të gjitha masave dhe aktiviteteve për Mbrojtje dhe Shpëtim brenda juridiksionit komunal.

***Dokumenti i vlerësimit të rrezikshmërisë duhet të rishikohet sipas rregullores në fuqi çdo tri vite e në raste sepcifike edhe më herët.***

## MISIONI DHE SYNIMI I VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË

Mënyra më e mirë për tu mbrojtur për situata të tilla është Vlerësimi, Planifikimi dhe Programimi i veprimit të menduar për emergjenca, duke udhëzuar kur veprimet emergjente janë të nevojshme.

Hartimi i Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë konsiston në identifikimin, analizimin, vlerësimin, strukturimin dhe arkivimin e informatave nga të gjitha subjektet juridike pjesëmarrëse dhe reaguese ndaj situatave emergjente në komunë, me qëllim të:

a. Hartimit të planeve të reagimit emergjent, planeve operative dhe planeve tjera përkatëse sipas legjislacioneve në fuqi;
b. Profilizimit dhe standardizimit të masave parandaluese dhe veprimeve konkrete për zvogëlimin, zbutjen dhe sanimin e pasojave të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
c. Caktimit të shkallës së cenueshmërisë (vatrave potenciale të rrezikut sipas shkallës së rrezikshmërisë), përcaktimit të moduleve vlerësuese për situatat e krijuara emergjente si dhe koordinimit të resurseve humane dhe teknike, të cilat do të përfshihen si përgjigje adekuate në situatat emergjente;

Vlerësimi i rrezikut nënkupton procesin e analizimit, vlerësimit dhe konkluzioneve të cilat inkorporohen në hartimin e planeve dhe strategjive afatshkurtra dhe afatgjate, me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve nga FNFT, realizimin e projekteve konkrete dhe menaxhimin e situatave emergjente me të cilat mund të përballet komuna.

## INFRASTRUKTURA LIGJORE

Hartimi i "Vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera ", për territorin e komunës së Kaçanikut", është i bazuar në ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, si dokument bazë për hartimin e planeve të reagimit emergjent dhe planeve tjera**.**

Vlerësimi i Rrezikshmërisë për territorin e komunës së Kaçanikut është dokument me karakter lokal, hartimi i të cilit është i bazuar në:

1. "Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera" Nr. 04/L-027;
2. Rregullorja për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë nga FNFT, Nr. 25/2020
3. Statutin e Komunës së Kaçanikut

# KREU I –rë

# PROFILI I KOMUNËS SË KAÇANIKUT

Komuna e Kaçanikut përfshin një sipërfaqe prej 211.40 kilometra katrorë.
Komuna e Kaçanikut shtrihet në pjesën jugore të Kosovës. Kufizohet me komunat: në veri, Ferizajin në verilindje, Vitinë në perëndim Shtërpcën dhe në jug Hanin e Elezit.
Territori i Komunës së Kaçanikut shtrihet rreth koordinantave gjeografike: 42°13 N të gjerësisë gjeografike veriore dhe 21° 15 E të gjatësisë gjeografike lindore.

***Harta 1:*** *Pozita e komunës së Kaçanikut në Kosovë,* ***aneksi i hartave.***

## 1. Pozita, karakteristikat gjeografike dhe klimatike të komunës së Kaçanikut

### 1.1.Zona e përgjegjësisë (përkufizimi hapësinor)

Komuna e Kaçanikut shtrihet në pjesën jugore të Kosovës. Kufizohet me komunat Ferizaj në veri, Vitinë në verilindje, Shtërpcën në perëndim dhe Hanin e Elezit në jug. Mirëpo kjo komunë edhe pse nuk përfshin ekstremin jugor kufizohet edhe me Maqedoninë e Veiut në juglindje e në perëndim.
Në këtë pjesë kufiri tërësisht ka karakter malor. Me komunën e Hanit të Elezit gjatësia e kufirit, ka shtrirje jugperëndim dhe kalon nëpër terren të theksuar malorë duke u kufizuar me Republikën e Maqedonisë së Veriut, këtu ndodhet kalimi kufitar Glloboçica dhe me tutje ngritët në malet e Sharrit deri te Maja e Lybetenit.
Me komunën e Vitisë gjatësia e kufirit ka drejtim jugor dhe juglindor. Nga kjo pikë kufiri komunal njëkohësisht është edhe kufi shtetëror, me drejtim të shtrirjes kah jugperëndimi (shih tabelën).

| Kufizimi me komunën, shtetin | Gjatësia e kufirtit (km) | Përqindja (%) |
|---|---|---|
| **Ferizaj** | 20,05 | **19.77** |
| **Vitia** | 27,10 | **26.72** |
| **Maqedonia JL** | 6,62 | **6,52** |
| **Hani i Elezit** | 23,34 | **23,00** |
| **Maqedonia JP** | 11,42 | **11,26** |
| **Shtërpca** | 12,88 | **12.74** |
| **Gjithsej** | **101.41** | **100** |

**Tabela 1:.** Gjatësia e vijës kufitare në komunën e Kaçanikut

Me komunën e Shtërpcës kufizohet në anën perëndimore, kalon tërësisht në terren malore dhe mund të thuhet se kjo pjesë ka lartësinë më te madhe mbidetare.
Largësia nga Prishtina është 58 km, nga Ferizaji 21 km, Gjilani 45 km dhe me Shkupin e ndan distanca 30 km. Pozita e qendrës komunale ndaj vendbanimeve të komunës është pjesërisht e mirë ngase ndodhet pothuajse në qendër të sipërfaqes dhe nuk i ndajnë distanca të largëta.

Relievi është njëri prej komponentëve më të rëndësishëm fiziko-gjeografik të çdo hapësire. Ndikimi i tij kushtëzon edhe faktorët tjerë natyrorë siç janë: klima, ujërat, tokat, vegjetacioni etj.,
Pikënisja e bazamentit strukturor të territorit të Kaçanikut lidhët me ngritjet periferike të maleve të Sharrit, Jezercit në jugperëndim - veriperëndim dhe të maleve të Karadakut në anën lindore, si dhe uljes se vazhdueshme të strukturës grabenore të fushëgropës së Kosovës në anën veriore.
Shpatet lindore të maleve të Sharrit të cilat shtrihen në pjesën jugperëndimore të territorit të Kaçanikut karakterizohen me pjerrtësi relativisht të madhe dhe me vlera të copëtimit vertikal dhe horizontal, mesatare deri të larta të relievit
Në këtë pjesë shtrihet edhe lartësia më e mëdha relievore maja e Lubotenit (2496m).
Në pjesën lindore të territorit të komunës së Kaçanikut shtrihet mali i Karadakut i cili karakterizohet me shtrirje JP-VL. Kryesisht karakterizohet si tërësi morfologjike kodrinoro-malore dhe malore me lartësi ma të madhe brenda këtij territori 1280m në majën e Blinajës në pjesën juglindore të Kaçanikut. Relievi karakterizohet me vlera deri mesatare të copëtimit vertikal dhe horizontal të cilat i kanë kushtëzuar rrjedhat e përroskave (përroi i Runjevës, përroi i Rakocit dhe përroi i Lakuar).

## 1.2. Sipërfaqja e përgjithshme e komunës së Kaçanikut

Gjatësia e vijës totale kufitare është 101.41km dhe sipërfaqe prej 211.40 km² (1.94%) nga territori i përgjithshëm i Kosovës, në të jetojnë 27,716 banorë ( Sipas regjistrimit të vitit 2024).
Teritorin e komunës së Kaçanikut e përshkojnë lumi “Lepenc”dhe lumi “Nerodime” largësia nga Prishtina është 58km nga Ferizaji 21 km, Gjilani 45 km dhe me Shkupin e ndan distanca 30 km..

Duke pas parasysh shtrirjen gjeografike, relievin, lartësinë mbidetare, etj. mund të thuhet që Komuna e Kaçanikut ka një pozitë të favorshme gjeografike nga se këto komponente natyrore dhe shoqërore janë shumë të rëndësishëm në çdo hapësirë. Komuna e Kaçanikut është mjaft komunikative, pasi ajo me të gjitha komunat fqinje lidhet nëpërmjet rrugëve automobilistike, dhe hekurudhore të cilat ndjekin kryesisht korridoret dhe kalimet natyrore .

Relievi është njëri prej komponentëve më të rëndësishëm fiziko-gjeografik të çdo hapësire. Ndikimi i tij kushtëzon edhe faktorët tjerë natyrorë siç janë: klima, ujërat, tokat, vegjetacioni etj.,
Pikënisja e bazamentit strukturor të territorit të Kaçanikut lidhët me ngritjet periferike të maleve të Sharrit, Jezercit në jugperëndim - veriperëndim dhe të maleve të Karadakut në anën lindore, si dhe uljes se vazhdueshme të strukturës grabenore të fushëgropës së Kosovës në anën veriore.
Shpatet lindore të maleve të Sharrit të cilat shtrihen në pjesën jugperëndimore të territorit të Kaçanikut karakterizohen me pjerrtësi relativisht të madhe dhe me vlera të copëtimit vertikal dhe horizontal, mesatare deri të larta të relievit

Në pjesën lindore të territorit të komunës së Kaçanikut shtrihet mali i Karadakut i cili karakterizohet me shtrirje JP-VL. Kryesisht karakterizohet si tërësi morfologjike kodrinoro-malore dhe malore me lartësi ma të madhe brenda këtij territori 1280m në majën e Blinajës në pjesën juglindore të Kaçanikut. Relievi karakterizohet me vlera deri mesatare të copëtimit vertikal dhe horizontal të cilat i kanë kushtëzuar rrjedhat e përroskave (përroi i Runjevës, përroi i Rakocit dhe përroi i Lakuar

Ndërsa me rregulloren për “**Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Kaçanikut " 01.nr. 60/01-36408/19** është bërë rregullimi dhe ndarja e vendbanimeve të komunës si në vijim:

| Nr. | Zona | Këshillat e qendrës urbane, fshatrave dhe vendbanimeve |
|---|---|---|
| 1 | Zona 1 | Këshilli i qendrës urbane zona I dhe; |
| 2 | Zona 2 | Këshilli i qendrës urbane zona II; |
| 3 | Zona 3 | Fshati Bob; |
| 4 | Zona 4 | Fshati Dërnagllavë, Korbliq dhe Llanishtë; |
| 5 | Zona 5 | Fshati Runjevë dhe Stagovë; |
| 6 | Zona 6 | Fshati Kaçanik i Vjetër; |
| 7 | Zona 7 | Fshati Begracë ; |
| 8 | Zona 8 | Fshati Doganaj dhe Koxhaj; |
| 9 | Zona 9 | Fshati Dubravë, Rekë dhe Vatë ; |
| 10 | Zona 10 | Fshati Duraj dhe Gërlicë e Epërme; |
| 11 | Zona 11 | Fshati Elezaj dhe Gabrricë; |
| 12 | Zona 12 | Fshati Bajnicë dhe Semajë ; |
| 13 | Zona 13 | Fshati Sllatinë dhe Soponicë ; |
| 14 | Zona 14 | Fshati Kovaçec |
| 15 | Zona 15 | Fshati Biçec; |
| 16 | Zona 16 | Fshati Nikaj; |
| 17 | Zona 17 | Fshati Gajre dhe Ivajë ; |
| 18 | Zona 18 | Fshati Strazhë ; |
| 19 | Zona 19 | Fshati Kotlinë dhe Gjyrgjedell; |
| 20 | Zona 20 | Fshati Glloboqicë; |
| | | Vërejtje : Vija ndarëse ndërmjet zonave urbane është përroi i Rakocit |

**Tabela 2;** Zonat e e përbëra nga Këshillat e qendrës urbane, fshatrave dhe vendbanimeve në territorin e Komunës së Kaçanikut

Kufiri komunal shtrihet në pjesë kryesisht malore, vetëm në pjesën veriore të komunës shtrihet në pjesën jugore të fushëgropës së Kosovës që shtrihet në terren të ulët.
Gjatësia e pikave ekstreme më të largëta në territorin e komunës është 22,34 km në mes fshatrave Sllatinë në perëndim dhe Korbliq në lindje, vijë që gati se përputhet me drejtimin e paralelit. Edhe në drejtim veri-jug, dallimet nuk janë aq të theksuara. Forma e sipërfaqes së komunës nuk ka ndonjë formë të rregullt por është mjaft e thyer.

***Harta 2 :*** *Harta fizike dhe ajo morfologjike e Kosovës* ***aneksi i hartave***
***Harta 3 :*** *Kufizimi dhe gjatësia e vijës kufitare i me komunat fqinje dhe RMV,* ***aneksi i hartave***

**Harta 4:** *Zonat Kadastrale në Komunën e Kaçanikut dhe gjatësia e vijës kufitare* ***aneksi i hartave***

**1.3. Hidrografia- lumenjtë dhe liqenet**
Komuna e Kaçanikut është një prej komunave më të pasura me ujëra sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Lumenjtë e kësaj komunë i takojnë pellgut të lumit Lepenci cili derdhet në Detin (Egje, Detin e Zi). Ujërat si element gjeografik kanë rëndësi për formimin e relievit inicial të kësaj hapësire. Në zonën qendrore të Kaçanikut kalojnë dy lumenj. Në pjesën perëndimore e përshkon lumi **Lepenc** i cili ka një rrjedhje me të shpejt dhe me një erozion vertikal ndërsa në pjesën qendrore të kësaj zone lumi Nerodime i cili ka një rrjedhje më të ngadaltë ku mbizotëron erozioni horizontal.
Territori i komunës së Kaçanikut ka rrjet hidrografik i cili i drenon ujërat në pjesën më të madhe në drejtim të pellgut të Detit Egje dhe një pjesë më e vogël në drejtim te Detit të Zi.

**Lumi Lepenc**
Në territorin e komunës së Kaçanikut kalon lumi Lepenc i rëndësishëm jo vetëm për komunën por për tërë Kosovën. Lumi Lepenci buron në shpatet veriore të malit Sharr te Oshlaku me lartësi mbidetare 2212m,. Lumi Lepenc ka gjatësi rreth 18 km, në territorin e komunës lumi hynë në fshatin Bajnicë (610 m lartësi mbidetare) dhe rrjedh në drejtim lindje-perëndim. Në fshatin Soponicë merr drejtim jugor dhe e lëshon territorin komunal në fshatin Gjyrgjedell (710 m lartësi mbidetare). Ky lumë vetëm me një sektor i takon kësaj komune pjesa tjetër më e madhe rrjedh në komuna dhe shtetet fqinje.
Në komunë lumi Lepenc ka rënie të tërësishme 214m ose rënie mesatare 11,8m/km. Gjerësia e lumit sillet 11 deri 20 m me thellësi mesatare 40 deri 60 cm, maksimale sillet edhe 2 m. Shtratin e ka të ndërtuar nga rëra, zhavorri dhe blloqe të shkëmbinjve që sjell lumi me fuqinë e tij gjatë niveleve të larta. Prurja mesatare e ujit te Lepencit sillet rreth 10,1 m3/s në Han të Elezit paraqet diku 8,2% të ujërave të Kosovës.

Moduli mesatar i prurjes sillet 14,1 l/s/km2 që tregon vlerë mjaft të lartë dhe është karakteristikë për lumenjtë malorë. Kjo vlerë sillet edhe deri në 25 l/s/km2 në viset e larta rreth Lypetenit.
Lumi Lepenc, ka rrjedhje shumë të shpejtë për shkak të terrenit malor nëpër të cilin kalon.
Pjesa perëndimore e zonës së lumit Lepenc ka një rrjedhje më të shpejtë ku mbizotëron erozioni vertikalë. Në këtë lumë derdhen këto përroska:

- Përroi i Kovaçëve - fsh.Soponicë,
- përroi i Dubravës - fsh. Dubravë,
- përroi i Koraçëve - fsh. Kovaçec,
- përroi i Kukajve - fsh. Kukaj,
- përroi i lagjes Çaka - fsh. Bob
- përroi i Kriva Rekës – fsh. Llanishtë

**Lumi Nerodime**

Dega më e rëndësishme e lumit Lepenc është lumi Nerodime i cili buron nga malet e Jezercit dhe gjatë rrjedhjes së tij bashkohet në dalje të qytetit të Kaçanikut me lumin Lepenc. Lumi Nerodime ka gjatësi 8,5 km në territorin komunal me rënie të tërësishme 53m dhe rënie mesatare 6,2 m/km që është dukshëm më e ulët se e lumit Lepenc. Deri në fshatin Stagovë ka karakter të lumit fushorë me rrjedhje të qetë e të ngadalshme. Prej këtij fshati lumi hynë në luginë në terren malorë me elemente të grykës normale duke kaluar nëpër qytetin e Kaçanikut që shpeshherë i ka përmbytur sipërfaqet për rreth brigjeve. Me rregullimin e shtratit në qytet ky problem është evituar.

Lumi Nerodime përshkon gjatësinë prej afër 25 km deri në derdhjen e tij në lumin Lepenc. Kryesisht kalon pjesë të banuara dhe pranë tokës bujqësore, për të vazhduar rrjedhën e tij nëpër qytetin e Kaçanikut, ndërsa në dalje derdhet në lumin Lepenc. Meqenëse ka gjatësi të madhe, përmbledh edhe shumë përroska të cilët janë shumë të shpejtë dhe të rrezikshëm.

Pjesa qendrore e zonës së lumi Nerodime ka një rrjedhje më të ngadaltë ku mbizotëron erozioni horizontal. Në këtë lumë derdhen këto përroska:

- përroi i Runjevës në fsh. Runjevë
- përroi i Rakocit në rrugën “Reshat Shehu”
- përroi i lagjes Tushë në rrugën “Hasan Prishtina"
- përroi i “Gurit të Zi” (Dyzebajrës) në rrugën “Mejdi Dalloshi”

Ujëmbledhësi i këtyre përroskave ka një shtrirje lindore në malet e vjetra të Karadakut, ky ujëmbledhës ndahet nga një relief i rrumbullakosur me një përbërje gjeologjike të përpunuar nga proceset ekzogjene.

**Lumi i Morava e Binçës**

**Morava e Binçës** buron në Malet e Karadakut (Malet e Zeza) në territorin e Maqedonisë në jug të Vitisë e në veri të Shkupit. Ky lum kalon mes fshatit Korbliq që gjendet në lindje të komunës së Kaçanikut., i cili kur të kalon kufirin njihet si Morava e Binçes. Emrin e ka marr nga vendbanimi Binçë.

Morava e Binçës i takon pellgut të Detit të Zi. Bashkohet me Moravën Perëndimore të cilat bashkohen dhe derdhen në Danub e pastaj në Detin e Zi. I tërë pellgu i Moravës së Binçës me degët e saj përfshinë sipërfaqen prej 1.156 km2

Kompania rajonale për furnizim( KRU) me ujë “Bifurkacioni” është autoriteti përgjegjës për mirëmbajtjen dhe për furnizim me ujë të pijshëm për popullatën e komunës së Kaçanikut

Një ndër qëllimet themelore të kompanisë është të siguroj ujë të kualitetit të pijes sipas standardeve te percaktuara nga OBSh.

Kompania rajonale për ujë dhe ujëra të zeza “Bifurkacioni” për mbulimin e zonës gjeografike për të cilën është përgjegjëse shfrytëzon këto pika furnizuese me ujë:

-Burimi: Uji i bardhë Lybeten dhe kapaciteti i burimit 10-12 lit/sec apo 864-1036,80m³ për24 orë,
-Burimi: Reka e Kafegjisë Lybeten dhe kapaciteti i burimit 8-10lit/sec apo 691.20 – 864,00m³ për24 orë.
- Burimi: Burimi i Shtrazës Lybeten dhe kapaciteti i burimit 3-5 lit/sec apo 259,20 – 432,00m³ për 24 orë.
- Burimi “Përroi i Madh 1” dhe kapaciteti i burimit 4-6lit/sec apo 345,60– 518,40m³ për24 orë.
- Burimi “Përroi i Madh 2” dhe kapaciteti i burimit 2-3lit/sec apo 172,80– 259,20m³ për24 orë.

Në përgjithësi rrjeti i ujësjellësit dominon nga materiali PVC -PE, por ka edhe lloje tjera të materialit etj.

| Nr. | Pellgu | S [km²] | Gjatësia në km brenda territorit të Kosovës | Q[m³/s] | q[l/skm²] | Rrjedhja vjetore [miliom m³] | Kahja e rrjedhjes |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Lepenci | 685 | 53 | 8.7 | 12.7 | 307 | Deti Egje |
| 2 | Morava e Binçës | 1.156 | 60 | 6.1 | 4.35 | 330 | Deti i Zi |

**Tabela 3 .** Pellgjet ujëmbledhës, sipërfaqja, gjatësia, sasia rrjedhëse e ujit dhe vend derdhja

***Harta 5.*** *Përrenjtë që rrezikojnë Komunën e Kaçanikut gjatë të reshurave të shiut,* ***aneksi i hartave***

***Harta 6****: Rrjeti Hidrografik i Komunës së Kaçanikut,* ***aneksi i hartave***

## KREU II-të

# 2. DEMOGRAFIA

Numri i popullsisë dhe vendbanimet janë një indikator i rëndësishëm për demografinë. Për të identifikuar numrin e popullsisë kemi shfrytëzuar të dhënat e regjistrimeve të popullsisë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ndër vite. Në Kosovë regjistrimet zyrtare të popullsisë pas luftës së fundit, janë bërë në vitin 2011 dhe në këtë vit/2024

Në komunën e Kaçanikut jetojnë rreth 27.716 banorë sipas regjistrimit 2024., për shkak të migrimit dhe emigrimit të popullsisë numri i banorëve ka shënuar rënje nga 33,409 (regjistrimi 2011) në 27,716 (regjistrimi 2024).

Pasqyrën e popullsisë së Komunës së Kaçanikut, vendbanimet, aspektet gjinore dhe variablat krahasimore si dhe diagramet sipas trendeve dhe zhvillimeve të Komunës së Kaçanikut do ti paraqesim në tabeloret dhe diagramet e mëposhtme:

| Komuna e Kaçanikut | Gjinia | | | Etnia | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | Meshkuj | Femra | Shqiptarë | Serbë | Turq | Boshnjak | Rom | Ashkali | Egjiptas | Goran | Të tjerë |
| | 27 716 | 14035 | 13681 | 27 685 | 6 | 0 | 6 | 5 | 1 | 0 | 0 | 13 |

**Tabela 4 :** *Popullsia e Komunës së Kaçanikut sipas gjinisë dhe etnive 2024*

| | Popullsia | | | | | | Popullsia e aftë për punë | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Komuna e Kaçanikut** | Gjithsej | Meshkuj | Femra | Foshnje 0-4 vjeç | Fëmijë 10-14 | Rinia 15-29 | 15-64 | Meshkuj | Femra | 65+ |
| **Gjithsej** | 27,716 | 14035 | 13681 | 1937 | 2309 | 6648 | 18613 | 9506 | 9107 | 2656 |
| **Urban** | 9,653 | 5,301 | 5,254 | 764 | 876 | 2430 | 6754 | 3250 | 2960 | 932 |
| **Rural** | 18,063 | 8,734 | 8,427 | 1173 | 1433 | 4218 | 11859 | 5852 | 6147 | 1724 |

**Tabela 5:** . Popullsia sipas tipit të vendbanimit, gjinisë dhe kontingjenteve themelore 2024

| Komuna e Kaçanikut Sipërfaqja në km² | Popullsia e vlerësuar 2024 | Shtimi natyror | Bilanci i migrimeve(2024) | Rritja e Përgjithshme (shtimi natyror dhe migrimi) për vitin 2024 | Numri i banorëve në 1 km² |
|---|---|---|---|---|---|
| **211.40km²** | **27,716** | **17.7** | Nuk ka të dhëna nga ASK | Nuk ka tëdhëna nga ASK | **159** |

**Tabela 6:** . Popullsia e komunës së Kaçanikut e vlerësuar për vitin 2024

| | Popullsia e Komunës së Kaçanikut në vite | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Viti** | **1948** | **1953** | **1961** | **1971** | **1981** | **1991** | **2009** | **2011** | **2024** |
| **Numri i popullsisë gjatë viteve** | **12.836** | **14.201** | **15.582** | **18.982** | **24.840** | **30.450** | **38.174** | **33.409** | **27.716** |

**Tabela 7 :** Numri i popullsisë sipas viteve




**Grafiku 1 :** Popullsia e Komunës së Kaçanikut sipas viteve

*Burimi: Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK); Data e botimit: 19.12. 2024*

Në bazë të regjistrimit të fundit, popullsia e komunës është kryesisht e re. Në të dhënat për vitin 2011 dhe vlerësimi për vitin 2024 vërehet mbizotërimi i grupmoshave nën 30 vjet me 47% në vitin 2011 dhe 56% në 2021. Popullsia aktive 15-64 vjet në vitin 2011 përfshinë rreth 60% të banorëve të komunës, që është pak më e ulët se mesatarja e Kosovës prej 65%. Ndërsa, bazuar në vlerësimin e popullsisë për vitin 2024 popullsia aktive është rreth 67.15%.

## 2.1. Kategoritë e banorëve të planifikuar për evakuim

Evakuimi bëhet me qëllim të largimit të popullsisë prej vendeve dhe objekteve të rrezikuara, në objekte dhe vende më pak të rrezikuara.
Evakuimi planifikohet në Komunë nga strukturat komunale, përgjegjëse për Mbrojtje dhe Shpëtim, duke ju përmbajtur Planit Komunal për Evakuim.
Ndër kategoritë potenciale ndaj të cilave duhet të ketë tretman të veçantë gjatë evakuimit në rast të katastrofave dhe fatkeqësive të mëdha natyrore, veçojmë:

- Nënat me fëmijë
- Fëmijë 0 deri në 14 vjeç, janë 7742 banorë (ASK 2024)
- Të moshuarit mbi 70 vjeç, janë 882.banorë. (ASK 2024)
- Personat me nevoja të veçanta 395 banorë. (Hendikos Kaçanik)

| **Kategoritë e pensionistëve në Komunën e Kaçanikut** | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pensionistë kointribues** | Pensione bazë | Pens. e Personave me Aftësi të Kufizuar | FSK | Pens. Invalidor i Punës | Trepça | TMK | Pen. Paraplegjik e Tetraplegjik | Pensione familjare | Kompensime monetare | **Arsimi** | **Totali** |  |
| **803** | **2372** | **388** | **20** | **2** | **0** | **38** | **71** | **87** | **43** | **58** | **4082** |  |

▪

**Tabela 8:** Kategoritë e pensionistëve në Komunën e Kaçanikut

| **Komuna e Kaçanikut** | | **Gjithsej** | **Grup-mosha 0-4** | **5-9** | **10-14** | **15-19** | **20-24** | **25-29** | **30-34** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Gjithsej** | 27,716 | 1937 | 2201 | 2309 | 2251 | 2449 | 1948 | **1881** |
| | **Meshkuj** | 14,035 | 942 | 1142 | 1214 | 1150 | 1297 | 1074 | **1002** |
| | **Femra** | 13,681 | 995 | 1059 | 1095 | 1101 | 1152 | 874 | **879** |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| **35-39** | **40-44** | **45-49** | **50-54** | **55-59** | **60-64** | **65-69** | **70-74** | **75-79** | **80+** |
| **1768** | 1722 | 1808 | 1779 | 1637 | 1370 | 1057 | 720 | 498 | **381** |
| **925** | 889 | 889 | 813 | 788 | 679 | 514 | 329 | 229 | **159** |
| **843** | **883** | **919** | **966** | **849** | **691** | **543** | **391** | **269** | **222** |

**Tabela 9:** Popullsia e Komunës së Kaçanikut sipas grupmoshave

| Punëkërkuesit e regjistruar sipas grupmoshave | | | |
|---|---|---|---|
| **Grup mosha** | **Totali** | Femra | **Meshkuj** |
| 15 – 24 | 4700 | 2253 | **2447** |
| 25 – 39 | 5597 | 2596 | **3001** |
| 40 – 54 | 5309 | 2718 | **2591** |
| 55 + | 5663 | 2965 | **2698** |
| **Totali** | **21269** | **10532** | **10737** |

**Tabela 10:** Punëkërkuesit sipas grupmoshave

| Nacionaliteti | Nr. i familjeve | Nr. Anëtarëve të familjes |
|---|---|---|
| Shqiptar | 5903 | 27685 |
| Turk | 0 | 0 |
| Serb | 0 | 6 |
| Mysliman | 0 | 6 |
| Komuniteti RAE | 1 | 6 |
| Të tjerë | 4 | 13 |
| Gjithsej | 5908 | 27, 716 |

**Tabela 11:** Numri i familjeve dhe anëtarëve sipas nacionalitetit

| Nr. | Fshati | Numri i personave | Nr. | Fshati | Numri i personave |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Bajnicë | **5** | 16 | Kaçanik - Urban. | **139** |
| 2 | Begracë | **24** | 17 | Kaçanik i Vjetër | **38** |
| 3 | Biqec | **22** | 18 | Korbliq | **0** |
| 4 | Bob | **11** | 19 | Kotlinë | **0** |
| 5 | Doganaj | **13** | 20 | Kovaçec | **11** |
| 6 | Drenogllavë | **1** | 21 | Llanishtë | **1** |
| 7 | Dubravë | **16** | 22 | Nikaj | **4** |
| 8 | Duraj | **4** | 23 | Nikoc | **0** |
| 9 | Elezaj | **3** | 24 | Rekë | **3** |
| 10 | Gabricë | **1** | 25 | Runjevë | **14** |
| 11 | Gajre | **6** | 26 | Semajë | **0** |
| 12 | Gërlicë e Epërme | **2** | 27 | Sllatinë | **2** |
| 13 | Glloboçicë | **24** | 28 | Soponicë | **13** |
| 14 | Gjurgjedell | **1** | 29 | Stagovë | **19** |
| 15 | Ivajë | **6** | 30 | Strazhë | **3** |
| | | | 31 | Vatë | **9** |
| | | | | **Nr. Përgjithëshëm** | **395** |

**Tabela 12:** Përsonat me nevoja të veçanta në Komunën e Kaçanikut

*Burimi: shoqata e personave me aftësi të kufizuar "Hendikos" - Kaçanik*

### 2.2. Dendësia e popullsisë

Komuna e Kaçanikut me dendësi mesatare rreth 159 banorë për km², që është pothuaj se e njëjtë me nivelin e Kosovës - 163.2 banorë për km². Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël.

Dendësia më e lartë e popullsisë është në lagjet urbane të qytetit të Kaçanikut, ku mesatarisht jetojnë rreth 857 banorë në një km². Gjithashtu ekzistojnë edhe disa vendbanime të tjera të cilat kanë dendësi të madhe siç janë: Soponica (467 b/km²), Bob (432 b/km²), Duraj - Gabrricë (382 b/km²), Rekë (369 b/km²), Doganaj (327 b/km²), Dubravë - Vatë (321 b/km²). Vendbanimet me shkallë më të vogël të dendësisë së popullsisë janë: Nikoc (1.4 b/km²), Sllatinë (9 b/km²), Korbliq (9.5 b/km²).
Popullsia urbane është 9150 banorë, kurse ajo rurale 18566 banorë. Nëse e analizojmë në përqindje, atëherë Komuna e Kaçanikut ka .33% të popullsisë urbane dhe 67% rurale.

***Harta 7:*** *Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve në Komunën e Kaçanikut,* ***aneksi i hartave***

### 2.2.1. Shpërndarja e familjeve në bazë të grupeve etnike në komunën e Kaçanikut

Komuna e Kaçanikut është njëra ndër komunat që dallohet për strukurë homogjene etnike




**Grafiku:** Përkatësia etnike në Komunën e Kaçanikut - 2024

*Burimi: ASK – dhjetor **2024***

**Struktura e popullsisë sipas gjinisë**
Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe për zhvillimin demografik dhe ekonomik të një vendi, si për të tanishmen ashtu edhe për të ardhmen. Nga kjo strukturë rrjedhin kontingjentet kyçë të popullsisë, që kanë ndikim në zhvillimin demografik dhe socio-ekonomik të një popullate. Në aspektin demografik kjo strukturë ka rëndësi për riprodhimin biologjik sepse krijohet kontingjenti fertil, ndërsa në aspektin socio-ekonomik ndikon në krijimin e kontingjentit të punës.

| Numri i popullsisë | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|
| **27.716** | 14.035 | 13.681 |

**Tabela 13:** Numri i popullsisë së përgjithshme sipas gjinisë dhe moshës në Komunën e Kaçanikut

*Burimi: ASK – dhjetor **2024***

Komuna e Kaçanikut ka popullsi kryesisht të re dhe me bazë të zgjeruar të piramidës sipas moshës, edhe pse në periudhat e fundit kohore vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja. Mosha mesatare e popullsisë është 28.3 vjet, që tregon se kjo komunë ka popullsi shumë të re.
Struktura gjinore e popullsisë po ashtu është karakteristike, me dominim të vogël të popullsisë mashkullore dhe me ndryshime të theksuara të koeficientit të maskulinitetit sipas grup-moshave.
Në përgjithësi grup-moshat e reja të popullsisë (0 deri 24 vjeç) dominojnë dukshëm në popullatën e përgjithshme të komunës, dhe kjo është një indikator mjaft i rëndësishëm që tregon se në të ardhmen do të ketë natalitet të lartë, nga fakti se këto grup-mosha në të ardhmen japin një përqindje të konsiderueshme të popullsisë fertile që konsiderohet si burim i lindshmërisë.
Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Kaçanikut ka karakteristikat e veta me dominim jo të madh të gjinisë mashkullore.

### 2.2.2. Të punësuarit të pa punët dhe pensionistët

Papunësia është një ndër problemet me të cilin më së shumti po përballet shoqëria kosovare. Shkalla e papunësisë në Kosovë është më e larta në rajon. . Sipas vlerësimeve aktuale, në popullsinë aktive në komunë përfshihen gjithsej 10168 persona, që përbën 28% të popullsisë së aftë për punë. Prej këtij numri të popullsisë aktive, 2943 (29%) janë të punësuar, ndërsa 7225 (71%) janë të papunësuar.
Sa i përket raportit gjinor në kuadër të popullsisë aktive, përgjithësisht kjo kategori dominohet prej meshkujve. Në kuadër të numrit e të punësuarve, meshkujt përbëjnë 75%, ndërsa femrat 25%, derisa në kuadër të papunësuarve, meshkujt përbëjnë 60%, ndërsa femrat 40%.
Kjo shkallë e lartë e papunësisë prek më së shumti femrat, të cilat në bazë të të dhënave statistikore të ASK-së 2024, numri i të punësuarave femra, në Komunën e Kaçanikut, arrin diku rreth 25 % nga numri total i të punësuarve.

Sipas regjistrimit të fundit, shkalla e punësimit në Kaçanik është 47.74%, ndërsa në nivel të Kosovës është 55.14%.

| Gjinia | Numri i të punësuarve | % |
|---|---|---|
| **Meshkuj** | 2207 | 75 |
| **Femra** | 736 | 25 |
| **Gjithsej** | 2943 | 100 |

**Tabela 14*:*** Numri i të punësuarve sipas gjinisë

Sipas të dhënave zyrtare, numri i të punësuarve në ndërmarrjet e Komunës së Kaçanikut, janë të paraqitur në tabelën nr. 10

| Nr. | Numri i përgjithshëm të punësuarve në ndërmarrje | 839 | % |
|---|---|---|---|
| **1** | Të punësuarit në sektorin e tregtisë | 305 | 36 |
| **2** | Të punësuarit në aktivitete shërbyese | 134 | 16 |
| **3** | Të punësuarit në bujqësi, transport dhe hoteleri | 200 | 24 |
| **4** | Sektorët tjerë | 200 | 24 |

**Tebela 15:** Numri i të punësuarve në ndërmarrje në Komunën e Kaçanikut

**Familja dhe karakteristikat e sajë**

Sipas të dhënave nga regjistrimi del se madhësia mesatare e familjes në komunën e Kaçanikut është 4.8 anëtar. Në përgjithësi në komunën e Kaçanikut dominojnë familjet me nga 3 dhe 5anëtar si dhe ato me nga 4 dhe 6 anëtar. Gjithashtu kemi edhe numër të konsiderueshëm të familjeve që kanë 6 e më shumë anëtar, ndërsa familjet me 1, 2 dhe 3 anëtar janë shumë pak, që janë rreth 12.4% e të gjitha familjeve në komunë.

| Komuna | Numri i ekonomive familjare | Madhësia mesatare e ekonomive familjare |
|---|---|---|
| **Kaçanik** | **5,908** | **4.8** |

**Tabela 16:** Numri i ekonomive familjare dhe madhësia mesatare

| Komuna | Mosha mesatare | |
|---|---|---|
| | **Burrat** | **Gratë** |
| Kaçanik | **40** | **38** |

**Tabela 17:** Mosha mesatare e gruas dhe burrit 2023

| Komuna | Numri i familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të luftës | | |
|---|---|---|---|
| | **2022** | **2023** | **2024** |
| **Kaçanik** | **244** | **243** | **239** |

**Tabela 18:** Familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (DFIDL)

*Burimi: ASK-Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave – Rezultatet Paraprake korrik 2024*

*Burimi: "Statistikat e mirëqenies sociale në Kosovë 2022, 2023"*

**Fuqia punëtore, punësimi dhe papunësia**

Shkalla e lartë e papunësisë është një nga çështjet më sfiduese në Kosovë, duke qenë një nga sfidat kryesore edhe për komunën e Kaçanikut.

Për ta treguar nivelin e punësimit, në Kosovë merret në shqyrtim popullsia e aftë për punë, përkatësisht grup mosha 15-64 vjeç. Fillimisht bëhet ndarja e popullsisë aktive në dy kategori: popullsia aktive dhe joaktive. Popullsia aktive (fuqia punëtore) përfshinë personat që punojnë dhe ata që në mënyrë aktive kërkojnë punë. Popullsia joaktive përfshinë personat që nuk punojnë dhe që nuk janë duke kërkuar punë (studentët, amviset, pensionistët dhe ata që nuk janë në gjendje për të punuar).

| Komuna Kaçanik | Popullsia e aktive e aftë për punë | Gjithsej të punësuar | Gjithsej Të pa punë | Meshkuj Të punësuar | Meshkuj të pa punë | Femra Të punësuar | Femra Të pa punësuar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **10168** | **2943** | **7225** | **2207** | **1765** | **736** | **1177** |
| **Përqindja %** | 28 | 29 | 71 | 75 | 60 | 25 | 40 |

**Tabela 19:** Numri i popullsisë aktive për punë, të punësuarit dhe të pa punësuarit sipas gjinisë.
*Burimi: "Statistikat e mirëqenies sociale në Kosovë 2022, 2023"*

| Komuna | 2022 | | | 2023 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Familje | Anëtarë | Anëtarë/ familje | Familje | Anëtarë | Anëtarë/ familje |
| **Kaçanik** | 715 | 2992 | 4,18 | 576 | 2417 | 4,20 |

**Tabela20:** Familjet dhe anëtarët e familjeve që kanë përfituar nga ndihma sociale 2022-2023

*Burimi: Statistikat e mirëqenies sociale në Kosovë 2022-2023*

**Burimet kryesore të jetesës**

Duke u bazuar në burimet e të hyrave në komunën e Kaçanikut, shihet se përqindja e të hyrave nga punësimi është shumë i ulët. Po ashtu, niveli i mbështetjes përmes pensioneve dhe skemave sociale është shumë i ulët. Banorët e Kaçanikut janë kryesisht të varur nga të hyrat që vijnë nga persona të tjerë dhe nga remitancat.

| | | Puna (përfshirë punën në prona, biznesit privat ose të biznesit familjar) | Pasuritë e patundshme,investimet, (qira, interesi) | Pensione | Ndihma sociale | Transferet tjera (përfitimet nga papunësia, sëmundjet,pushimi i lehonisë,bursave) | Remitencat (Të ardhurat nga të afërmit nga jashtë vendit) | Mbështetje nga njerëzit e tjerë | Burimet e tjera | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kaçaniku** | Nr. | 7635 | 138 | 2931 | 3186 | 57 | 11610 | 22671 | 6385 | **54613** |
| | *%* | **14** | **0.2** | **5.5** | **5.8** | **0.1** | **21.2** | **41.5** | **11.7** | **100** |

**Tabela 21 :** Burimet kryesore të jetesës - *Burimi: REKOS,*

**Pensionistët**

Numri i pensioneve bazike të moshës në komunën e Kaçanikut ishte 2300 (janar-dhjetor 2023).




**Grafiku:** Numri i pensioneve bazike të moshës në komunën e Kaçanikut

Numri i pensioneve  kontribut-paguese të moshës ishte  813 (janar-dhjetor 2023 ).




**Grafiku:** Numri i pensioneve  kontribut-paguese të moshës ishte  813 (janar-dhjetor 2023

Numri i familje nga skema për fëmijët  me aftësi të kufizuara (mosha 18- 65) ishte 384 (janar-dhjetor 2023 ).




**Grafiku:** Numri i familje nga skema për fëmijët  me aftësi të kufizuara (mosha 18- 65)

Numri i familje nga skema për fëmijët  me aftësi të kufizuara (mosha 1- 18) ishte 64 (janar-dhjetor 2023 ).




**Grafiku:** Numri i familje nga skema për fëmijët  me aftësi të kufizuara (mosha 1- 18) 64 (janar-dhjetor 2023 ).

Numri i anëtarëve, të  familjeve të cilët kanë përfituar nga skema sociale ishte 2404 (janar-dhjetor 2023 ).




**Grafiku:** Numri i anëtarëve, të  familjeve të cilët kanë përfituar nga skema sociale  (janar-dhjetor 2023 ).

## 2.3 Arsimi

Procesi edukativo-arsimor në komunën e Kaçanikut zhvillohet në objekte arsimore (çerdhe, objekte shkollore të ndërtuara në komunën e Kaçanikut dhe atë në disa nivele, siç janë: niveli parashkollor në 1 çerdhe, fillor dhe i mesëm i ultë në 12 shkolla në funksion në 14 objekte shkollore , i mesëm i lartë, gjimnaze dhe profesionale në 2 shkolla në funksion, me gjithësej 2 objekte shkollore, që nënkupton edhe stafin edukativo-arsimor prej 522 mësimdhënësve, ndërsa të dhënat statistikore janë paraqitur në tabelat në vijim. Ndërsa shpërndarja e objekteve ( ndërtesave) shkollore në tabela dhe harta. Me shkallë emergjente janë të pajisura 2 ndërtesa të shkollave në arsimin parauniversitar me etazhitet më shumë se një kat .

Struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Kaçanikut është e organizuar ne katër nivele: arsimin parashkollor (5 - 6 vjeçar), arsimin fillor ( I – V ), arsimin e mesëm të ulët (VI – IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (X – XII).

Në procesin edukativo-arsimor janë të angazhuar 559 punëtor. Prej tyre 474 mësimdhënës 22 punëtor administrativ, 63 punëtor teknik dhe nxënës 5433.

**1.a**. Në Qendrën për Edukimin dhe Arsimin Parashkollor (QEAP) me qëndrim tërë ditor zhvillohet edukimi dhe arsimi për fëmijët e moshës nga 9 muaj deri në 6 vjeç. Aktivitetet në këtë qendër edukimi bëhen në grupe: Grupi 9 muajsh deri në 2 vjeç, 2 -3 vjeç, 3 – 4 vjeç, 4 – 5 vjeç dhe 5- 6 vjeç. Objekti është i ri (është përuruar më 20 dhjetor 2019) dhe bashkëkohor me hapësirë të mjaftueshme, ndërkaq plotëson të gjitha nevojat për zhvillimin normal të aktiviteteve për fëmijë të këtyre grup moshave. Një dhomë mësimi/dhomë qëndrimi ka sipërfaqe prej 86 metra katrorë, ndërsa sipërfaqja e përgjithshme e objektit është 1700 metra katror.

**1.b**. Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët (i obliguar) - në tërë territorin e komunës mësimet i ndjekin rreth 5433 nxënës.

Pjesa dërmuese e vendbanimeve mësimin e zhvillojnë në një dhe dy turne, përjashtim bënë shkolla e Kaçanikut në të cilën mësimi zhvillohet në 3 turne.

**1.c**. Arsimi i mesëm i lartë - përfshin tri dhe katër vite të shkollimit për nxënësit e grup-moshës 15 deri 18 vjeç. Në këtë komunë janë dy shkolla të mesme Gjimnazi "Skënderbeu" dhe Shkolla e Mesme Profesionale"F Guri" dhe "Vllëzërit Çaka" me disa drejtime të ndryshme, dhe gjenden në zonën urbane. Në këto shkolla numri i nxënësve që i ndjekin mësimet është 965 nxënës, me një kuadër të mësimdhënësve prej 86 që janë të angazhuar në procesin edukativo-arsimor.

| Nr. | Shkolllat | Emërtimi i shkollës | Vendi |
|---|---|---|---|
| **1** | SHFMU | "Emin Duraku" | Kaçanik ( paralelet e ndara Dushkajë dhe Runjevë) |
| **2** | SHFMU | "Idriz Seferi" | Bob ( paralelet e ndara Kovaçec – Gajre) |
| **3** | SHFMU | "Jusuf Gërvalla" | Biçec ( paralelen e ndarë në Nikaj) |
| **4** | SHFMU | "Kadri Zeka" | Dubravë (me paralelet e ndara në Vatë e Provoli) |
| **5** | SHFMU | "Ali Asllani" | Doganaj |
| **6** | SHFMU | "Nazmi Osmani" | Elezaj ( me paralelen e ndarë në Bajnicë) |
| **7** | SHFMU | "Qamil Ilazi" | Kaçanik i Vjetër (me paralelen e ndarë në Fushë të Pajtimit) |
| **8** | SHFMU | "7 Shtatori" | Begracë |
| **9** | SHFMU | "Agim Bajrami" | Stagovë |
| **10** | SHFMU | " Gafurr Luma" | Glloboçicë |
| **11** | SHFMU | "Dituria" | Ivajë ( me paralelen e ndarë në Strazhë) |
| **12** | QEAP | "Agimi" | Kaçanik |
| **13** | AML | "Skenderbeu" | Kaçanik |
| **14** | IAAP | "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" | Bob |

**Tabela 22:** Numri i institucioneve në arsimin parauniversitar në komunën e Kaçanikut 2023-2024

| Numri i nxënësve sipas klasave dhe sipas shkollave në vitin shkollor 2023-2024 | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | | **Para f. 0** | **Kl. 1** | **Kl. 2** | **Kl. 3** | **Kl. 4** | **Kl. 5** | **Kl. 6** | **Kl. 7** | **Kl. 8** | **Kl. 9** | **Kl. 10** | **Kl. 11** | **Kl. 12** | **Gjithsej** |
| **1** | **QEAP "Agimi"** | 27 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 27 |
| **2** | **SHFMU "Emin Duraku"** | 115 | 137 | 164 | 149 | 153 | 151 | 145 | 145 | 165 | 136 | 0 | 0 | 0 | 1460 |
| **3** | **SHFMU "Idriz Seferi"** | 36 | 56 | 52 | 54 | 55 | 50 | 43 | 64 | 45 | 43 | 0 | 0 | 0 | 498 |
| **4** | **SHFMU "Kadri Zeka"** | 32 | 52 | 37 | 48 | 49 | 51 | 50 | 38 | 37 | 43 | 0 | 0 | 0 | 437 |
| **5** | **SHFMU "Nazmi Osmani"** | 32 | 36 | 47 | 30 | 25 | 32 | 37 | 30 | 36 | 29 | 0 | 0 | 0 | 334 |
| **6** | **SHFMU "Jusuf Gërvalla"** | 23 | 40 | 36 | 35 | 31 | 36 | 36 | 21 | 29 | 28 | 0 | 0 | 0 | 315 |
| **7** | **SHFMU "Qamil Ilazi"** | 42 | 55 | 49 | 28 | 42 | 34 | 55 | 50 | 47 | 46 | 0 | 0 | 0 | 448 |
| **8** | **SHFMU "Ali Asllani"** | 23 | 21 | 28 | 34 | 20 | 34 | 27 | 33 | 38 | 39 | 0 | 0 | 0 | 297 |
| **9** | **SHFMU "7 Shtatori"** | 18 | 26 | 28 | 31 | 25 | 23 | 36 | 29 | 38 | 27 | 0 | 0 | 0 | 281 |
| **10** | **SHFMU "Agim Bajrmi"** | 19 | 22 | 13 | 19 | 19 | 19 | 16 | 17 | 16 | 15 | 0 | 0 | 0 | 175 |
| **11** | **SHFMU "Dituria"** | 4 | 3 | 6 | 3 | 12 | 7 | 9 | 8 | 5 | 11 | 0 | 0 | 0 | 68 |
| **12** | **SHFMU "Gafur Luma"** | 7 | 10 | 7 | 11 | 13 | 17 | 13 | 13 | 17 | 20 | 0 | 0 | 0 | 128 |
| **13** | **Gjimnazi "Skënderbeu"** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 173 | 186 | 202 | 561 |
| **14** | **SHMP "F.Guri dhe V.Çaka"** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 159 | 150 | 95 | 404 |
| **Gjithsej** | | 378 | 458 | 467 | 442 | 444 | 454 | 467 | 448 | 473 | 437 | 332 | 336 | 297 | 5433 |

| | |
|---|---|
| **Klasa 1-5** | 2265 |
| **Klasa 6-9** | 1825 |
| **Klasa 10-12** | 965 |
| **Klasa 1-9** | 4090 |
| **Klasa 1-12** | 5055 |
| Parafillor | 378 |
| | **5433** |

**Tabela 23:** Numri i nxënësve sipas klasave dhe sipas shkollave në vitin shkollor 2023-2024

| Stafi mësimdhënës, Administrativ,Teknik dhe ndihmës për vitin 2024- gusht 2024 (sipas listës së pagave) | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | | Numri I mësimdhënësve arsim special | Numri I mësimdhënësve arsim parafillor | Numri I mësimdhënësve arsim fillor | Numri I mësimdhënësve të sh.mesme | Totali mësimdhënës | Numri I personelit administrativ për parafillor | Numri I personelit teknik ndihmës për parafillor | Numri I personelit administrativ për sh.fillore | Numri I personelit teknik ndihmës për sh.fillore | Numri I personelit administrativ për sh.mesme | Numri I personelit teknik ndihmës për sh. Mesme | Shërbimi profesional Pedagogjik/Psikologjik | Total staf Profesional,Administrativ dhe ndihmës | **Total staf në Arsim** |
| **1** | **QEAP "Agimi"** | 1 | 13 | 0 | 0 | **14** | 1 | 5 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **6** | **20** |
| **2** | **SH.F "Emin Duraku"** | 6 | 6 | 74 | 0 | **86** | 0 | 0 | 4 | 14 | 0 | 0 | 3 | **21** | **106** |
| **3** | **SH.F "Idriz Seferi"** | 1 | 2 | 40 | 0 | **43** | 0 | 0 | 2 | 4 | 0 | 0 | 1 | **7** | **50** |
| **4** | **SH.F "Kadri Zeka"** | 1 | 2 | 34 | 0 | **37** | 0 | 0 | 2 | 6 | 0 | 0 | 1 | **9** | **45** |
| **5** | **SH.F "Nazmi Osmani"** | 2 | 2 | 27 | 0 | **31** | 0 | 0 | 1 | 5 | 0 | 0 | 1 | **7** | **39** |
| **6** | **SH.F "Jusuf Gërvalla"** | 0 | 2 | 24 | 0 | **26** | 0 | 0 | 1 | 4 | 0 | 0 | 0 | **5** | **31** |
| **7** | **SH.F "Qamil Ilazi"** | 1 | 1 | 27 | 0 | **29** | 0 | 0 | 1 | 3 | 0 | 0 | 2 | **6** | **33** |
| **8** | **SH.F "Ali Asllani"** | 0 | 1 | 23 | 0 | **24** | 0 | 0 | 1 | 4 | 0 | 0 | 0 | **5** | **28** |
| **9** | **SH.F "7 Shtatori"** | 0 | 2 | 17 | 0 | **19** | 0 | 0 | 2 | 3 | 0 | 0 | 0 | **5** | **24** |
| **10** | **SH.F "Agim Bajrmi"** | 0 | 1 | 10 | 0 | **11** | 0 | 0 | 1 | 2 | 0 | 0 | 0 | **3** | **14** |
| **11** | **SH.F "Dituria"** | 0 | 0 | 14 | 0 | **14** | 0 | 0 | 1 | 2 | 0 | 0 | 0 | **3** | **17** |
| **12** | **SH.F "G. Luma"** | 1 | 1 | 11 | 0 | **13** | 0 | 0 | 1 | 2 | 0 | 0 | 0 | **3** | **17** |
| **13** | **GJIMNAZI "Skënderbeu"** | 0 | 0 | 0 | 38 | **37** | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 4 | 1 | **7** | **44** |
| **14** | **SHMP "F.Guri dhe V.Çaka"** | 0 | 0 | 0 | 48 | **48** | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 5 | 1 | **8** | **54** |
| | **Totali** | **13** | **33** | **301** | **86** | **432** | **1** | **5** | **17** | **49** | **4** | **9** | **10** | **95** | **522** |

**Tabela 24:** Stafi mësimdhënës, Administrativ,Teknik dhe ndihmës për vitin 2024- gusht 2024

*Burimi: Drejtoria e arsimit- Kaçanik*




**Grafikoni :** Grafiku i nxënësve parauniversitarsipas gjinive në Komunë e Kaçanikut 2023 -2024




**Grafikoni :** Përkatësia gjinore e mësimdhënësve e shprehur në përqindje

Bazuar në gjendjen fizike të objekteve shkollore, mundë të konstatojmë se rrjeti i shkollave të nivelit AF, AMU dhe AML është në nivel të kënaqshëm dhe ekzistojnë kushte relativisht të mira për zhvillimin normal të procesit mësimor, me përjashtim të objektit të vjetër të Shkollës fillore “Emin Duraku” në Kaçanik dhe shkollës në Doganaj. Të dy këto objekte shkollore janë shumë të vjetëruara dhe të dëmtuara, ndërkohë që nuk plotësojnë kushtet minimale për zhvillimin e procesit mësimor.

Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Doganaj, i filluar në vitin 2019, sipas kontratës është dashtë të përfundoj më 2022 dhe tani më ka kaluar afatet kohore të planifikuara, ndërkohë DKA, është duke bërë përpjekje të pareshtura për të siguruar investimet e nevojshme për ndërtimin e objektit të ri shkollor, në shkollën e qytetit, përkatësisht objektit të SHFMU "Emin Duraku" në Kaçanik.
Paralelja e ndarë e shkollës fillore "Emin Duraku"në Dushkajë është ndërtuar në vitin 2014 në një terren ku përbërja pedologjike e tokës nuk i plotëson kushtet për ndërtim, edhe pse janë marrë masat për stabilizimin e tokës me ndërhyrje inxhinjerike, ende paraqet rrezik për rrëshqitje të tokës duke rrezikuar nxënësit dhe objektin shkollor.

*Burimi i të dhënave DKA –Kaçanik*

### 2.3.1. Identifikimi i rreziqeve

Ekzistojnë mbi 14 objekte shkollore të frekuentuara në arsimin parauniversitar të cilave ju mungojnë shkallët emergjente për evakuim të nxënësve, ku në raste të fatkeqësive natyrore apo fatkeqësive tjera, duke mos anashkaluar edhe shkollat- paralele të ndara që janë mbi 10 objekte, ku mungojnë edhe shenjëzimet themelore informuese për nxënësit dhe mësimdhënësit, në rast të çfaqjes së nevojës për evakuim emergjent, ku mungojnë pajisjet për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësi tjera si dhe edukimi bazik për reagim emergjent.

### 2.3.2. Rekomandime :

Për zvogëlimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera si zjarri, vërshimet, rrëshqitjet e dheut etj. në objektet arsimore rekomandohet që të pajisen të gjitha shkollat me:

- Shkallë evakuimi për të gjitha objektet me 2 ose më tepër etazha;

-Pajisja me aparate kundër zjarrit, veshje mbrojtëse dhe vegla tjera për raste të fatkeqësive natyrore;

-Pajisja e objekteve me sinjalistikë për lajmërim të zjarrit dhe fatkeqësi tjera ;

-Pajisja e objekteve me shenjëzime informuese;

-Pajisja me planin e evakuimit për rastet e fatkeqësive, etj. ;

**KREU III-të**

# 3. TË MIRAT MATERIALE, KULTURORE DHE TË MJEDISIT

## 3.1.Trashëgimia kulturore

Territori i Kosovës ka një rezervë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore ndër shekuj, në këtë rast nuk bënë përjashtim as Komuna e Kaçanikut sa i përket trashëgimisë kulturore material dhe jo-materiale.

Në komunën e Kaçanikut ekzistojnë potenciale të rëndësishme të trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale. Në shumëllojshmërinë e vetë, kjo trashëgimi kulturore përfshinë objekte të trashëgimisë arkitekturale, arkeologjike, peizazh kulturor dhe një zonë të veçantë të mbrojtur.

Si në pjesën tjetër të Kosovës, ashtu edhe në qytetin e Kaçanikut trashëgimia kulturore (monumentet e trashëguara) mund të ndahet në tri periudha të ndryshme kohore: bizantine(ortodokse), monumente islamike dhe arkitektura vernakulare (lokacionet tradicionale, tregjet dhe qendrat urbane historike).

Bjeshkët e Kaçanikut, të njohura gjithandej në rajon, janë joshëse për pushime. Ajo që e bënë të veçantë në këtë rrafsh janë:

- Maja e Lybetenit - një kodër me lartësi më të madhe në Kosovë, gjatë stinës së verës e vizitojnë turistë të shumtë nga Kosova e më gjerë për të pushtuar majën e Lybetenit (2496m).
- Gryka e Kaçanikut - i jep një rëndësi historike specifike për mbarë shqiptarët. Aty u zhvilluan beteja vendimtare për çështjen kombëtare dhe me një bukuri natyrore të spikatur, të gjitha këto e bëjnë tërheqëse për shumë vizitor nga Kosova dhe trevat tjera shqiptare.
- Vendshpallja e Kushtetutës së Kosovës - Shtëpia e Kulturës, "Xheladin Kurtaj". Vend ku u shpall Kushtetuta e Republikës së Kosovës në Kaçanik, në vitin 1990. Ky objekt specifik është bërë vend mjaft i frekuentuar për rëndësinë e saj historike për Kosovën dhe mbarë shqiptarët.
- Xhamia e Koxha Sinan pashës e ndërtuar në vitin 1594 e restauruar në vitin 2012 - 2013
- Bjeshkët e Kaçanikut
- Livadhet e Shtrazës
- Kalaja e Kaçanikut e ndërtuar në vitin 1595 e restauruar në vitin 2012 - 2013

Për shkak injorimit të gjatë të trashëgimisë kulturore nga ana e regjimeve të mëhershme ka pësuar degradim të madh, sepse një numër i objekteve të trashëgimisë kulturore janë dëmtuar rëndë, e disa janë shkatërruar në tërësi.

Monumentet kulturo-historike begatojnë resurset e shumta turistike në komunën e Kaçanikut.

Kalaja e ndërtuar në fund të shekullit XVI ( në vitin 1595 ) , në qendër të qytetit, është një eveniment i çmuar që tangjentohet nga dy lumenj, Lepenci dhe Nerodimja, para bashkimit të tyre në dalje të qytetit. Ndër monumentet e vjetra kulturore që ka mbetur edhe sot është xhamia e Kaçanikut e ndërtuar nga veziri i madh Koxha Sinan Pasha në vitin 1594



**Foto 1 :** Kalaja e Kaçanikut



**Foto 2** : Xhamija e Koxha Sinan Pashës

Varrezat e dëshmorëve, te Dardha, dhe shumë pllaka përkujtimore dhe lapidarë në lokalitete të ndryshme të komunës sonë, i takojnë periudhës së pasluftës dhe paraqesin potencial të bollshëm kulturo-historik të komunës sonë.

Komuna e Kaçanikut ka 5 biblioteka publike. Biblioteka kryesore gjendet në Kaçanik dhe ka 20461 libra, gjithashtu ekzistojnë edhe degët e sajë në Stagovë, Doganaj dhe Glloboqicë të cilat kanë 30694 libra. Në objektin e komunës është arkivi i komunës i cili është i mirëmbajtur mirë nga zyrtarët përgjegjës komunal.




**Foto 3:** Vorrezat e Dëshmorëve




**Harta 8 :**Harta e Trashigimisë kulturoren në Komunës së Kaçanikut (Burimi i të dhënave: Komuna e Kaçanikut)

*Burimi: Kaçaniku Vlerë e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore –Komuna Kaçanik 2022*

**Tabela 16:** Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme (2022-2023) – trashëgimia arkeologjike, nënkategoria: lokalitet arkeologjik/monument/(2 të parat)dhe lokalitet arkeologjik rezervat; MKRS

## Trashëgimia arkeologjike

Lista e trashëgimisë arkeologjike përfshinë tërë territorin komunal. Në kuadër të trashëgimisë arkeologjike përfshihen 5 lokalitete arkeologjike/rezervat te cilat janë në listën e MKRS shih tabelën më poshtë. Janë edhe disa lokalitete të rëndësishme që Komuna/ MKRS duhet ti fusin në listë si: lokaliteti i Kalasë antike/ Tophanes si pjesë e Kompleksit të Kalasë së Kaçanikut, rruga e vjetër romake në Gjyrgjedell, etj.

Mbishkrimi i varrit të shek.II të erës sonë, i gjetur në vitet e 80-ta me rastin e ndërtimit të shtëpisë së mallrave në Kaçanik, është një dëshmi e ekzistimit të vendbanimeve në këto anë edhe gjatë kohës antike. Po ashtu në Dushkajë gjatë ndërtimit të rrugës është gjetur pllaka me portretin e kalorësit. Këto pllaka tani gjenden të ekspozuara në Shtëpinë e Kulturës në Kaçanik.



**Foto 4:** Pllakat me mbishkrime të varrit të shekullit II të erës sonë të zbuluara në Kaçanik

| Emri | Periudha | Vendi | Nr. unik i bazës së të dhënave |
|---|---|---|---|
| **Monument/Ansambël** | | | |
| **Lokalitet arkeologjik në Soponicë*** | Romake, Antikitet i vonë | Soponicë Kaçanik | **3455** |
| **Lokalitet arkeologjik në Kaçanikun e Vjetër** | Antikë, Mesjetë | Kaçanik i Vjetër, Kaçanik | **3456** |
| **Kalaja e Kaçanikut** | Antike, Antikitet i Vonë, Mesjetë | Kaçanik | **143** |
| **Lokaliteti arkeologjik te kisha në Bob**** | Antikitet i Vonë | Bob, Kaçanik | **643** |
| **Kalaja e Llanishtës** | Antikitet i Vonë | Llanishtë, Kaçanik | **645** |
| ***Lokaliteti arkeologjik në Soponicë ekziston, por që gjurmët nuk mund të vërtetohen ngase janë bërë ndërtime dhe autostrada R6 kalon mbi një pjesë të saj;** | | | |
| ****Lokaliteti arkeologjik te kisha në Bob nuk ekziston sepse në këtë hapësirë është e ndërtuar xhamia e fshatit, objekti shëndetësorë dhe oda e fshatit.** | | | |

**Tabela 25.** Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme (2022-2023) – trashëgimia arkitekturale, nënkategoria: monument/ ansambël; MKRS

**Trashëgimia arkitekturale**

Në kuadër të listës së trashëgimisë arkitekturale përfshihen 19 objekte, një i ndërtuar në shek. XV kurse tjerat të ndërtuara gjatë shekujve XIX dhe XX. Kjo listë përfshinë një shumëllojshmëri objektesh - kulla, shtëpi, dhe objekte fetare që janë të shpërndara përgjatë tërë territorit komunal. Lista e mëposhtme duhet të plotësohet në vitet në vijim me komplekse dhe objekte të luftës së fundit të UÇK-së, objekte/ shtëpi me vlerë etnografike, etj.

| Emri | Periudha | Viti | Statusi | Nr. Unik në databazë |
|---|---|---|---|---|
| **Xhamia e Sinan Pashës (në listë të përhershme)** | 1594 -1995 | Kaçanik | | **3172** |
| **Tyrbja e Musa Kesexhisë** | Shek. XX | Kaçanik | Nuk ekziston | **3172** |
| **Salla e shpalljes së Kushtetutës së Kaçanikut** | 1991 | Kaçanik | | **4158** |
| **Shkolla e vjetër në Kaçanik** | | Kaçanik | Nuk ekziston | **4159** |
| **Shtëpia e Shaip Hysajt në Stagovë** | 1936 | Stagovë, Kaçanik | | **1092** |
| **Xhamia në Begracë** | Shek. XX | Begracë, Kaçanik | | **152** |
| **Oda e Familjës Luzha në Begracë** | Shek. XIX | Begracë, Kaçanik | | **821** |
| **Xhamia në Glloboçicë** | 1830 - 1840 | Glloboçicë, Kaçanik | | **171** |
| **Shtëpia e Enver Lumës** | 1895 | Glloboçicë, Kaçanik | | **4153** |
| **Shtëpia e Minah Lumës** | 1830 | Glloboçicë, Kaçanik | | **4155** |
| **Xhamia në Gurëzi (Shtrazë)** | 1920 | Shtrazë, Kaçanik | | **163** |
| **Xhamia në Kurbali** | Shek. XIX | Kurbali, Kaçanik | | **3568** |
| **Bujtina "Hanxhik" e Kadrie Berishës** | Shek. XIX | Runjevë, Kaçanik | | **4152** |
| **Mulliri i fshatit Biçec** | 1930 | Biçec, Kaçanik | | **4156** |
| **Shtëpia e Rrahim Rizah Rekës** | 1910 | Korbliq, Kaçanik | | **4157** |
| **Shtëpia - kullë e Halit Selmanit – Stagovë** | 1910 – 1920 | Stagovë, Kaçanik | Nuk ekziston | **1067** |
| **Shtëpia - kullë e Xhemajl Brahës** | Shek XIX | Stagovë, Kaçanik | | **1070** |
| **Shtëpia e Ismail Rakës Kaçanik** | | Kaçanik | Propozuar | |
| **Kulla e Hasanit** | | Bob | Propozuar | |

**Tabela 26:** Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme (2022-2023) – trashëgimia arkitekturale, nënkategoria: monument/ ansambël; MKRS

## 3.2. Parqet nacionale

### 3.2.1.Parqet natyrore dhe rezervatet

Parku Kombëtar Malet e Sharrit është një park kombëtar i cili shtrihet në pjesën jugore të Kosovës, në një pjesë të Rajonit të Ferizajit dhe të Rajonit të Prizrenit.

Vija që përshkon kuotat e larta nëpër majat malore të Sharrit përcakton kufirin ndarës, që është pjesë e kufirit ndërshtetëror, në mes të Kosovës dhe të Republikës së Maqedonisë së Veriut . Përmes luginës të lumit Lepenc (Siriniq) lidhet me Fushën e Kosovës ndërsa përmes Luginës së Lumëbardhit të Prizrenit (Sredska) lidhet me Rrafshin e Dukagjinit.[1]

Këto hapësira karakterizohen me lloje të shumta relikte dhe endemike të florës, vegjetacionit dhe faunës. Vlera të trashëgimisë gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrologjike, kulturore, edukativo-arsimore dhe turistike

Në bazë të analizave dhe hulumtimeve të IPH është konstatuar se sipërfaqja e tanishme e parkut nacional „Mali Sharr'' është 22600ha, ndërsa në **Komunën e Kaçanikut propozohen për mbrojtje 2717ha.**

***Harta 9****: Sipërfaqja e Parkut Kombëtar e Malit Sharr në Komunën e Kaçanikut,* ***aneksi i hartave***

### 3.2. 2. Sipërfaqet pyjore

Pyjet në komunën e Kaçanikut kanë sipërfaqe prej **11,909.20 (ha)** ku hyjnë pyjet e dendura dhe ato me intensitet më të ulët ose 58.92% e sipërfaqes se përgjithshme.

Një sasi e madhe e pyjeve të dendura gjendet në shpatet lindore të Maleve të Sharrit në pjesën jugperëndimor dhe veri perëndimore. Brenda territorit të Kaçanikut mund të diferencohen këto njësi morfologjike, malet e Sharrit dhe ato të Jezercit.

Në këtë pjesë shtrihen edhe lartësitë më të mëdha relievore maja e Lubotenit (2496m).

Në pjesën lindore të territorit të Kaçanikut shtrihet mali i Karadakut i cili karakterizohet më shtrirje JP-VL. Kryesisht karakterizohet si tërësi morfologjike kodrinoro-malore dhe malore me lartësi ma të madhe brenda këtij territori 1280m në majën e Blinajës në pjesën juglindore të Kaçanikut.

Pasuri e madhe pyjore shtrihet në perëndim dhe në lindje të komunës, që dallohen me formacione ahu (fagus sylvatica), qarri (quercus cerris), bungu, shkoza (carpinus orientalis), brekia, bliri (tilia kordata), frashëri etj.

| Nr. | Njësitë pyjore | Sipërfaqet pyjore ( ha) | Llojet e drunjëve |
|---|---|---|---|
| | | | |
| 1 | Ahishtë | 2,672.10 | Ah, Shkozë, Pishë |
| 2 | Uji i bardhë | 2,600.40 | Bung, Ah, Shkozë |
| 3 | Bodoshnjak | 2,836.10 | Bung, Ah, Shkozë, Frashër |

**Tabela27:** Sipërfaqet me pyje të dendura

| Nr. | Pronësia e sipërfaqes së pyjeve | Sipërfaqe në ha | Përqindja % |
|---|---|---|---|
| 1 | Pyje në pronësi publike | 8108.60 | 68 |
| 2 | Pyje në pronësi private | 3800.60 | 32 |

**Tabela 28:** Pronësia e Sipërfaqeve me pyje në Komunën e Kaçanikut

Burimi*: të dhënat nga sektori i pylltarisë në komunën e Kaçanikut*

[1] Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës – Instituti për planifikim Hapësinor- "Parku Kombëtar Sharri"

Përhapje kanë edhe tipet tjera që janë të ulëta, lloji i shkurreve si thana (cornus mas ), murrizi (crataegus monogyna), kaça (rosa canina), manaferra e egër (rubus fruticosus), shtogu (sambocus nigra), kulumbria (prunus spicosa), lajthia (corylus avellana), në vise të larta fieri shqiponjë (pteridium aquilinium) etj.
Sa i përket llojit të drurit, dominon ahu, lisi dhe shkoza por ka edhe pishë, frashër, etj.

Degradimet e pyjeve janë dukuri e njëjtë sikur në çdo pjesë të Kosovës e sidomos prerjet ilegale.
Nuk ka të dhëna të sakta lidhur me prerjet ilegale, por në bazë të raportit të Gjendjes së Mjedisit 2006-2007 nga AKMM humbjet llogariten shumë të mëdha. Vetëm nga zjarret komuna ka pas humbje në vlerë ne rreth 150000 euro.
Gjatë viteve të 90-ta pyjet janë shkatërruar shumë si nga pushteti serb poashtu edhe nga keqpërdoruesit e ndryshëm të cilët edhe tani shkatërrojnë pyllin, duke eksploatuar masën drunore për nevoja dhe qëllime të tyre. Si pasojë e këtij eksploatimi, sot kemi me qindra hektarë sipërfaqe të zhveshura që ka pasoja ekologjike të konsiderueshme.

*Burimi i të dhënave Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural*

***Harta 10:*** *Shtrirja e pyjeve në Komunën e Kaçanikut,* ***aneksi i hartave***

| Emërtimi i Sipërfaqes | Lloji I Sipërfaqes | Kultura | Përkatësia Pronësore | Ha |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| Sip.brenda teritorit të Komunës | PYJORE | TË MBULUARA | PUBLIKE | 8108,60 |
| | | | PRIVATE | 3800,60 |
| | | | Σ | **11.909.20** |
| | | TË ZHVESHURA | PUBLIKE | 0 |
| | | | PRIVATE | 0 |
| | | | Σ | |
| | GJITHSEJTË PYJORE | | PUBLIKE | **8108,60** |
| | | | PRIVATE | 3800,60 |
| | BUJQËSORE | ARA | PUBLIKE | 243.03 |
| | | | PRIVATE | 2843.83 |
| | | | Σ | |
| | | LIVADHE | PUBLIKE | 337.29 |
| | | | PRIVATE | 1670.96 |
| | | | Σ | **2008.3** |
| | | KULLOSA | PUBLIKE | 1629.73 |
| | | | PRIVATE | 707.79 |
| | | | Σ | **2367.53** |
| | | KULTURA SHUMËVJEQARE (PA RRETHOJA) | PUBLIKE | 0 |
| | | | PRIVATE | 0 |
| | | | Σ | 0 |
| | | TË TJERA | PUBLIKE | 0 |
| | | | PRIVATE | 0 |
| | | | Σ | 0 |
| | GJITHËSEJTË BUJQËSORE | | PUBLIKE | 580.32 |
| | | | PRIVATE | **4514.79** |
| UJRAT | UJRA RRJEDHËSE | NATYRALE | LUMENJ | 198.29 |
| | | | PËRRENJË | 0 |
| | | | Σ | |
| | | KANALE | | |
| | | | Σ | |
| | UJRA TË QETA (STAGNUESE) | NATYRORE | LI QENE | |
| | | | MOQALE DHE KËNETA | |
| | | | TJERA | |
| | | | | |
| | | | Σ | |
| | | ARTIFICIALE | AKUMULUESE | |
| | | | RETENZIVE | |
| | | | TË TJERA | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | Σ | |
| | | | Σ | |
| SIPËRFAQE TOTALE SIPAS PRONËSISË | | | PUBLIKE | |
| | | | PRIVATE | |
| SIPËRFAQJA TOTALE E KOMUNËS | | | | **18.009.74** |
| SIPËRFAQE NË NËKUADËR TË KUFIJVE TË PËRSHKRUAR | TOKA URBANE | | | |
| | SIPËRFAQE PUBLIKE (rrugë etj.) | | | |
| | OBJEKTE NATYRORE NËN MBRIJTJE TË VEQANTË | | | **2717** |
| | Objekte të rrethuara | | | |
| | OBJEKTE PESHKATARIE (HURDHA) | | | |
| | TË TJERA | | | |

**Tabela 29:** Sipërfaqja e pyjeve në territorit të Komunës së Kaçanikut

### 3.2.3. Zonat e mbrojtura dhe trashëgimia natyrore

Përpos begative të tjera në territorin e Komunës së Kaçanikut gjendet edhe Parku Kombëtar i Malit Sharr, me sipërfaqe **2717 (ha)** që karakterizohet me  lloje të shumta relikte dhe endemike të florës, vegjetacionit dhe faunës.

Trashëgimia natyrore ka një rëndësi të madhe ekonomike, me mundësi të zhvillimit të turizmit që është një faktor me rëndësi për zhvillimin e vendit. Humbja e trashëgimisë natyrore është çështje e rëndësisë jetike për të gjithë.
Komuna e Kaçanikut shquhet me trashëgimi të pasur natyrore. Deri më tani janë të evidentuara 14 zona/monumente të mbrojtura të trashëgimisë natyrore, të shpërndara përgjatë gjithë territorit komunal. Nga ky numër është një (1) park kombëtar, një (1) peizazh i mbrojtur dhe dymbëdhjetë (12) monumente të natyrës. Të gjitha këto të listuara i gjeni në tabelën 30.

| Nr. | Emërtimi i zonës/ objektit | Kategoria | Viti i mbrojtjes | Përshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| **1** | Parku Kombëtar “Sharri” | Park Kombëtar | 1978, 2013 | Karakterizohen me lloje të shumta relikte dhe endemike të florës, vegjetacionit dhe faunës. Vlera të trashëgimisë gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrologjike, kulturore, edukativo-arsimore dhe turistike. |
| **2** | Shpella e Shullanit në Sllatinë | Monument natyror | 2015 | Monument natyror me karakter speleologjik |
| **3** | Humnera në shpatin e Qenares, në Glloboqicë | Monument natyror | 2015 | Monument i natyrës i karakterit speleologjik |
| **4** | Trungu i qarrit, në Kaçanik i Vjetër | Monument natyror | 2015 | Monument i natyrës me karakter botanik |
| **5** | Guri i gjatë në Stagovë | Monument natyror | 2015 | Monument i natyrës i karakterit gjeomorfologjik |
| **6** | Guri i Zi në Llanishtë | Monument natyror | 2015 | Monument i natyrës me karakter botanik |
| **7** | Trungjet e qarrit, në Kaçanik i Vjetër | Monument natyror | 2015 | Monument i natyrës me karakter botanik |
| **8** | Trungu i qarrit në Kovaqec | Monument natyror | 2015 | Monument i natyrës me karakter botanik |
| **9** | Trungjet e bungut në Bob | Monument natyror | 2015 | Monument i natyrës me karakter botanik |
| **10** | Kompleksi i trungjeve të dushkut në Runjevë | Monument natyror | 2015 | Monument i natyrës me karakter botanik |
| **11** | Trungu i shelgut në Kaçanik | Monument natyror | 2015 | Monument i natyrës me karakter botanik |
| **12** | Trungjet e dushkut në Ivajë | Monument natyror | 2015 | Monument i natyrës me karakter botanik |
| **13** | Trungu i qarrit në Kotlinë | Monument natyror | 2015 | Monument i natyrës me karakter botanik |
| **14** | Kompleksi i pishave, në Strazhë | Peizazh i mbrojtur | 2015 | Peizazh me vlera floristike, edukativo, arsimore dhe turistike |
| | | | | |

**Tabela 30:** Lista e zonave të mbrojtura për Komunën e Kaçanikut
Burimi: *Instituti për Mbrojtjen e Natyrës, Zonat e Mbrojtura 2021*

**Fauna** – Përfshin shumë kafshë të rralla dhe të rrezikuara të cilat janë paraqitur në tabelë

| Nr. | Kafshët | Shpezët |
|---|---|---|
| 1 | Ariu i murmë (Ursus arctos), | Shqiponja e malit (Aquila chrysaetos) |
| 2 | Rruqebulli (Lynx lynx), | Thëllëza e malit (Alectoris graeca) |
| 3 | Derri i egër (Sus scrofa), | Gjeli i egër (Tetrao urogallus) |
| 4 | Ujku (Canis lupus) | Skifteri kthetërbardhë (Falco naumanni) |
| 5 | Kaprolli (Capreolus capreolus) | Bufi (Bubo bubo) |
| 6 | Dhia e egër (Rupicapra rupicapra) | Shkaba (Gyps fulvus). |

**Tabela 31:** Kafshët e rralla dhe të rrezikuara në komunën e Kaçanikut

Në teritorin e komunës tonë kafshët më të shpeshta janë të paraqitura në tabelën 32

| Nr. | Kafshët më të shpeshta | Shpezët | Shpezët mishëngrënës | Llojet e Peshqëve |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Lepuri | Korbi | Shqiponjat | Trofta |
| 2 | Ketri | Laraskat | Petritët | Mlyshi |
| 3 | Gjarpëri i ujit (natrix natrix ) | Gurgulleshat | Gjeraqinat | Mrena |
| 4 | Gjarpëri i gurit (vipera ammodites) | Harabelat | Hutat | Mustaku |
| 5 | Bollujca ( tropidonatus natrix), | Qukapikët | | Bërcoku |
| 6 | Kërmilli i vjeshtës (helix pomatia) | Kumriat | | Krapuliqi |
| 7 | Breshka e rëndomtë (testudo bermanni) | Thëllëzat | | |
| 8 | | Lejlekët | | |

**Tabela 32:** Llojet e kafshëve, shpezëve dhe peshqëve në territorin e komunës së Kaçanikut

Peshq nuk ka shumë lloje, përderisa në lumin Lepenc më kryesorët janë trofta e përroskave që jeton në ujëra të shpejta dhe të ftohta, mrena është i shpeshtë në pjesët e ulëta të lumit Lepenc dhe Nerodimes, mustaku i përrenjve, bërcoku, mlyshi, krapuliqi, etj

**Flora** - Shkalla e lartë e biodiversitetit bimor në rajon është rrjedhojë e diversitetit të habitateve, pozicionit gjeografik të rajonit dhe faktorëve historikë të zhvillimit të tij. Për rrjedhojë, këto male janë të pasura me një numër tejet të madh speciesh bimore.

| Nr. | Llojet e drunjëve | Drunjët e ulëta (shkurret) | Bimët mjekësore |
|---|---|---|---|
| 1 | Ahu (fagus sylvatica) | Thana (cornus mas) | çaji i malit (origanum vulgare) |
| 2 | qarri (quercus cerris) | Lajthia lajthia (corylus avellana) | kantarioni (hypercium perforatum) |
| 3 | bungu | murrizi (crataegus monogyna) | kamomili (matricaria chamomila) |
| 4 | shkoza (carpinus orientalis) | kaça (rosa canina) | dredhëza (fragaria vesca ) |
| 5 | Pisha | manaferra e egër (rubus fruticosus) | mjedra, |
| 6 | Shelgu | shtogu (sambocus nigra) | boronica |
| 7 | Verri | kulumbria (prunus spicosa) | Hudhra e egër (Allium ursinum) |

**Tabela 33:** Llojet e drunjëve, shkurreve dhe bimëve në territorin e komunës së Kaçanikut

Në pjesët kodrinore të Komunës dominojnë pyjet me mjaft lloje dhe janë të përziera. Prej drunjëve dallohen pyjet gjetherënëse që janë me shumicë dhe pyjet gjethembajtëse që mbulojnë një pjesë të parkut nacional të malit Sharr dhe një sipërfaqe në pjesën lindore të komunës, në malin e Karadakut.

Në lartësitë mbi 1500 m shtrihen kullotat malore që janë bimë barishtore të ulëta. Edhe pse Hapësira e rrafshët e komunës është e vogël pa drunjë të dendur ku zakonisht rritet shelgu (salix alba) dhe verri në brigje të lumenjve.

*Burimi: Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, 2020-2022*

## 3.3. Bujqësia

### 2.3.1. Zonat e prodhimtarisë bujqësore

Bujqësia është një nga veprimtaritë kyçe në këtë trevë mirëpo, sipas regjistrimit të fundit të ekonomive familjare (2024), vetëm rreth 18.8 % të të punësuarve janë të angazhuar në sektorin e bujqësisë. Bujqësia, në sektorin privat është e zhvilluar kryesisht në formë të bujqësisë familjare, fermave për jetesë dhe tokave të vogla private bujqësore, ku viteve të fundit sektorit të bujqësisë është duke iu kushtuar vëmendje më e shtuar si nga institucionet qeveritare ashtu edhe nga ato komunale, me subvencione, ndërtim të kanaleve për ujitje dhe aplikimit të masave intensive agro-teknike. Pjesa më e madhe e koncentrimit bujqësorë-agrar është në zonat e tokës bujqësore duke rritur prodhimtarin e produkteve të drithërave, pemëve dhe perimeve..

#### 2.3.1.1. Zhvillimi bujqësor dhe rural

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë për Kaçanikun ka rëndësi të veçantë, si në aspektin e përmirësimit të bilancit tregtar, uljes së papunësisë, sigurisë së produkteve ushqimore, mbrojtjes së ambientit dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve në përgjithësi. Si rezultat i mbështetjes se këtij sektori të ardhurat neto në fermë janë rritur ndjeshëm

Tokat e punueshme shfrytëzohen për të siguruar ushqim për njerëz, kafshë dhe për kultivimin e kulturave lavërtare: grurë, misër dhe perime. Sa i përket sektorit të pemëtarisë, Komuna e Kaçanikut ka mbështetur me subvencione ngritjen e plantacioneve që kultivohen: mollë, dardhë, kumbulla, mjedra arra, manaferra, etj. për 24.40 hektarë.

Komuna e Kaçanikut ka mbështetur zhvillimin e ekonomisë bujqësore lokale me ndërtimin e kanaleve për ujitje gjatë vitit 2022-2024 janë ndërtuar 4.450m kanal, si dhe sigurimin e 5.370 m² serra, apo 5.37ha për 896 ekonomi familjare. Kjo mbështetje ka treguar rezultate premtuese në prodhimin e kulturave perimore (tranguj, domate, speca, sallatë e gjelbër, etj.).

| Komuna | Gjithsej | | Sipërfaqja e tokës në përdorim nga ekonomitë familjare | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Ekonomi familjare | Ekonomi familjare qe kane tokë ne pronesi apo ne shfrytezim | Tokë e punueshme (të korrat vjetore) | Serrat | Livadhet (tërfili, bari i përzier, jonxhe etj) | Pemishte | Vreshta | Djerrinë (tokë e pakultivuar për më shumë se 2 vite) | Kullosë | Pyje | Të tjera (oborre shtëpie, hurdha peshqish …) |
| | | | ha | ha | ha | ha | ha | ha | ha | ha | ha |
| **Kaçanik** | **5,908** | **1093** | **410** | **9.30** | **2008** | **31.65** | **0** | **1094.63** | **2367.5** | **12449,05** | **343.97** |

**Tabela 34:** Sipërfaqja e tokës nëpërdorim nga ekonomitë familjare

*Burimi: Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural*

**Harta 11**: *Struktura dhe shpërndarja e tokave në komunën e Kaçanikut*, ***aneksi i hartave***

Viteve të fundit ka filluar përkrahja e fermerëve përmes subvencionimit, ndërsa nevojat për përkrahje janë ende më të mëdha se mundësitë buxhetore.

Prodhimtaria bujqësore është orientuar në: prodhimtarinë bimore, prodhimtarinë blegtorale, shpeztari, dhe bletari.

Në vitin 2020 numri aktual i të punësuarve në ndërmarrje bujqësore është 90, që tregon përgjithësisht për kapacitete të vogla të ndërmarrjeve, dhe strukturim kryesisht familjar.
Edhe pse Kaçaniku është komunë që ofron potencial për zhvillim të bujqësisë, numri i ndërmarrjeve bujqësore është tejet i ulët. Siç u përmend me lartë, numri total i ndërmarrjeve të regjistruara bujqësore përbën vetëm 4% të ndërmarrjeve në komunë.

Sa i përket shpërndarjes hapësinore të tokave bujqësore në komunën e Kaçanikut në vazhdim paraqesim zonat (vendbanimet) me fond më të madh të tokës bujqësore dhe me rendimente të larta siq janë Elezaj, Duraj, Doganaj, Koxhaj, Kaçanik i Vjetër, Begracë Bajnicë, Dubravë, Kovaqec.

### 3.3.2 Ndikimi i prodhimitarisë bujqësore në ekonominë e Komunës

Bujqësia si degë e ekonomisë është bazë e zhvillimit të ekonomisë së Komunës së Kaçanikut. Bazuar në zhvillimet bujqësore të katër viteve paraprake janë identifikuar trendët prodhuese, në bazë të analizave nga të dhënat statistikore lokale, niveli ka lëvizur prej 3.5 t/ha deri në 4.5 t/ha të gruri, te misri prej 5t/ha deri në 6.5 t/ha, që shënon një rritje prej 1-1.5 t/ha, shprehur në % kemi një rritje prej 30%. Llojet që kultivohen më së shumti janë gruri me 52.63 % dhe misri me 38.78%, patate 4.15% dhe perime 4.43%
Kultivimi i foragjereve përfshinë vetëm jonxhën, që kultivohet në gjithsej 60 ha.
Sipërfaqet e kultivuara me perime përfshijnë vetëm 32 ha. Dominojnë sipërfaqet me spec me 40.62%, domate 37.5%, tranguj 3.75 %, qepë 12.5% dhe llojet tjera 5.63%. Vlen të theksohet se kultivimi i perimeve bëhet kryesisht për plotësimin e nevojave familjare, vetëm tepricën e prodhimeve e shesin në tregun lokal, (prodhues komercial kemi në numër shumë të ulët).
Ekzistojn kushte specifike të cilat favorizojnë bujqësinë e këtaj komune për prodhumin e rendimenteve bujqësore të kualitetit të lartë. Prodhimtarija bujqësore është e orjentuar në prodhimtarinë: bimore, blegtorale, shpenztari, bletari, etj.
Komuna e Kaçanikut, me një reliev mjaft heterogjen dhe me një klimë të mesme kontinentale, ofron kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, përkatësisht të degëve të saj: lavërtarisë dhe blegtorisë. Në këto vendbanime mbizotrojnë kulturat dominuese si: drithërat e bardha,gruri, misri, tërshëra si dhe kulturat tjera si: pemët, perimet, etj.
Vlen të theksohet se kultivimi i perimeve bëhet kryesisht për plotësimin e nevojave familjare, vetëm tepricën e prodhimeve e shesin në tregun lokal, (prodhues komercial kemi në numër shumë të ulët).

- Zona Aluviale – e përshtatshme për për kulturat e perimtarisë,
- Zona Humusore – e përshtatshme për kultivimin e bimëve të lavërtarisë,
- Zona Gëlqerore – kondrinore e përshtatshme për kultivimin e pemëtarisë.

Perimet kultivohen shumë pakë kryesisht për nevoja familjare dhe të tregut lokal dhe nuk kanë ndonjë shpërndarje hapësinore specifike.
Kurse, pemët kanë një përqendrim kryesisht të rregullt dhe janë të përqëndruara kryesisht në anën e djathtë të lumit Lepenc apo në shpatet e malit të Sharrit.

*Burimi: Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural*

### 3.3.3. Kultivimi i bimëve një vjeçare (të korrat)

Niveli i prodhimit të drithërave në Kaçanik ka treguar ndryshime viteve të fundit. Statistikat për periudhën 2019 – 2022 tregojnë trend të rritjes dhe zvogëlimit në prodhimin e drithërave, në rastin e grurit kemi zvogëlim nga 4.5 t/ha në vitin 2019 në 4.0 t/ha në vitin 2022, ndërsa në vitin 2024 kemi rritje 4.5 t/ha, në rastin e misrit kemi rritje nga 6.5 t/ha në 7.0 t/ha. Llojet që kanë rendiment më të lartë të prodhimit është misri që pasohet nga gruri.

Në vitin 2022 sipërfaqet e kultivuara me perime përfshijnë 74.2 ha, ku dominojnë patatja me 47.0%, specat me 16.0%, domatja me 12.0%, ndërsa perimet si trangujt, qepët kanë sipërfaqen më të vogël. Sa i përket sasisë së prodhimit statistikat për periudhën 2019 – 2022 tregojnë rritje në rastin e specave nga 50 t/ha në 55 t/ha, domateve nga 70 t/ha në 75 t/ha, patatet nga 35 t/ha në 40 t/ha, domateve në serra nga 150 t/ha në 160 t/ha, ndërsa perimet tjera kanë treguar zvogëlim ose sasia e prodhimit ka qenë e njëjtë.

Në komunën e Kaçanikut për mbjellje pranverore 2022-2024 janë mbjellë sipërfaqe të kulturave si vijon:

| Nr. | KULTURA | Fermer /numri | Sipërfaqja e planifikuar / ha | | | Sipërfaqja e realizuar /ha | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 2022 | 2023 | 2024 | 2022 | 2023 | 2024 |
| 1 | Misër | 169 | 460 | 430 | 500 | 390 | 400 | 440 |
| 2 | Grurë | 135 | 530 | 480 | 550 | 480 | 410 | 530 |
| 3 | Elb | 1 | 5 | 4 | 4 | 4 | 0 | 0 |
| 4 | Tërshërë | 3 | 10 | 20 | 15 | 7 | 15 | 13 |
| 5 | Bimë furragjere | 4 | 10 | 0 | 5 | 5 | 0 | 3 |
| 6 | Bimë industriale | 1 | 0 | 0 | 4 | 0 | 0 | 2,5 |
| 7 | Perime në sera | 700 | 7,8 | 10 | 9,7 | 7,5 | 9,5 | 9,3 |
| 8 | Perime nëfushë të hapur | 1800 | 25 | 35 | 25 | 25 | 30 | 20 |
| 9 | Patate | 80 | 40 | 40 | 45 | 35 | 35 | 40 |

**Tabela 35:** Sipërfaqja e realizimit e të mbjellave pranverore 2022-2024

Vlen të theksohet se kultivimi i perimeve bëhet kryesisht për plotësimin e nevojave familjare, vetëm tepricën e prodhimeve e shesin në tregun lokal, (prodhues komercial kemi në numër shumë të ulët).




**Grafikoni :** Sipërfaqet e planifikuara me bimë një-vjeçare /ha 2022-2024




**Grafikoni :** Sipërfaqet e realizuara me bimë një-vjeçare /ha 2022-2024

### 3.3.4. Kultivimi i kulturave bujqësore shumë-vjeçare

Në vitin 2022 sipërfaqet e kultivuara me pemë përfshijnë rreth 32 ha, kryesisht (plantacione të reja të ngritura pas luftës së fundit), sipërfaqet e kultivuara me mollë përfshijnë 62.0%, me mjedër 16.35% , me arrë 13.2%, dhe me dardhë 8.33%. Vlen të theksohet se sipërfaqe me pemë ekzistojnë shumë më tepër, por janë në formë shkapërderdhura dhe nuk disponojmë me të dhëna të sakta lidhur me sipërfaqen për ha.

Sa i përket sasisë së prodhimit, analizat e statistikave për periudhën 2019 – 2022 tregojnë rritje të prodhimit të të gjitha pemëve, duke filluar nga molla prej 8.5 t/ha në 10 t/ha, dardha prej 0.8 t/ha në 2.0 t/ha, mjedra prej 6 t/ha në 8 t/ha dhe arra (plantacione të reja) nga 8.4 t/ha në 12.44 t/ha.

| Nr. | KULTURA | Fermer /numri | Sipërfaqja e planifikuar / ha | | | Sipërfaqja e realizuar /ha | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 2022 | 2023 | 2024 | 2022 | 2023 | 2024 |
| 1 | Pemë molla | 3 | 1.50 | 1 | 1.50 | 1.30 | 0.50 | 1 |
| 2 | Arra | 9 | 4.5 | | | 4.0 | | |
| 3 | Mjedër | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0- | 0- |
| 4 | Dardha | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Lajthi | 6 | 0 | 1.50 | 1.30 | | 1.20 | 1.23 |

**Tabela 36:** Sipërfaqet e planifikuar dhe të realizuara me pemë në vitin 2024




**Grafikoni :** Sipërfaqet e planifikuara me kultura shumë-vjeçare /ha 2022-2024




**Grafikoni :** Sipërfaqet e realizuara me kultura shumë-vjeçare /ha 2022-2024

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2024 kemi këtë pasqyrë të sipërfaqeve ekzistuese të pemëve në Komunën e Kaçanikut:

| Nr. | Fermer | Kultura | Sipërfaqet ekzistuese |
|---|---|---|---|
| 1 | 40 | Pemë molla | me mbi 0.5ha 17 fermer+ ( 23 fermer nën 0.5/ha) =31.65 |
| 2 | 22 | Arra | me mbi 0.5ha 8 fermer+14 fermer nën 0.5ha =25ha |
| 3 | 6 | Mjedër | 2.05ha |
| 4 | 3 | Dardha | 3.48ha |
| 5 | 6 | Lajthi | 4.93ha |

**Tabela 37:** Sipërfaqet ekzistuese të pemëve në Komunën e Kaçanikut 2024




**Grafikoni : :** Sipërfaqet ekzistuese të pemëve në Komunën e Kaçanikut 2024

*Burimi: Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural 2024*

### 3.4. Agrobiznesi

Ekonomia e komunës së Kaçanikut është kryesisht bazuar biznesin individual ne sektorin e Agrobiznesit, bujqësisë, tregtië, ndërtimtarisë dhe përpunimit të ushqimit. Në komunën e Kaçanikut janë të regjistruara dhe zhvillojnë aktivitete aktive 562 biznese private që operojnë brenda juridiksionit komunal.

Bujqësia është një ndër sektorët me potencial të madh e të rëndësishëm në rritjen e ekonomisë dhe të sigurisë së ushqimit. Sektorët të cilët vazhdojnë të kenë kushte të favorshme dhe me rendimente në rritje janë: Sektori i pemëtarisë, blegtorisë, drithërat si dhe kultivimi i frutave dhe perimeve dhe përpunimi i tyre në produkte finale. Pas lufte për shkak të migrimit të popullsisë nga fshati në qytet nji pjesë e madhe e tokës ka mbet e pa punuar. Po ashtu ndikim negativ ka edhe ndërtimi i objekteve të ndryshme në toka bujqësore, siç janë: objektet e banimit, objektet hoteliere, pompat e benzinës dhe objektet e ndryshme industriale, kjo ka ndikuar që sipërfaqet e tokës bujqësore të zvogëlohen gradualisht, duke u shëndërruar në tokë ndërtimore.

Sektori i agrobiznesit viteve të fundit është duke dominuar, si kultivimi i frutave dhe perimeve dhe përpunimi i tyre në produkte finale.

#### 3.4.1. Fermat bujqësore

Kultivimi i shtazëve, shpezëve dhe përpunimit të mishit ka të bëjë me biznesin privat andaj bartës ekskluziv të kësaj sfere janë subjektet private dhe fermerët individual të cilët merren me këtë veprimtari.

Në komunën e Kaçanikut subjektet private( fermerët individual) që zhvillojnë veprimtarinë janë afër 430 fermer, të cilët zotërojnë sipërfaqe prej 1320 hektar.

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural sot kemi këtë pasqyrë të kultivimit të shtazëve në Komunën e Kaçanikut:

| Nr. | Kategoria e fermave | Nr. i fermave | Njësia në copë/krerë | Lokacioni | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ferma e lopëve me mbi 5 krerë | 146 | 1534 krerë lopë +1200 viça =3795 krerë | Në të gjitha fshatrat e komunës së Kaçanikut | Qumështore Reproduktim |
| 2 | Fermer me nga mbi 5 krerë lopë | 490 | 980 | Në të gjitha fshatrat e komunës së Kaçanikut | |
| 3 | Fermer të deleve | 23 | 3582 | Koxhaj, Bajnicë, Semajë, Doganaj, Gllobоçicë Strazhë, Dubravë, Kaçanik i Vjetër | |
| 4 | Ferma të dhive | 7 | | Ivajë, Nikaj, Dubravë | |
| 5 | Ferma të Pulave | 1 | 5000 | Llanishtë- Kaçanik | |
| 6 | Bletë | 63 me mbi 30 koshere<br>52 prej tyre 1-20 koshere | 4217<br>Gjithsej 4154 | Në të gjitha fshatrat e komunës së Kaçanikut | |

**Tabela 38:** Fermat e shtazëve në komunën e Kaçanikut

*Burimi: Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural 2024*

Vlen për t'u theksuar se disa prej fermave të prezantuar nuk janë duke i shfrytëzuar kapacitetet e tyre të plota. Ndërsa sa i përket objekteve për përpunimin e mishit theksojmë se në komunën e Kaçanikut funksionojnë 2 dyqane të pavarura zejtare që merren me therjen dhe shitjen e mishit.

### 3.4.2. Turizmi

Kaçaniku edhe pse dallohet me pozitë mjaft të mirë për zhvillimin e turizmit, si psh.: pjesëmarrja në PNMSH, pasuritë ujore (Lepenci), Gryka e Kaçanikut, disa objekte hoteliere dhe dy pishina, Xhamia e Koxha Sinan Pashës si dhe objekte dhe lokalitete tjera atraktive dhe me vlerë kulturore.
Qyteti në veçanti do të ofrojë paketë turistike mikse kulturo-natyrore, natyrës ikonike të Grykës së Kaçanikut, Gurit të Shpuar, bashkimit të lumit Lepenc me lumin Nerodime, ku luginave të tyre iu gërshetohet historia urbane me Kalanë antike/ mesjetare, Xhaminë mesjetare (Koxha Sinan Pasha 1594), qarshinë e cila ende qëndron, lokacionet e ndryshme kulturore, etj., si dhe tregimet për betejat e shpeshta shqiptare në Grykën e Kaçanikut.
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm në vitin 2022 hartoi broshurën turistike; Kaçaniku, Vlerë e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore ku janë të prezantuara vendndodhja e pikave turistike, Duke i pasur parasysh potencialet, mund të pritet që këto lista të zgjerohen edhe më tej në të ardhmen.
*Burimi i të dhënave, Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe turizmit*

Nyje shumë e rëndësishme turistike mbetet mali Sharr, ku Zona tashmë e shpallur turistike e Strazhës do të jetë fokusi kryesor me shpërndarjet drejt Parkut Nacional Sharri (stanet tradicionale, pyjet unike dhe Maja e Lybotenit (2498 lmd)), pyjeve të pishave dhe natyrës fantastike. Përveç bizneseve shërbyese hoteliere dhe vilave private aty ofrohen sportet verore dhe dimërore (rrëshqitje/ skijim), rekreacion dhe lëvizje në natyrë, etj.

Krejt këtij aranzhimi i shtohen edhe pikat tjera turistike si hapësira turistike përreth Liqenit të Pranverës (Kotlinë), Uji i Bardhë (BoB), Dubrava, Glloboçica, Kotlina (turizëm shëndetësor) dhe Gajra. Në pjesën e Karadakut është nyja e Korbliqit që do të ofrojë elemente natyrore përmes lumenjve të pastër, ujëvarave interesante, hapësirës natyrore të paraparë për shërbime hotelerie (duke i përfshirë ato shëndetësore) dhe disa pikave tjera interesante (Gjurgjedell, te Vestë, lokme, fshati Drenogllavë, etj.).



**Foto 5:** Liqeni i Pranverës – Kotlinë

Vlerat unike natyrore do të plotësohen me vlerat krenare të trashëgimisë historike shumë të rëndësishme të luftës së UÇK-së dhe betejave tjera historike në Grykë të Kaçanikut. Gjithandej nëpër Sharr, Karadak, qytet dhe vendbanime tjera janë lokacionet, përmendoret dhe përkujtimoret e luftës për çlirim të Kaçanikut. Gjatë prezantimit të ofertës turistike, këto asete do të jenë vlerë shtesë e tregimit kaçanikas për traditën e përpjekjes së pakufishme dhe të vazhdueshme për jetë të lirë dhe të sigurte të banorëve dhe për të mundësuar shijimin e kësaj natyre ga vizitorët.



**Foto 6:** Stina e Pranverës rrëzë majës së Lybetenit

Përmes transportit të organizuar, vizitave private dhe dhënies së informacionit, ky funksionalitet turistik organizohet nga qyteti i Kaçanikut përmes nyjës kryesore dhe pikave informuese në Fushë të Pajtimit dhe në Shtrazë. Shpërndarja dhe qasja në informacion digjital është pjesë e domosdoshme e këtij funksionaliteti.

Sipërfaqet turistike në Shtrazë, Ivajë dhe Guri i Shpuar do të definohen më tej me HZK ku përmes nënzonimit ku do të përcaktohen nënzonat ku lejohen zhvillimet banuese/ rekreative (vila) apo hotelieri shërbyese, tregtare, etj. Në të gjitha sipërfaqet tjera rekreative turistike dhe jashtë atyre nënzonave te tri të lartpërmendurat, nuk do të lejohet kurrfarë zhvillimi që do ti dëmtonte vlerat natyrore të atyre sipërfaqeve.

**Harta 12:** *Harta turistike e Komunës së Kaçanikut,* ***aneksi i hartave***
**Harta 13:** *Harta turistike e Qytetit,* ***aneksi i hartave***

### 3.4.3. Sektori privat /komuniteti i biznesit

Qyteti i Kaçanikut ka një traditë të hershme manifakturale dhe private, sidomos për prodhimin e gurit gëlqeror, rërës, drurit për ndërtimtari dhe shërbime të ndryshme zejtare. Veprimtari bazë e ndërmarrjeve private është prodhimi i materialit ndërtimor si: gurët, ndërmarrja për prodhimin e bllokave të Silkaporit që kanë zënë vend të veçantë në ndërtimtari moderrne.

Kaçaniku ka kushte mjaftë të mira edhe për zhvillimin e industrisë ekstraktuese, ndërtimit, industrisë së ushqimit dhe përpunimit, që do të mund të ishin shtesë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të komunës. Potencialet për zhvillim ekonomik nuk janë shfrytëzuar relativisht pak deri më tani, ndërsa Kaçaniku pas ndarjes së Hanit të Elezit i takon komunave me një zhvillim më të ulët industrial të Kosovës. Burimi kryesor i gjenerimit të hyrave të qytetarëve të komunës së Kaçanikut janë prodhimtaria e vogël, shërbimet, bujqësia (ekonomitë familjare) dhe tregtia. Në përgjithësi, mjedisi për zhvillimin e bizneseve makro, ende mbetet i pafavorshëm dhe kërkon mbështetje institucionale të fuqishme.

| Nr. | Ndërmarrjet Private në Komunën e Kaçanikut | | |
|---|---|---|---|
| | **Kompania** | **Pronari** | **Lokacioni** |
| **1** | SH.P.K. “SILKAPOR” | Zelqif Beriusha | Matlumë |
| **2** | N.P. “X- FORT” | Sali Selmani | Doganaj |
| **3** | SHPK “SANKOS” | Xhavit Neziri | Kaçanik |
| **4** | N.T.P.” EUROPLAST” | Blerim Zenuni | Matlumë |
| **5** | N.P. “EUROTHESI” | Syl Selmani | Doganaj |
| **6** | N.P. “KIVO” LLC | Driton Ramajli | Kaçanik i Vjetër |
| **7** | Sh.P.K. “”UDA” | Burim Kolshi | Doganaj |
| **8** | SH.P.K. KAÇINKA | Jetmir Shehu | Kaçanik i Vjetër |
| **9** | M&V Group Company | Mevlud Zharku | Kaçanik i Vjetër |
| **10** | SH.P.K. “JLG” Construction | Adem Zeneli | Begracë |
| **11** | SIMTEX SH.P.K | Bekim Musliu | Kaçanik i Vjetër |

**Tabela 39:** Ndërmarrjet private në Komunën e Kaçanikut

Në komunë janë të regjistruara gjithsej 1275 ndërmarrje. Nga bizneset e regjistruara afro 82% biznese janë individuale ndërsa 15% biznese Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe pjesa tjetër përfshin Shoqëritë aksionare Ortakëritë, Bizneset e huaja dega ne Kosovë, etj. Ndërmarrjet të cilat kanë pronar te gjinisë femërore janë 16% (tipi biznesit tek pronaret femra fokusohet me shume ne biznese individuale) ndërsa pronaret meshkuj përfshin rreth 84% te bizneseve. Viteve te fundit ka rritje te bizneseve te tipit shoqëri me përgjegjësi te kufizuar.
***Burimi:*** *Komuna e Kaçanikut 2022 (duke përfshirë të gjithë nënsektorët në lidhje me ndërmarrjet)*

**Sektorët ekonomik dhe pronësia e ndërmarrjeve**

Sektorët ekonomik dominues janë kryesisht tregtia me shumicë dhe pakicë, aktivitetet shërbyese dhe ndërtimtaria. Tregtia përfshinë 31% të ndërmarrjeve, aktivitetet shërbyese 27%, ndërtimtaria 11%, ndërsa sektorët tjerë përfshinë pjesën tjetër prej 31%. Këta sektorë edhe janë shquar për rritje gjatë viteve të fundit, ndërsa rënie nuk është shënuar në asnjë sektor. Përkundër potencialeve të Kaçanikut për zhvillimin e bujqësisë, ky sektor mbetet fare pak i përfaqësuar, me vetëm 3%. Të gjitha ndërmarrjet janë private.

**Ndërmarrjet sipas vendbanimeve**

Numri më i madh i ndërmarrjeve është i përqëndruar në Kaçanik, si qendër komunale dhe udhëkryq regjional. Kaçaniku përbën 49% të numrit të ndërmarrjeve në nivel komunal. Vendbanimi i dytë për kah numri i ndërmarrjeve është Doganaj 6%, e pasuar nga Kaçaniku Vjetër, Dubrava, etj. Gjatë viteve të fundit, përgjithësisht numri i ndërmarrjeve në të gjitha vendbanimet është rritur, përveç në disa fshatra të vogla ku numri ka mbetur konstant. Duke i marrë për bazë sektorët në të cilat janë të orientuara ndërmarrjet, përqendrimi i tyre është në qendrën komunale, vendbanimet e mëdha si Doganaj dhe rrugët kryesore (nacionale, rajonale dhe kryesore lokale) si dhe në vendbanimet që shtrihen pranë rrugëve të rëndësishme në nivel rajonal. Ndërmarrjet me te mëdha si për nga kapitali dhe numri punëtorëve gjenden përgjatë rrugës nacionale N2 dhe në Doganaj.

### 3.4.4. Shoqatat afariste

Në Komunën e Kaçanikut veprojnë; Shoqata e Bjeshkatare Alpiniste **“Kaaçaniku 2015”,** Organizata për mbrojtjen e mjedisit ”**Gjethi,”** Shoqata e Gjuetarëve**” Drenusha,”** Shoqata e Peshkatarëve **“Trofta,”** Shoqatae Bizneseve etj.

## 3.5. OBJEKTET

### 3.5.1. Objektet e banimit

Komuna e Kaçanikut në pjesën më të madhe karakterizohet me banim me veçori rurale dhe me dendësi të ulët. Shumica e njësive të banimit janë të reja, të ndërtuara pas luftës, si rezultat i shkatërrimeve të konsiderueshme. Nevoja për përmirësim e kushteve të banimit, qoftë drejtpërdrejt në njësi të banimit apo në shërbime të tjera që ndikojnë cilësinë e banimit është ende e dukshme, sidomos në zonat rurale. Në dekadat e fundit, ndërtimi i objekteve të banimit ka ndryshuar tërësisht, si në formë ashtu edhe në cilësi. Tani objektet e banimit ndërtohen me një e më shumë kate, ndërsa janë të ndërtuara me material të fortë ndërtimor, si: tulla, blloka të pjekur, betoni e hekuri dhe materiale izoluese.

Në nivel komunal banimi përfshinë 1980 ha, që përbën 0.90% të sipërfaqes së përgjithshme të Komunës.

Në Qytet ka 22.50 ha banim. Pjesën më të madhe e përbën banimi individual me 18 ha. Etazhiteti i njësive individuale të banimit shkon deri në P+3. Në afërsi të rrugëve kryesore, katet e poshtme kryesisht shfrytëzohen për afarizëm. Pjesa më e madhe e banimit në bashkëpronësi është e përqendruar në qendër, me etazhitet P+7. Pjesa tjetër përfshinë banimin social, të përqendruara në pjesët periferike jugperëndimore.

| Tipologjia | Nr. i ndërtesave të banimit | Njësitë e banimit |
|---|---|---|
| Ndërtesat për banim në bashkëpronësi P+2 - P+7 brenda zonës urbane | 21 | 715 |
| Ndërtesat individuale deri në P+3 brenda zonës urbane | 3046 | 3115 |
| Ndërtesat individuale deri në P+3 në fshatra | 6379 | 6385 |

**Tabela 40:** Tipologjia e banimit dhe etazhiteti

Banimi në fshatra përfshinë 225 ha dhe përbën 26.67% të sipërfaqeve të ndërtuara në zonën rurale. Fondi i përgjithshëm i banimit në zonën rurale në tërësi përbëhet prej banimit individual, si banim me dendësi të ulët. Etazhiteti i njësive individuale të banimit shkon deri në P+3.

Shikuar përgjithësisht, në nivel të komunës ekziston një shpërputhje në mes numrit të njësive të banimit dhe numrit të familjeve . Nga fondi i tërësishëm i banimit në Kaçanik, rreth një e pesta, përkatësisht 20% mbetet i pashfrytëzuar. Mendohet që një numër i madh i njësive vakante të banimit janë në pronësi të njerëzve që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit.

Zona urbane e qytetit të Kaçanikut karakterizohet me dendësi më të lartë se zonat rurale dhe kjo dendësi është rreth 878 banorë/$km^2$. Kjo dendësi është më e lartë se në zonat rurale por është e ulët për një zonë urbane, ku shtrihen kryesisht njësi të banimit.

Cilësia e jetës në komunë gjithashtu ndikohet edhe nga vlerat rekreative të trashëgimisë natyrore, zhvillimin e objekteve dhe pajisjeve për një infrastrukture adekuate sociale dhe teknike, e cila i merr parasysh nevojat e banorëve. Promovohet ndërtim i objekteve sipas standardeve në hapësirat jo të ndërtuara dhe masat mbrojtëse për reduktimin e pasojave nga fatkeqësitë( tërmetet, vërshimet, erozionet etj.) si dhe vënia në zbatim e rregullave të ndërtimit për banim në dobi të rritjes së dendësisë për sipërfaqe në zonat e banimit. Çdo ndërtim i ri do të respektojë masat për Efecientë të Energjisë sipas kërkesave, bazuar në rregulloren për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave (MEA Nr. 04/18). Të gjitha këto veprime do të mundësojnë që komuna të përmirësojë kualitetin e banimit në komunë, dhe në të njëjtën kohë të akomodojë kërkesat për njësi të reja të banimit.

Në vendbanimet rurale, që gjenden me pozita hapësinore atraktive dhe distanca të afërta me vendet urbane si dhe pranë akseve rrugore që lidhin qytetet më të fuqishme në vend, dendësia e banimit brenda zonës së ndërtuar, është mjaft e lartë dhe është e përafërt me shumë qytete të vogla të Kosovës. Ndërsa në vendbanimet më periferike, sidomos ato afër brezit kufitarë, dekadave të fundit ka ndodhur imigrim i pa kontrolluar drejt vendbanimeve urbane. Vendbanimet rurale, përveç objekteve të banimit janë të ndërtuara edhe një numër të konsiderueshëm të objekteve përcjellëse (ekonomike). Në dy dekadat e fundit në Komunën e Kaçanikut ka ndodhur një zhvillim dinamik urban, i përcjellur edhe me infrastrukturë kritike në vendbanime urbane dhe rurale, duke ndërtuar objekte të cilat i plotësojnë standard të afirmuara dhe kushte më të mira për banim.

Në komunën e Kaçanikut, numri i gjithmbarshëm i njësive të banimit është 8852, ku pjesa më e madhe e njësive të banimit gjendet në zonën urbane të komunës 3560, ndërsa në atë rural 5292 ekonomi familjare.

| **Komuna** | Ndërtesë me më së paku një banesë të banueshme të zakonshme | Numri mesatar i banesave për ndërtesë | Numri i banesave të zakonshme | Numri i banesave të zbrazëta |
|---|---|---|---|---|
| Kaçanik | **5260** | **157** | **8276** | **2449** |

**Tabela 41:**Numri i ndërtesave me më së paku një banesë të shfrytëzuar të zakonshme, numri mesatar i banesave për ndërtesë, numri i banesave të zakonshme, numri banesave të zbrazëta.

| Komuna | **STATUSI I BANIMIT** | | |
|---|---|---|---|
| | **Gjithsej** | Banesa të zakonshme | Njësi tjera banimi |
| Kaçanik | **8852** | **8276** | **576** |

**Tabela 42 :** Banesat sipas statusit të banimit

| **Lloji i objektit** | **Urban** | | | **Rural** | | | **Gjithsej** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Banesë kolekt. | Ekonom. Familjare | Persona | Banesë kolekt. | Ekonom. Familjare | Persona | Banesë kolekt | Ekonom. Familjare | Persona |
| **Komuna e Kaçanikut** | 21 | 525 | 2100 | 2 | 36 | 180 | 23 | 561 | 4140 |
| **Banesa e zakonshme** | 3560 | 3560 | 6477 | 5292 | 5292 | 17231 | 8253 | 8852 | 21848 |
| **Lloj tjetër banese** | 191 | 5 | 573 | 385 | 385 | 1155 | 576 | 390 | 1728 |

**Tabela 43:** Banesat sipas llojit, statusitë shfrytëzimit dhe tipit tëvendbanimit

| | **Njësitë e banimit** | **Të banuara** | **Vakante** | **Ekonomi Familjare** | **Banor për /km$^2$** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Kaçaniku** | 9011 | 76.33% | 23.67% | 6878 | **152** |
| **Kosova** | 412.884 | 71.3% | 28.7% | 297.090 | **163.2**[11] |

**Tabela 44.:** Fondi i banimit

Pothuaj se tërë fondi i banimit në Komunën e Kaçanikut, përkatësisht 8981 (99.7%) është në pronë private ndërsa 30 njësi banimi janë pronë komunale.

### 3.5.2. Objektet Afariste

Strukturë heterogjene të ndërtimeve në Komunën e Kaçanikut dominon banimi i ulët, ndërsa akset përgjatë rrugëve kryesore që e kufizojnë këtë zonë, janë të ndërtuara objekte në të cilat zhvillohen veprimtari të ndryshme: afariste, tregtare, prodhuese, shërbyese, zejtare, kulturore, shëndetësore, arsimore etj. Nga pjesa më e madhe e objekteve janë ndërtuar para luftës së fundit në Kosove, ndërsa përgjatë aksit të magjistrales, (Prishtinë - Shkup), ndërtimet janë bërë pas vitit 1999, dhe kryesisht janë objekte në të cilat zhvillohen veprimtari të ndryshme.
Kaçaniku përbën 49% të numrit të ndërmarrjeve në nivel komunal.

Duke i marrë për bazë sektorët në të cilat janë të orientuara ndërmarrjet, përqendrimi i tyre është në qendrën komunale, vendbanimet e mëdha dhe rrugët kryesore (nacionale, rajonale dhe kryesore lokale), si dhe në vendbanimet që shtrihen pranë rrugëve të rëndësishme në nivel rajonal. Ndërmarrjet më të mëdha si për nga kapitali dhe numri punëtorëve gjenden përgjatë rrugës nacionale N2 dhe në Doganaj.

Bizneset që afarojnë me objekte prodhuese, deponime të materialeve të ndryshme, materialeve lehtë-ndezëse apo materiale të rrezikshme janë të ndërtuara në zona /park biznesi me destinacion dhe planifikim hapësinorë dhe urbanistik, në pajtueshmëri me PZhK dhe normat ligjore në fuqi.
Veprimtaritë e përshtatshme për zhvillimin e ekonomisë komunale mund të jenë:

• Industria dhe bizneset me ndotje të vogël;
• Industritë/ bizneset të cilat prodhimin e bazojnë në lëndën e parë nga resurset vendore dhe të importuara, ( me materie të rrezikshme, lehtëndezëse, shpërthyese, etj)
• Prodhimtaria dhe bizneset e përqendruara në produkte bujqësore.

| Objektet sipas funksionit | Nr. Objekt. | % |
|---|---|---|
| Shtëpi Banimi | 5547 | 89.22% |
| Apartamente | 23 | 0.37% |
| Objekte Bujqësore | 26 | 0.42% |
| Depo/Magazina | 1 | 0.02% |
| Lokale afariste/dyqane | 510 | 8.20% |
| Objekte të braktisura | 8 | 0.13% |
| Objekte të papërfunduara | 12 | 0.19% |
| Fabrika/uzina | 6 | 0.10% |
| Garazh/Parking | 20 | 0.32% |
| Komerc. të pa shfrytëzuara | 3 | 0.05% |
| Pasuritë e përjashtuara | 0 | 0.00% |
| Pishina | 2 | 0.03% |
| Punishte | 4 | 0.06% |
| Restorante | 47 | 0.76% |
| Zyra | 8 | 0.13% |
| **Gjithsej** | **6217** | **100.00 %** |

**Tabela 45:** numri i objekteve sipas funksionit

### 3.5.3. Objektet sportive

Në përgjithësi infrastruktura sportive në Kaçanik, ashtu si në nivel të Kosovës, nuk është në nivelin optimal. Mungesa e infrastrukturës për të gjitha disiplinat e sportit dhe financimi i kufizuar janë disa nga faktorët kryesorë sfidues në nivelin komunal. Në kuadër të shkollave të mesme gjenden edhe dy salla të tjera sportive të cilat mund të shfrytëzohen edhe pas orëve të mësimit.Viteve të fundit janë ndërtuar edhe salla sportive në shkollat fillore në fsh. Elezaj, Kaçanik të Vjetër dhe në fshatin Begracë, po ashtu janë ndërtuar edhe fusha të hapura me standarde moderne në fshatin Dubravë dhe Gllobоçicë.

Situata në Kaçanik si qendër komunale është diçka më e mirë se në vendbanimet tjera, por jo e kënaqshme.

**Palestra sportive**

Palestra sportive është ndërtuar në vitin 2021 dhe është në funksion nga viti 2022, lokacioni është skaj lumit Lepenc në qendër të qytetit në vendin e ish stadionit "Besnik Begunca" kjo palestër është e vetmja në të gjithë territorin e komunës.Në këtë palestër aktivitetin e tyre e kryejnë edhe klubet sportive si: Klubi i basketbollit "Kaçaniku", klubi i hendbollit "Lepenci," klubi i mundjes "Kaçaniku", klubi Taekwondos" Kaçaniku 2000" klubi i volejbollit "Kaçaniku"etj.





**Foto 7** *:* Palestra e sportit Kaçanik

**Stadiumi**

Në vitin 2016 ka filluar ndërtimi i stadiumit të qytetit i cili me lokacion është në fshatin Stagovë, për shkak të kostos së madhe financiare punimet janë duke u zhvilluar me faza.

Mirëpo lokacioni i këtij stadioni në periferi të Kaçanikut e vë në pikëpyetje qasshmërinë nga Kaçaniku dhe vendbanimet tjera.

Stadiumi ka kapacitet mbi 3 mijë ulëse, ndërsa posedon edhe hapësirat ndihmëse– fushën rezervë dhe dhomat e veshjes.





**Foto 8:** Stadioni i futbollit "Besnik Begunca "

### 3.5.4. Objektet kulturore

Jeta kulturore dhe artistike në komunën e Kaçanikut kryesisht zhvillohet në qytet ku edhe gjendet shtëpia e kulturës "Xheladin Kurtaj," po ashtu disa aktivitete zhvillohen edhe nëfshatrat e komunës. Në Kaçanik veprojnë shoqatat dhe klubet kulturore-artistike që merren me aktivitete koncertale, letrare, valle dhe aktivitete tjera rinore. Në kuadër të këtyre aktiviteteve ka përkrahje dhe bashkëpunime me DKRS

Në komunën e Kaçanikut për nder të Çlirimit të Kaçanikut (11.06.1999 ) mbahet Festivali Kombëtar i Shoqërive Kulturo Artistike, ku pjesëmarrës janë shoqëritë nga të gjitha trevat Shqiptare.

Në objektin e shtëpisë së kulturës aktivitetin e ushtrojnë këto shoqëri kulturo artistike:

Shoqëria kulturo artistike "Gryka e Kaçanikut,

Shoqëria artistike ""Kaçaniku",

Shoqëria kulturo artistike ""Tingujt e vendlindjes"

Po ashtu në shtëpia e kulturës „Xheladin Kurtaj" në Kaçanik, është i vendosur edhe

- Muzeu etnografik ,

-Biblioteka e qytetit , ndërsa në disa fshatra të komunës aktivitetin e tyre e zhvillojnë edhe këto biblioteka:

-Biblioteka në fshatin Doganaj-pjesë e bibliotekës së qytetit,

-Biblioteka në fshatin Stagovë- pjesë e bibliotekës së qytetit,

-Biblioteka në fshatin Kaçanik i Vjetër- pjesë e bibliotekës së qytetit.

-Shtëpia e Kulturës në fshatin Glloboqicë,

*Burimi i të dhënave : Komuna e Kaçanikut 2020*

## 3.6. Strehimoret dhe objektet për strehim

Fatkeqësitë elementare, brenda një kohë shumë të shkurtër lënë një numër të madh njerëzish, jo vetëm pa kulm mbi kokë, por edhe pa mjete më të domosdoshme për jetë. Për këtë arsye, krahas evakuimit dhe strehimit, planifikohet edhe përkujdesja për të evakuarit dhe të strehuarit qysh më parë, në bazë të vlerësimit nga fatkeqësitë elementare dhe fatkeqësitë tjera. Parashikohen dhe sigurohen mjete materiale të domosdoshme për furnizimin e atyre të cilët kanë mbetur pa to.

Krahas përkujdesjes parashikohet dhe përgatitet edhe vendosja e domosdoshme për një kohë të caktuar në objekte publike (hotele, shkolla, shtëpi, pushimore etj.) për të gjithë njerëzit që evakuohen nga vendbanimet e përhershme.

Gjatë ndodhjes së fatkeqësisë së pari caktohet lokacioni (zona) e grumbullimit e banorëve të prekur e pastaj fillon evakuimi në vende të caktuara dhe më pak të rrezikuara.

Evakuimi bëhet me qëllim të largimit të popullsisë prej vendeve dhe objekteve të rrezikuara në objekte dhe vende më pak të rrezikuara.

### 3.6.1. Përcaktimi i lokacioneve (zonave) të grumbullimit në rast të fatkeqësive

Banorët e Kaçanikut në raste emergjente, do të mund të strehoheshin në objekte afariste dhe publike, në të cilat ekzistojnë kushte për strehim dhe ushqim për një afat të shkurtër, sikur që është ish shtëpia e mallrave „Sharri", Shkollat e mesme dhe fillore, ish objekti i Sanatoriumit, restorantet të cilët bëjnë organizimin e dasmave, që kanë hapësira të mëdha e që mund të përdoren për këtë qëllim si dhe banesat që bodrumet i kanë të ndërtuar me material të fortë. Këto bodrume (strehimore), tash për tash janë jashtë përdorimit, sepse nuk janë bërë investime për aftësimin(restaurimin) e tyre[2].

[2]Pas rekomandimit të sektorit të emergjencave Strehimorja te Gjimnazi "Skenderbeu" është pastruar dhe aftësuar për strehim

### 3.6.2. Lokacioni i strehimoreve /Titullari

Në komunën e Kaçanikut në raste të krijimit të situatave emergjente për evakuim dhe strehimin të përkohshëm, janë përcaktuar lokacionet/objektet për strehim, ashtuqë është një pajtueshmëri e plotë në mes organeve gjegjëse komunale dhe titullarëve të objekteve, duke arritur ujdi përmes memorandumeve të mirëkuptimit:

- Hapësira e Kalasë së Kaçanikut me koordinata Kosova Ref01, X=7521137.650, Y=4676529.540
- Hapësira e stacionit të autobusëve me koordinata, X=7521072.410, Y=4676566.500,
- Hapësira e objektit "Sankos" Sh.P.K (Fabrika e konfeksionit të tekstilit dhe mjeteve mbrojtëse në punë). Me koordinata X= 7520931.990, Y=4676679.200




**Orto foto 1:** lokacionet (zonat) për grumbullimin e banorëve të prekur nga fatkeqësitë

### 3.6.3. Kapacitetet e strehimoreve

Objektet afariste dhe publike, në të cilat ekzistojnë kushte për strehim dhe ushqim për një afat të shkurtër, sikurse restorantet të cilët bëjnë organizimin e dasmave, që kanë hapësira të mëdha e që mund të përdoren për këtë qëllim si dhe banesat që bodrumet i kanë të ndërtuar me material të fortë janë të evidentuara si objekte strehimi ku mund të strehohen 1140 banorë në rast të një fatkeqësie.

| Nr. | Lloji i strehimores | Lokacioni Rruga | Agjencia menaxhuese | Kapaciteti në individ | Koha e qëndrimit në orë | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Afatsh kurtë (48) orë | Afatm esëm (15ditë | Afatgj at (60 **dit)** |
| **1** | Nëntokësore | Rr.Agim Bajrami | Shtëpia e mallrave “Sharri” | 70 | X | | |
| **2** | Nëntokësore | Banesa e madhe | Kuvendi Komunal | 75 | | X | |
| **3** | Nëntokësore | Gjimnazi Skenderbeu | Kuvendi Komunal | 130 | | X | |
| **4** | Nëntokësore | UÇK | Policia e Kosovës | 35 | | X | |
| **5** | Palestra sportive | Vëllezërit Çaka | Kuvendi Komunal | 145 | | X | |
| **6** | Shtëpia e Kulturës | Bul.”Ismal Raka” | Kuvendi Komunal | 120 | X | | |
| **7** | Objekt banimi | Ish Saniteksi | Kuvendi Komunal | 130 | | X | |
| **8** | Objekt banimi | Shkolla e mesme Profesionale | Kuvendi Komunal | 80 | X | | |
| **9** | Hotel Restorant | Magjistrale | Fontana | 90 | | | **X** |
| **10** | Hotel Restorant | Magjistrale | Mani | 70 | | | **X** |
| **11** | Hotel Restorant | Magjistrale | Evropa 92 | 40 | | | **X** |
| **12** | Restorant Parku | Magjistrale | Rest. Parku | 50 | | **X** | |
| **13** | Restorant | Magjistrale | Art Cafe | 60 | | | **X** |
| **14** | Restorant | Magjistrale | Beni | 50 | | | **X** |

**Tabela 46:** Llojet e strehimoreve, kapaciteti i tyre dhe objektet tjera për strehim




**Ortofoto 2 :** Vendndodhja e strehimoreve që mund të përdoren gjatë një fatkeqësie

### 3.6.4. Gjendja e strehimoreve

Në bazë të gjendjes faktike, në qytetin e Kaçanikut ekzistojnë dy strehimore publike(me kapacitet prej 130vetash) që i kanë plotësuar kushtet për atë kohë që janë ndërtuar, dhe ato gjenden në Gjimnazin „Skënderbeu" dhe te banesa e madhe P+8 në qendër të Kaçanikut, strehimorja te gjimnazi "Skënderbeu" është pastruar dhe e mirëmbajtur për momentin, ndërsa te banesa e madhe P+8 nuk është mirëmbajtur, dhe nuk i plotëson kushtet për strehim (është rekomanduar që kjo strehimore të pastrohet dhe të adaptohet për strehim).





**Foto 9 :** Strehimoret Te Gjimnazi "Skenderbeu " dhe te objekti banesor P+8

## 3.7. Kapacitetet shëndetësore publike dhe private

### 3.7.1. Institucionet Shëndetësore

Në komunën e Kaçanikut, shëndetësia është e organizuar ne sektorin publik, ku ofrohen shërbime të nivelit parësor, dhe ne sektorin privat i cili ofron shërbime parësore të profesioneve të specializuara mjekësore.

Në sektorin publik, kujdesi primar shëndetësor është i organizuar në 10 institucione shëndetësore te mjekësisë familjare:

**Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) "Dëshmorët e Lirisë" – Kaçanik**

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) funksionon në Kaçanik. Ndërtimi i saj është bërë në vitin 2016/2017. Gjendja fizike është shumë e mirë dhe ofron shërbime për qytetarët 24 orë në ditë.Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) janë gjithsej 6 dhe Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF) janë 6 – shih tabelën më poshtë.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) **"Dëshmorët e Lirisë" në Kaçanik,** si bartëse e kujdesit primarë, është e vendosur në qytetin e Kaçanikut dhe ofron shërbime në një objekt me hapësirë **2100.86 $m^2$**. Ky objekt është ndërtuar në vitin e 2017 në participim, Komuna, Qeveria dhe Caritasi i Luxemburgut.




**Foto 10 :** Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) **"Dëshmorët e Lirisë"** në Kaçanik

Në **QKMF** në Kaçanik ofrohen këto shërbime shëndetësore :

- Shërbimi emergjent
- Shërbime laboratorike
- Shërbimi i RTG
- Shërbimet e vaksinimit – i rregullt
- Shërbimet stomatologjike
- Shërbimi i patronazhës
- Shërbimet e emergjencës
- Shërbimet gjinekologjike

Shërbimi parësorë shëndetësorë publikë në territorin e komunës së Kaçanikut udhëhiqet nga Komuna dhe kryhet në :

- Qendrën **Kryesore** të Mjekësisë Familjare(QKMF )..............1
- Qendrën Mjekësisë Familjare(QMF )......................................6
- Ambulanca e Mjekësisë Familjare(AMF )...............................6

Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) janë gjithsej 6 dhe Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF) janë 6 – shih tabelën më poshtë.

| Vendi | Emri | Gjendja fizike e objektit | Numri i mjekëve | Numri i inferm-ereve | Rrezja e mbulimit<br><br>Cilat fshatra i mbulon? |
|---|---|---|---|---|---|
| **Kaçanik** | QKMF*** | Shumë e mirë | 18 | 59 | **Te gjitha fshatrat e komunës së Kaçanikut e ne veçanti Runjeva,Gajra,Kovaqec,Gjurgjedelli , Drenagllava, Korbliqi, dhe Semaja** |
| **Stagovë** | QMF | Pjesërisht e mirë | 0 | 1 | **Fsh. Stagovë** |
| **Kaçanik i Vjetër** | QMF** | Pjesërisht e mirë | 0* | 2 | **Fsh. Kaçanik i Vjetër** |
| **Glloboçic** | QMF** | E mirë | 0* | 2 | **Fsh. Glloboçicë** |
| **Bob** | QMF** | E mirë | 0 | 1 | **Fsh.bob** |
| **Elezaj** | QMF** | E mirë | 0 | 1 | **Fsh. Elezaj** |
| **Doganaj** | QMF** | Është ndërtuar objekt i ri | 0 | 1 | **Fsh. Doganaj** |
| **Shtrazë** | AMF | E mirë | 0 | 1 | **Fsh. Strazhë** |
| **Kotlinë** | AMF | E mirë | 0 | 1 | **Fsh. Kotlinë** |
| **Biçec** | AMF | E mirë | 0 | 1 | **Fsh. Biçecë** |
| **Begracë** | AMF | E mirë | 0 | 1 | **Fsh. Begracë** |
| **Dubravë** | AMF | E mirë | 0 | 1 | **Fsh. Dubravë** |
| **Ivajë** | **AMF** | **E mirë** | **0** | **1** | **Fsh. Ivajë** |

**Tabela 47:** Institucionet shëndetësore (Rrezja e mbulueshmerisë)

*-Mjek me kohë të pjesshme (3 herë në javë) deri para disa muajsh. Pjesën tjetër të javës shërbenin në QKMF. Momentalisht nuk ka mjek fare. Përafërsisht e njëjtë gjendja është edhe në QMF-të tjera.
**-QMF që japin shërbim të nivelit të AMF/ shërbim infermierie

Edhe pse infrastruktura e shëndetit publik mbulon të gjithë territorin e komunës së Kaçanikut, siç shihet edhe në tabelën e mësipërme jo të gjitha qendrat janë plotësisht funksionale, sidomos ato në zonat rurale. Prandaj, shumica e popullatës në zonat rurale duhet të udhëtojnë për në qendrën komunale për të kërkuar kujdes mjekësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, e cila duhet të përballojë një numër të shtuar të pacientëve.

Gjashtë Ambulanca në fshatrat: Begracë, Biçec, Dubravë, Kotlinë, Stagovë, dhe Strazhë, kryesisht kanë hapësira të punës në gjendje të mirë fizike, meqenëse janë të ndërtuara pas vitit 1999 nga donacionet e organizatave ndërkombëtare dhe pjesërisht me investime të qeverisë.

Hapësira e përgjithshme e këtyre gjashtë AMF-ve është 615 $m^2$. Në këto ambulanca, mjeku punon dy herë në javë, ndërsa dy infermiere pesë ditë në javë dhe ofrojnë shërbimin parësor shëndetësorë për 12347 banorë ose 33.34 % e popullatës të përgjithshme të komunës.

Nga të dhënat e analizuara vërehet se popullata e komunës së Kaçanikut është e mbuluar tërësisht me shërbime shëndetësore si dhe shpërndarja hapësinore e objekteve shëndetësore i plotëson kriteret e parapara me rregulloren për shërbime parësore.

| Shërbime shëndetësore të realizuara | | | |
|---|---|---|---|
| Në nivel Komune në QKMF | **Vizita** | **Intervenime** | **Gjithësej** |
| | **54547** | **78250** | **132817** |

**Tabela 48:** Raporti i shërbimeve mjekësore

Sëmundjet e diagnostifikuara më së shpeshti, sipas klasifikimit ndërkombëtar kanë qenë sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes, sistemit digjestiv dhe kardiovaskular.
Me diagnozë të parë prinë Diabeti (sëmundja e sheqerit) me 512 raste, Anemia (pagjakësia) me 128 raste, Tumore/neoplazmat malinje në 21 raste.
:

| Nr. | Kapacitetet mjekësore reaguese publike | Dinamika |
|---|---|---|
| **1.** | Dhënja e ndihmës së parë nga personeli profesional | |
| **2.** | Transporti nga lokacioni i pacientit në spital (shtëpi shëndeti) | 35 min nga fshati më i largët |
| **3.** | Transporti nga lokacioni i pacientit në qendrat tjera rajonale dhe QKU | Spit. rajon.– Ferizaj . QKUK-Prishtinë |
| **4.** | Numri i ekipeve kujdestare të ndihmës së parë | **15** |
| **5.** | Numri i shtretërve në spital | **x** |
| **6.** | Numri i shtretërve në shtëpi shëndeti | **12** |
| **7.** | Numri i shtretërve mobil në shtëpi shëndeti | **2** |
| **8.** | Numri i leseve për të lënduar | **7** |
| **9.** | Autoambulanca | **5** |

**Tabela 49:** Kapacitetet mjekësore reaguese

Gjashtë Ambulanca në fshatrat: Begracë, Biçec, Dubravë, Kotlinë, Stagovë, dhe Strazhë, kryesisht kanë hapësira të punës në gjendje të mirë fizike, meqenëse janë të ndërtuara pas vitit 1999 nga donacionet e organizatave ndërkombëtare dhe pjesërisht me investime të qeverisë.

### 3.7.2. Kapacitetet humane shëndetësore

**Kapacitetet humane shëndetësore** në Qendrën kryesore të mjekësisë familjare në komunën e Kaçanikut.

| Nr. | Profesioni | Numri i personelit |
|---|---|---|
| **1.** | Specialist të mjekësisë familjare | 3 (tre) |
| **2.** | Specialist i oftomologjisë | 1 (një) |
| **3.** | Specialist i emergjencës | 1 (një) |
| **4.** | Doktor të medicinës të mjekësisë familjare | 14 (katërmbëdhjetë) |
| **5.** | Doktori i stomatologjisë të mjëkësisë familjare | 1 (një) |
| **6.** | Specialist i pediatrisë | 1 (një |
| ***Gjithësejt mjek*** | | ***21 (njëzet e një)*** |
| **Kuadri i lartë dhe i mesëm medicional** | | |
| **7.** | Infermier të diplomuar (Bachelor) | 9 (nëntë) |
| **8.** | Infermiere | 63 (gjshtëdhjet e tre) |
| **9.** | Mami | 16 (gjashtëmbëdhjetë) |
| **10.** | Laborant | 4 (katër) |
| **11.** | Teknik rentgeni | 3 (tre) |
| **12.** | Punëtor administrate | *8* (tetë) |
| **13.** | Shofera | 8 (tetë) |
| **14** | Pastruese | 4 (pesë) |
| **15.** | ***Gjithësej*** | **136** |

**Tabela 50:** Struktura profesionale në QKMF, sipas profileve

### 3.7.3. Kapacitetet teknike reaguese shëndetësore në Sektorin Publik

Ekipi shëndetësor i emergjencave në rast të aktivizimit – alarmimit ka këto mjete dhe pajisje

| N r. | Lloji i automjetit | Tabelat | Kubik – lënda djegëse | Viti i prodhimit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Peugeot - Ambulancë** | **05-718-DJ** | 2.0 – Naftë | 2017 |
| 2 | **Peugeot - Ambulancë** | **05-454EF** | 2.0 – Naftë | 2018 |
| 3 | **Kombi T6** | 05-259 | 2.5 – Naftë | 2009 |
| 4 | **Citroen Ambulancë** | 05-231-AE | 2.2 – Naftë | 2008 |
| 5 | **Fiat Ambulancë** | 05-11FF | 2.3 – Naftë | 2020 |
| 6 | **Jeep Toyota –LC** | 05-743AQ | 4.2 – Naftë | 2000 |
| 7 | **Toyota HI -AC** | 05-392AG | 2.4 – Naftë | 1999 |
| 8 | **Peugeot - Dializë** | 05-719 DJ | 2.0 – Naftë | 2017 |
| 9 | **Suzuki Vitara** | 05-616GK | 1.4 - hibrid -benzin | 2022 (donacion) |
| 10 | **Peugeot – vizita shtëpiake** | 05-702 HC | 1.5 – Naftë | 2023(donacion) |
| 11 | **Peugeot kombi- 05-719-DJ** | 05-701HC | 2.0 – Naftë | 2023 |

**Tabela 51 :** Kapacitetet teknike shëndetësore në sektorin Publik

*Burimi : QKMF- Kaçanik 2024*

**Harta 14:** *Shtrirja hapësinore e objekteve shëndetësore,* ***aneksi i hartave***

### 3.7.4. Kapacitetet mjekësore private

Në sektorin privat veprojnë institucione shëndetësore, të cilat aktivitetin e tyre e zhvillojnë kryesisht në zonën urbane. Në këto ordinanca ofrohen shërbime: pediatrike, internistike, stomatologjike dhe mjekësisë familjare, ku punojnë specialist të degëve përkatëse.
Në fshatin Kaçanik i Vjetër punon edhe ambulanta private ku janë të punësuar edhe mjekë specialist, që kryejnë shërbime të ndryshme mjekësore për banorët e kësaj ane e më gjerë.

**Sektori privat**

Në kuadër të sektorit privat funksionojnë disa ordinanca mjekësore, shumica në Kaçanik, ku përfshihen:

| Nr. | Lloji i ordinancave private | Numri i ordinancave | Vendi i aktivitetit |
|---|---|---|---|
| **1** | Ordinanca dentare | 4 | Kaçanik |
| **2** | Ordinanca urologjike | 1 | Kaçanik |
| **3** | Ordinanca gjinokologjike | 1 | Kaçanik |
| **4** | Ordinanca interne dhe pediatrike | 1 | Kaçanik |
| **5** | Ordinanca e përgjithshme mjekësore | 1 | Kaçanik |
| **6** | Ordinanca ortopedike | 1 | Kaçanik |
| **7** | Laborator | 2 | Kaçanik |
| **8** | Ambulanc private | 1 | Kaçanik i Vjetër |

**Tabela 52:** Ordinancat private në komunën e Kaçanikut

### 3.7.5. Detyrat e ekipeve për shërbime mjekësore në situata emergjente

Njësitë profesionale të Shërbimeve Emergjente Mjekësore ( ekipet mobile ) në raste të aksidenteve të mëdha duhet të kryejnë shërbime mjekësore emergjente dhe të ndihmojnë në zhvendosjen e popullatës nga zonat e goditura dhe të koordinojnë aktivitetet me institucionet relevante. Ekipet e ndihmës së parë i bashkëngjiten shërbimit mjekësorë emergjent dhe i nënshtrohen urdhrave të zyrtarit të këtij shërbimi

- Ofrimi i ndihmës së parë medicinale në vendin e incidentit,
  - të siguroj vendin për dhënien e ndihmës së parë,
  - të afrojë dhënien e ndihmës së parë emergjente të personave të lënduar.
  - të zvogëloj dhimbjen dhe të minimizoj pasojat e lëndimeve për deri sa të arrin ekipet profesionale.
- Triazhimi i personave të aksidentuar, plotësimi i kartonit të trijazhës së pacijentit dhe mbajtja e evidencës,
- Evakuimi dhe bartja adekuate e personave të lënduar nga zona e fatkeqësisë në qendrat spitalore dhe repartet tjera të specijalizuara medicinale,
- Marrja e masave preventive anti-epidemiologjike si dhe luftimi i vatrave të mundshme të paraqitjes së tyre,
- Aplikimi i sistemit të mbrojtjes karantinë me rastin e shfaqjes së sëmundjeve të ndryshme infektive e të tjera,
- Informimi i popullatës lidhur me gjendjen sanitare në teren dhe dhënia e udhëzimeve-këshillave adekuate medicinale për veprim në situata të caktuara emergjente,
- Sanimi i terenit-lokacionit të aksidentuar,
- Planifikimi dhe krijimi i rezervave kritike në medikamente dhe produkte tjera farmaceutike për funkcionim adekuatë në situata emergjente,
- Dhe detyra tjera sipas specifikave dhe nevojave,

**KREU IV – të**

# 4. INFRASTRUKTURA TEKNOLOGJIKE DHE E TRAFIKUT

## 4.1. Rrugët (rrjeti rrugor dhe qarkullimi)

Konfiguracioni i territorit të komunës së Kaçanikut ka kushtëzuar kryesisht krijimin e disa nga rrugët me të rëndësishme dhe me specifika të veçanta, sidomos ndërlidhja e rrugëve që përshkojnë luginat përgjatë rrjedhave të lumenjve.

Shtrirja e rrjetit rrugor në territorin e Kaçanikut si dhe përmbajtja e të gjitha niveleve të hierarkisë rrugore kombëtare dhe komunale, mundësojnë lidhje të mira brenda Kosovës si dhe në nivel ndërkombëtar. Duke qenë një udhëkryq lokal regjional, rruga nacionale dhe ato regjionale përballojnë trafik të ngarkuar apo mesatarisht të ngarkuar, që vërehet sidomos në qytetin e Kaçanikut, ku kryqëzohen rrugët regjionale.

### 4.1.1. Rrugët e nivelit kombëtar - Autostrada Prishtinë-Shkup

Shtrihet në pjesën perendimore të komunës, rrëzë terreneve kodrinore. Gjatësia e segmentit të Kaçanikut është afër 17.3 km. Përmes kësaj rruge Kaçaniku bëhet pjesë e korridoreve me rëndësi ndërshtetërore regjionale.
Autostrada që e lidh Prishtinën me Shkupin, është lëshuar për qarkullim më 29 maj 2019, e cila më vonë është emëruar me emrin e njërit prej figurave të shquara shqiptare "Arbën Xhaferi"
Autostrada "Arbën Xhaferi" është me gjatësi prej 65.5kilometra ka urën më të gjatë në rajon me një gjatësi prej 5.7 kilometra pa ndërprerje, kurse lartësia e urës gjarpërore është 83 metra.

**Rruga nacionale Prishtinë - Shkup**

Shtrihet në pjesën perëndimore të qytetit, gjatësia e segmentit të Kaçanikut është afër 16.7 km. Përmes kësaj rruge mundësohet lidhja me Ferizajin, Vitinë, Hanin e Elezit, Shtërpcën dhe Prizrenin.
Gjendja fizike e rrugës vlerësohet si e mirë. Profili përbëhet prej dy shiritave me nga 3.5 metra, ndërsa trotuari ekziston vetëm në disa segmente.

### 4.1.2. Rrugët urbane

Rrugët primare të Kaçanikut paraqesin segmentet urbane të rrugëve (nacionale-regjionale), kryqëzimi i të cilave paraqet nyjet kyqe urbane dhe ndërurbane. Këto rrugë paraqesin arteriet e qarkullimit që e lidhin qytetin dhe vendbanimet në përgjithësi. Nëpër tërë gjatësinë rrugore primare, rrugët dhe trotuaret janë të rregulluara, ndërsa në disa segmente kanë nevojë për përmirësime.
Sa i përket qarkullimit në rrugët primare, si arterie kryesore lidhëse brenda qendrës komunale, në periudha të caktuara shfaqen ngarkesa që e pengojnë qarkullimin e rrjedhshëm, por dhe jetën dhe funksionet e saj si vendbanim.
Këto ngarkesa shkaktohen për disa arësye, si:psh. trafik i dendur në sezonën e kthimit të bashkëatdhetarëve nga diaspora, mungon rruga transit, mungesa e rrugëve me më shumë korsi, rrjeti rrugëve sekondare në brendi të lagjeve i zhvilluar në formë të lirë dhe i karakterizuar me rrugë qorre, si pasojë e zhvillimeve të paplanifikuara hapësinore, ashtu që rrugët sekondare kanë nevojë edhe për përmirësimin e profileve rrugore.

Po ashtu, mungesa e trotuareve të mjaftueshme dhe të dizajnuara mirë paraqet vështërsi në lëvizjen e lirë të këmbësorëve

### 4.1.3. Rrugët e nivelit komunal –rrugë lokale

Komuna e Kaçanikut ka bërë investime të konsiderueshme në infrastrukturën rrugore në të gjithë territorin e saj, është bërë një rrjetizim i qytetit dhe të vendbanimeve me njëra-tjetrën, përveç fshatrave Nikoc, Drenogllavë dhe Korbliq të cilët lidhen me një rrugë që ka nevojë për rregullim dhe shtrim.
Gjatësia e përgjithshme e rrjetit rrugor lokal është 332.37km prej tyre të asfaltuara janë 272.89km ose 82.29% rrugë të asfaltuara.
Në kuadër të rrjetit rrugor janë mbi 20 ura me një gjatësi totale prej 300 m, të gjitha të ndërtuara nga betoni dhetë kalueshme për automjete, shumë prej tyre janë të ngushta për trafikun dy kahor dhe për lëvizjen e sigurt të këmbësorëve.

### 4.1.4. Rrugët në vendbanime lokale

Përmirësimi i rrugëve brenda vendbanimeve është në vijim e sipër viteve të fundit. Përgjithësisht, për shkak të dendësisë rurale të ndërtimit dhe zhvillimit të vendbanimeve në lagje të ndara, rrugët e vendbanimeve karakterizohen me shpërndarje të madhe në raport me njësitë e banimit të cilave ju shërbejnë. Këto rrugë kanë nevojë për përmirësim në disa segmente, si në trajtimin e rrjetit / larg-përquesve elektrik, kabllovikut, sistemit të ujësjellësit dhe knalizimit, ujërave atmosferike dhe krijimin e kushteve për lëvizjen e sigurt të këmbësorëve, shtegun e biçiklistëve etj..

Në anën tjetër, në vendbanimet më rurale qarkullimi për këmbësorë mbetet më i vështirë me lidhje jo të mira dhe në shumë raste pa infrastrukturë përcjellëse(trotuare, shtegun e bicikletave, etj). Edhe pse komuna e Kaçanikut, ka bërë përpjekje për të përmirësuar lëvizshmërinë duke ndërtuar infrastrukturë rrugore (rreth 332.37 km), 3 nënkalime, 1 mbikalim, 38,73km trotuare, dhe ende ka mungesë të trotuareve për këmbësorë, sidomos në lagjet ku ka lëvizje të nxënësve në drejtim të shkollave, ashtu që e bën më të vështirë dhe më të pasigurt lëvizjen në shumicën e rasteve për nxënësit që shkojnë dhe kthehen nga shkolla.

Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore bëhet sipas kontratës për mirëmbajtje, nga kompania kontraktuese, nëpërmjet tenderit publik ku caktohet kontraktuesi që bën sanimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

| Kategoria | Gjatësia (km) | Përqindja: |
|---|---|---|
| **Autoudhë** | 17.3 | 4.34% |
| **Rrugë nacionale** | 16.7 | 4.19% |
| **Rrugë rajonale** | 32 | 8.03% |
| **Rrugë tjera** | 332.37 | 83.43% |
| **Gjithsej** | 398.37 | 100.00% |

**Tabela 53 :** Rrugët sipas kategorive në Komunën e Kaçanikut

**Harta 15:** *Infrastruktura e transportit në komunën e Kaçanikut,* ***aneksi i hartave***

**Linjat transportuese ndërkomunale, urbane dhe rurale**

Shërbimi i transportit ofrohet në kuadër të sektorit privat. Në mënyrë që të plotësohen kërkesat, janë në funksion autobusëdhe minibusë privat si dhe shërbime të ndryshme të taksive.

**Transporti publik ndërkomunal**

| Udhëtimet nga Kaçaniku | Numri i nisjeve | Numri i ardhjeve |
|---|---|---|
| Kaçanik- Ferizaj - Prishtinë | 3 | 2 |
| Kaçanik-Ferizaj | 29 | 29 |
| Kaçanik- Hani Elezit | 10 | 10 |

**Tabela 54:** Transporti ndërkomunal

**Transporti publik komunal (Urbanë dhe Ruralë – periferik)**

Zona urbane e Kaçanikut ka sipërfaqe relativisht të vogël dhe nuk është racionale të mbulohet me transport publik. Ndërsa në nivel komunal ekziston transporti publik për shumicën e vendbanimeve (shiko tabelën më poshtë).

| Udhëtimet nga Kaçaniku | Numri i nisjeve | Numri i ardhjeve |
|---|---|---|
| Kaçanik - Biçec | 5 | 5 |
| Kaçanik- Dubravë (Imishtë) | 5 | 5 |
| Kaçanik- Dubravë (Sepetin) | 6 | 5 |
| Kaçanik- Strazh -Gllobočicë | 3 | 3 |
| Kaçanik– Doganaj | 5 | 6 |
| Kaçanik - Duraj | 5 | 6 |
| Kaçanik - Semajë | 5 | 5 |
| Kaçanik –Kaçanik i Vjetër - Begracë | 4 | 4 |
| Kaçanik –Stagovë | 5 | 5 |
| Kaçanik –Gajre | 5 | 5 |
| Kaçanik –Ivajë | 11 | 11 |
| Kaçanik - Kovaçec | 7 | 7 |

**Tabela 55:** Transporti urban-rural

**Hapësirat ekzistuese për parkim**

Në komunën e Kaçanikut janë gjithsej 20 parkingje (lokacione), 827 vende për parkim prej tyre 5 parkingje me vende te rezervuara për persona me nevoja të veçanta.

**Ngarkesa e qarkullimit në trafik**

Për vlerësimin e shpeshtësisë së trafikut në rrugët kryesore në Komunën e Kaçanikut janë marrë në konsideratë karakteristikat e jo-linearitetit kohorë të qarkullimit të automjeteve në periudha të ndryshme kohore. Rezultatet më të mira janë dalë në raste të numërimit të frekuentimit të automjeteve përmes numëruesve automatik, në periudha më të gjata kohore. Nga rezultatet e numërimit gjatë periudhës brenda vitit vlerësohet **trafiku mesatar ditor vjetor** (TMDV), dhe dhe shpeshtësia e frekuentimit të automjeteve brenda vitit. Ky është një tregues i rëndësishëm për planifikimin e rrugëve dhe menaxhimin e qarkullimit të automjeteve në rrjetin rrugor

| Nr. | Identifikimi i parkingut | Lokacioni/Adresa | Nr. pozitave për parking -gjithsej | Parking i Rezervuara për pers.me aftësi të kufizuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Parkingu qendër | Rr. Ismail Raka | **129** | 2 |
| 2 | Te Qarshia | Rr. Idriz Seferi | **12** | 0 |
| 3 | Te Shoqata | Rr. Vëllezërit Çaka | **46** | 1 |
| 4 | Oborri te komuna | Rr. Qamil Ilazi | **50** | 1 |
| 5 | Te Banesa 8+1 | Rr. Ismail Raka | **26** | 0 |
| 6 | Institucionet shkollore | | **180** | 0 |
| 7 | Varrezat e dëshmorëve | Rr.Komandat Zefi-M2 | **58** | 0 |
| 8 | Te kalaja | Rr. A. Bajrami | **18** | 0 |
| 9 | Magjistarle M-2 | Rr. Komand. Zefi | **8** | 0 |
| 10 | Te Lushi | Rr. Rr. Avdyl Gafurr Luma | **4** | 0 |
| 11 | Glloboçicë | Rr. Avdyl Gafurr Luma | **2** | 0 |
| 12 | Te QKMF | Rr.Ismail Raka | **21** | 2 |
| 13 | Oborri i QKMF-së | Oborri i QKMF-së | **50** | 1 |
| 14 | Te Banesat | Rr. Vëllezërit Çaka | **15** | 0 |
| 15 | Te BK Center | Rr.Ismail raka | **13** | 0 |
| 16 | Te ETC | Rr. Ismail Raka | **78** | 0 |
| 17 | Te VIVA Fresh | Rr. Vëllezërit Çaka | **74** | 0 |
| 18 | Te Tropikali - privat | Rr. Ismail Raka | **13** | 0 |
| 19 | Te Tropikali - privat | Rr. Qamil Ilazi | **14** | 0 |
| 20 | Te Shtëpia Mallrave | Rr. Qamil Ilazi | **16** | 0 |
| | Gjithsej | Janë 20 parkingje/lokacione | Janë 827 vende për parkim/pozicione | Janë 5 lokacione/parkingje e vende të rezervuara për persona me nevoja të veçanta |

**Tabela 56:** Vend-parkimet në Komunën e Kaçanikut

### 4.1.5. Siguria në trafik

Vlerësimi i sigurisë në trafik në rrugët kryesore në Komunën e Kaçanikut është e bazuar në analizën nga të dhënat analitike të ofruara nga sektori i sigurisë së policisë për nivelin e sigurisë së trafikut rrugor në regjionin e Ferizait Të dhënat janë paraqitura ndë vite kanë për qëllim vlerësimin dhe trendin e ngjarjeve /aksidenteve rrugore si dhe pasojave sipas metodës krahasuese;

| Statistika për aksidente të trafikut në Komunën e Kaçanikut | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Viti:** | **Aksidente me dëme** | **Aksidente me lëndime të rënda** | **Aksidente me fatalitet** | **Përsona të vdekur** | **Gjithsej:** |
| **2010** | 78 | 40 | 6 | 7 | **131** |
| **2011** | 92 | 35 | 5 | 5 | **137** |
| **2012** | 100 | 38 | 4 | 6 | **148** |
| **2013** | 66 | 36 | 1 | 1 | **104** |
| **2014** | 51 | 39 | 3 | 3 | **96** |
| **2015** | 60 | 35 | 2 | 2 | **99** |
| **2016** | 65 | 34 | 1 | 1 | **101** |
| **2017** | 84 | 32 | 1 | 3 | **120** |
| **2018** | 61 | 29 | 5 | 7 | **102** |
| **2019** | 60 | 25 | 1 | 1 | **87** |
| **2020** | 38 | 18 | 1 | 1 | **58** |

**Tabela 57 :** Statistika për aksidente të trafikut në komunën e Kaaçanikut




Rrezikun e mundshëm që bazohet në sasinë dhe llojet e rreziqeve nga materiet e rrezikshme të cilat qarkullojnë në rajonet në të cilat hartohet vlerësimi i rrezikut dhe varësisht nga lloji dhe dendësia e qarkullimit, gjegjësisht rrjedhave të qarkullimit dhe rajoneve nëpër të cilat kalojnë (vendbanimet, hapësirat bujqësore, lumenjtë liqenet etj.)[3]

[3] Udhëzim Administrative Nr.19/2008- Neni 12 - 1. 2. katastrofat tekniko – teknologjike dhe fatkeqësitë e mëdha që shkaktohen në komunikacionin rrugor, hekurudhor dhe ajror.

### 4.1.6. Burimet e rreziqeve (Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve në infrastrukturën rrugore

Në territorin e komunës së Kaçanikut kalon vija hekurudhore, rruga automobilistike (Magjistralja ) dhe Autostrada "Arbën Xhaferi" me rëndësi strategjike që lidhë Kosovën me Maqedoninë, prandaj rreziku më i madh vjen nga shkaqet e ndryshme por faktori njeri është më i shpeshtë pasi që nuk janë duke u respektuar rregullat e përgjithshme në trafik, nga manipulimi i pasigurt me automjet, tejkalimi ishpejtësisë, mosmbajtja e distancës, mosrespektimi i shenjave të trafikut dhe mospërshtatja e kushteve të rrugës përdorimi i shpeshtë i telefonave mobil, vozitja nën ndikimin e alkoolit, substancave narkotike, ndikimi i lodhjes apo pagjumësisë, trajnimi joserioz gjatë dhënies së provimit për shofer, por duke mos munguar as faktori rrugë dhe automjet.
Karakteristikë në komunën tonë është edhe kullotja e kafshëve rreth rrugëve dhe vijës hekurudhore, ku si pasojë kanë ndodhur shumë aksidente me dëme materiale dhe dëmtim të kafshëve. Të dhënat zyrtare të shërbimeve përkatëse komunale dhe Policisë së Kosovës, **si pika kritike në komunikacion**, janë identifikuar në magjistralen Hani Elezit – Kaçanik (te Kulla me qeshme), në udhëkryqet e fshatrave dhe rrugën magjistrale( te Dardha), që lidhet me Autostradën "Arbën Xhaferi", rrugët dytësore që lidhen me rrugën magjistrale, si dhe kalimi i vijës hekurudhore në Kaçanik, Runjevë, Stagovë, dhe Kaçanik të Vjetër..



**Foto:** Zjarri që kaploi autbusin në magjistralen Hani Elezit – Kaçanik (te Kulla me qeshmë - pa pasoja në njerëz) me dt.03.08.2021 –

## 4.2.Hekurudhat

### Transporti hekurudhor

TRAINKOS është kompani publike dhe është operatori i vetëm legal në Kosovë që ofron shërbime të transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe mallrave. Komuna e Kaçanikut ka qasje direkte në rrjetin hekurudhor dhe ka stacionin hekurudhor funkcional për qasjen e udhëtarëve dhe mallrave.

Rrjeti hekurudhor në komunën e Kaçanikut është i karakterit shtetëror dhe ka shtrirje veri-jug, përkatësisht i takon kategorisë së komunikacionit magjistral i cili i lidhe dy kryeqytetet e shteteve fqinjë (Republikës së Kosovës dhe asaj të Maqedonisë). Linja hekurudhore Prishtinë – Shkup e cila kalon në pjesën qendrore të komunës së Kaçanikut është një binarësh me gjatësi prej 18.23 km.

Në aspektin e sigurisë së kalimeve në hekurudhë, Komuna do të bashkëpunojë me Hekurudhat e Kosovës për të zgjidhur çështjet dhe ofruar siguri optimale për banorët që lëvizin nga njëra anë në tjetrën (lëvizje motorike apo jo-motorike).

Vlen të theksohet se është rregulluar nënkalimi i cili e depërton hekurudhën dhe lidhë dy rrugët për kalim të këmbësorëve, rrugën "Ismal Raka" dhe rrugën "Skenderbeu", të cilin nënkalim e shfrytëzojnë nxënësit të cilët ndjekin mësimet në shkollën fillore dhe të mesme të ulët "”Emin Duraku" në lagjen Dushkajë.

Emergjencë tjetër mbetet rregullimi funksional i mbikalimit(viaduktit) mbi lumin Nerodime dhe hekurudhën në zonën urbane, nga rruga "Agim Bajrami"(Gjimnazi "Skenderbeu"), deri në rrugën "Ismal Raka", gjithashtu masa tjera për rregullimin e vendkalimeve duhet të mirren edhe në Kaçanik të Vjetër, Stagovë dhe Runjevë.

Momentalisht hekurudha nuk është funksionale sepse Hekurudhat e Kosovës janë duke e rindërtuar rrjetin.

**Harta 16***: Rrjeti hekurudhor i Kosovës dhe stacionet,* ***aneksi i hartave***

## 4.3. Aeroportet

Përveç Aeroportit të Prishtinës, si alternativë përdoren edhe aeroportet ndërkombëtare të Tiranës dhe Shkupit. Autostrada ekzistuese Durrës-Merdarë si dhe ajo Prishtinë-Han i Elezit mundësojnë lidhje të shpejtë dhe cilësore me këto aeroporte.

Qyteti ynë është distancë nga Aeroporti" Adem Jashari" afërsisht 67 km. Ndërtimi i infrastrukturës rrugore Autoudhës "Arbën Xhaferi" dhe autoudhës "Ibrahim Rugova" përshpejton mundësinë për qasje më të shpejtë në linjat e transportit ajror njëkohësishtë janë edhe mundësi reale për shfrytëzim të vijave emergjente për furnizim emergjent nga vendet tjera në raste të FNFT. Duhet pasur parasysh se transporti ajror përveq të mirave dhe dobisë në transporte publike dhe emergjente, mund të kemi edhe potencialisht rreziqe dhe fatkeqësi me pasoja për fluturaken mbi qiellin tonë por edhe me rreziqe në raste të aksidenteve ajrore. Prandaj duhet të jemi të përgatitur me ekipe profesionale të KSh, në aspektin human( të trajnuar dhe certifikuar), teknik (pajisje adekuate për reagim dhe K-Sh ), ekipe profesionale hulumtuese për fatkeqësinë, Ekipi për vlerësim të dëmeve materiale etj.

**Sfidat:**

- Trajnimet e pamjaftueshme profesionale për reagim në rast të fatkeqësive ajrore;
- Mungesa e Planit lokal të veprimit, mjeteve dhe pajisjeve adekuate për reagim dhe Kërkim–Shpëtim në aviacion civil;
- Faktorët e përkeqësimit (kushtet klimatike: mjegulla, shiu, bora, ngricat, shtrëngatat, temperaturat, erërat e forta ,etj);
- Mungesa e fluturakeve vendore (të helikopterëve, dronëve vëzhgues, etj.) për kërkim-shpëtim nga ajri;
- Etj.

## 4.4. Urat dhe tunelet

### 4.4.1. Urat

Të gjitha urat, e identifikuar në tërë territorin e komunës së Kaçanikut, i takojnë dy kategorive të komunikacionit: Komunikacionit rrugor (36) dhe komunikacionit hekurudhor (12)

**Urat në komunikacionin rrugor** – nga 37 ura të cilat janë të ndërtuara në rrjetin rrugor të komunës, 8 prej tyre janë të ndërtuar në Autostradën "Arbën Xhaferi" 6 prej tyre shtrihen në rrugë magjistrale dhe 3 në rrugë regjionale.



**Foto 11**; Autostrada "Arbën Xhaferi"

| Nr. | Emërtimi | vendi | Gjatësia në (m) |
|---|---|---|---|
| 1. | Ura | Soponicë | 30m |
| 2. | Ura | Biçec | 170m |
| 3. | Ura | Në hyrje të fsh. Kukaj | 191m |
| 4. | Ura | Në dalje të fsh. Kukaj | 116m |
| 5. | Ura | Bob | 196m |
| 6. | Ura | Në hyrje të fsh. Gajre | 614m |
| 7. | Ura | Në dalje të fsh. Gajre | 393m |
| 8. | Ura | Gajre -Paldenicë | 5713m |

**Tabela 58:** Urat në autostradën "Arbën Xhaferi"

**Urat në rrugën magjistrale** - Konfiguracioni i terrenit ka imponuar që në gjithsej 16.42 km rrugë magjistrale të ndërtohen 6 ura mjaft të rëndësishme për komunikacionin e rrugës magjistrale.
Urat kryesore dhe më të rëndësishme mbi këtë kategori të rrugëve është ajo në dalje të zonës urbane, përkatësisht në pjesën jugore të zonës urbane me gjatësi prej 240m,

**Urat mbi rrugë rajonale** – janë të vendosura në të dy drejtimet e rrugëve rajonale,
- Kaçanik – Viti dhe
- Kaçanik - Tetovë.

**Urat në rrugët lokale**
Urat shtrihen në rrugë lokale dhe ato të pa kategorizuara të cilat kanë gjatësi prej 15 deri 43m dhe gjithësej janë 11 ura

| Emri /numri | Kapaciteti bartës | Lokacioni adresa | Lokacioni koordinatat | Gjatësia | Gjerësia | Lartësia | Gjendja | Rreziku | Shënim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ura në Magjistrale** | 50t | Fusha e Pajtimit | Y=7517535.035 X=4682447.604 | 24m | 8.5m | 4.m | E mirë | I kufizuar | E renovuar nga KFOR-i |
| **Ura në Magjistrale Në hyrje të Kaçanikut** | 50t | Në hyrje të Kaçanikut (te vorrezat e vjetra të qytetit) | Y=7520998.136 X=4676784.952 | 35m | 8.5m | 4m | E mirë | I kufizuar | E renovuar nga KFOR-i |
| **Ura në Magjistrale mbi Lumin Lepenc** | 50t | Kaçanik në Magjistrale mbi Lumin Lepenc | Y=7520956.956 X=4676583.882 | 95m | 8.5m | 7m | E mirë | I kufizuar | E renovuar nga KFOR-i |
| **Ura te Guri i Shpumë Në rr. Magjistrale Kaçanik- H. Elezit** | 50t | Kaçanik në Magjistrale mbi Lumin Lepenc | Y=7521121.268 X=4676784.799 | 165m | 9.5m | 7m | E mirë | I kufizuar | E ndërtuar nga KFOR-i |
| **Ura mbi lumin e lakuar (Kriva Rekë) Në rr. Magjistrale Kaçanik- H. Elezit** | 50t | Kaçanik mbi përroin e Kriva Rekës | Y=7521001.625 X=4674264.229 | 140m | 9.5m | 30m | E mirë | I kufizuar | E renovuar nga KFOR-i |
| **Ura në Kashan Në rr. Magjistrale Kaçanik- H. Elezit** | 50t | Gjyrgjedell Mbi përroin e Kashanit | Y=7522413.435 X=4670660.282 | 210m | 9.5m | 20m | E mirë | I kufizuar | Gjysma e urës gjendet në territorin e Hanit të Elezit |
| **Urat në rrugën Rajonale në drejtim të pikes Kufitare në Glloboçicë** | | | | | | | | | |
| **Ura mbi lumin Lepenc.Rr. Rajonale Kaçan.- Glloboqicë** | 50t | Fsh. Doganaj Rruga për Glloboçicë | Y =7514886.644 X=4680824.473 | 55m | 8.5m | 6m | E mirë | I kufizuar | |
| **Ura për te stanet e Koxhajve** | 50t | Dubravë -Vataj | Y=7514041.714 X=4677547.403 | 30m | 8.5m | 4m | E mirë | I kufizuar | |
| **Ura mbi përroin Reka e kafegjisë** | 50t | Rruga për te Burimi i Ujit | Y=7514823.899 X=4675787.609 | 50m | 8.5m | 4m | E mirë | I kufizuar | |
| **Ura në rrugën rRjonale për Glloboqicë** | 50t | Në hyrje të tunelit Glloboqicë. | Y=7514188.183 X=4673586.236 | 50m | 8.5m | 4m | E mirë | I kufizuar | |
| **Ura në rrugën Rajonale për Glloboqicë** | 50t | Në dalje të tunelit Glloboqicë | Y=75141196.443 X=4673477.176 | 55m | 8.5m | 4m | E mirë | I kufizuar | |

**Tabela 59:** Urat në rrugën magjistrale dhe regjionale

| Emri /numri | Kapaciteti bartës | Lokacioni adresa | Lokacioni koordinatat | Gjatësia | Gjerësia | Lartësia | Gjendja | Rreziku | Shënim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ura e Konakut mbi lumin Nerodime** | 40t | Kaçanik Rr. "A. Bajrami" | Y=7521197.916 X=4676504.142 | 25m | 6.5m | 3m | E mirë | I kufizuar | Ura e vjetër |
| **Ura e II-të mbi lumin Nerodime(qendër)** | 50t | Kaçanik Rr. "A. Bajrami" | Y=7521195.816 X=4676544.532 | 25m | 8.5m | 3m | E mirë | I kufizuar | E ndërtuar me donacion nga USAID me 2010 |
| **Ura e Hazirit mbi lumen Nerodime** | 30t | Kaçanik Bulevardi "I. Raka | Y=7521099.313 X=4677184.827 | 25m | 3m | 3m | E mirë | I kufizuar | E ndërtuar nga Hazir Jaha |
| **Ura e Germanit Mbi lumin Lepenc** | 30t | Kaçanik Rr. "Vllezërit Çaka" | Y=7520991.503 X=4676564.690 | 43m | 6.50m | 4m | E mirë | I kufizuar | E ndërtuar me donacion nga USAID |
| **Ura mbi lumin Lepenc** | 12t | Kovaqec (te seperacioni) | Y=7519828.173 X=4677928.212 | 30m | 3m | 4m | E dobët | I kufizuar | Nuk është e mirëmbajtur |
| **Ura mbi lumin Lepenc** | 30t | Rruga për në fsh. Dubravë | Y=7517800.151 X=4680814.367 | 25m | 6m | 4m | E mirë | I kufizuar | E ndërtuar me donacion |
| **Ura mbi lumin Lepenc** | 40t | Dalloshë-Doganaj (rruga për te Hani) | Y=7515885.796 X=4681122.339 | 35m | 4m | 4m | E mirë | I kufizuar | E ndërtuar nga Komuna - 2017 |
| **Ura mbi lumin Lepenc** | 6t | Fshatin Sllatinë | Y=7514502.951 X=4680814.367 | 25m | 2.5m | 4m | E dobët | Mesatar | E ndërtuar nga vetë banorët |
| **Ura mbi lumin Nerodime** | 30t | Kaçanik i Vjetër Afër Hekurudhës | Y=7518917.465 X=4684553.172 | 15m | 3m | 3m | E mirë | I kufizuar | E ndërtuar nga Komuna - 2018 |
| **Ura mbi lumin Nerodime** | 30t | Stagovë -Afër stc.Hekurudhor | Y=7518919.206 X=4084553.399 | 15m | 3m | 3m | E mirë | I kufizuar | E ndërtuar nga vetë banorët |
| **Ura mbi lumin Nerodime** | 30t | Stagovë – lagja Teneq | Y=7520959.500 X=4680157.290 | 15m | 3m | 3m | E mirë | I kufizuar | E ndërtuar nga Komuna - 2020 |

**Tabela 60:** Urat në rrugët lokale

**Urat në komunikacionin hekurudhor** – Në rrjetin hekurudhor të zonës urbane të Kaçanikut janë të ndërtuara gjithsejtë 12 ura. Prej gjithsejtë 12 urave mbi rrjetin hekurudhor, 9 janë të ndërtuar mbi lumin Lepenc dhe 3 mbi lumin Nerodime-s. Urat më të rëndësishme mbi rrjetin hekurudhor janë ato të ndërtuara mbi lumin Lepenc të cilat kanë gjatësi prej 10 deri në 70m.

| Emri /numri | Kapaciteti bartës | Lokacioni adresa | Lokacioni koordinatat | Gjatësia | Gjerësia | Lartësia | Gjendja | Rreziku | Shënim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ura mbi lumin Nerodime** | 60t | Fsh. Stagovë | Y=7521016.340 X=4680502.050 | 25m | 5.8m | 3.5m | E mirë | I Kufizuar | |
| **Ura mbi lumin Nerodime** | 60t | Fsh. Runjevë | Y=7520984.160 X=4679544.060 | 35m | 5.8m | 3.5m | E mirë | I Kufizuar | |
| **Ura mbi lumin Nerodime** | 60t | (Xhamija e Dëshmorëve) | Y=7521019.140 X=4677760.010 | 25m | 5.8m | 3.5m | Jo e mirë | I Kufizuar | Duke u riparuar |
| **Ura mbi Lumin Lepenc (te ish fabrika e gëlqeres)** | 60t | Kaçanik në hyrje të fabrikës së gëlqeres | Y=7521181.357 X=4676252.888 | 40m | 5.8m | 3.5m | E mirë | I Kufizuar | |
| **Ura mbi Lumin Lepenc në fund të ish fabrikës** | 60t | në dalje të fabrikës së gëlqeres | Y=7521153.124 X=4675920.459 | 40m | 5.8m | 3.5m | E mirë | I Kufizuar | |
| **Ura mbi Lumin Lepenc te Guri i Shpuar** | 60t | Kaçanik - te Teqja | Y=7521136.690 X=4675844.680 | 30m | 5.8m | 3.5m | E mirë | I Kufizuar | |
| **Ura mbi Lumin Lepenc ,Gajre** | 60t | Kaçanik Në hyrje të Tunelit | Y=7521199.830 X=4675443.020 | 40m | 5.8m | 3.5m | E mirë | I Kufizuar | |
| **Ura mbi Lumin Lepenc** | 60t | Kaçanik Në dalje të Tunelit | Y=7521068.540 X=4675244.090 | 60m | 5.8m | 3.5m | E mirë | I Kufizuar | |
| **Ura mbi Lumin Lepenc- Gajre** | 60t | Në hyrje të tunelit të Gajrës | Y=7520697.590 X=4675012.430 | 40m | 5.8m | 3.5m | E mirë | I Kufizuar | |
| **Ura mbi Lumin Lepenc** | 60t | Në dalje të Tunelit të Gajrës | Y=7520603.050 X=4674705.626 | 40m | 5.8m | 3.5m | E mirë | I Kufizuar | |
| **Ura mbi Lumin Lepenc** | 60t | Te Kulla e Qeshmës | Y=7520635.840 X=4674591.326 | 80m | 5.8m | | E mirë | I Kufizuar | |
| **Ura mbi Lumin Lepenc** | 60t | Ura e Djegur Te Kulla e Qeshmës | Y=7520854.970 X=4674354.246 | 80m | 5.8m | | E mirë | I Kufizuar | |

**Tabela 61:** Urat në komunikacionin hekurudhor

### 4.4.2.Tunelet

**Tunelet në vijën hekurudhore** – Një ndër karakteristikat e hekurudhës që kalon në komunën e Kaçanikut janë edhe tunelet që datojnë nga viti 1892 kur dhe është ndërtuar hekurudha. Në territorin e komunës së Kaçanikut janë gjithsej 5 tunele që janë të ndërtuara në rrjetin hekurudhor

| Emri/numri | Lokacioni/ adresa | Lokacioni koordinatat | Gjatësia | Gjerësia | Lartësia | Gjendja | Rreziku |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | |
| **Tuneli 1.** | Në hyrje të fsh. Stagovë | Y=7520052.070 X=4682361.329 | 90m | 5.20m | 6.30m | E mirë | I kufizuar |
| **Tuneli 2.** | Në fsh. Runjevë | Y=7520956.470 X=4679639.729 | 130m | 5.20m | 6.30m | E mirë | I kufizuar |
| **Tuneli 3.** | Në hyrje te Guri i Shpumë | Y=7521195.004 X=4675412.287 | 90m | 5.20 | 6.30m | E mirë | I kufizuar |
| **Tuneli 4.** | Tuneli i Gajrës | Y=7520665.804 X=4674942.587 | 203m | 5.20m | 6.30m | E mirë | I kufizuar |
| **Tuneli 5.** | Te Kulla e Qeshmës | Y=7521998.998 X=4671983.765 | 70m | 5.20m | 6.30m | E mirë | I kufizuar |

**Tabela 62:** Tunelet në rrugën hekurudhore

**Tunelet në rrugën Magjistrale dhe regjionale**– Karakteristikë e të dy kategorive të komunikacionit që zhvillohen në territorin e komunës së Kaçanikut janë tunelet në sistemin hekurudhor dhe atë në Magjistralen Prishtinë Kaçanik- Shkup. Gjithsejtë tunele janë të ndërtuara 8. Dy tunele janë të ndërtuara në rrugën magjistrale Prishtinë Shkup (tuneli në komunën kadastrale të Kaçanikut me gjatësi prej 144m dhe tuneli në komunën kadastrale të Gjyrgjedellit me gjatësi prej 170m), një në rrugën regjionale Kaçanik – Tetovë (tuneli në komunën kadastrale të Glloboqicës me gjatësi prej 55m)

| Emri/numri | Lokacioni/ adresa | Lokacioni koordinatat | Gjatësia | Gjerësia | Lartësia | Gjendja | Rreziku |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Në rrugën rajonale Glloboqicë | Glloboqicë | Y=7514189.744 X=4673555.487 | 55m | 9m | 6.20m | E mirë | I kufizuar |
| Në rrugën Magjistrale | Guri i Shpum-(Lumi i lakuar) | Y=7520779.075 X=4674630.175 | 140m | 9m | 6.20m | E mirë | I kufizuar |
| Në rrugën Magjistrale | Gjyrgjedell (Kashan) | Y=7522008.421 X=4670945.539 | 150m | 9m | 6.20m | E mirë | I kufizuar |

**Tabela 63:** Tunelet në rrugën magjistrale dhe rajonale

**Harta 17:** *Urat dhe tunelet në komunën e Kaçanikut,* ***aneksi i hartave***

## 4.5. Sistemi energjetik (objektet dhe sistemi)

Furnizimi me energji elektrike sigurohet nëpërmjet një sistemi të përbashkët me komunat fqinje . Njësia punuese KEDS në Kaçanik mbulon 26 vendbanime, ndërsa 6 vendbanime mbulohen nga njësite punuese të komunave fqinje. Trafostacionet në zonën urbane janë;
TS- te ish Komiteti  në rrugën "Vëllezërit Çaka", TS – në  rrugën "Idriz Seferi", TS në  rugën "Mejdi Dalloshi", TS te shtëpia e mallrave rruga "Agim Bajrami", TS te Policia  Rruga "Hasan Prishtina", TS Vakufi  rruga "Qamil Ilazi", TS P+8  (te banesa e madhe), TS te ish pylltaria "rruga "Sali Bajra",  TS – Shtëpia e kulturës  rruga ""Ismal Raka", TS te Policia  Rruga "Hasan Prishtina" TS – Pompa  në rrugën Ismal Raka (ndërmjet shtëpisë së shëndetit dhe shtëpisë së kulturës,
TS- Hekurudha, TS – Rakoc – rruga "Reshat Shehu
**Rrjeti i shpërndarjes** Sistemi i shpërndarjes në komunë funksionon në nivelet 35kV, 10(20)kV, 10kV dhe 0.4kV. Linjat e nivelit 35kV arrijnë gjatësinë totale prej 8.7km, ndërsa ato 10kV 138.97km. Linjat e nivelit 0.4kV janë ajrore gjatësinë totale 137km. Transformimi i tensionit për nivelin komunal bëhet përmes 2 transformatorëve 35/10 kV ne NS të Kaçanikut, 2 transformatorëve ne NS e Silcaporit nga i cili furnizohet Silcapori dhe shtatë konsumator tjerë, prej 2 transformatorëve tjerë 35/0.4kV si dhe një hidrocentrali, Linjat e nivelit 35kV arrijnë gjatësinë totale prej 8.7km, ndërsa ato 10kV 138.97km

## 4.6. Largpërçuesit dhe trafo-stacionet

Në komunën e Kaçanikut ndodhen këto objekte të veçanta të karakterit energjetik të cilat janë si pjesë e rrjetit elektro-energjetik të KEDS/KESCO:
Nënstacioni është vendosur në zonën urbane, perkatësisht në afërsi të gjimnazit "'Skenderbeu." Nga ky Trafo-stacion bëhet shpërndarja e EE në 6 drejtime të ndryshme të cilat mundësojnë edhe shpërndarjen e EE në nivel Komunal.

| Nr. | Drejtimi i rrjetit energjetik | TS | Individuale | Kolektive |
|---|---|---|---|---|
| **1** | Drejtimi Voskopojës 10 kv | 37 | 9 | 28 |
| **2** | Drejtimi i Pylltarisë 10 kv dhe | 19 | 3 | 16 |
| **3** | Drejtimi i qytetit 10 kv | 9 | 3 | 6 |
| **4** | Drejtimi i Bob-it 10 kv | 25 | 6 | 19 |
| **5** | Drejtimi i 10 kv | 4 | 0 | 4 |
| **6** | Drejtimi i fabrikës së gëlqeres 10kv | 4 | 4 | 0 |
| **7** | Total | **98** | **25** | **73** |

**Tabela 64:** Trafo-stacionet në komunën e Kaçanikut
*Burimi i të dhënave: KEDS 2022*

Në rrjetën e furnizimit me energji elektrike të komunës së Kaçanikut, sipas drejtimeve të shpërndarjes së shfrytëzuesve, kemi të vendosura gjithsej 165 trafo-stacione të kapaciteteve të ndryshme. Duke u nisur nga ky fakt mund të konstatojmë se nga 165 Trafo-Stacione(TS), funksionale janë 98 prej tyre kolektive janë 73 ndërsa 25 të tjera janë individuale.

| Numri i konsumatorëve për Komunën e Kaçanikut | | | |
|---|---|---|---|
| | Kategoria | Nr. kons. | % |
| **Furnizimi nga NS Kaçaniku dhe Silcapori** | | 9074 | 93.58% |
| | Amvisëri | 7967 | 87.80% |
| | Komercial | 1043 | 11.49% |
| | Ndriçim publik | 64 | 0.71% |
| **Furnizimi nga Hani Elezit** | | 282 | 2.91% |
| | Amvisëri | 257 | 91.13% |
| | Komercial | 22 | 7.80% |
| | Ndriçim publik | 3 | 1.06% |
| **Furnizimi nga Ferizaj** | | 341 | 3.52% |
| | Amvisëri | 298 | 87.39% |
| | Komercial | 37 | 10.85% |
| | Ndriçim publik | 6 | 1.76% |
| **Gjithsejtë** | | 9697 | |
| | Amvisëri | 8522 | 87.88% |
| | Komercial | 1102 | 11.36% |
| | Ndriçim publik | 73 | 0.75% |

**Tabela 65:** Shfrytëzuesit e energjisë elektrike

Kualiteti i furnizimit me energji elektrike, sipas statistikave të furnizimit me energji elektrike, si dhe gjendjes së rrjetës energjetike në nivel të komunës administrative të Kaçanikut, mund të vërejmë se ka një furnizim me energji elektrike jo në nivelin e kënaqshëm, prandaj duhet të përmirësohet kualiteti i energjisë elektrike në 10 vendbanime të komunës duke përmirësuar edhe rrjetin e energjisë elektrike, i cili do të ndikoj në zvogëlimin e humbjeve të energjisë.
Gjithashtu duhet që të lëshohet në funksion linja e energjisë elektrike për fshatin Nikoc me kapacitet prej 10kv, me qëllim që të krijohen kushte të mira për banorët të cilët dëshirojnë të jetojnë në atë fshat.

**Harta 18** : *Rrjeti transmetues që kalon përmes komunës së Kaçanikut*, ***aneksi i hartave***

### 4.7. Sistemet e telekomunikimit

#### 4.7.1. Objektet dhe shërbimet (brenda komunës).

**Telefonia Fikse** – Rrjeti i telefonisë fikse në komunën e Kaçanikut është i lidhur nëpërmjet fibrit optik, i cili i përket linjës së trasesë Ferizaj–Han i Elezit.
Ky rrjet menaxhohet nga njësia e PTK-së, në Kaçanik e cila ka vetëm një objekt postar dhe ka centralin e lidhur me fibër optik. Kapaciteti total i centralit të postës së Kaçanikut gjithsej 4500 qifte, prej të cilave 890 shfrytëzohen, ndërsa pjesa tjetër janë të pa shfrytëzuara.
Kërkesa e telefonisë së re është duke u përmbushur nga operatorët e rrjetës së telefonisë mobile siç është VALA dhe IPKO. Gjithashtu në komunë funksionon edhe rrjeti i internetit nga VALA, Kujtesa, Elektra dhe IPKO.

### 4.7.2. Personat juridik

**Shërbimet e Internetit** – Ekzistojnë disa operator të cilët bëjnë shpërndarjen e shërbimeve të internetit në zonën urbane të Kaçanikut, të cilët e mbulojnë shumë mirë tërë territorin e zonës urbane. Kryesisht interneti në zonën urbane është i shpërndarë në, lidhje individuale dhe lidhjeve të institucioneve të caktuara

| Nr. | Institucioni | Tel. Kontaktues | Adresa elektronike |
|---|---|---|---|
| 1 | **PTK** | | info@telekomi.net<br>**info@valamobil.com** |
| 2 | **IPKO** | **080070070** | **info@ipko.com** |
| 3 | **Kujtesa** | | **ofice@kujtesa.com** |
| 4 | **Elektro** | **049/598-266 0290/385-385** | **ntp_elektra@hotmail.com** |

**Tabela 66:** Lista e përsonave juridik në telekomunikacion:

### 4.7.3. Qendrat telekominikuese transmetuese dhe repetitorët

Në komunë e Kaçanikut ndodhen gjithësej 7 antena 3 të operatorit Vala 3 të operatorit IPKO dhe një e PTK-së.

Operatorët me ndikim më të madh, që ofrojnë shërbime të internetit janë:

- **PTK** - Darda NET, nëpërmjet të telefonisë fikse;
- **IPKO** – ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave (individuale);
- **KUJTESA** - ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave (individuale); etj.

**Shërbimet Postare**

- në zonën urbane të Kaçanikut shpërndahet e klasifikuar sipas rrugëve dhe adresave të cilat janë të evidentuara në bazën e të dhënave të PTK-së, njësia në Kaçanik.

**Harta 19:** *Shpërndarja e antenave të telefonisë mobile,* ***aneksi i hartave***

### 4.7.4. TV dhe radiostacionet

**Radiotelevizioni** – Rrjeta e Radiotelevizionit në zonën urbane të Kaçanikut është e shpërndarë pothuajse në tërë territorin e zonës. Ekzistojnë disa forma të shfrytëzimit të valëve radio-televizive të ndara në dy grupe:

1. Radio-televizionet Nacionale – RTK, RTV21, TV Klan dhe KTV,
2. Radio- lokale – Radio Kaçaniku, (nuk funksionon)
3. Radio-televizionet nëpërmjet antenave Satelitore,
4. Radio-televizionet nëpërmjet sistemeve kabllore.

Informacioni është çdo lloj lajmi, i cili bën të mundur komunikimin e ndërsjellë përmes të shkruarit, të folurit etj. Informacioni është diçka që mund të mësojmë, njohim apo kuptojmë. Kriteret bazë të klasifikimit të mediave përcaktohen kryesisht nga forma se si i ofrohen ato konsumatorit mediatik për tú shfrytëzuar. Mediatklasifikohen kryesisht në katër grupe kryesore të cilat janë:

1. Mediat televizive
2. Mediat radiofonike
3. Mediat e shkruara
4. Mediat sociale (interneti).

## 4.8. Sistemet hidroteknike

### 4.8.1. Objektet për furnizim me ujë

Bazuar në Planin Zhvillimor Komunal, në kuadër të drejtorisë së shërbimeve publike dhe emergjencës janë bërë llogari të shpenzimeve dhe kapacitetit të nevojshëm të ujit të pijes për banoret e kësaj zone e cila duhet të jetë në harmoni me kërkesat për furnizim me ujë të pijes për qytetin e Kaçanikut dhe fshatrat e sajë, me qëllim të realizimit të projekteve si pjesë integrale e Planit të Veprimit të komunës së Kaçanikut meqë rast parashihet zgjërimi i rrjetit të ujësjellësit në territorin e komunës, në koordinim dhe bashkëveprim me K.R.U. "Bifurkacioni".

Pjesa më e madhe e territorit të komunës së Kaçanikut furnizohet me ujë të pijes, i cili ka shtrirje në 26 vendbanime, derisa pjesa tjetër e vendbanime nuk kanë qasje në rrjetën e furnizimit kolektiv me ujë të pijes.
Resurset ujore janë kryesisht burime natyrore dhe ndodhen në pjesën e identifikuar si zona e vlerave natyrore perëndimore. Një pjesë e konsiderueshme e popullatës të komunës kanë sisteme lokale, të cilat nuk menaxhohen nga KRU "Bifurkacioni". Këto sisteme lokale e marrinë ujin nga burimet natyrore dhe shpimet nëntokësore. Të gjitha këto resurse ndodhen në pjesën e identifikuar si ZONA E ZHVILLIMIT AKTIV. Nga këto sisteme, në bazë të sasive të ujit, që momentalisht janë në dispozicion, konsumimi mesatar ditor për banor, vlerësohet të jetë përafërsisht 200-250 litra në ditë
Rrjeti kryesor i sistemit të ujësjellësit nga burimi deri te rezervuari kryesor shtrihet në terren me konfiguracion mjaftë të pjerrët në të cilin janë të shpërndara në 14 odat ndërprerëse të cilat kanë funksion të rregullimit të presionit të rrjedhjes së ujit. Këto oda ndërprerës janë të gjitha me dimenzione **3.20x3.40m.**
Qytetarët e komunës së Kaçanikut furnizohen me ujë të pijshëm në tri forma:
1. sistemi qendror i furnizimit-ujësjellësi,
2. sistemet e vogla -ujësjellësit lokal,
3. puset individuale
Burimet e marrjes së ujit për qendrëm urbane dhe 4 fshatra janë këto: (" Uji i Bardhë" Lybeten, "Reka e Kafexhisë" Lybeten, "Burimi i Shtrazës" Lybeten, Burimi "Përroi i Madh_1"- Ivajë dhe Burimi "Përroi i Madh_2"- Ivajë), ku uji merret nga këto burime me anë të veprave të marrjes me ramje të lirë nëpërmjet tubacioneve dhe veprave të rrjetit deri në rezervuarin aktual i cili ka kapacitet **V=500.00m³** ku nga rezervuari furnizohet pjesa urbane dhe vendbanimet: Bob, Kovaçec, Runjevë dhe Shtrazë.
Ndërsa rezervuari i ri i cili është ndërtuar me kapacitet **V=1000.00m³** në një disnivel më të lartë në mënyrë që të mbulon tërë pjesën urbane, në vitin 2021 është lëshuar në funksion.




**Figura 1.** Skema e sistemit të furnizimit me ujë për qytetin e Kaçanikut

| | Vendbanimet | Burimi dhe Kapaciteti | Nr i Banorëve | Kyçje Shtëpiake në databazë | Gjatesia (l) |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Qyteti Kaçanikut | 27-36 l/s | 10,393 | 2,690 | **22,600 m** |
| 2 | Shtrazë | 27-36 l/s | 258 | 54 | **600 m** |
| 3 | Bob | 27-36 l/s | 1,606 | 334 | **800 m** |
| 4 | Kovaqec | 27-36 l/s | 1,030 | 284 | **2,500 m** |
| 5 | Runjevë | 27-36 l/s | 698 | 168 | **4,000 m** |
| | ***TOTALI :*** | | ***14175 banorë*** | ***4127 ek. familj.*** | **30.500m** |

**Tabela 67:** Furnizimi me ujë i zonës urbane dhe 4 fshatrave

### 4.8.2. Korporatat rajonale të ujërave ( KRU) dhe burimet alternative

Aktualisht, KRUK ‘ Bifurkacioni’ Sh. A. e cila është ofruesi kryesor me ujë të pijshëm në komunën e Kaçanikut, e cila ofron shërbime për pjesën e qytetit dhe fshatrave te cilat furnizohen nga burimet dhe shpimet me puse. Koha e furnizimit me ujë të pijshëm është 24 orë.

Uji i ofruar për zonën e shërbimit të cilën e menaxhon KRUK “Bifurkacioni” i plotëson standardet e ujit të pijshëm sipas rregullores, respektivisht standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) dhe rregulloreve dhe normave të IKSHP.

### 4.8.3. Sistemi i distribuimit të ujit për pije

Qyteti i Kaçanikut dhe disa fshatra për rreth furnizohen me ujë të pijes nga tre vend- burime rrëzë Lybetenit dhe dy vend-burimeve afër fshatit Ivajë. I gjithë sistemi është me ramje të lirë dhe uji akumulohet në rezervarin akumulues që do ti plotësoj nevojat e qytetarëve për furnizim me ujë të pijes. Nga rezervuari aktual dhe ai i ri i rrjetit të ujësjellësit furnizohet pjesa urbane e qytetit dhe fshatrat me paralagjet e tyre : Strazhë, Kovaqec, Runjevë dhe Bob .
Gjendja aktuale e sistemit të ujësjellësit është deri diku e kënaqme pasi që kemi humbje të mëdha të ujit, keqpërdorime të ndryshme nga kyqjet ilegale, defekte të shumta etj.
Një segment i rrjetit të ujësjellësit nga materiali Azbest çimento me gjatësi përafërsisht L=500.00m gjatë vitit 2021-2023 është zëvendësuar me gyp plastike PE.




**Harta 20 :***Burimet e ujit, kapacitetet dhe rezervoarët*

Me zgjerimin e rrjetit, shtohen nevojat e përdoruesve të ujit prandaj duhet të identifikohen burimet e reja, të kaptohen në mënyrë që të shtohet sasia e ujit.

Kapaciteti i Burimeve të ujit dhe sasitë e nxjerrjes apo kapjes sipas KRUK "Bifurkacioni" janë:

| NR. | vendndodhja | Sasia l/sec. | m³ / në ditë |
|---|---|---|---|
| 1 | Uji i Bardhë" Lybeten | 10-12 | 864-1036,80 |
| 2 | Reka e Kafexhisë" Lybeten | 8-10 | 691.20-864,00 |
| 3 | Burimi i Shtrazës" Lybeten | 3-5 | 259,20-432,00 |
| 4 | Burimi "Përroi i Madh_1 | 4-6 | 345,60-518,40 |
| 5 | Burimi "Përroi i Madh_2 | 2-3 | 172,80-259,20 |

**Tabela 68:** Kapaciteti i burimeve të ujit dhe sasitë e nxjerrjes apo kapjes

Të gjitha këto burime apo kaptime të ujit të pijes nëpërmjet sistemit të rrjetit të ujësjellësit dhe elementeve përcjellëse dërgohen deri te konsumatori për konsumim.

Në kuadër të nevojës për analizën e gjendjes ekzistuese të sistemit të ujësjellësit dhe furnizimit me ujë të pijes për qytetin, pjesëve urbane dhe rurale janë të angazhuar ekipe profesionale për të analizuar dhe planifikuar këtë gjendje në mënyrë që në të ardhmen të kemi një sistem të qëndrueshëm të furnizimit me ujë të pijes.

Gjithashtu gjatë dekadës së fundit janë bërë zëvendësime të tubave të vjetra dhe shtrirje e re e rrjetit në mënyrë që të mbulohet i tërë qyteti janë zëvendësuar që nga viti 2000 e këndej ku pjesa më e madhe e zëvendësimeve është bërë gjatë vitit 2004-2010 dhe kryesisht zëvendësimet e bëra janë me diametër të vogël dhe të mesëm. Sistemi shpërndarës i furnizimit me ujë përfshin pjesën urbane:

**Rrjeti shpërndarës ekzistues**
Vendbanimet (fshatrat) që furnizohen me ujë në Komunën e Kaçanikut janë paraqitur në formë tabelore duke përfshirë edhe kapacitetin e burimeve, numrin e kyçjeve shtëpiake, gjatësinë e tubave etj.
Sipas gjendjes ekzistuese rezulton se në pjesën urbane mbulueshmëria e furnizimit me ujë sipas numrit të banorëve arrin 64.25 %.

| Nr | Vendbanimet | Burimi dhe Kapaciteti | Nr i Banorëve | Nr. i ek. familjare | Gjatësia (m) |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Nikaj | 67.5 l/s (Burimet e kaptuara) | 778 | 182 | |
| **2** | Rekë | 67.5 l/s (Burimet e kaptuara) | 652 | 169 | |
| **3** | Dubravë | 67.5 l/s (Burimet e kaptuara) | 2239 | 407 | |
| **4** | Soponicë | 67.5l/s (Burimet e kaptuara) | 1062 | 293 | |
| **5** | Doganaj | 67.5 l/s (Burimet e kaptuara) | 957 | 229 | |
| **6** | Koxhaj | 67.5 l/s (Burimet e kaptuara) | 980 | 178 | |
| **7** | Elezaj | 67.5 l/s (Burimet e kaptuara) | 495 | 109 | **21,857.00** |
| **8** | Sllatinë | 5.0 l/s (Burimi i Sllatines) | 211 | 38 | **3,015.00** |
| **9** | Kaçaniku i Vjetër | 18.0 l/s Pusi me shpim ( Ballkan Petroli) | 1840 | 438 | |
| **10** | Begracë | 18.0l/s Pusi me shpim ( Ballkan Petroli) | 1936 | 499 | **6,010 .00** |
| **11** | Glloboshicë | 4.0 l/s | 1287 | 258 | **5,500.00** |
| **12** | Stagovë | 8.0 l/s Pusi me shpim (Koxhaj) | 1160 | 283 | **5,250.00** |
| | | | **13.597 banorë** | **2645 ek. familj.** | |

**Tabela 69:** Vendbanimet të cilat kanë sistem të furnizimit dhe menaxhohen nga KURK**"Bifurkacioni"**

**Ortofoto 21**: *Skema e sistemit të furnizimit me ujë për qytetin e Kaçanikut,* ***aneksi i hartave***

**Burimet alternative të ujit për pije**

**Burimet e furnizimit për pjesën rurale**
Burimet kryesore të furnizimit me ujë të fshatrave të Kaçanikut janë burime të cilat shfrytëzohen përmes puseve me anë të sistemit të pompimit thithës, këto burime dhe puse ndodhen në zona të caktuara të cilat janë paraqitur në tabelën vijuese dhe po ashtu janë paraqitur edhe në hartën e burimeve të ujit:

| Nr | Emri i Vendburimeve | X | Y | Z mnm |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Kepi i Tushës 1 | 7511829.66 | 4675663.15 | **1673.92** |
| 2 | Kepi i Tushës 2 | 7511913.48 | 4675673.25 | **1654.71** |
| 3 | Kepi i Tushës 3 | 7511985.48 | 4675672.73 | **1636.77** |
| 4 | Kepi i Tushës 4 | 7511817.76 | 4675716.81 | **1647.15** |
| 5 | Katër Lisat | 7512193.98 | 4675985.62 | **1570.18** |
| 6 | Uji I Bardhë | 7511185.60 | 4675446.57 | **1786.80** |
| 7 | Vatha e Koxhës | 7510600.72 | 4676426.01 | **1675.95** |
| 8 | Stanet e Koxhajve 1 | 7510809.12 | 4677614.00 | **1536.22** |
| 9 | Stanet e Koxhajve 2 | 7510810.31 | 4677582.38 | **1545.57** |
| 10 | Stanet e Koxhajve 3 | 7510919.53 | 4677572.55 | **1544.49** |
| 11 | Stanet e Koxhajve 4 | 7511143.59 | 4677708.25 | **1478.21** |
| 12 | Burimet e Sllatinës | 7512066.37 | 4678015.57 | |
| 13 | Burim_1 | 7513238.45 | 4674873.19 | |
| 14 | Burim_2 | 7513255.58 | 4674983.14 | |
| 15 | Kroni i Ftoft | 7514233.85 | 4676801.70 | **974.85** |
| 16 | Kepi i Grremit | 7514675.78 | 4676789.59 | **894.27** |
| 17 | Kepi i Dhisë | 7514881.64 | 4677015.09 | **867.88** |
| 18 | Pusi me shpim Stagove | 7513906.05 | 4683011.96 | |
| 19 | **Pusi me shpim K. Vjeter - Begracë** | 7517363.92 | 4684158.93 | **590.72** |
| 20 | **Vepra e Marrjes - Gllobоçicë** | **7514398.47** | **4672203.96** | |

**Tabela 70:** Burimet dhe puset me shpime

| Nr | Vendbanimet | Burimi dhe Kapaciteti | Nr i Banorëve | Nr. i ek. familjare | Gjatësia (m) |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Semajë | 0.3 l/s | 193 | 50 | **2000.00 m** |
| 2 | Bajnica | 0.02 l/s | 800 | 115 | **7000.00 m** |
| 3 | Duraj - Gabrricë | 1.5 l/s | 944 | 140 | **12.000 m** |
| 4 | Gërlica e Epërme | 1.5 l/s | 387 | 65 | |
| 5 | Kotlinë | 1.0 l/s | 416 | 124 | |
| 6 | Ivaja | 2.0 l/s | 596 | 74 | **2500.00m** |
| 7 | Gajra | 1.0 l/s | 574 | 108 | **2000.00m** |
| 8 | Biçeci | 2.5 l/s | 1496 | 324 | **23,000.00m** |
| | | | **5081 banorë** | **1103 ek.familjare** | |

**Tabela 71:** Vendbanimet që kanë sistem të furnizimit, por që menaxhohen nga vetë banorët

| Nr | Vendbanimet | Burimi dhe Kapaciteti | Nr i Banorëve | Nr i ek. familjare | Gjatësia (m) |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Nikoci | Ska shenime | 7 | 1 | x |
| 2 | Drenogllava | Ska shenime | 34 | 11 | x |
| 3 | Korbliq | Ska shenime | 124 | 31 | x |
| 4 | Gjurgjedelli | Ska shenime | 436 | 47 | x |
| **Totali:** | | | **601 banorë** | **90 ek. familjare** | x |

**Tabela 72:** Vendbanimet që nuk kanë rrjet të ujësjellësit

| Vendi i marrjes së mostrës:BiO3/Kaçanik- Kuvendi Komunal | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Pika e mostrimit** | **Nr. i most. kim .** | **Poz. Kim.** | **%** | **Paramet.** | **Nr.i most. Bak.** | **Poz. Bakt.** | **%** | **Paramet.** | **CI.** |
| **1** | Ujësjellës local R1/R2 | 3 | | | **NTU 1.5** | **3** | **20** | | | 0.089 |
| | **Totali** | **3** | | | | **3** | **20** | | | |

**Tabela 73:** Vendi i marrjes së mostrës- BiO3/ Kaçanik – Kuvendi komunal

Nga të gjitha të dhënat e paraqitur sipër, rezulton se nga 30 fshatra sa ka komuna e Kaçanikut:

- 26 fshatra kanë sistem të ujësjellësit,
- 4 fshatra nuk kanë ende sistem të ujësjellësit

### 4.8.4 Monitorimi i ujërave për pije

Për ujësjellësin urban të Kaçanikut, marrja e mostrave bëhet dy (2) herë në muaj me 10 mostra për analizë bakteriologjike dhe 6 për analizë kimike.

**Rezultatet e analizave tremujori II 2022 në aspektin fizik kimik dhe bakteriologjik nga IKSHPK-ja**[4]

| Vendi i marrjes së mostrës:BiO3/Kaçanik- Sheshi Ismajl Raka | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Pika e mostrimit** | **Nr. i most. kim .** | **Poz. Kim.** | **%** | **Paramet.** | **Nr.i most. Bak.** | **Poz. Bakt.** | **%** | **Paramet.** | **CI.** |
| **1** | Ujësjellës local R1/R2 | 3 | | | | **3** | **10** | | | 0.085 |
| | **Totali** | **3** | | | | **3** | **10** | | | |

| Vendi i marrjes së mostrës:BiO3/Kaçanik- KRU-Bifurkacioni- Kaçanik | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Pika e mostrimit** | **Nr. i most. kim .** | **Poz. Kim.** | **%** | **Paramet.** | **Nr.i most. Bak.** | **Poz. Bakt.** | **%** | **Paramet.** | **CI.** |
| **1** | Ujësjellës local R1/R2 | 3 | **1** | | **NTU 1.5** | **3** | **24** | | | 0.088 |
| | **Totali** | **3** | **1** | | | **3** | **24** | | | |

| Vendi i marrjes së mostrës:BiO3/Kaçanik- Lagja Dushkaja | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Pika e mostrimit** | **Nr. i most. kim .** | **Poz. Kim.** | **%** | **Paramet.** | **Nr.i most. Bak.** | **Poz. Bakt.** | **%** | **Paramet.** | **CI.** |
| **1** | Ujësjellës local R1/R2 | 3 | | | **NTU 1.5** | **3** | **10** | | | 0.101 |
| | **Totali** | **3** | | | | **3** | **10** | | | |

| Vendi i marrjes së mostrës:BiO3/Kaçanik- SHFMU Qamil Ilazi | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Pika e mostrimit** | **Nr. i most. kim .** | **Poz. Kim.** | **%** | **Paramet.** | **Nr.i most. Bak.** | **Poz. Bakt.** | **%** | **Paramet.** | **CI.** |
| **1** | Ujësjellës local R1/R2 | 3 | | | | **3** | | | | 0.104 |
| | **Totali** | **3** | | | | **3** | | | | |

**Tabela 74 :**Rezultatet e analizave tremujori II 2022 në aspektin fizik kimik dhe bakteriologjik nga IKSHPK-ja

[4] Raport i punës tremujori II 2022 Njesia Operative Kaçanik

Në komunën e Kaçanikut gjatë vitit 2022, janë mostruar 170 ujëra nga të cilët 148 janë të rregullta ose 87 % kurse 22 kimikisht jo të rregullta ose 13 %.
Janë mostruar 133 ujëra nga ujësjellësi nga të cilët 127 kanë qenë të pijshëm ndërsa 6 jo të pijshëm Është bërë mostrimi i ujit të 36 puseve, nga të cilët 16 ishin jo të rregullta, ndërsa 20 ishin kimikisht në rregull..

### 4.8.5. Ndotësit e mundshëm të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor

Ndotja e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor në Komunën e Kaçanikut paraqesin përroskat ose gropat septike të cilat nuk janë të ndërtuara sipas kritereve standarde e që paraqesin rrezik për ndotjen e puseve, uji i të cilëve përdoret për pije, në veçanti lumi Nerodime sidomos pjesa që kalon në territorin e Ferizajit, ku për shkak të mungesës së impiantit në këtë Komunë, të gjitha ujërat e zeza derdhen në këtë lumë duke vazhduar në territorin e Komunës së Kaçanikut dhe duke sjellë mbeturina dhe fekale që kundërmojnë dhe janë të padurueshme sidomos gjatë sezonës së verës.

Sa i përket vendbanimeve, prinë Kaçaniku me 2690 shfrytëzues (48,50%), dhe Begracë me 325 shfrytëzues (5,90%). Shikuar përgjithësisht, menaxhimi i mbeturinave ende paraqet problem të pazgjidhur plotësisht, pasi ende ka shfaqje të deponive ilegale, që janë ndër ndotësit kryesorë të tokës dhe ujit në komunë.

| Numri i shfrytëzuesve | | Përqindja % |
|---|---|---|
| Numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të shërbimit të mbeturinave në komunë | 5,671 | 100 |
| amvisëri | 5,364 | 94.6 |
| shfrytëzuesit komercial | 272 | 4.8 |
| shfrytëzuesit publik | 35 | 0.6 |

**Tabela 75:** Numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të shërbimit të mbeturinave
*Burimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike 2022*

**Mbeturina industriale - Zona e I-rë** është zonë e mbrojtjes së regjimit të rreptë e përcaktuar për mbrojtje të rreptë dhe të drejtpërdrejtë. Kërkohet vendosja e rrethojave prej të paktën 10 m nga kokat e puseve. Këto rrethoja duhet të rehabilitohen në të gjitha rastet e mësipërme dhe duhet të vendosen tabelat me shenja. Rekomandohet një rishikim i duhur i kapakëve të puseve i cili e parandalon ndotjen e puseve. Në rrethoja duhet të instalohet një tabelë që e informon publikun për kufizimin.

**Në Zonën e II**-të e gjithë infrastruktura dhe aktivitetet që mund të dëmtojnë infrastrukturën e furnizimit me ujë ose ndotjen e burimet të ujit janë të ndaluara. Pronarët e puseve private duhet të jenë të informuar dhe të detyruar t'i mbyllin puset e tyre. Më tej, të gjitha deponitë e mbeturinave duhet të largohen dhe tabelat me shenjat/shkrimet standarde duhet të vendosen në rrugët që janë në zonën e kufizuar.

**Zona e III-të** (zonë e mbrojtur sanitare) përbën ujëmbledhësin dhe disa rrathë mbrojtës të pusit. Të gjitha ujërat që infiltrohen në këtë zonë arrijnë në pus dhe pompohen në sistemin shpërndarës. Meqenëse zona është mjaft e gjerë, numri i burimeve të mundshme të ndotjes është i madh.

**Mbeturina mjekësore**

Në bazë të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027 Komuna - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të sigurojë dhe vendosë kontejnerë për hedhjen e barnave të papërdorura dhe me afat të skaduar direkt nga qytetarët.

Deri më tani nuk është bërë trajtimi dhe klasifikimi i tyre. Edhe pse si mbeturina mjaft të rrezikshme, ato grumbullohen në kontejner të llojit 1,1m,³ dhe deponohen bashkë me mbeturinat e amvisërisë: sasia e tyre sillet rreth 2.5ton /muaj

Prodhuesit e mbeturinave medicinale publike dhe private, gjatë aktivitetit të tyre të kujdesit shëndetsorë, do të hudhin mbeturinat e tyre në mënyrë të klasifikuar mbeturinat sipas llojeve në kontejnerë, enë apo thasë përkatëse të siguruar nga vetë ata, deri sa të grumbullohen nga operatori i licencuar që i përpunon dhe i menaxhon ato. Inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë do të siguroj zbatimin e këtij obligimi ligjor.
Operatorët publik dhe privat, si prodhues të mëdhenjë të mbeturinave medicinale të rrezikshme do të hartojnë planin për menaxhimin e mbeturinave medicinale dhe ekzistenca e këtij plani dhe zbatimi i tij do të kontrollohen nga inspekcioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë.[5]

**Mbeturinat shtëpiake**
Në komunën e Kaçanikut, organizmi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave bëhet në kuadër të kompanisë regjionale të mbeturinave KRM "Pastërtia" me seli në Ferizaj. Mbulimi i zonës, e shprehur në përqindje 80%[6] prej amvisërive. Kjo ka mundësuar pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë në sektorin e menaxhimit të mbeturinave në disa lokalitete. Operatori dytë i përfshirë në sektorin e MM, N.P. "Krasniqi" është prezent në lokalitetet para urbane: **Kaçanik i Vjetër, Begracë dhe Doganaj.**

| Operatorët e mbeturinave nën përgjegjësi komunale | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Emri i operatorit (biznesit) | Forma e pronësisë | Kategoria e menaxhuar e mbeturinave | Mbulimi me shërbim % | Statusi i kontraktimit (po/jo) |
| **Operatori 1** | KRM "Pastërtia" | Publike | Komunale dhe Shtazore | 69.1 | Po |
| **Operatori 2** | N.P. "Krasniqi" | Private | Komunale | 10.8 | Po |

**Tabela 76:** Operatorët e mbeturinave nën përgjegjësi komunale
Në territorin e komunës së Kaçanikut, nuk ka deponi sanitare të mbeturinave. Operatorët për menaxhimin e mbeturinave KRM –"Pastërtia" dhe NP "Krasniqi", sipas nevojës për deponimin e mbeturinave shfrytëzojnë Deponinë Sanitare të Mbeturinave në Velekincë të Gjilanit apo Deponinë Sanitare në Mirash të Obiliqit, që menaxhohen nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë – KMDK.

**Për menaxhimin e mbeturinave shtazore, medicinale dhe kategorive tjera të mbeturinave** nuk ofrohet ndonjë praktikë standarde e menaxhimit të tyre. Kjo për shkak se komuna nuk ka gjenerim të madh të këtyre llojeve të mbeturinave dhe rrjedhimisht nuk ka procedurë standarde. Mbeturinat medicinale kryesisht menaxhohen nga ministria, kurse për të tjerat kategori nuk ka gjenerim të madhë.

[5] Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027
[6] Raporti për menaxhimin e mbeturinave komunale 2021, AMMK 2022

### 4.8.6. Masat parandaluese ndaj ndotjes së ujit

Masat që duhet ndërmarrë për parandalimin e ndotjës së ujërave janë të shumta, por do të adresohen disa që janë më kryesore;

- Hartimi i një Plani lokal për parandalimin e ndotjës së burimeve ujore;
- Të identifikohen të gjithë ndotësit potencial të ujërave;
- Për shkelsit e ligjit për mbrotjën e ujërave të marren masat për parandalimin dhe penalizimin e tyre nga Inspektorët përgjegjës ;
- Monitorimi i vazhdueshëm i ujërave të ndotura;
- Trajtimi i ujërave për arritjen e përputhshmërisë me standardet normative vendore;
- Dhënia e lejeve të shfrytëzimit të ujit për hidrocentrale vetëm ne raste kur nuk e dëmton eko-sistemin ujor te lumenjve dhe respektimin e minimumit biologjik;
- Shmangie nga çfardo lloj shkarkimi të pesticideve, vajrave dhe kemikateve të rrezikshme në ujëra;
- Ndalimi i hudhjes së mbeturinave afër çdo burimi të ujërave, etj;

### 4.8.7. Rekomandimet:

- Implementimi i infrastrukturës ligjore të ujërave;
- Kompletimi dhe modernizimi i sistemit për monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor;
- Nevoja për investime kapitale në infrastukturën për trajtimin e ujërave urbane;
- Rritja e kapaciteteve dhe avansimi i sistemit të ujësjellësve;
- Përmirësimi dhe shtrirja e rrjetit për trajtimin e ujërave urbane dhe industriale;
- Masat për parandalimin e humbjës së ujërave në rrjet;
- Hulumtime në fushën e ujërave, s idomos resurseve ujore nëntokësore;
- Ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore;
- Ngritja e vetdijësimit në komunitetin e biznesit dhe ekonomive familjare për shfrytëzimin racional të ujërave;
- Vlerësimi dhe prioritizimi i nevojave për investime në infrastrukturën e ujërave.

## 4.9. Sistemet e shpërndarjes së gazit dhe naftës

### 4.9.1. Pompat e derivateve

Në territorin e Komunës së Kaçanikut janë të shpërndara gjithësej 13 pika të shitjes së karburanteve të cilat veprimtarinë e tyre e ushtrojnë shumica skaj rrugës magjistrale si dhe në disa qendra të vendbanimeve. Deri më tani nuk kemi pasur të evidentuar asnji rast zjarri në këto pika të shitjes, edhe pse disa nga këto pika të shitjes nuk i plotësojnë kushtet e teknike të kërkuara me ligj.

**REGJISTRI I PIKAVE TË KARBURANTEVE NË KOMUNËN KAÇANIK**

| Nr. | Emri i kompanisë (personi fizik apo juridik) | Emri dhe mbiemri i personit pergjegjës dhe nr. i tel | Adresa dhe Komuna | Lokacioni i objektit | Pëlq. në Lok. nga AME | Pëlq. në Doku-mentac. | Pranimi teknik i objektit | Kapaciteti i derivateve | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Naftë- litra | Benzin litra | GLN litra |
| 1 | IP – KOS | Asmir Dema 044 225 246 | Kaçanik Hyrje - dalje | Pran varrezave të qytetit Kaçanik | Po, i përkohshëm | ? | Jo | 100.000 | 50.000 | 5000 |
| 2 | NTSH “Bujari” | Samir Krivanjeva 044 620 147 | Nikaj Kaçanik | Rruga magjistrale Kaçanik – Ferizaj, kilometri i 3-të | Po | Po | Jo | 50.000 | 30.000 | Jo aktiv |
| 3 | Liria Petrol | Nexhmedin Zenuni 044 166 240 | Duraj (rruga për Shtërpc) Kaçanik | Kaçanik – Shtërpc Kilometri i 10-të | Po | Po | Jo | 60.000 | 60.000 | 7000 |
| 4 | AL Blero SHPK | Adnan Vishi 044 808 433 | Dubravë Kaçanik | Fshati Dubravë | Po | Po | Jo | 30499 | 30496 | 5000 |
| 5 | Bubeari Petrol 1 | Naser Guri 044 711 567 | Nikaj Kaçanik | Rruga magj: Kaç. Feri., kilometri i 4 | Po | Po | Jo | 174.221 | 57.022 | 15m3 |
| 6 | Shkëndija SHPK | Xhafer Zharku 044 142 054 | Fushë e Pajtimit Kaçanik | Fush e Pajtimit,-Doganaj, kilometri. i 1-rë | Po | Po | Jo | 150.000 | 50.000 | 7500 |
| 7 | Vata Petrol | Hajriz Mema 044 173 070 | Dubravë Kaçanik | Rruga magj. Kaç. Glloboqic, km. 15-të | ? | ? | Jo | 60.000 | 60.000 | 15.000 jo aktiv |
| 8 | NTP Veda Petrol | Zymer Miftari 044 655 554 | Begracë Kaçanik | Rruga Regj. Kaç.- Viti, km. i 15 -të | Po | Po | Jo | 80.000 | 40.000 | 5000 |
| 9 | Inex Petrol 1 | Ilaz Zharku 044 121 218 | Dushkajë Kaçanik | Rruga magj. Kaça. - Ferizaj, kilometri. i 3-të | Po | Po | Jo | 30.000 | 30.000 | 7000 |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **10** | Inex Petrol 2 | Ilaz Zharku | Rruga A. Bajrami Kaçanik | Rruga “Agim Bajrami” p.n. | Po | Po | Jo | 10.000 | 10.000 | S’ka |
| **11** | UDA SHPK | Arsim Kolshi | Doganaj Kaçanik | Rruga Kaçanik – Tetovë. | Po | Po | Jo | 80.000 | 40.000 | S’ka |
| **12** | Ballkan Petrol | Imri Haliti dhe Zenel Haliti | Kaçanik i Vjetër Kaçanik | Magjist. Kaçanik – Prishtinë, kilometri i 10-të | Po | Po | Jo | 12.000 | 60.000 | 10 m3 |
| **13** | Buberi Petrol 2 | Naser Guri 044 711 567 | Nikaj Kaçanik | Nikaj- Biçec | Po | Po | Jo | 30.000 | 30.000 | 7000 |

**Tabela 77:** Regjistri i pikave te derivateve te naftës (naftë, benzinë dhe GLN)

**Harta 22.** *Pikat e karburantit në Komunën e Kaçanikut, **aneksi i hartave***

Për sa i përket sigurimit të të dhënave për Stacionet e karburanteve për shitje me pakicë (naftë – benzinë) dhe rezervuarëve të GLN gjatë kësaj kohe, në dy raste, ka qenë e pamundur të sigurohen të dhëna të sakta nga shkaku i mungesës së personit përgjegjës. Në këto raste është vendosur shenja pikëpyetje, por që ditëve në vazhdim do të plotësohen edhe këto të dhëna. Po ashtu është vërtetuar që brenda këtij viti apo vitit paraprak, aktivitetin biznesorë e kanë ndërprerë disa Stacione derivatesh dhe ato të GLN. Psh. 2 raste të mbylljes së aktivitetit me derivate i kemi në fshatin Begracë, një në fshatin Rakaj dhe një në fshatin Dubravë, kurse GLN është pasiv në “Fontana 92” dhe në Bujari SHPK[7].

Është vërtetuar se është mbyllur edhe pompa tjetër në Begracë (Izahir Luzha)

### 4.9.2. Deponitë e derivateve /kapacitetet

Në komunën e Kaçanikut, veprimtarinë e tyre e zhvillojnë 13 pika karburanti (aktive) dhe 11 rezervuarë GLN (aktivë).

| Nr. | GLN (Propan butan) | Naftë: | Benzinë | Prodhohet poashtu edhe CO2 |
|---|---|---|---|---|
| 1. | 95000 | 874.221 L. | 547.491 L. | ( rreth 40 ton rezervuari, acetileni e të ngjashme). |

**Tabela 78:** Kapacitetet e derivateve në Komunën e Kaçanikut

[7] Shënime të marra nga Inspektori i Parandalimit dhe Hetuesisë ndaj Zjarrit

# KREU i V-të

## 5. OBJEKTET E RËNDËSISË SË VEÇANTË

Sikurse komunat tjera edhe Komuna e Kaçanikut nuk bën përjashtim të ekspozimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore, por duke mos e përjashtuar edhe rrezikun nga faktori njeri, qoftë si rrjedhojë e proceseve tekniko-teknologjike qoftë edhe ato të qëllimshme, andaj edhe objektet e rëndësisë së veqantë kanë rol dhe rëndësi jetike në paqë dhe në rrethana të krijuara nga FNFT.

| Nr. | Emri i Objektit | Lokacioni/ adresa | Aset | Lokacioni/ koordinatat |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Objekti i Komunës | Rr. “Qamil Ilazi” Kaçanik | KK Kaçanik | X=7521341.210 Y=4676486.700 |
| 2 | Policia e Kosovës | Rr. “Hasan Prishtina” Kaçanik | MPB | X=7521329.170 Y=4676550.820 |
| 3 | Shtëpia e Shëndetit –(QKMF) | Rr.”Ismail Raka“ Kaçanik | KK Kaçanik | X=7521143.250 Y=4677289.460 |
| 4 | Njësia Profesionale e Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit – (NJPZSH) | Rr.”Qamil Ilazi Kaçanik” | KK Kaçanik | X=7521349.480 Y=4676512.510 |
| 5 | Shtëpia e Kulturës ”Xheladin Kurtaj” | Rr.”Ismail Raka“ Kaçanik | KK Kaçanik | X=7521153.200 Y=4677379.110 |
| 6 | Objekti e Gjykatës Komunale | Rr.”Ismail Raka“ Kaçanik | KK Kaçanik | X=7521150.530 Y=4677379.060 |
| 7 | Posta e Kaçanikut | Rr. “Qamil Ilazi” Kaçanik | Post telekomi i Kosovës | X=7521342.080 Y=4676570.290 |
| 8 | Palestra Sportive | Rr. “ Vëllezërit Çaka” Kaçanik | KK Kaçanik | X=7521000.510 Y=4676479.510 |
| 9 | Gjimnazi ”Skenderbeu” | Rr.”Skenderbeu” Kaçanik | KK Kaçanik | X=7521087.400 Y=4676757.230 |
| 10 | Shkolla e Mesme Profesionale “Vëllezërit Çaka dhe Feriz Guri” | Rr.“ Vëllezërit Çaka” fshati Bob | KK Kaçanik | X=7520515.750 Y=4676892.600 |
| 11 | Shkolla Fillore “Emin Duraku” | Rr. “Sali Bajra” Kaçanik | KK Kaçanik | X=7521249.010 Y=4677217.310 |
| 12 | Shkolla Fillore “Emin Duraku”-Dushkajë | Rr. “Emsale Frangu” Kaçanik | KK Kaçanik | X=7520813.460 Y=4677733.790 |
| 13 | Qendra e Arsimit Parashkollor ”Agimi” | Rr.”Daut dhe Adem Rakoci - Kaçanik | KK Kaçanik | X=7521232.850 Y=4677152.820 |
| 14 | Shkolla fillore “ Idriz Seferi | Rr. “Muhamet Zeneli” Fshati Bob | KK Kaçanik | X=7520799.072 Y=4676546.714 |
| 15 | Shkolla fillore “ 7 Shtatori” | Rr. “ Komandant Bardhi” Fshati Begracë | KK Kaçanik | X=7520400.830 Y=4686156.360 |
| 16 | Stacioni i trenave | Rr. ‘Skenderbeu” Kaçanik | KK Kaçanik | X=7521071.970 Y=4677094.370 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **17** | Stacioni i autobusave | Rr.“ Vëllezërit Çaka” Kaçanik | KK Kaçanik | X=7521074.050 Y=4676553.630 |
| **18** | Shkolla fillore “ Komandant Bardhi” | Rr. “Komandant Bardhi” Fshati Kaçanik i Vjetër | KK Kaçanik | X=7518787.580 Y=4684288.680 |
| **19** | Xhamia “Koxha Sinan Pasha” | Rr. “Qamil Ilazi “ Kaçanik | Trashigimi Kulturore | X=7521253.565 Y=4676493.255 |
| **20** | Objekti i sistemit të furnizimit me ujë të pijes së qytetit | Fshati Bob | KK Kaçanik | X=7520651.240 Y=4675720.650 |
| **21** | Objekti i sistemit të furnizimit me ujë të pijes në Sepetin | Rr. “AbdylGafurr Luma“ Fshati Dubravë | KK Kaçanik | X=7515571.162 Y=4678548.775 |
| **22** | Objekti i Kompanisë rajonale KRM “Pastërtia” Njësia Kaçanik | Rr. “Hamzë Jashari” Kaçanik | KK Kaçanik | X=7519948.100 Y=4677954.260 |
| **23** | Objekti i KEDS-sit | Rr. ”Dëshmorët e Lirisë” Kaçanik | KEDS-i | X=7521035.930 Y=4676795.210 |
| **24** | Objekti i Qendrës së Regjistrimit Civil | Rr. “Qamil Ilazi” Kaçanik | MPB | X=7521354.890 Y=4676524.510 |
| **25** | Kisha ortodokse | Rr. “Agim Bajrami” Kaçanik | Trashigimi Kulturore | X=7521040.610 Y=4677954.260 |

**Tabela 79:** Objektet e Rëndësisë së Veçantë në Komunën e Kaçanikut

## 5.1. Objektet e sigurisë

Siguria si term ka nocion të gjërë por duhet pasur parasysh që është edhe një gamë e gjërë e disa segmenteve të ndëlidhura dhe shumë të rëndësishme , me qëllim të krijimit të një mesi të sigurtë.
Në Komunën e Kaçanikut objekti i stacionit të policisë është i vendosur në qendër të qytetit, në rrugën “Hasan Prishtina” ndërsa Objekti i Njësisë Profesionale të Zjrrfikjes dhe Shpëtimit në rrugën “Qamil Ilazi”, Objekti i Gjykatës Themelore të Ferizait, dega – Kaçanik në rrugën” Ismal Raka” ;

Për koordinimin e aktiviteteve reaguese emergjente dhe lehtësimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjeta, bëhet nga qendra operative rajonale/ objekti i QOE-112 - Gjilan;

Objektet janë të siguruar me roje fizike dhe me sistem të kamerave 24 orë.

## 5.2. Objektet dhe hapësirat qeveritare në Komunën e Kaçanikut

Sikurse komunat tjera edhe Komuna e Kaçanikut nuk bën përjashtim ekspozimit të rrezikshmërisë nga atkeqësitë natyrore por duke mos e përjashtuar edhe rrezikun nga faktori njeri , qoftë si rrjedhojë e proceseve tekniko-teknologjike qoftë edhe ato të qëllimshme. Objekte të karakterit të tillë në komunën tonë janë: Objektet e Administratës civile komunale dhe shërbimet publike; QKMF dhe QMF në Komunë; Objektet e shërbimeve postare dhe telekomit; Objektet energjetike Objektet sportive; Objektet kulturore; Impiantet e ujërave/KRU,etj.
Objektet e shërbimeve administrative në komunë janë të shpërndara në disa objekte:

Objekti i Administratës në Komunën e Kaçanikut është në shërbim të pajisjes së qytetarëve me dokumente të gjendjes civile. Tani këto shërbime ofrohen edhe në mënyrë elektronike. Qasja në objektet e administratës publike dhe shpërndarja hapësinore është e mirë. Objektet janë në gjendje të mirë fizike dhe tani për tani i plotësojnë kushtet për aktivitet që janë dedikuar.

## 5.3. Institucionet dhe shërbimet financiare

Në komuën e Kaçanikut aktivitetin e tyre e kryejnë këto banka dhe agjencitë të ndryshme të sigurimeve të cilat kryejnë shërbime për qytetarë. Të gjitha objektet financiare në komunë janë të siguruar me roje fizike dhe përcjellje të kamerave 7/24.

| Objektet e sigurisë | Objektet e shërbimeve administrative | Shërbimet financiare |
|---|---|---|
| | | |
| Stacioni policor | K.K. Kaçanik | Raiffesen Bank – dega, Kaçanik; |
| Gjykata Themelore e Feriz. dega – Kaçanik; | Posta | Banka Ekonomike Sh.A; |
| Njësia Profesionale e Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit – NJPZSH | Palestra Sportive;<br>Zyra komunale për punësim (për momentin punën e zhvillon në këtë palestër) | NLB Banka |
| | Shtëpia e Kulturës ”Xheladin Kurtaj”; | BPB – Banka Private e Biznesit; |
| | Zyrat e vendit; - Kaçanik i Vjetër,<br>- Doganaj,<br>- Dubravë,<br>- Glloboçicë, dhe<br>- Ivajë | KEP banka; |
| | Objekti i kompanisë rajonale të mbeturinave KRM “Pastërtia” | FINCA - mikro bankë |
| | Objekti i kompanisë rajonale të ujësjellësit KRU “Bifurkacioni”; | AFK - mikro bankë |
| | Objekti i qendrës kryesore të mjekësisë familjare “Dëshmorët e Lirisë”; | |

**Tabela 80:** Objektet e sigurisë, shërbimeve administrative dhe financiare në komunë

## 5.4. Objektet shkollore - parashkollore, shkolla fillore e mesme e ulët (shfmu), shkolla e mesme e lartë (shml)

Komuna e Kaçanikut posedon këto institucione arsimore:

- Drejtoria Komunale e Arsimit menaxhon me 1 objekt parashkollore (çerdhe);
- Drejtoria Komunale e Arsimit menaxhon me 5 objekte /Shkolla fillore e ultë ( SHFU );
- Drejtoria Komunale e Arsimit menaxhon me 11 objekte / shkolla të mesme të ulëta;
- Drejtoria Komunale e Arsimit menaxhon me 2 objekte / shkolla të mesme të larta.

Bazuar në gjendjen fizike të objekteve shkollore, mundë të konstatojmë se rrjeti i shkollave të nivelit AF, AMU dhe AML është në nivel të kënaqshëm dhe ekzistojnë kushte relativisht të mira për zhvillimin

normal të procesit mësimor, me përjashtim të objektit të vjetër të Shkollës fillore "Emin Duraku" në Kaçanik dhe shkollës në Doganaj. Të dy këto objekte shkollore janë shumë të vjetëruara dhe të dëmtuara, ndërkohë që nuk plotësojnë kushtet minimale për zhvillimin e procesit mësimor.

Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Doganaj, i filluar në vitin 2019, sipas kontratës është dashtë të përfundoj më 2022 dhe tani më ka kaluar afatet kohore të planifikuara, ndërkohë DKA, është duke bërë përpjekje të pareshtura për të siguruar investimet e nevojshme për ndërtimin e objektit të ri shkollor, në shkollën e qytetit, përkatësisht objektit të SHFMU "Emin Duraku" në Kaçanik.

Paralelja e ndarë e shkollës fillore "Emin Duraku"në Dushkajë është ndërtuar në vitin 2014 në një terren ku përbërja pedologjike e tokës nuk i plotëson kushtet për ndërtim, edhe pse janë marrë masat për stabilizimin e tokës me ndërhyrje inxhinjerike, ende paraqet rrezik për rrëshqitje të tokës duke rrezikuar nxënësit dhe objektin shkollor.

Objekti i Qendrës për Edukimin dhe Arsimin Parashkollor (QEAP)"Agimi" është i ri (është përuruar më 20 dhjetor 2019) dhe bashkëkohor me hapësirë të mjaftueshme, ndërkaq plotëson të gjitha nevojat për zhvillimin normal të aktiviteteve për fëmijë të këtyre grup moshave. Një dhomë mësimi/dhomë qëndrimi ka sipërfaqe prej 86 metra katrorë, ndërsa sipërfaqja e përgjithshme e objektit është 1700 metra katror.

Objektet e shkollave të ndërtuara pas lufte, sidomos pas vitit 2015 janëtë ndërtuar me hapësira të mjaftueshme dhe me objekte ndihmëse ( salla sportive, fusha sportive për lojë në hendboll, basketboll, dhe volejboll.

Objekteve, ju mungojnë edhe shenjëzimet themelore informuese për nxënësit dhe mësimdhënësit, në rast të çfaqjes së nevojës për evakuim emergjent, ku mungojnë pajisjet për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësi tjera si dhe edukimi bazik për reagim emergjent.

## KREU VI-të

## 6. LLOJET E FATKEQËSIVE

Fatkeqësitë, varësisht nga shkaktari i tyre ndahen në: fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësitë tjera(FNFT);

**Fatkeqësitë natyrore** janë fenomene të cilat shkaktojnë humbje me pasoja në popullatë, të mira materiale, mjedis dhe trashëgimi kulturore.

Ndryshimet klimatike në përgjithësi, veçanërisht frekuenca e ngjarjeve ekstreme të motit dhe luhatjet e temperaturave që parashikohen të ndodhin si rrjedhojë e ndryshimeve klimatike, po ndikojnë edhe tek ne, duke krijuar klimë me cenueshmëri më të lartë, duke përfshirë, ndër të tjera: zjarre në pyje, thatësira, reshje të dendura të shiut me shtrëngata, breshëri, bora, acari , orteqet, erërat e fuqishme, vërshimet, zjarret (urbane, malore, fushore), epidemitë/pandemitë, stuhitë e erës, rrëshqitjet e tokës, valët e të nxehtit, tërmetet dhe fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga forcat natyrore, etj;

**Fatkeqësi tjera** nënkuptohen ato fatkeqësi tekniko-teknologjike të shkaktuara nga faktori njeri apo përmes proceseve teknologjike /incidentet në objektet afariste, tregtare, zjarret urbane dhe malore, fatkeqësitë në miniera, shkatërrimet e pendave, aksidente në trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, aksidentet nukleare si dhe aksidentet tjera ekologjike dhe industriale të shkaktuara nga aktivitetet dhe veprimet e njeriut, veprimet luftarake dhe terroriste;

## 6.1. Intensiteti, llojet dhe ndikimet e veprimit të fatkeqësive natyrore në territorin e komunës së Kaçanikut.

Për shkak të konfiguracionit të terenit ndikimi i veprimit të fatkeqësive natyrore në komunën e Kaçanikut karakterizohet me dëme të konsiderueshme varësisht nga lloji i fatkeqësisë.
Zakonisht dëme paraqiten nga vërshimet dhe zjarret të cilat janë prezentë në stinët e verës dhe vjeshtës së vonshme duke shkaktuar dëme të konsiderueshme dhe ndikuar në jetën e njeriut, infrastrukturën, ekonominë, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe në ambient.
Gjatë viteve lumi "Nerodime" së bashku me përroin "Rakoc" ka vërshuar një pjesë të madhe të qytetit dhe disa pjesë të fshatrave që gjenden skaj këtij lumi.
Deri më tani, në këtë pikë vërshuese është evidentuar evakuimi i një pjese të banorëve në muajin maj të vitit **1916, 1961, 1976, 1979** dhe në pranverën e vitit **2005** ku ka pas dëme të konsiderueshme në të mira materiale dhe dëme në infrastrukturë.
Rrëshqitja e dheut në territorin e komunës së Kaçanikut është evidente ne lagjen "Dushkaja", "Migjeni", "Idriz Seferi" dhe te "Guri i Shpumë" në magjistralen Prishtinë - Shkup për shkak të përbërjes pedologjike të tokës
Një ndër rrëshqitjet e tokës që është vlerësuar me shkallën e rrezikshmërisë shumë të lartë e që është kërkuar, intervenim i menjëhershëm në nivel qendror, ka ndodhur në Magjistrale Kaçanik – Shkup, (Guri i Shpumë) nga kjo rrëshqitje e dheut është ndërprerë qarkullimi i komunikacionit për disa ditë, pasojat nga kjo rrëshqitje kan qenë të mëdha duke ditur se kjo rrugë është vitale që lidhë dy shtete të cilat kanë qarkullim të madh të trafikut dhe mallrave.

## 6.2. Prioritizimi i fatkeqësive natyrore bazuar në matricën e rreziqeve (Lista sipas prioriteteve)

Vlerësimi i autoriteteve lokale për rreziqet e fatkeqësive natyrore bazohet në analizën e plotë të rreziqeve dhe pasojave të mundshme në popullatë, në të mira materiale, kulturore dhe mjedis, brenda zonës së tyre si dhe atyre që mund të vijnë nga zonat fqinje. Vlerësimet përfundimtare bëhen për secilën masë të mbrojtjes dhe shpëtimit në raport me mundësitë reale për mbrojtje dhe shpëtim si dhe vlerësimin e resurseve njerëzore dhe materiale të nevojshme për tu përballë me pasojat e fatkeqësive natyrore., duke e marrë për bazë edhe Profilin e rrezikut( fletë-pune e profilit të rrezikut);
Matrica e rrezikut pasqyron gërshetimin apo korrelacionin e probabilitetit (gjasave ) dhe pasojave, të nivelit të rrezikut e cila përbëhet nga dy boshte:

- **boshti horizontal** në të cilin paraqiten vlerat e gjasave (*e sigurtë/ gati e mundur/ e besueshme/ e pa besueshme/ e pamundur),* ndërsa
- **boshti vertikal** në të cilin paraqiten vlerat e pasojave *(e papërfillshme/ e vogel/ e mesme/ kritike/ katastrofike);*

- **Prioritizimi i listës së fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera** është produkt matricës së probabilitetit/gjasave. Matrica e probabiliteti/gjasave janë të bazuara në **treguesit e probabilitetit /gjasave**:

- Probabbiliteti dhe frekuenca e ndodhjes;
- Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut;
- Pasojat ekonomike nga FNFT;
- Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social-infrastruktura kritike;
- Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social-dëmi material i përgjithshëm në objekte me rëndësi të veqantë;
- Matrica përmbledhëse e cila pasqyron stabilitetin shoqëror (3a dhe 3b/pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social-dëmet nga infrastruktura kritike dhe pasojave ekonomike);
- Matrica e cila pasqyron rrezikun e përgjithshëm;

## 6.3. Matrica e gjasave

Pa so Gjasat

| Ashpersia | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|---|---|---|---|---|---|
| 5 | 5 | 10 | 15 | 20 | 25 |
| 4 | 4 | 8 | 12 | 16 | 20 |
| 3 | 3 | 6 | 9 | 12 | 15 |
| 2 | 2 | 4 | 6 | 8 | 10 |
| 1 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

Shkalla e ashpërsisë

| | |
|---|---|
| 5 | Veprim katastrofik – (rrezik nr. 15 – 25) |
| 4 | Prioritet i ashpër – (rrezik nr. 10 – 12) |
| 3 | Prioritet mesatar – (rrezik nr. 5 – 9) |
| 2 | Prioritet i mbrojtur – (rrezik nr. 2 – 4) |
| 1 | Prioritet i ulët – (rrezik nr. 1)<br>nuk kërkohet veprim |

**Matrica e probabilitetit:**




Duke u bazuar në historikun e fatkeqësive natyrore që kanë goditur komunën tonë dhe të dhënat që posedojmë, është vlerësuar se vërshimet, zjarret dhe rrëshqitja e dheut janë dukuri që më së shpeshti prekin komunën tonë duke shkaktuar, pasoja në popullatë, të mira materiale, trashëgimi kulturore dhe mjedis.

- Vërshimet,(janë dukuri më të shpeshta gjatë sezonës së të reshurave atmosferike).
- Rrëshqitja e tokës, dhe erozioni (gjatë sezonës së të reshurave atmosferike)
- Zjarret malore dhe fushore, gjatë thatësirave të mëdha, muaji; mars, korrik, tetor, nëntor

## 6.4. Reziqet nga fatkeqësitë natyrore

Fatkeqësi natyrore konsiderohen fatkeqësitë që shkaktohen nga dukuri apo fenomene natyrore deri në nivele ekstreme, duke filluar nga ato me shpeshtësi më të madhe dhe me probabilitet të lartë të ndodhjes deri tek ato më ekstreme me pasoja të rënda dhe me probabilitet të ultë. Fatkeqësitë natyrore përbëjnë një listë të gjatë të fenomeneve natyrore, si : vërshimet, tërmetet, zjarret, rrëshqitjet e dheut dhe erozionet, ortekët, erërat e fuqishme, breshëri, borë me shi, acari, thatësira, epidemitë dhe pandemitë, fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga natyra e dukuri tjera që ndikojnë në humbje të jetërave të njerëzve, të mirave materiale, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

### 6.4.1.Vërshimet

Vërshimet shkaktohen kur uji del prej shtratit të vet duke përfshirë hapësirat për rreth, me ç'rast vjen te dëmtimi i rrugëve, hekurudhave, urave objekteve të banimit, rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, sipërfaqeve bujqësore, si dhe rrezikimit të njerëzve, shtazëve dhe të mirave materiale.

Vërshimet mund të ndodhin shpejtë dhe mund të jenë shumë serioze edhe nëse toka është e ngrirë ose është e ngopur me ujë.

Territori i Komunës së Kaçanikut bazuar në bazën e të dhënave egzistuese si dhe në të dhëna historike, ka një cenueshmëri dhe rrezik serioz nga vërshimet, tek delta e pellgjeve lumore apo hapësirat e rrafshëta, ku shkaktohen nga fryrja e lumenjëve(përrockave) dhe ngritja e nivelit të ujërave , gjatë të reshurave të rrëkeshme apo shkrirjes së shpejtë të dëborës;

Territorin e Komunës së Kaçanikut e përshkojnë dy lumenjë ; Lepenci dhe Nerodimja dhe përroskat që rrezikojnë më shumë me vërshime të shpejta janë në zonat rurale siqë janë; fshati Kukaj, Soponicë(lagja Dallosh), Kovaçec dhe pjesa lindore e qytetit të Kaçanikut që rrezikohet nga përroi i Rakocit.

Ujë rrjedhat e lumit Lepenc dhe Neredime gjatë periudhës së lagështisë kanë predispozita të rrezikimit të sipërfaqeve tokësore.

Në shumicën e vërshimeve njëra ndër dukuritë e para që ndodhë është vërshimi i rrugëve ku pamundësohet transporti i njerëzve dhe të të mirave materiale.

### 6.4.2. Identifikimi i rreziqeve nga vërshimet;

Procesi i identifikimit të rrezikut nga vërshimet është një aktivitet profesional dhe i spektrit të gjërë (ndër disiplinarë) e cila ngërthen në vete një mori aspektesh dhe të fushave që mund të prekin dhe cenojnë: jetën e njeriut, sistemet e shumta infrastrukturën, ekonominë, mjedisin, trashëgiminë kulturore, etj.

Vërshimet dhe përmbytjet determinohen nga një mori faktorësh ndër të cilët dallojmë:

- Mosrregullimi i infrastrukturës së shtretërve të lumenjve ;
- Degradimi i shtretërve të lumenjve - gërmimet dhe eksploatimet e pakontrolluara i resurseve natyrore – rërës dhe masës drunore në shtratin dhe përgjatë shtratit të lumenjve, duke inicuar vërshime, erozion të brigjeve të lumenjve dhe ndërrimin e drejtimit të lumenjve;
- Punimet e paautorizuara në dhe rreth shtretërve të lumenjëve me ç'rast paraqitet dukuria e dëmtimit të tubacioneve të ujit që për pasojë ka ngritjen e nivelit të lumenjve dhe përmbytjen e vendbanimeve të caktuara;
- Ndërtimet e egra të shtëpive të banimit dhe objekteve tjera në dhe rreth shtratit të lumenjve,
- Ndikimi i faktorit njëri në kuptimin e papërgjegjësisë qytetare në hedhjen e mbeturinave inerte në shtretërit e lumenjve, sidomos në pikat kritike si : urat, kanalet, tubacionet etj.
- Mosfunksionimi normal dhe mirëmbajtja jo e rregullt e infrastrukturës së rrjetit të ujërave atmosferikë dhe fekale, etj.

  ***Harta19 :*** *Zonat e rrezikuara nga vërshimet në komunën e Kaçanikut , aneksi i hartave , faqe*

### 6.4.3. Karakteristikat hidrografike dhe ndikimet e saj në paraqitjen e vërshimeve

Territori i Komunës së Kaçanikut sipas vlerësimit të rreziqeve, ka një rrezikshmëri të madhe nga vërshimet, ku kryesisht hynë vërshimet nga lumenjtë, fryrja e përrenjve dhe ngritja e nivelit të ujërave nëntokësor gjatë stinëve me të reshura. Kushtet natyrore të Komunës së Kaçanikutjanë të tilla, ku pjesët e rrafshta të territorit janë të përshtatshme dhe me potencial për toka bujqësore dhe shtrirjen e vendbanimeve, vendosjen e industrisë, zhvillimin e infrastrukturës, ndërsa pjesët me lartësi më të madhe mbidetare qe shtrihen më në periferi, kushtëzon rrjedhjen e shpejt të ujërave dhe me kapacitete shpesh maksimale të ujë-rrjedhave dhe pellgjeve lumore. Vërshimet janë fatkeqësi natyrore që mund të dëmtojnë zona të mëdha të deltave lumore të lumenjve dhe të shkaktojnë vërshime rrëke në përrenj më të vegjël. Për më tepër, për shkak të ndryshimit të klimës, ndikimet e ashpra të vërshimeve mund të priten edhe në komunën tonë në të ardhmen.





**Foto 12:** përmbytje nga lumi Lepenc me datën **01.12.2017** në fabrikën ”SANKOS” SH.P.K – Kaçanik dhe Vërshimet e përroskës në lagjen “Shaqir Kuka “ **03.02.2018**

### 6.4.4. Historiku i vërshimeve (koha, hot-spotet/pikat e nxehta)

Deri më tani, në këto pikë vërshuese janë evidentuar evakuimi i një pjese të banorëve në muajin maj të vitit **1916, 1961, 1976, 1979** dhe në muajin janar shkurt të vitit **2005, 2011, 2017, 2018, 2021** ku ka pas dëme të konsiderueshme në të mira materiale dhe dëme në infrastrukturë. Sipas tregimeve dhe statistikave, lumi Lepenc dhe Nerodime së bashku me përroin e Rakocit gjithmonë kanë sjellë probleme në popullatë edhe në kohët e hershme.

**Pikat e nxehta në zonën urbane janë:**

-bllokimi i urës së “Konakut” nga mbeturinat që i sjellë ky lum gjatë rrugëtimit të tij 24 km,

-bllokimi i kanalizimeve, shpërthimi i tyre dhe prurjet që derdhen nga përroskat që nuk janë në numër të vogël dhe që e ngarkojnë shumë këtë lum,

-Pikë e nxehtë ështëvendi ku bëhet bashkimi i përroit të Rakocit me lumin Nerodime, i cili gjatë sezonës së shirave bartë me vete një sasi të madhe të gurëve dhe rërës që derdhen në shtratin e lumit, duke vështirësuar rrjedhjen e lumit dhe duke krijuar fyt të ngushtë gjatë kalimit nën urë.



**Foto 13:** Vërshimet 1979 (vërshimi i Urës së Konakut)

Të reshurat intensive, të pandërprera në më shumë se 48 orë, nënkupton se vërshimet janë momentale dhe gjendja në normalitet mund të rikthehet 12 orë pas ndërprerjes së të reshurave. Të reshurat normale dhe të kohëpaskohshme nuk rrezikojnë vërshimet në përmasa alarmuese.

### 6.4.5. Vendet ( vendbanimet ) më të atakuara nga vërshimet /Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara me numrin dhe strukturën e banorëve/

Gjatë viteve lumi Lepenc dhe Nerodime” së bashku me përroin e Rakocit kanë vërshuar një pjesë të madhe të qytetit dhe disa pjesë të fshatrave që gjenden rreth këtij lumi.

Gjatë muajit shkurt dhe mars 2021 janë evidentuar lokacionet në zona të ndryshme të komunës që mund të rrezikohen nga vërshimet – përmbytjeve në rast të të reshurave të mëdha të shiut dhe shkrirjes së borës, ku si pasojë do të rrezikohen jetët dhe të mirat materiale të banorëve të komunës sonë.
Zona ku mund të ketë vërshime, përfshin: qendrën e qytetit, fshatrat: Doganaj, Soponicë, Bob, Kaçanik i Vjetër (Lagja Topojan), Stagovë dhe Runjevë.

| Komuna e Kaçanikut | Pellgu lumor | | |
|---|---|---|---|
| | **Lumi Lepenc** | **Lumi Nerodime** | **Përroi i "Rakocit"** |
| Lokacioni i vërshimeve (lagja, fshati) | Sllatinë, Doganaj, Soponicë, Trimor, Bob, Qendra urbane e Kaçanikut, Rruga "V. Çaka"dhe "Agim Bajrami" | Kaçaniku i Vjetër (lagja e Topojanëve), Stagovë (Lagja e Bajramëve), Runjevë dhe qendra e qytetit të Kaçanikut .(Bulevardi "Ismal Raka") | Lagja e Rakocit dhe një pjesë të qytetit.(Bulevardi :"Ismal Raka") |
| Numri dhe struktura e banorëve në atë lokacion | 87 banorë<br>Femra = 48<br>Meshkuj = 39<br>Fëmijë = 41<br>Pleqë = 10<br>Të hendikepuar = 3 | 96 banorë<br>Femra = 51<br>Meshkuj = 45<br>Fëmijë = 48<br>Pleqë = 12<br>Të hendikepuar =4 | 70 banorë<br>Femra = 38<br>Meshkuj = 32<br>Fëmijë = 42<br>Pleqë = 11<br>Të hendikepuar =2 |
| Sipërfaqja e mundëshme e vërshimeve | 17 ha | 22.50 ha | 3.0 ha |
| Objektet e rrezikuara nga vërshimet e mundëshme | Shkolla M.P. "V. Çaka dhe F. Guri" Kaçanik | Urae hekurudhës, Xhamia e Dëshmorëve Stacioni hekurudhor, dhe objekte të bizneseve të vogla në rrugën "Ismal Raka" | Objektet familjare në rrugën "Sali Bajra" "Reshat Shehu", Përmendorja e Rakocit, objekte biznesi etj |
| Resurset për angazhim (humane dhe teknike) | DESHP, Drejtorit komunale, PK, SHZSH Kompanitë private etj | DESHP, Drejtorit komunale, PK, SHZSH, Kryqi i Kuq Komunal Kompanitë private etj. | DESHP, Drejtorit komunale , PK, SHZSH, Kompanitë private Kryqi i Kuq Komunal. |

**Tabela 81:** Identifikimi i lokacioneve për vërshime në komunën e Kaçanikut

***Harta 23**: Zonat e rrezikuara nga vërshimet në komunën e Kaçanikut, **aneksi i hartave***

### 6.4.6. Kushtet Hidrometeorologjike

Territori i komunës së Kaçanikut në kuptimin klimatik i nënshtrohet ndikimeve atmosferike kontinentale dhe mediterane të pa qëndrueshme në përgjithësi në nivel vendi.
Edhe komuna e jonë sikur në gjithë vendin, me disa dallime të vogla klimatike shënojmë vlerat ekstreme pozitive të temperaturave në komunë.
Në bazë të dhënave historike gjatë dhjetë viteve të fundit nga statistikat e stacioneve meteorologjike rezulton se reshjet më të dendura të borës gjatë vitit janë në dimër, në muajt janar dhe shkurt, kurse stinët me reshje të dendura të shiut janë në stinën e pranverës ( prill- maj) dhe vjeshtës ( shtator- tetor).
Sasia e madhe e reshjeve ia jep karakteristikën themelore kësaj hapësire. Prej fushëgropës në drejtim të rrëzës së malit dhe tërësisë malore sasia e reshjeve është në rritje.

**Sasia vjetore e reshjeve**: në komunën e Kaçanikut sillen rreth 861,4 mm, ndërsa, gjatë vegjetacionit arrijnë 40,4mm.
Maksimumi absolut është 286,8mm në muajin shkurt që paraqet 33% të sasisë mesatare. Muaji me minimum absolut është korriku me vetëm 0,4mm (40 mililitra për m2).

| Muajt | Reshjet Mesatare mm | Sasia absolute maksimale mm | Sasia absolute minimale mm | Maksimumi absolut ditor |
|---|---|---|---|---|
| **Janar** | 74,1 | 228,4 | 21,0 | **45,0** |
| **Shkurt** | 78,1 | 286,8 | 10,7 | **40,7** |
| **Mars** | 57,1 | 124,5 | 2,7 | **30,2** |
| **Prill** | 72,5 | 133,3 | 9,0 | **70,8** |
| **Maj** | 95,7 | 174,7 | 29,9 | **41,0** |
| **Qershor** | 67,8 | 132,8 | 13,7 | **70,5** |
| **Korrik** | 49,3 | 119,5 | 0,7 | **100,5** |
| **Gusht** | 40,4 | 106,0 | 2,5 | **50,6** |
| **Shtator** | 45,2 | 126,4 | 9,9 | **40,9** |
| **Tetor** | 83,2 | 206,8 | 0,4 | **70,5** |
| **NËntor** | 121,4 | 228,5 | 12,5 | **70,4** |
| **Dhjetor** | 76,6 | 224,0 | 16,0 | **45,0** |
| **Vjetore** | **861,4** | 1056,8 | 580,3 | **100,5** |
| **Dimri** | 228,8 | | | |
| **Pranvera** | 225,3 | | | |
| **Vera** | 157,5 | | | |
| **Vjeshta** | 249,8 | | | |
| **Per.vegje** | **370,9** | | | |

**Tabela 82:** Sasia e reshjeve në milimetra në komunën e Kaçanikut

| Muaji | I | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII | Sasia mesatare |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kaçanik** | 74,1 | 78,1 | 57,1 | 72,5 | 95,7 | 67,8 | 49,3 | 40,4 | 45,2 | 85,2 | 121,4 | 76,6 | **861,4** |

**Tabela 83:** Reshjet gjatë muajve dhe sasia mesatare në komunën e Kaçanikut




**Grafikoni :** Reshjet gjatë muajve dhe sasia mesatare




**Grafikoni :** Reshjet sipas stinëve dhe mesatarja vjetore

**Lagështia**:Muaji më i lagësht është nëntori (121,4) ndërsa muaji më i thatë gushti me 40,4mm
Siçë shihet në tabelë gjatë periudhës vegjetative bien 43% e sasisë së reshjeve. Prej stinëve, vjeshta është më e lagështa ndërsa vera është më e thata me 157,5 mm.

**Era:** Në komunën e Kaçanikut është e theksuar në drejtimin veri - jug dhe veri – lindje , të cilat erëra kohë pas kohe arrijnë shpejtësinë 19 metra në sekondë.
Sipas të dhënave në tabelë shihet se ka raste kur bien pa ndërprerë edhe deri ne 100,5mm në ditë në muajin korrik. Kjo është sasi e madhe e koncentruar për kohë të shkurtër në raport me mesataren vjetore (përfshin 11,6 % të sasisë vjetore).

**Thatësia s**i dukuri që paraqitet herë pas herë është fatkeqësi elementare, në Kaçanik mund të zgjate edhe deri në 65 ditë pa reshje që është paraqitur gjatë muajve tetor, nëntor dhe dhjetor.
Reshje më shumë bien në pjesën perëndimore në rrëzën e Malit Sharr, ku është përshtatshmëria më e madhe e kondensimit të ujit për shkak të lartësisë, asnjë pjesë e Rrafshit të Kosovës nuk posedon aq reshje sa territori i Komunës së Kaçanikut çka e bën të dallohet prej viseve të tjera.
Duke shkuar prej fushëgropës së Kaçanikut në të cilën sasia mesatare e reshjeve arrin në 861,4 mm, ka tërësia e rrëzës së malit reshjet janë në rritje.

**Temperatura**t: Në komunën e Kaçanikut oscilojnë dhe kanë mjaft dallime mujore dhe sezonale.
Për analizë do të shfrytëzohen temperaturat mesatare mujore 15 vjeçare, minimumet dhe maksimumet absolute.
Temperatura mesatare është 10,2 ºC, muaji më i ftohtë është janari me temperaturë mesatare -1,4 ºC, muaji më i ngrohtë është korriku me 20,6 ºC. Muaji më i ftohtë me temperaturë ekstreme është janari me -26 ºC ndërsa muaji me temperaturë më të lartë është gushti me 37,3ºC.
Amplituda më ekstreme për ketë periudhe është 63,3 ºC. Amplituda mesatare për të gjithë muajt është 36,4 ºC. Në bazë të analizës së izotermave vjetore vërehet se pjesa e rrëzës malore ndodhet ndërmjet izotermës 10 dhe 9 ºC, ndërsa tërësia e malit Sharr ndërmjet izotermave vjetore 9 e 8 ºC Vendbanimi i Glloboçicës ka klimë diçka më të butë, temperatura më të larta ngase ka ndikim pjesa e Pollogut dhe Fushëgropa e Shkupit nga Maqedonia.

### 6.4.7. Treguesi hidrologjik

Ndryshimi i tipareve gjeomorfologjike, siç janë fushat e gjera të rrethuara me male dhe shtretërit e lumenjve të parregulluar dhe jo të mirëmbajtur, hedhja e mbeturinave në lumenj dhe nxjerrja e pakontrolluar e zhavorrit dhe rërës nga shtretërit e lumenjve, ndikon në shtrirjen dhe dinamikën e vërshimeve në komunën tone. Vërshimet prekin kryesisht zonat bujqësore pothuajse çdo vit duke shkaktuar dëme të konsiderueshme ekonomike dhe ekologjike. Shumica e kanaleve të lumenjve nuk mund të pranojnë sasi shtesë të ujit të krijuar ngjarje ekstreme të motit, shpesh duke çuar në vërshime të një game të gjerë.

Për shkak të ndryshimit të klimës, ngjarjeve ekstreme të motit, të tilla si reshjet e mëdha të shiut dhe vërshimet janë rritur në frekuencë dhe intensitet duke shkaktuar një rritje të konsiderueshme të dëmtimit të ekonomisë, zonave urbane, infrastrukturës, mjedisit dhe natyrës.

- Shtretërit relativisht të cekët të lumit Lepenc, Nerodime dhe përroit të Rakocit,
- Mospastrimi i digave të përroskave,
- Mosrregullimi i infrastrukturës në shtretërit e lumenjve në zonat urbane të komunës, përveç një pjese të rregulluar të shtratit të lumit,
- Degradimi i shtretërve të lumenjve - gërmimet dhe eksploatimet e pakontrolluara të resurseve natyrore – rërës dhe masës drunore në shtratin dhe përgjatë shtratit të lumenjve, duke shkaktuar vërshime, erozion të brigjeve të lumenjve dhe ndërrimin e drejtimit të lumenjve,
- Punimet e pa autorizuara dhe shpluarja e sipërfaqeve të tokës,
- Ndërtimet e egra të shtëpive të banimit dhe objekteve tjera në dhe rreth shtratit të lumenjve,
- Ndikimi i faktorit njëri në kuptimin e papërgjegjësisë qytetare në hedhjen e mbeturinave inerte në shtretërit e lumenjve dhe përroskave, sidomos, tek pikat kritike si : urat, kanalet, tubacionet etj.
- Mosfunksionimi normal dhe mirëmbajtja jo e rregullt e infrastrukturës së rrjetit të ujërave atmosferikë dhe fekale.

***Harta 24:*** *Zonat e vërshuara- përmbytura në komunën e Kaçanikut,* ***aneksi i hartave***

**Masat Parandaluese**

Masat e propozuara nga Grupi Punues për hartimin e dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë nga vërshimet:

Rritja e kontrollit mbi ndërtimet e egra të objekteve të banimit në shtretërit dhe brigjet e lumit;
- Rregullimi i shtretërve të lumenjve sipas standardeve të kërkuara;
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujërave atmosferike dhe fekale, kanaleve të hapura të ujitjes etj. që kalojnë edhe nëpër qytet, shtretërve të lumenjve, urave, etj;
- Pengimi i ndërtimeve dhe veprimeve pa planifikim dhe leje urbane që mund të sjellin pasoja nga vërshimet,
- Ndalimi dhe kontrolli i gërmimeve dhe eksploatimeve të pa kontrolluara të resurseve natyrore , meqërast ndërron edhe kahja e rrjedhës së ujit e më pastaj dalja nga shtrati;
- Mirëmbajtja e lumenjve nga organet kompetente;
- Zgjërimi i shtretërve të lumenjve nga pronarët që i posedojnë ngastrat pranë;
- Hapja e kanaleve anësore( të kullimit) dhe të rrugëve nga ndërtimet e paligjshme të pronarëve privat, etj.

**Infrastruktura e ndërtuar për mbrojtje nga vërshimet në Komunën e Kaçanikut**

Me qëllim të parandalimit të vërshimeve dhe zvogëlimit të pasojave të shkaktuara nga to, komuna e Kaçanikut në vazhdimësi ka bërë përpjekje dhe ka bërë investime të konsiderueshme në ndërtimin e infrastrukturës për mbrojtje nga vërshimet, të cilat i përshkruajmë si vijon:

Rregullimi shtratit të lumit "Nerodime" me gjatësi L= 1300 m (është kryer)
- **Projekti "Rregullimi i shtratit të lumit "Lepenc"** në një gjatësi lumore prej L= 2139 metra (është kryer)
- Pastrimi dhe thellimi shtratit të Lumit Nerodime nga "Xhamia e Dëshmorëve" deri në fshatin Kaçanik i Vjetër L=10.000m H= 2m, B= 6 - 8m është në përfundim (Projekt i Qeverisë -2024)
- Pastrimi i shtratit të lumit Lepenc dhe hapja e fytave të ngushtë

Rregullimi i shtretërve, pastrimi dhe thellimi i përroskave në:
- fshatin Soponicë - lagja Dallosh, L=121m, H=1.5m, B=3.0m,
- fshatin Kovaçec lagja – Koraç L= 195m, H=2.0m, B=2.0m,
- fshati Stagovë, lagja e Bajramëve L=90m, H=0.70m, B=1.5m,
- fshatin Bob – lagja Çaka, L=190m, H=1.5m B=3.0m,
- fshatin Runjevë, rruga -"Xhevë dhe Fehmi Lladrovci" L=160m, H=1.4m, B=2.5m,
- Lagja Rakoc- rruga Mahi Loku, L=160m, H=1.0m, B=1.0m
  , ndërsa në pjesën urbane Lagja Rakoc, lagjen "Hasan Prishtina" lagjen "Shefket Fera" lagjen "Avdurrahim Shehu" lagjen "Vëllezërit Çaka" lagjen "Mejdi Dalloshi"

Vlen të theksohet se vazhdon projekti Rregullimi i Shtretërve të Përroskave dhe Lumenjve në komunën e Kaçanikut edhe gjatë vitit 2024 -2027.





**Foto 16:** Rregullimi i shtratit të përroit në rrugën -"Xhevë dhe Fehmi Lladrovci"- Runjevë dhe rregullimi i shtratit të përroit në fshatin Soponicë lagja Dallosh

**Rekomandime:**

- Marrja e masave për rregullimin, mirëmbajtjen dhe pastrimin e shtretërve të lumenjëve;
- Ndalimi i shfrytëzimit të pakontrolluar i lëndëve inerte nga shtretërit e lumenjve në Kosovë;
- Marrja e masave nga organet e nivelit lokal në menaxhimin adekuat të mbeturinave në shtretërit e lumenjëve;
- Të ndalohet ndërhyrja në ndryshimin e rrjedhjes së lumenjve dhe përroskave që mund të sjellin rrezik dhe pasoja nga vërshimet,
- Të bëhet pastrimi, zgjerimi dhe thellimi i shtratit të lumit Lepenc nga shkolla e mesme profesionale "Vëllezërit Çaka dhe Feriz Guri" e deri në fshatin Doganaj,
- Të vazhdohet me rregullimin e shtretërve të përroskave që kanë mbetur pa u rregulluar,
- Të hartohen plane dhe projekte për vetëdijësimin e popullatës për rrezikun nga vërshimet
- Marrja e masave në mirëmbajtjen e rrjetit të ujërave atmosferike dhe fekale;
- Të ngritet niveli i bashkëpunimit ndërinstitucional veçënarisht në nivelin Komunal, kompanitë e furnizimit dhe shkarkimit të ujërave, lidhur me parandalimin, mbrojtjen nga vërshimet; dhe
- Masa tjera që ndikojnë pozitivisht për tu mbrojtur nga ndikimet e veprimeve të dëmshme të ujërave.etj.



**Foto 14:**Pastrimi i lumit Nerodime - Runjevë 2024



**Foto15 :** Pastrimi i përroit Rakoc pas reshjeve

**Hartëzimi i rreziqeve nga vërshimet - Skenari 1**




**Harta 25 :** Skenari 1. i vërshimeve (Burimi i të dhënave DSHPE- Sektori i emergjencave), Sipërfaqet e rrezikuara nga vërshimet – përmbytjet në komunën e Kaçanikut

**Skenari 1 – Vërshimet**

| Emri i skenarit: | Vërshim |
|---|---|
| *Frekuenca e ndodhjes:* | |
| ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>X E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>☐Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| ☐ E papërfillshme (më pak se 10%) X - E kufizuar( 10 deri 25%)<br>☐ Kritike: 25 deri 50% . ☐ Katastrofike: Më shumë se 50% | |
| Lloji i skenarit: | |
| X- Skenari 1; ☐ Skenari 2; ☐ Skenari 3; | |
| Ndikimi: | |
| ☐ I papërfillshëm; X - I vogël ; ☐ I mesëm ; ☐ Katastrofike; | |
| Data e vlerësimit: | |
| **03/02./2023** | |

<table>
<tr><th></th><th>Parametrat:</th><th>Përmbajtja:</th></tr>
<tr><td></td><td>Vendi i ngjarjes (lokacioni)</td><td>Vendet më të rrezikuara nga vërshimet janë: fshatrat, Kaçanik i Vjetër (lagja Përzh, Topojan), Runjevë, Kaçaniku (qyteti, hekurudha te “Xhamia e Dëshmorëve”).




Zonat e prekura nga vërshimet e shkurtit 2022 në komunën e Kaçanikut</td></tr>
<tr><td></td><td>Kushtet meteorologjike</td><td>Për tri ditë rresht, nga data 01.02.2023 - 03.02.2023 në komunën e Kaçanikut dhe fshatrat, Kaçanik i Vjetër, Runjevë dhe Soponicë. ka pasur të reshura me dendësi të madhe. Sipas analizave meteorologjike, reshjet e deritanishme maksimale të evidentuara janë të krahasueshme me ato të 10 viteve më parë.</td></tr>
<tr><td></td><td>Periudha e vitit:</td><td>01 – 03 shkurt 2023</td></tr>
<tr><td></td><td>Lloji i ditës:</td><td>Ditë pune dhe vikendi</td></tr>
<tr><td></td><td>Analiza meteorologjike për kohën</td><td>-Mundësia për të ndodhur vërshimet në këtë vit kalendarik është e madhe, në komunën e Kaçanikut, për çdo 3 vite kanë ndodhur vërshime, kurse nëse e marrim 10 vjeçarin e fundit kemi pasur 4 vërshime në zona të ndryshme, që d.m.th. se për çdo të tretin vit kemi pasur kërcënime nga vërshimet (, 2011, 2017, 2018, 2021,2023).<br>Koha e paraqitjes së vërshimeve është 03 shkurti 2023.<br>Si pasojë e të reshurave në shkurt 2023, ka pasur prurje të mëdha ujore, duke nxjerrë lumenjtë dhe përroskat nga shtrati dhe duke vërshuar vendbanime në rrjedhën e poshtme të pellgjeve lumore. Në datë 4 shkurt 2023 ka filluar tërheqja e ujit në shtretërit e lumenjve dhe përroskave.</td></tr>
<tr><td></td><td>Popullata</td><td>Numri i familjeve të prekura nga vërshimi në zonën e vërshuar është 24, kurse numri i banorëve ishte 144, prej tyre:<br>➢ Fëmijë-72;<br>➢ Të moshuar - 8;<br>➢ Invalid: 3;<br>➢ Gra; 32;<br>➢ Meshkuj: 29;</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| | **Infrastruktura kritike ekzistuese** | Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga vërshimi ka pasur dëme dhe pasoja në infrastrukturë, në këtë zonë.<br>➢ Rruga magjistrale afër 3km<br>➢ Rrugët lokale – 9km<br>➢ Ura standarde - 3<br>➢ Dëmtimi i hekurudhës -3km<br>➢ Ura hekurudhore- 3<br>➢ Sistemi i kanalizimi 4km<br>➢ Sistemi i ujit( primare dhe sekondare), 3km. |
| | **Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut)** | Gatishmëria e Shtabit të Reagimit Emergjent si dhe edukimi qytetarë për të mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore (popullatë rezistente nga FNFT), në këtë rast janë premisa që ndihmojnë në masë të madhe zvogëlimin e reziqeve përmes kampanjave vetëdijësuese, edukimit shkollorë, udhëzuesve (fletëpalosjeve), ushtrimeve të ndryshme, etj.<br>Në pajtueshmëri të plotë me paralajmërimet e hershme nga IHMK për sasinë e reshjeve të shiut QOER-112 ka lëshuar informacion urgjent sipas procedurave standarde operative për organet kompetente shtetërore në nivel qëndror dhe lokal si akter për ndërmarrjen e masave për mbrojtje nga vërshimet, duke ngritur nivelin e gatishmërisë së ekipeve të K-SH<br>- Në nivelin lokal, Kryetari i Komunës do të aktivizojë Komitetin për Mbrojtje dhe Shpëtim (KMSH), Qendrën Operative Emergjente Lokale (QOEL), të ndërmerr masat dhe aktivitetet e nevojshme për K-Sh nga vërshimet, sipas Planit të Reagimit Emergjent lokal, duke bërë edhe informimin publik, paralajmërimin e hershëm dhe alarmimin si dhe udhëzimet e nevojshme publike për evakuim.<br>-Mobilizimi i Ekipeve Reaguese Emergjente me të gjithë potencialin human dhe teknik duhet të jenë në gatishmëri të plotë për reagim në çdo kohë duke u mbështetur edhe me resurse reaguese lokale siq janë:, Kryqi i Kuq komunal, Klubet Alpiniste OJQ-të për mbrojtjen e ambientit dhe kompani të kontraktuara nga Komuna e Kaçanikut për intervenime emergjente në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.<br>-Masat parandaluese për mbrojtje nga vërshimet nënkuptojnë të gjitha masat e nevojshme për zvogëlimin e rrezikut, duke filluar nga ato operacionale deri tek masat për sanimin e gjendjes. |
| **INCIDENTI-NGJARJA** | | |
| | **Shkaku dhe shkaktari** | Pas reshjeve intensive të shiut gjatë orëve të pasditës të datës 03. Shkurt 2022. jemi njoftuar nga banorët e disa lagjeve të Kaçanikut, ku kemi marrë informacion se në këto lagje janë shkaktuar vërshime.<br>Me datë 03.shkurt 2023 Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) lëshoi njoftim / komunikatë përmes webfaqes htt:/ihmk-rks.net/dhe në face book të sajë:për informim të institucioneve dhe publikut në lidhje me mundësinë e vërshimeve të shpejta i parashikuar nga IHMK:<br>Sipas Institutit hidrometeorologjik të Kosovës të reshurat e shiut do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim.<br>- Shkaqet e vërshimeve kanë qenë , si në vijim:<br>-Shtrati i lumit relativisht i ngushtë, ndërtimet skaj lumit pa kriter, hedhja e mbeturinave dhe materialeve inerte, të cilat kanë ndikuar në ngushtimin e shtratit të lumit. |

| | | |
|---|---|---|
| | | Zona e vërshimeve përfshinë rendin e parë të oborreve dhe të bodrumeve e shtëpive individuale të banimit përgjatë lumit Nerodime duke rrezikuar pajisjet e amvisërisë dhe të mirat materiale. Gjatësia në të dy krahët e lumit Nerodime arrin 800m, të rrezikuar janë 24 shtëpi, ku më të rrezikuara janë shtëpitë e ndërtuar skaj shtratit të këtij lumi. Në këtë gjatësi janë 3 ura hekurudhore dhe 3 ura standarde për kalimin e këmbësorëve dhe mjeteve motorike, të cilat ndikojnë në përkeqësimin e situatës vërshuese dhe krijimin e barrierave nga materialet inerte dhe zënien e fyteve të urave që pengojnë qarkullimin e ujit. |






**Harta 22 :** Njoftim i Institutit Hidrometeorologjik mbi reshjet në pellgun e lumit Lepenc dhe lumit Nerodime që mund të rrezikohen nga vërshimet - përmbytjet.

| NR. | PELLGU | STACIONI | LUMI | QMIN | QMES | QMAX |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | LEPENCI | Kaçanik | Nerodime | 0.15 | 4.17 | 17.50 |
| **2** | | Hani i Elezit | Lepenci | 0.10 | 10.49 | 184 |

**Tabela 84:** Vlerat maksimale, minimale dhe mesatare vjetore të prurjeve (Q=m3 /s) të stacioneve hidrometrike sipas pellgjeve lumore

Në pellgun e Lumit Lepenc janë aktive 3 stacione hidrologjike, prej tyre 2 në Lepenc (Brod dhe Hani Elezit) dhe një në Nerodime në rrugën “Ismal Raka” - Kaçanik. Në lumin Lepenc niveli më i lartë i regjistruar gjatë kësaj periudhe ka qen 119.9 cm dhe është regjistruar më datën 21.05.2016, ndërsa ai minimal më datën 18.06.2016, dhe ka pasur vlerën 0.334 cm.

Stacioni hidrometeorologjik i lumit Nerodime - Kaçanik

Niveli i ujit (cm): 2020
Pellgu i lumit: Lepenci
Emri i lumit: Nerodime
Lartësia mbidetare e st.: 478 m lmd
Distanca nga grykëderdhja: 0.7 km
Zona ujëmbledhëse: 214 km²

| Dita | I | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 36 | 38 | 45 | 47 | 47 | 46 | 39 | 41 | 34 | 33 | 32 | 32 |
| 2 | 36 | 37 | 44 | 50 | 50 | 46 | 38 | 37 | 34 | 32 | 33 | 31 |
| 3 | 36 | 37 | 46 | 57 | 50 | 47 | 38 | 35 | 34 | 32 | 33 | 32 |
| 4 | 35 | 37 | 56 | 66 | 47 | 45 | 39 | 35 | 34 | 32 | 32 | 32 |
| 5 | 36 | 45 | 63 | 71 | 46 | 44 | 39 | 47 | 33 | 32 | 32 | 32 |
| 6 | 36 | 43 | 54 | 68 | 45 | 43 | 41 | 59 | 33 | 33 | 32 | 32 |
| 7 | 35 | 41 | 53 | 59 | 46 | 43 | 42 | 63 | 33 | 34 | 33 | 34 |
| 8 | 34 | 42 | 96 | 56 | 45 | 44 | 39 | 46 | 34 | 33 | 32 | 34 |
| 9 | 34 | 42 | 79 | 54 | 44 | 47 | 38 | 44 | 34 | 33 | 32 | 33 |
| 10 | 35 | 41 | 72 | 53 | 43 | 51 | 37 | 39 | 34 | 33 | 32 | 34 |
| 11 | 35 | 48 | 66 | 52 | 43 | 47 | 37 | 37 | 34 | 32 | 32 | 32 |
| 12 | 36 | 55 | 59 | 52 | 42 | 46 | 37 | 37 | 34 | 33 | 32 | 32 |
| 13 | 36 | 50 | 57 | 52 | 42 | 43 | 38 | 39 | 34 | 40 | 32 | 32 |
| 14 | 36 | 46 | 55 | 54 | 41 | 42 | 37 | 37 | 34 | 34 | 32 | 32 |
| 15 | 36 | 47 | 55 | 58 | 41 | 42 | 37 | 38 | 33 | 33 | 32 | 32 |
| 16 | 36 | 44 | 52 | 60 | 40 | 41 | 36 | 41 | 33 | 46 | 32 | 32 |
| 17 | 35 | 42 | 50 | 65 | 40 | 42 | 38 | 37 | 33 | 40 | 32 | 32 |
| 18 | 36 | 41 | 49 | 60 | 41 | 41 | 39 | 37 | 32 | 36 | 32 | 32 |
| 19 | 36 | 41 | 48 | 51 | 41 | 40 | 40 | 40 | 32 | 34 | 32 | 32 |
| 20 | 35 | 43 | 49 | 48 | 45 | 38 | 37 | 40 | 32 | 33 | 32 | 32 |
| 21 | 35 | 42 | 51 | 53 | 52 | 43 | 36 | 37 | 32 | 33 | 32 | 32 |
| 22 | 35 | 40 | 46 | 69 | 47 | 41 | 36 | 36 | 31 | 33 | 32 | 32 |
| 23 | 35 | 40 | 46 | 61 | 44 | 57 | 36 | 36 | 35 | 33 | 32 | 32 |
| 24 | 35 | 40 | 47 | 55 | 43 | 74 | 38 | 36 | 35 | 32 | 32 | 32 |
| 25 | 35 | 40 | 47 | 53 | 43 | 64 | 39 | 40 | 33 | 35 | 32 | 32 |
| 26 | 35 | 40 | 47 | 51 | 44 | 58 | 38 | 37 | 34 | 34 | 32 | 33 |
| 27 | 36 | 42 | 50 | 50 | 42 | 55 | 36 | 35 | 33 | 33 | 32 | 36 |
| 28 | 37 | 44 | 52 | 49 | 44 | 53 | 35 | 35 | 32 | 33 | 31 | 37 |
| 29 | 40 | 48 | 50 | 48 | 51 | 52 | 35 | 35 | 34 | 33 | 31 | 34 |
| 30 | 43 | | 49 | 48 | 48 | 47 | 35 | 34 | 39 | 33 | 32 | 33 |
| 31 | 39 | | 46 | | 47 | | 34 | 34 | | 33 | | 36 |
| Dita | 8+ | 3+ | 2 | 1 | 16+ | 20 | 31 | 4+ | 19+ | 5 | 5+ | 2 |
| Min | 33 | 36 | 43 | 45 | 39 | 37 | 32 | 33 | 30 | 30 | 30 | 29 |
| Mes | 36 | 43 | 54 | 56 | 45 | 47 | 38 | 39 | 34 | 34 | 32 | 33 |
| Max | 46 | 59 | 114 | 104 | 57 | 82 | 48 | 76 | 44 | 51 | 34 | 44 |
| Dita | 30 | 12 | 8 | 17 | 2+ | 24 | 25 | 7 | 30 | 16 | 2 | 27+ |

Gjendja e nivelit të ujit të pellgut të lumit Lepenc, lumi Nerodime

Ditë të barabarta ose që bien nën vlerat e treguara:

| Dita | Vlerë | Dita | Vlerë | Dita | Vlerë | Dita | Vlerë | Dita | Vlerë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 366 | 96 | 357 | 65 | 210 | 40 | 70 | 33 | 9 | 32 |
| 365 | 79 | 356 | 64 | 183 | 38 | 60 | 32 | 8 | 32 |
| 364 | 74 | 350 | 59 | 150 | 36 | 50 | 32 | 7 | 32 |
| 363 | 72 | 340 | 55 | 130 | 35 | 40 | 32 | 6 | 32 |
| 362 | 71 | 330 | 53 | 120 | 35 | 30 | 32 | 5 | 32 |
| 361 | 69 | 320 | 51 | 110 | 34 | 25 | 32 | 4 | 31 |
| 360 | 68 | 300 | 48 | 100 | 34 | 20 | 32 | 3 | 31 |
| 359 | 66 | 270 | 45 | 90 | 33 | 15 | 32 | 2 | 31 |
| 358 | 66 | 240 | 42 | 80 | 33 | 10 | 32 | 1 | 31 |




*Të dhënat e marra nga ;Vjetari Hidrometeorologjik -2020 -* Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

| | | |
|---|---|---|
| | | - IHMK varësisht nga zhvillimet e cikloneve do të ofrojë njoftime me buletinin meteorologjik, me qëllim që të mbahen të informuar institucionet dhe qytetarët me parashikimet meteorologjike.<br>-Në disa segmente lumore dalja e ujit nga shtrati ka krijuar situate kritike me vërshime dhe përmbytje ne zona te caktuara urbane dhe fushore, ashtu siç edhe është përshkruar në raportet /njoftimet e IHMK, të paraqitura më lartë.<br>-Pas ndërprerjes se reshjeve, niveli i ujërave në lumenj: |
| | **Ngjarja kryesore** | Thelbi i skenarit i nxitur nga një sërë shkaqesh deri te pasojat.<br>- Më: **03/02./2023**, uji i dalur nga shtrati, ka bërë një vërshim përgjatë lumit Nerodime në gjatësi 800m, dhe me sipërfaqe rreth 12 ha, tokë duke përfshirë dhe rrezikuar: objekte banimi, infrastrukturë rrugore( rrugë 1.5km,vijën hekurudhore300m, 3 ura të hekurudhës, dhe 3 ura për mjete motorike dhe këmbësorë.<br>Vërshimet në këtë pjesë janë momentale dhe pas 3-5 orësh zvogëlohet shkalla e rrezikut.<br>- Janë ndërmarrë masat për zvogëlimin e rreziqeve, thellimin e shtretërve të lumenjve dhe heqjen e barrierave ( masave inerte nga lumi) për rrjedhje të ujit pa pengesa, masat për mbrojtjen e sistemit të ujit të pijshëm, infrastrukturën rrugore( urat, rrugët). Vërshimet kanë përfshirë 24 shtëpi banimi me dëme të amvisërisë dhe biznese të vogla, si dhe objekte përcjellëse, kafshë shtëpiake, janë përmbytur 12 ha tokë me të mbjellura ( të lashta),<br>Operacioni i KSh është zhvilluar në shpëtimin e familjeve të ngujuar, evakuimin e 24 familjeve të përmbytura nga vërshimi dhe janë vendosur në vend-strehine të përkohshme në lokacione si: Palestra e Sportit, objekte hoteliere(restorant Fontana, restorant Beni, restoran Evropa 92).<br>Për sanimin e gjendjes pas vërshimeve janë angazhuar edhe mekanizmat institucional dhe publik, siç janë: Drejtoria e Shërbimeve Publike, NJPZSH ( me mekanizëm dhe pompa të presionit të lartë), biznesi privat me makineri etj. |
| | **Pasojat primare dhe efektet anësore** | - Humbje e pasurisë në objekte banimi ( pjesërisht të dëmtuara nga vërshimi) 24 objekte.<br>Dëmtim i përkohshëm eroziv 12 ha<br>-Dëmtim i Infrastrukturës rrugore, ura të dëmtuara 3, rrugë të dëmtuara dhe një pjesë e hekurudhës e dëmtuar<br>- Dëmtim i Infrastrukturës kritike sistemi i ujësjellësit, sistemi energjetik hekurudha ; të pa llogaritura<br>- Shtëpi të përmbytura ( dëmtim i plotë i orendive shtëpiake: 9 shtëpi);<br>- Si pasojë e përmbytjeve në ambient janë dëmtuar toka bujqësore dhe kultura bujqësore 12 hektar;<br>-Dëmtimi i bizneseve: **12,500.00€**<br>Vlera e përgjithshme e përllogaritur e dëmit : |
| | **Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti** | ➢ Vështirësi për qarkullim në trafik ( urat në vijën hekurudhore Kaçanik - Ferizaj në fshatin Stagovë dhe Runjevë, ura për këmbësorë dhe mjete motorike në fshatin Stagovë );<br>➢ Paraqitja e rrëshqitjes së dheut ( Kaçanik, Runjevë Stagovë );<br>➢ Mungesë e ujit të pijes si pasojë e dëmtimit të rrjetit apo ujit të turbullt në impiante (198 banor të fshatit Runjevë );<br>➢ Pasojat e përmbytjeve në ambient dhe tokë pjellore ( 12 ha); |

| | | |
|---|---|---|
| | NDIKIMI- INDIKATORËT TREGUES | |
| | **Rastet me fatalitet** | - Nuk ka pasur raste me fatalitet |
| | **Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar;** | Nuk ka banorë të evidentuar nga ndonjë sëmundje, apo të lënduar.<br>Bazuar në statistikat e QKMF, situata e krijuar pas vërshimeve nuk paraqet rrezik për shpërthimin e epidemiologjik (tifoja, ethet e minjëve, sëmundjet lëkurore etj.) |
| | **Mungesë e nevojave elementare** | - Si pasojë e vërshimeve kemi dëmtime të rrugëve dhe urave,<br>- Punëtorët me vërshtirësi shkojnë në punë, fëmijët në shkolla e kopshte;<br>- Furnizimet e nevojave themelore: ushqimit, veshë-mbathjes, shtrojë e mbulojë, mjeteve higjienike, energjia/të kufizuara;<br>- Kujdesi i ofruar shëndetësorë jo i duhuri<br>- Mungesa e ujit të pijshëm, pjesërishtë etj. |
| | **Të evakuuarit** | Janë kryer 3 veprime operacionale të K-Sh gjatë kohës së vërshimeve;<br>-Më shumë se 90 njerëz u evakuuan gjatë vërshimeve në të gjitha rastet; |
| | **Ndikimi i përgjithshëm ekonomik** | - Dëmet në njerëz( shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj, të pa evidentuara;<br>-Dëmet e shkaktuara në:Infrastrukturë rrugore(rrugët, urat,trotuare,etj) të përllogaritura në Euro: **54,196.00€**<br>-Dëmet e shkaktuara në bujqësi( sipërfaqe të mbjellura me të lashta, sera) , të përllogaritura në Euro : **25.600.00€;**<br>- Dëmet e shkaktuara në: Ekonomi familjare ( 24 familje), të përllogaritura: **83,400.00 €;**<br>-Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë kritike (ujësjellës dhe kanalizim, KRU, ShA), të përllogaritura në Euro: **10,100.00€**<br>- Dëmtimi i bizneseve:**12,300.00€**<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë kritike (energjia elektrike), shuma të pa përllogaritura(KEDS);<br>**-** Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura është **173,296.00 €;** |
| | **Ndikimi në natyrë dhe mjedisi** | -Rritja e nivelit të ujit në lumenj dhe ujëra nëntokësorë mund të sjellë ndotje dhe humbje të kualitetit të ujit (duke i shtuar edhe sasinë e konsiderueshme të shkarkimit të ujërave të zeza);<br>- Humbja/dëmtimi i tokës bujqësore nga erozioni; etj. |
| | **Ndërprerjet në jetën** e **përgjithshme** | - Ndërprerje e pjesërishme e furnizimit me ujë të pijshëm,<br>- Funksionimi i infrastrukturës rrugore( ndërprerje të akseve të caktuara rrugore apo kalim me vështirësi) |
| | **Humbje në trashëgimi kulturore** | Jo |
| | **Implikime politike** | Jo |
| | **Ndikimi i përgjithshëm** | Rrezik i vogël |
| | **Probabiliteti** | - Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësorë dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të ulët të mundshëm, duke marrë për bazë të dhënat historike dhe pasojave. |

| | |
|---|---|
| **Paralajmërimi i hershëm** | -Fatkeqësia ishte pjesërisht e pritshme (bazuar në parashikimet meteorologjike) por pastaj gjërat u përkeqësuan dhe rëndoi në masë të madhe ngjarjen kryesore;<br>-Informimi publik për të reshurat ishte me kohë, sipas njoftimit të parashikimeve meteorologjike, me paralajmërime për mundësi të vërshimeve dhe probabilitetit për cenueshmëri;<br>- Informimi i publikut bëhet në përputhje me PRK ose planin komunal për reagim emergjent(PRE) përmes: mediave të shkruara dhe elektronike, njoftimet e shkruara, mesazhe SMS, rrjete sociale, web-faqe interneti, etj. |
| **Masat parand. gjatë periudhës së paralajmërimit të hershëm** | -Pas marrjes së Paralajmërimit nga IHMK për parashikimin e motit (reshjet e dendura), ngritët gatishmëria e lartë për të papriturat dhe aktivizohet Planifikimi Kontigjent për vërshimet si dhe ngritët gatishmëria e kapaciteteve humane dhe teknike të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim; |
| **Kohëzgjatja e pritshme e ngjarjes** | -Faza akute e ngjarjes zgjati 3 ditë.<br>-Koha e parashikuar e nevojshme për sanim të gjendjes është rreth 5 muaj |
| **Koordinimi** | -Instituti meteorologjik i Kosovës dërgon njoftimin mbi parashikimin e motit në QOE -112 të AME-së për reshjet e dendura komplekse dhe të pafavorshme për ditët në vijim, sipas PSO njoftohen organet kompetente dhe administrative shtetërore, organet vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe strukturat për M&Sh për menaxhimin e situatës së pritshme emergjente sipas PRE;<br>-Bazuar në informacionet nga tereni për shtimin enorm të prurjeve lumore nga të reshurat e dendura, në nivel lokal aktivizohet QOE komunale / Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili kryesohet nga Kryetari i Komunës apo i deleguari i tij.<br>-Koordinimi i aktiviteteve nga niveli qendror deri tek ai lokal dhe anasjelltas bëhet përmes QOE -112 në nivel rajonal;<br>-Duhet të bëhet aktivizimi i Komisionit lokal për mbledhjen e të dhënave mbi vlerësimin e dëmeve në terren të shkaktuara nga vërshimi, të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar;<br>- Komisioni Qendror, bashkon raportet e komisioneve lokale dhe bën verifikimin e vërtetësisë së dëmeve të vlerësuara nga komisionet lokale dhe këtë raport ia dorëzon Qeverisë së RK për shqyrtim dhe miratim;-<br>-Raportin e miratuar nga qeveria ia dorëzon Agjencisë/DKMSh-së QOE-112 rajonale dhe QOE lokale) në afat prej 15 ditëve; |
| **Info plotësuese** | Hartimi i raportit vlerësues për gjendjen e krijuar pas vërshimeve |

**Probabiliteti/Gjasat:**

Sipas kritereve në tabelë, ngjarja e përmbytjes nga viti 2022 mund të klasifikohet si fatkeqësi të moderuara / të mundshme. Sipas të dhënave nga IHK, përmbytjet kanë rënë nga nëntori i vitit 2016.

**Treguesit e probabilitetit**

**Probabiliteti/frekuenca:**

| Probabiliteti / frekuenca | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kategorizimi** | Cilësia | Probabiliteti/gjasat | Frekuenca | Përcaktimi |
| **1** | E papërfillshme/ E pa mundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | |
| **2** | E vogël/ E pa besueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në 20 deri 100 vjet | **X** |
| **3** | Mesatare/ E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në 2 deri 20 vjet | |
| **4** | E madhe / Gati e mundur | 51-98 % | 1 ngjarje në 1 deri 2 vjet | |
| **5** | Jashtëzakonisht e madhe / E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

**Vlerësimi i pasojës:**

**Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut**

-Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, për fat të mirë nuk ka pasur viktima, por duke pasur parasysh numrin e banorëve në nevojë, rrezikun dhe pasojat, vërshimet vlerësohen(përllogariten) si mjaft serioze.

-Përveç kërcënimit të drejtpërdrejtë gjatë vërshimeve (përmbytjeve), vlerësohet si një përkeqësim afatgjatë i standardit jetësor në zonën e prekur nga vërshimet;

**Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:**

| Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi:* | ***Pasojat:*** | ***Kriteret:*** | ***I përcaktuar:*** |
| **1** | Të vogla/ minimale | < 50% | **X** |
| **2** | Të vogla | 50 - 200 | |
| **3** | Mesatare | 201 - 500 | |
| **4** | Kritike | 501-1500 | |
| **5** | Katastrofike | > 500 | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

Dëmet materiale në infrastrukturë janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën **64,296.00€**

- Pasojat në ekonomi të shkaktuara nga vërshimet, përllogariten në raport me bruto-produktin e GDP-së së komunës së Kaçanikut;

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

| Pasojat ekonomike | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | ***Pasojat*** | ***Kriteret*** | ***Përcaktimi*** |
| **1** | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| **2** | Të vogla | 3 - 5% GDP | |
| **3** | Mesatare | 5- 10% GDP | **X** |
| **4** | Kritike | 10-15% GDP | |
| **5** | Katastrofike | >15% GDP | |

**Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social – dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike**

- Vlera e dëmeve materiale në infrastrukturën kritike janë përllogaritur në bazë të raportit të komisioneve lokale për vlerësimin e dëmeve dhe arrinë shumën: **10,100.00€**
( duke mos futur në përllogaritje humbjet në rrugën maxhistrale dhe hekurudhën e Kosovës);

***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike***

| *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social- infrastruktura kritike* | | | |
|---|---|---|---|
| ***Kategorizimi*** | ***Pasojat*** | ***Kriteret*** | ***Përcaktimi*** |
| **1** | Të papërfillshme | < 1% GDP | |
| **2** | Të vogla | 1 - 3% GDP | **X** |
| **3** | Mesatare | 5 - 10% GDP | |
| **4** | Kritike | 5 - 10% GDP | |
| **5** | Katastrofike | >10% GDP | |

***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social - dëmi material i përgjithshëm i objekteve me rëndësi të veqantë:***

| *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social - dëmi material i përgjithshëm në objekte me rëndësi të veqantë:* | | | |
|---|---|---|---|
| ***Kategorizimi*** | ***Pasojat*** | ***Kriteret*** | ***Përcaktimi*** |
| **1** | Të papërfillshme | < 0.5 % GDP | |
| **2** | Të vogla | 0.5 -1 % GDP | **X** |
| **3** | Mesatare | 1 – 3 % GDP | |
| **4** | Kritike | 3 – 5 % GDP | |
| **5** | Katastrofike | > 5 % GDP | |

### 1.1.1. Matricat:

Matrica e gjasës:

**Nivelet e fatkeqësive:**

| | | |
|---|---|---|
| *1* | ***I ULËT*** | |
| *2* | ***I MBROJTUR*** | |
| *3* | ***I MESËM*** | |
| *4* | ***I ASHPËR*** | |
| *5* | ***KATASTROFIK*** | |

**Matrica 1**: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*




**Matrica 2:** *Rreziku për pasojat në ekonomi:*



**Matrica 3:** *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:*




**Matrica 4:** *Pasqyron rrezikun e përgjithshëm*



### 1.3.1.9. Hartëzimi i rreziqeve nga vërshimet -Skenari 2




**Harta 26:** - Zona e rrezikuara nga vërshimet

**Skenari 2 – Vërshimet**

| Emri i skenarit: | Vërshim |
|---|---|
| *Frekuenca e ndodhjes:* | |
| ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>X E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>☐ Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| ☐ E papërfillshme (më pak se 10%)<br>X Kritike: 25 deri 50% . | ☐ E kufizuar( 10 deri 25%)<br>☐ Katastrofike: Më shumë se 50% |
| Lloji i skenarit: | |
| ☐ Skenari 1; **X Skenari 2;** ☐ Skenari 3; | |
| Ndikimi: | |
| ☐ I papërfillshëm; ☐ I vogël ; X ☐ I mesëm ; ☐ Katastrofike; | |
| Data e vlerësimit: | |
| **03/02/2023** | |

| KONTEKSTI | | |
|---|---|---|
| | **Parametrat:** | **Përmbajtja:** |
| | **Vendi i ngjarjes (lokacioni)** | Vendet më të rrezikuara nga vërshimet janë: Kaçaniku (zona urbane), fshatrat, Kaçanik i Vjetër (lagja Topojan), Stagovë (Lagja e Bajramëve), dhe fshati Runjevë (rruga Kemal Thaqi).<br><br><br>Zonat e prekura nga vërshimet e shkurtit 2022 në komunën e Kaçanikut |
| | **Kushtet meteorologjike** | Për tri ditë rresht, nga :01.02.2023, e deri më 03.02. 2023 ka pasur të reshura me dendësi të madhe. Sipas analizave meteorologjike, reshjet e deritanishme maksimale të evidentuara janë të krahasueshme me ato të para, 3 viteve më parë. |
| | **Periudha e vitit:** | 01 – 03 shkurt 2023 |
| | **Lloji i ditës:** | Ditë pune dhe vikendi |
| | **Analiza meteorologjike për kohën** | -Mundësia për të ndodhur vërshimet në këtë vit kalendarik është e madhe në komunën e Kaçanikut. Për çdo 3 vite kanë ndodhur vërshime, kurse nëse e marrim 10 vjeçarin e fundit kemi pasur psh 3 apo 4 vërshime në zona të ndryshme, që dmth se për çdo të tretin vit kemi pasur kërcënime nga vërshimet. Vitet që kanë ndodhur vërshime janë: viti 2005, 2011,2016, 2018, 2021,2023.<br>Koha e paraqitjes sëkësaj fatkeqësie ishte 1 shkurti 2023<br>Si pasojë e të reshurave të mëdha në shkurt 2022, ka pasur prurje të mëdha ujore, duke nxjerrë lumenjtë nga shtrati dhe duke vërshuar vendbanime në rrjedhjen e poshtme të pellgjeve lumore. Në datë 4 shkurt 2022 ka filluar tërheqja e ujit në shtretërit e lumenjve dhe përroskave. |
| | **Popullata** | Numri i familjeve të prekura nga vërshimi në zonën e vërshuar, në fshatin Kaçanik i Vjetër, Stagovë, Runjevë dhe në zonën urbane është 38, kurse numri i banorëve ishte 235, prej tyre:<br>➢ Fëmijë- 124; |

| | | |
|---|---|---|
| | | ➢ Të moshuar 5;<br>➢ Invalid: 6;<br>➢ Gra; 55;<br>➢ Meshkuj: 45; |
| | **Infrastruktura kritike ekzistuese** | Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga vërshimi ka pasur dëme dhe pasoja në infrastrukturë, në këtë zonë.<br>➢ Struktura rrugore;<br>➢ Rruga magjistrale - bllokimi i rrugës nga shembje e dheut në gjatësi 50m (Kaçanik – H. Elezit);<br>➢ Rrugët lokale – 9 km;<br>➢ Ura – 6;<br>➢ Tunele -2;<br>➢ Sistemi i ujit( primare dhe sekondare), afërsisht 1.5 km. |
| | **Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut)** | -Në pajtueshmëri të plotë me paralajmërimet e hershme nga IHMK për sasinë e reshjeve të shiut, QOER-112 ka lëshuar informacion urgjent sipas procedurave standarde operative për organnet kompetente në nivel qëndror dhe lokal si akter për ndërmarrjen e masave për mbrojtje nga vërshimet, duke ngritur nivelin e gadishmërisë së Ekipeve të K-Sh.<br>-Në nivelin lokal, Kryetari i Komunës së Kaçanikut do të aktivizojë Komitetin për Mbrojtje dhe Shpëtim (KMSH), Qendrën operative emergjente lokale (QOEL), të shpallë gjendje emergjente, të ndërmerr masat dhe aktivitetet e nevojshme për K-Sh nga vërshimet, sipas Planit të Reagimit Emergjent lokal, duke bërë edhe informimin publik, paralajmërimin e hershëm dhe alarmimin si dhe udhëzimet e nevojshme publike për evakuim. Ngritja e gatishmërisë të Njësisë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, Policin e Kosovës, Shërbimet Emergjente Mjekësore, , Kryqi i Kuq, Klubet Alpiniste OJQ-të për mbrojtjen e ambientit dhe kompani të kontraktuara nga Komuna e Kaçanikut për intervenime emergjente në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.<br>-Masat parandaluese për mbrojtje nga vërshimet nënkuptojnë të gjitha masat e nevojshme për zvogëlimin e rrezikut, duke filluar nga ato operacionale deri tek masat për sanimin e gjendjes.<br>-Mobilizimi i Ekipeve Reaguese Emergjente me të gjithë potencialin human dhe teknik duhet të jenë në gatishmëri të plotë për reagim në çdo kohë, duke u mbështetur edhe me resurse reaguese lokale, siç janë: Kryqi i Kuq Komunal (KKK), ,Klubet e Alpinistëve, Dhuruesit e gjakut, OJQ për mbrojtjen e ambientit dhe kompanitë të kontraktuara nga Komuna e Kaçanikut për intervenime emergjente në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera. |
| | **Info plotësuese** | Hartimi i raportit vlerësues për gjendjen e krijuar pas vërshimit. |
| | **INCIDENTI-NGJARJA** | |
| | **Shkaku dhe shkaktari** | Pas reshjeve intensive të shiut gjatë tri ditëve të fundit të shoqëruar me shkrirje të borës si pasojë e temperaturave të larta të ndikuar edhe nga pasojat e ngrohjes globale. |

Kjo shkrirje e shpejtë ka bërë që vërshimet të mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të territorit të Komunës së Kaçanikut, në këtë rast të gjitha institucionet lokale, u alarmuan dhe vepruan në bazë të përgjegjësive ligjore për mbrojtje nga FNFT. Me datë: 01 shkurt 2023, Instituti Hidrometeorlogjik i Kosoves (IHMK) lëshoi njoftim/komunikatë përmes web faqes http://ihmk-rks.net/?page=1,40,44 dhe facebook të sajë: https://www.facebook.com/ihmk.rks/ për informim të institucionove dhe publikut në lidhje me mundësinë e vershimeve në zona të caktuara të Kosovës. Në vazhdim është dhënë paralajmërimi për vërshime të shpejta i parashikuar nga IHMK:

Nga këto vërshime janë rrezikuar njerëzit, janë shkaktuar shkatërrime në pasuri, në rrugë, ujësjellës, kanalizime, rrjetin elektrik, paralizimin e shërbimeve emergjente dhe shërbimeve tjera për qytetarë. Nga banorët e fshatit Kaçanik i Vjetër jemi njoftuar se në disa lagje janë shkaktuar vërshime. Sipas Institutit hidrometeorologjik të Kosovës të reshurat e shiut do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim.

Nga këto të reshura ka ardh deri të rritja enorme e nivelit të ujit të rrjetit të lumenjve dhe prrojeve në territorin e Komunës së Kaçanikut.

Gjithashtu, nga shkaku i të reshurave intensive, ka ardhë deri të stërngopja e truallit me ujë dhe paraqitja e ujërave nëntokësor si dhe paraqitja e dukurive erozive dhe rrëshqitjes së dheut.

Shkaqet e vërshimeve kanë qenë , si në vijim:

- mosmirëmbajtja e shtratit të lumit Nerodime dhe degëve të saj,
- mosmirëmbajtja e argjinaturës së lumenjve dhe kanaleve kulluese,
- mosmirëmbajtja e shtretërve nga vegjetacioni,
- ndërtimet pranë lumit dhe përroskave pa kriter,
- shtrati i lumit relativisht i ngushtë,
- hedhja e mbeturinave dhe materialeve inerte, të cilat kanë ndikuar në ngushtimin e shtratit të lumit dhe përroskave.

Gjatë muajit shkurt 2023 si pasojë e ngritjes së nivelit të ujit në lumin Nerodime, fryerja e përroskave në fshatin Kaçanik i Vjetër, Stagovë, Runjevë dhe në zonën urbane të Kaçanikut, ka rezultuar me vërshime të shpejta duke rrezikuar banorët dhe të mirat materiale të këtyre fshatrave.

Vërshimet kanë rrezikuar infrastrukturën rrugore duke dëmtuar urat në fshatin Kaçanik i Vjetër, Stagovë, Runjevë dhe qendrën e qytetit të Kaçanikut. Nga prurjet e mëdha kemi ngujim të popullsisë së këtyre vendbanimeve dhe ndërprerje të lëvizjes së banorëve në këtë aks rrugor.

Zona e vërshimeve ka cenuar rendin e parë të oborreve dhe bodrumeve të shtëpive individuale të banimit përgjatë lumit Nerodime duke rrezikuar pajisjet e amvisërisë dhe të mirat materiale, po ashtu janë rrezikuar objekte të rëndësisë së veçantë siç është, hekurudha dhe stacionet hekurudhore që gjenden në Kaçanik të Vjetër, Stagovë dhe në Kaçanik. Vërshimi i shpejtë ka shkaktuar ndotjen (kontaminimin) e ujit të pijes, jo vetëm në burimet vetanake të banorëve por edhe mundësinë e depërtimit në rrjetin e ujësjellësit, duke shkaktuar infeksione. Si pasojë e infektimit është shtuar kërkesa e banorëve për trajtim medicinal, por pa fatalitet në njerëz.

Nga këto vërshime në komunën e Kaçanikut janë goditur 38 familje

Evakuimi i familjeve të rrezikuar nga vërshimet dhe vendosja e tyre te të afërmit e tyre është bërë për periudhë kohore nga 6 deri 24 orë.

| | | |
|---|---|---|
| | **Ngjarja kryesore** | - Më 2 dhe 3 shkurt 2023, lumi Nerodime ka dal nga shtrati, në një gjatësi rreth 7 km, me sipërfaqe rreth 55ha, duke rrezikuar: objekte banimi, infrastrukturë rrugore( ura 6 të rrezikuara dhe rrugë<br>- dëmtim të infrastrukturës kritike (sistemi i ujësjellësit, kanalizimit, energjetikës);<br>- dëmtimi i vijës hekurudhore Kaçanik – Hani i Elezit<br>- humbje të pasurisë në objekte banimi (pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga vërshimet);<br>- dëmtim i infrastrukturës rrugore, rrugë të dëmtuara dhe ura;<br>- shtëpi të përmbytura (dëmtimi i orendive shtëpiake- 38 shtëpi);<br>- Sipërfaqe e tokave bujqësore (Lavërtari, Perime kulturë, pemëtari) me sipërfaqe 55 (ha);<br>- Sera të dëmtuar 3<br>- Dëmtim i bizneseve-5;<br>-Janë ndërmarrë masat për zvogëlimin e rreziqeve , thellimin e shtretërve të lumenjve dhe heqjen e barrierave ( masave inerte nga lumi) për rrjedhje të ujit pa pengesa, masat për mbrojtjen e sistemit të ujit të pijshëm, infrastrukturën rrugore( urat, rrugët).<br>-Për sanimin e gjendjes gjatë dhe pas vërshimeve janë angazhuar edhe mekanizma institucional dhe publik, siç janë: NjPZSh ( me mekanizëm dhe pompa me presion të lartë, Drejtoria komunale e Shërbimeve publike, biznesi privat me makineri, FSK me makineri, etj. |
| | **Pasojat primare dhe efektet anësore** | - Humbje e pasurisë në objekte banimi ( pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga vërshimi): 38 shtëpi<br>-Dëmtim i Infrstrukturës rrugore(ura të dëmtuara 6 rrugë të dëmtuara 9km)<br>- Dëmtim i Infrstrukturës kritike( sistemi i ujësjellësit, kanalizim);<br>- Shtëpi të përmbytura ( dëmtim i plotë i orendive shtëpiake: 22shtëpi);<br>- Sipërfaqja e tokave bujqësore ( kultura bujqësore të dëmtuara): 55 (ha)<br>- Dëmtimi i bizneseve të dëmtuara **32,100.00€** |
| | **Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti** | - Vështirësi për qarkullim në trafik ( dëmtimi i rrugës dhe urës që lidh fshatin Stagovë me qytetin e Kaçanikut );<br>- Paraqitja e rrëshqitjes së dheut në gjatësi prej 45m në disa lagje të fshatit Stagovë. ;<br>- Mungesë e ujit të pijes si pasojë e dëmtimit të rrjetit apo ujit të turbullt në impiante, ndotjen apo kontaminimin e ujit të pijes për shkak të mundësisë së depërtimit në rrjetin e ujësjellësit dhe infeksionet e mundshme kërkesat për trajtim medikal, por pa fatalitet në njerëz;.<br>- Kërcënimi për mundësinë e shfaqjes së ndonjë epidemie ( si pasojë e kafshëve të ngordhura, nga shkarkimet e gropave septike, etj);<br>- Pasojat e përmbytjeve në ambient dhe tokë pjellore ( janë dëmtuar lavërtari, perime kulturë, pemëtari ); |
| | | |

| NDIKIMI- INDIKATORËT TREGUES | |
|---|---|
| **Rastet me fatalitet** | -Nuk ka pasur raste me fatalitet; |
| **Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar;** | -Bazuar në të dhënat e Komisionit për vlerësimin e dëmeve në Amvisëri dhe ekonomi Familjare të formuar nga Kryetari i Komunës, me dt.05.02.2023 nga pasojat e vërshimeve të shkurtit 2023 janë prekur rreth 38 ekonomi familjare me 235 banorë);<br>-Situata e krijuar pas vërshimeve është shqetësuese dhe paraqet rrezik i shpërthimit epidemiologjik( tifoja , ethet e minjëve, sëmundjet lëkurore, etj.) si dhe ndotja e ujit të pijshëm në puse;(sipas informatat që kemi nga QKMF është shtuar numri i pacientëve me diare që kërkojnë ndihmë në këtë qendër.) |
| **Mungesë e nevojave elementare** | - Si pasojë e vërshimeve kemi dëmtime të rrugëve dhe urave,<br>- Punëtorët nuk mund të shkojnë në punë, fëmijët në shkolla e kopshte;<br>- Kujdesi i ofruar shëndetësorë jo i duhuri;<br>- Furnizimet e nevojave themelore: ushqimit, vesh-mbathjes, shtrojë e mbulojë, mjeteve higjienike, energjia, etj./të pa mjaftueshme;<br>- Mungesa e ujit të pijshëm, etj. |
| **Të evakuuarit** | - Janë kryer 5 veprime operacionale të K-Sh gjatë kohës së vërshimeve;<br>- Më shumë se 130 njerëz u evakuuan gjatë vërshimeve në të gjitha rastet |
| **Ndikimi i përgjithshëm ekonomik** | - Dëmet në njerëz (shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj.) , të pa evidentuara;<br>- Dëmet e shkaktuara në: Ekonomi familjare ( rreth 38 familje), të përllogaritura: **253,352.00€**<br>- Dëmet e shkaktuara në bujqësi( sipërfaqe të mbjella me të lashta), në sipërfaqe të dëmtuara 55(ha) të përllogaritura në Euro: **116.357.00€,;**<br>- Dëmtimi i pronave individuale (fusha të shkatërruara, sera të dëmtuara, objekte ndihmëse) të përllogaritura në Euro: **48,257.00 €;**<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë rrugore(rrugët ,urat, trotuare, etj.) të përllogaritura në Euro: **115,452.00 €;**<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë kritike (energjia elektrike – KEDS, hekurudhë)të pallogaritura;<br>- shuma të mëdha por të pa përllogaritura(KEDS);<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë kritike (ujësjellës dhe kanalizim, KRU), të përllogaritura në Euro: **25,347.00 €;**<br>- Dëmtim i bizneseve-;**32,100.00€;**<br>- Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura është: **590,865.00 €;** |
| **Ndikimi në natyrë dhe mjedisi** | -Rritja e nivelit të ujit në lumenjë dhe ujëra nëntokësorë mund të sjellë ndotje dhe humbje të kualitetit të ujit (duke i shtuar edhe sasinë e konsiderueshme të shkarkimit të ujërave të zeza);<br>- Humbja/dëmtimi i tokës bujqësore nga erozioni;etj. |
| **Ndërprerjet në jetën e përgjithshme** | - Ndërprerje e furnizimit me ujë të pijshëm,<br>- Funksionimi i infrastrukturës rrugore( ndërprerje të akseve të caktuara rrugore apo kalim me vështirësi). |
| **Humbje në trashëgimi kulturore** | Jo |

| | | |
|---|---|---|
| | | |
| | **Implikime politike** | Jo |
| | **Ndikimi i përgjithshëm** | Rrezik i mesëm |
| | | **PROBABILITETI-GJASAT** |
| | **Probabiliteti** | - Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësorë dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të mesëm të mundshëm, duke marrë për bazë të dhënat historike, |
| | **Paralajmërimi i hershëm** | -Fatkeqësia ishte pjesërisht e pritshme (bazuar në parashikimet meteorologjike) por pastaj gjërat u përkeqësuan dhe rëndoi në masë të madhe ngjarjen kryesore;<br>-Informimi publik për të reshurat ishte me kohë, sipas njoftimit të parashikimeve meteorologjike, me paralajmërime për mundësi të vërshimeve dhe probabilitetit për cenueshmëri;<br>- Informimi i publikut bëhet në përputhje me PRK ose planin komunal për reagim emergjent(PRE) përmes: mediave të shkruara dhe elektronike, njoftimet e shkruara, mesazhe SMS, rrjete sociale, web-faqe interneti, etj. |
| | **Masat parand. gjatë periudhës së paralajmërimit të hershëm** | -Pas marrjes së Paralajmërimit nga IHMK për parashikimin e motit (reshjet e dendura), ngritet gatishmëria e lartë për të papriturat dhe aktivizohet Planifikimi Kontingjent për vërshimet si dhe ngritët gatishmëria e kapaciteteve humane dhe teknike të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim; |
| | **Kohëzgjatja e pritshme e ngjarjes** | -Faza akute e ngjarjes zgjati 3 ditë.<br>-Koha e parashikuar e nevojshme për sanim të gjendjes është rreth 6 muaj |
| | **Koordinimi** | -Instituti meteorologjik i Kosovës dërgon njoftimin mbi parashikimin e motit në QOE -112 të AME-së për reshjet e dendura komplekse dhe të pafavorshme për ditët në vijim, sipas PSO njoftohen organet kompetente dhe administrative shtetërore, organet vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe strukturat për M&Sh për menaxhimin e situatës së pritshme emergjente sipas PRE;<br>-Bazuar në informacionet nga terreni për shtimin enorm të prurjeve lumore nga të reshurat e dendura, është aktivizuar QOE komunale/ Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili kryesohet nga Kryetari i Komunës apo i deleguari i tij.<br>- Koordinimi i aktiviteteve nga niveli qendror deri tek ai lokal dhe anasjelltas bëhet përmes QOE -112 në nivel rajonal;<br>- Duhet të bëhet aktivizimi i Komisionit lokal për mbledhjen e të dhënave mbi vlerësimin e dëmeve në terren të shkaktuara nga fatkeqësia /vërshimi, të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar;<br>- Komisioni Qendror, bashkon raportet e komisioneve lokale dhe bën verifikimin e vërtetësisë së dëmeve të vlerësuara nga komisionet lokale dhe këtë raport ia dorëzon Qeverisë së RK për shqyrtim dhe miratim;- |

| | | |
|---|---|---|
| | | -Raportin e miratuar nga qeveria ia dorëzon Agjencisë/DKMSh-së në afat prej 15 ditëve;<br>- Është dhënë ndihma nga shteti dhe persona të tjerë juridikë e fizikë për popullatën brenda mundësive dhe kapaciteteve;<br>- Menaxhim dhe koordinimi i situatës bëhet sipas PRK-së :/ përmes, QOE-112 rajonale dhe QOE lokale ); |
| | **Informata plotësuese** | |

**Probabiliteti/Gjasat:**

Sipas kritereve në tabelë, ngjarja e përmbytjes nga viti 2022 mund të klasifikohet si fatkeqësi të moderuara / të mundshme. Sipas të dhënave nga IHK, përmbytjet kanë rënë nga nëntori i vitit 2016.
ishte një periudhë kthimi prej T = 15 vjet, pra probabiliteti i ndodhjes p = 7%.

***Treguesit e probabilitetit***

| *Probabiliteti / frekuenca* | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ***Kategorizimi*** | ***Cilësia*** | ***Probabiliteti/gjasat*** | ***Frekuenca*** | ***Përcaktimi*** |
| 1 | E papërfillshme/<br>E pa mundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | |
| 2 | E vogël/<br>E pa besueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në 20 deri 100 vjet | |
| 3 | Mesatare/<br>E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në 2 deri 20 vjet | X |
| 4 | E madhe /<br>Gati e mundur | 51-98 % | 1 ngjarje në 1 deri 2 vjet | |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe /<br>E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

**Vlerësimi i pasojës:**

**Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut**

-Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, për fat të mirë nuk ka pasur viktima, por duke pasur parasysh numrin e banorëve në nevojë, rrezikun dhe pasojat, vërshimet vlerësohen(përllogariten) si mjaft serioze.
-Përveç kërcënimit të drejtpërdrejtë gjatë vërshimeve (përmbytjeve), vlerësohet si një përkeqësim afatgjatë i standardit jetësor në zonën e prekur nga vërshimet;

*Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:*

| Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi:* | *Pasojat:* | *Kriteret:* | *I përcaktuar:* |
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | X |
| 4 | Kritike | 501-1500 | |
| 5 | Katastrofike | > 500 | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

- Dëmet materiale në infrastrukturë janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: **85,456.00** €.
- Dëmet materiale në ekonomi familjare dhe biznese janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: **285,452.00 €.**;

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

| Pasojat ekonomike | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | X |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

**Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social – dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike**

- Vlera e dëmeve materiale në infrastrukturën kritike janë përllogaritur në bazë të raportit të komisioneve lokale për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë shumën: **25,347.00 €;**
( duke mos futur në përllogaritje humbjet e KEDS dhe Hekurudhës);

***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike***

| *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social- infrastruktura kritike* | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 1% GDP | |
| 2 | Të vogla | 1 - 3% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5 - 10% GDP | X |
| 4 | Kritike | 5 - 10% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >10% GDP | |

## Matrica e gjasës:

### Matrica 1: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*




### Matrica 2: *Rreziku për pasojat në ekonomi:*



Matrica 3a: *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:*




Matrica 4: *Pasqyron rrezikun e përgjithshëm*



Hartëzimi i rreziqeve nga vërshimet - **Skenari 3**




**Harta 26 :** Harta e vërshimeve në Komunën e Kaçanikut ( Burimi i të dhënave Komuna e Kaçanikut)

**Skenari 3 - Vërshimet**

| Emri i skenarit: | Vërshim |
|---|---|
| *Frekuenca e ndodhjes:* | |
| ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>☐E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>**X** Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| ☐ E papërfillshme (më pak se 10%) ☐ E kufizuar( 10 deri 25%)<br>☐ Kritike: 25 deri 50% . **X**☐ Katastrofike: Më shumë se 50% | |
| Lloji i skenarit: | |
| ☐ Skenari 1; ☐ Skenari 2; **X** ☐**Skenari 3**; | |
| Ndikimi: | |
| ☐ I papërfillshëm; ☐ I vogël ; ☐ I mesëm ; **X** Katastrofike; | |
| Data e vlerësimit: | |
| **03/02/2023** | |

| KONTEKSTI | | |
|---|---|---|
| | **Parametrat:** | **Përmbajtja:** |
| | **Vendi i ngjarjes (lokacioni)** | Vendet më të rrezikuara nga vërshimet janë: Kaçaniku (zona urbane), fshatrat, Kaçanik i Vjetër (lagja Topojan), Stagovë (Lagja e Bajramëve), dhe fshati Runjevë (rruga Kemal Thaqi).<br><br><br>Sipërfaqet e prekura nga vërshimet e shkurtit 2022 në komunën e Kaçanikut |
| | **Kushtet meteorologjike** | Për tri ditë rresht, nga :01.02.2023, e deri më 03.02.2023 ka pasur të reshura me dendësi të madhe. |
| | **Periudha e vitit:** | 01 – 03 shkurt 2023 |
| | **Lloji i ditës:** | Ditë pune dhe vikendi |
| | **Analiza meteorologjike për kohën** | -Mundësia për të ndodhur vërshimet në këtë vit kalendarik është e madhe në komunën e Kaçanikut. Për çdo 3 vite kanë ndodhur vërshime, kurse nëse e marrim 10 vjeçarin e fundit kemi pasur 3 apo 4 vërshime në zona të ndryshme, që dmth se për çdo të tretin vit kemi pasur kërcënime nga vërshimet. Vitet që kanë ndodhur vërshime janë: viti 2005, 2011,2016, 2018, 2023<br>Si pasojë e të reshurave të mëdha në shkurt 2023, ka pasur prurje të mëdha ujore, duke nxjerrë lumenjtë nga shtrati dhe duke vërshuar vendbanime në rrjedhjen e poshtme të pellgjeve lumore. Sipas Institutit Hidrometeorologjik reshjet do të vazhdojnë edhe ditëve në vijim. |
| | **Popullata** | Numri i familjeve të prekura nga vërshimet, në fshatin Kaçanik i Vjetër, Stagovë, Runjevë dhe në zonën urbane është 230, kurse numri i banorëve ishte 1370, prej tyre:<br>- Fëmijë- 473;<br>- Të moshuar 135;<br>- Invalid: 56;<br>- Gra; 374;<br>- Meshkuj: 332; |

| | | |
|---|---|---|
| | **Infrastruktura kritike ekzistuese** | Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga vërshimi ka pasur dëme dhe pasoja në infrastrukturë, në këtë zonë.<br>- Struktura rrugore;<br>- Ura në rrugë lokale; -6 ura të dëmtuar pjesërisht;<br>- Vija hekurudhore Kaçanik – Hani i Elezit 2km e dëmtuar;<br>- 2 tunele në vijën hekurudhore Kaçanik – Hani i Elezit<br>- Rruga magjistrale - bllokimi i rrugës nga shembje e dheut në gjatësi 70m (Kaçanik – H. Elezit);<br>- Rrugët lokale të dëmtuar - 23 km;<br>- Sistemi i ujit( primare dhe sekondare), afërsisht 1.5 km; |
| | **Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut)** | - Në pajtueshmëri të plotë me paralajmërimet e hershme nga IHMK të RK për sasinë e madhe të reshjeve të shiut, QOE-112 ka lëshuar informacion urgjent sipas procedurave standarde operative, për organet kompetente shtetërore , në nivel qendror dhe lokal si akter për ndërmarrjen e masave për mbrojtje nga vërshimet, duke ngritur nivelin e gatishmërisë së Ekipeve të K-Sh.<br>- Në nivelin lokal, Kryetari i Komunës së Kaçanikut do të aktivizojë Komitetin për Mbrojtje dhe Shpëtim (KMSH), Qendrën operative emergjente lokale (QOEL), të shpallëgjendje emergjente, të ndërmerr masat dhe aktivitetet e nevojshme për K-Sh nga vërshimet, sipas Planit të Reagimit Emergjent lokal, duke bërë edhe informimin publik, paralajmërimin e hershëm dhe alarmimin si dhe udhëzimet e nevojshme publike për evakuim.<br>- Masat parandaluese për mbrojtje nga vërshimet nënkuptojnë të gjitha masat e nevojshme për zvogëlimin e rrezikut, duke filluar nga ato operacionale deri tek masat për sanimin e gjendjes.<br>- Mobilizimi i Ekipeve Reaguese Emergjente me të gjithë potencialin human dhe teknik duhet të jenë në gatishmëri të plotë për reagim në çdo kohë, duke u mbështetur edhe me resurse reaguese lokale, siq janë: Kryqi i Kuq Komunal (KKK), ERE të SMShN, Klubet e Alpinistëve, Dhuruesit e gjakut, OJQ për mbrojtjen e ambientit dhe kompanitë të kontraktuara nga Komuna e Kaçanikut për intervenime emergjente në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera. Për shkak të nivelit të lartë të rrezikshmërisë, përmes QOER 112- Gjilan ndihmë është kërkuar edhe nga ekipet e kërkim shpëtimit të nivelit Qendrorë. |
| | **Info plotësuese** | Hartimi i raportit vlerësues për gjendjen e krijuar pas vërshimit dhe ndjekja e procedurave për shpalljen e gjendjes emergjente lokale. |
| **INCIDENTI - NGJARJA** | | |
| | **Shkaku dhe shkaktari** | Pas reshjeve intensive të shiut gjatë periudhës 01-03 shkurt 2023 te cilat shkaktuan vershime në disa zona që përfshijnë pothujse gjithë teritorin e Republikës së Kosovës, në këtë rast të gjitha institucionet qendrore dhe lokale, u alarmuan dhe vepruan në bazë të përgjegjësive ligjore për mbrojtje nga FNFT.<br>Me datë: 01 shkurt 2023, Instituti Hidrometeorlogjik i Kosoves (IHMK) lëshoi njoftim/komunikatë përmes web faqes http://ihmk-rks.net/?page=1,40,44 dhe facebook të sajë: https://www.facebook.com/ihmk.rks/ për informim të institucionove dhe publikut në lidhje me mundësinë e vershimeve në zona të caktuara të Kosovës. Në vazhdim është dhënë paralajmërimi për vërshime të shpejta i parashikuar nga IHMK: |







- Reshjet e shiut, të cilat pritet të fillojnë gjatë orëve të pasditës së datës 01-02/2023, me intensitet mesatarë deri të lartë, fillimisht do të përfshinë pjesën veri- lindore të vendit (zonën malore të Karadakut), të cilat në vazhdim do të përfshinë pjesën jug- perendimore (zonën malore të Sharrit). Kjo situatë do të vazhdoj për disa ditë (deri më: 03-02/2023), ku si pasojë e intensitetit më të lartë të tyre, në disa zona mund të paraqiten vërshime të shpejta, të cilat potencialisht shkaktojnë ngritje të shpejta të nivelit të ujit nëpër lumenj e sidomos nëpër rrjedhat ujore të cilat kanë karakter të rrëkeve. Në lumin Nerodime dhe Lepenc do të ketë ngritje të niveleve gjatë ditëve në vijim, ndërsa rrjedhat me karakter malor dhe ato të rrëmbyeshme do të paraqesin mundësi të vërshimeve të shpejta dhe vështirësi në (zonën urbane), fshatrat, Kaçanik i Vjetër (lagja Topojan), Stagovë, dhe Runjevë.

| | | |
|---|---|---|
| | | -Rëndimit të situatës i ka kontribuar edhe shkrirja e borës në viset e larta.. Kjo shkrirje e shpejtë ka bërë që vërshimet të mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të territorit të Komunës së Kaçanikut, duke rrezikuar njerëzit, duke shkaktuar shkatërrime në pasuri, në rrugë, ujësjellës, kanalizime, rrjetin elektrik, paralizimin e shërbimeve emergjente dhe shërbimeve tjera për qytetarë. Nga banorët e fshatit Kaçanik i Vjetër jemi njoftuar se në disa lagje janë shkaktuar vërshime.<br><br>**Vërejtje;** *Në lumenjt, Lepenc, Nerodime dhe përroi i Rakocit tendencat janë në ngritje, kështu që nesër më datë 02-02/2023, pritet që të shkaktohen përmbytje dhe* vërshime të shpejta *në zonat ku kalojnë këta lumenjë.*<br><br>Nga këto të reshura ka ardhur deri të rritja enorme e nivelit të ujit të rrjetit të lumenjve dhe përroskave në teritorin e Komunës së Kaçanikut.<br>Gjithashtu, nga shkaku i të reshurave intensive, ka ardhë deri të stërngopja e truallit me ujë, paraqitja e ujrave nënëtokësorë, dukurive erozive dhe rrëshqitjes së dheut.<br><br>Shkaqet e vërshimeve kanë qenë , si në vijim:<br>- mosmirëmbajtja e shtratit të lumit Nerodime dhe degëve të saj,<br>- mosmirëmbajtja e argjinaturës së lumenjve dhe kanaleve kulluese,<br>- mosmirëmbajtja e shtretërve nga vegjetacioni,<br>- ndërtimet pranë lumit dhe përroskave pa kriter,<br>- shtrati i lumit relativisht i ngushtë,<br>- ngushtimi (ngulfatja) e fyteve të urës nga materialet që sjellë lumi,<br>- hedhja e mbeturinave dhe materialeve inerte, të cilat kanë ndikuar në ngushtimin e shtratit të lumit dhe përroskave.<br><br>Kjo situatë do të vazhdoj për disa ditë (deri më: 03/02/2023), ku si pasojë e intensitetit më të lartë të tyre, në disa zona mund të paraqiten vërshime të shpejta, të cilat potencialisht shkaktojnë ngritje të shpejta të nivelit të ujit në lumenj e sidomos nëpër rrjedhat ujore të cilat kanë karakter të rrëkeve.<br>Gjatë muajit shkurt 2023 si pasojë e ngritjes së nivelit të ujit në lumin Nerodime, fryerja e përroskave në fshatin Kaçanik i Vjetër, Stagovë, Runjevë dhe në zonën urbane të Kaçanikut, ka rezultuar me vërshime të shpejta duke rrezikuar banorët dhe të mirat materiale të këtyre banorëve. Nga prurjet e mëdha kemi ngujim të popullsisë së këtyre vendbanimeve dhe ndërprerje të lëvizjes së banorëve në këtë aks rrugor.<br>Zona e vërshimeve përfhsin oborret dhe bodrumet e shtëpive individuale të banimit përgjatë shtratit të lumit Nerodime dhe Lepenc në gjatësi në të dy krahët e rrjedhjes afër 10km. Në këtë gjatësi janë 6 ura për automjete dhe këmbësorë të cilat gjatë reshjeve të shiut përmbledhin mbeturina duke ngulfatur dhe rrezikuar rrjedhjen e ujit, po ashtu janë rrezikuar urat hekurudhore(4), objekte të rëndësisë së veçantë siç është hekurudha dhe stacionet hekurudhore që gjenden në Kaçanik të Vjetër, Stagovë dhe në Kaçanik. |

| | | |
|---|---|---|
| | **Ngjarja kryesore** | M e datën 2 dhe 3shkurt 2023, lumi Nerodime dhe lumi Lepenc ka dal nga shtrati, në një gjatësi rreth 10 km, me sipërfaqe rreth 95ha, duke rrezikuar:<br>- dëmtim të infrastrukturës kritike (sistemi i ujësjellësit, kanalizimit, energjetikës);<br>- dëmtimi i vijës hekurudhore Kaçanik – Hani i Elezit 2km<br>- humbje të pasurisë në objekte banimi (pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga vërshimet);<br>- dëmtim i infrastrukturës rrugore, rrugë të dëmtuara dhe ura;<br>- shtëpi të përmbytura (dëmtimi i orendive shtëpiake- 38 shtëpi);<br>- Sipërfaqe e tokave bujqësore (Lavërtari, Perime kulturë, pemëtari) me sipërfaqe 95 (ha);<br>- sera të dëmtuar 3<br>- dëmtim i bizneseve-5;<br>- Janë ndërmarrë masat për zvogëlimin e rreziqeve , thellimin e shtretërve të lumenjve dhe heqjen e barrierave ( masave inerte nga lumi) për rrjedhje të ujit pa pengesa, masat për mbrojtjen e sistemit të ujit të pijshëm, infrastrukturën rrugore( urat, rrugët, tunelet). Operacionet e KSh kanë zhvilluar operacione të Shpëtimit të 200 familjeve të ngujuara, evakuimin e 30 familjeve të rrezikuar nga vërshimet dhe vendosja e tyre në Palestrën Sportive, te ish Sanatoriumi dhe në restorante që posedojnë salla për organizimin e ahengjeve të ndryshme.(Fontana , Mani, Beni dhe Evropa 92).<br>- Për sanimin e gjendjes gjatë dhe pas vërshimeve janë angazhuar edhe mekanizma institucional dhe publik, siq janë: NjPZSh ( me mekanizëm dhe pompa me presion të lartë, Drejtoria komunale e Shërbimeve publike, Operatorët Ekonomik të kontraktuar nga Komuna e Kaçanikut për Intervenime Emergjente, biznesi privat me makineri, niveli Qendror me institucionet përkatëse, FSK , AME me ekipet e kërkim shpëtimit në ujëra. |
| | **Pasojat primare dhe efektet anësore** | - Humbje e pasurisë në objekte banimi ( pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga vërshimi):<br>- Dëmtim i Infrastrukturës rrugore(ura të dëmtuara, rrugë të dëmtuara 23km<br>- Dëmtim i Infrastrukturës kritike( sistemi i ujësjellësit, sistemi energjetik);<br>- Shtëpi të përmbytura ( dëmtim i plotë i orendive shtëpiake: 230 shtëpi);<br>- Sipërfaqja e tokave bujqësore ( kultura bujqësore të dëmtuara): 95 (ha)<br>- Dëmtimi i krerëve të kafshëve dhe ushqimi për to:<br>- -Dëmtimi i bizneseve; 7 biznese të dëmtuara |
| | **Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti** | - Vështirësi për qarkullim në trafik ( dëmtimi i rrugës dhe urës që lidh fshatin Stagovë me qytetin e Kaçanikut );<br>- Paraqitja e rrëshqitjes së dheut në gjatësi prej 45m në disa lagje të fshatit Stagovë. ;<br>- Mungesë e ujit të pijes si pasojë e dëmtimit të rrjetit apo ujit të turbullt në impiante, ndotjen apo kontaminimin e ujit të pijes për shkak të mundësisë së depërtimit në rrjetin e ujësjellësit dhe infeksionet e mundshme kërkesat për trajtim medikal, por pa fatalitet në njerëz;. |

| | |
|---|---|
| | - Kërcënimi për mundësinë e shfaqjes së ndonjë epidemie ( si pasojë e kafshëve të ngordhura, nga shkarkimet e gropave septike, etj.);<br>- Pasojat e përmbytjeve në ambient dhe tokë pjellore ( janë dëmtuar lavërtari, perime kulturë, pemëtari ); |
| **NDIKIMI - INDIKATORËT TREGUES** | |
| **Rastet me fatalitet** | -Nuk ka pasur raste me fatalitet; |
| **Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar;** | - Me dt.05.02.2023 nga pasojat e vërshimeve të shkurtit 2022 janë lënduar 14 persona të cilët janë në QKMF për tretman (gjendje e tyre është e rëndë);<br>- Sipas informatat që kemi nga QKMF është shtuar numri i pacientëve që kërkojnë ndihmë në këtë qendër. |
| **Mungesë e nevojave elementare** | - Si pasojë e vërshimeve kemi dëmtime të rrugëve dhe urave,<br>- Punëtorët nuk mund të shkojnë në punë, fëmijët në shkolla e kopshte;<br>- Kujdesi i ofruar shëndetësorë jo i duhuri;<br>- Furnizimet e nevojave themelore: ushqimit, veshë-mbathjes, shtrojë e mbulojë, mjeteve higjienike, energjia, etj./të pa mjaftueshme;<br>- Mungesa e ujit të pijshëm, etj. |
| **Të evakuuarit** | Janë kryer 6 veprime operacionale të K-Sh gjatë kohës së vërshimeve;<br>-Më shumë se 150 banorë u evakuuan gjatë vërshimeve në të gjitha rastet; |
| **Ndikimi i përgjithshëm ekonomik** | - Dëmet në njerëz (shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj.) , të pa evidentuara;<br>- Dëmet e shkaktuara në: Ekonomi familjare ( rreth 230 familje), të përllogaritura: **326,458.00€**<br>- Dëmet e shkaktuara në bujqësi( sipërfaqe të mbjella me të lashta), në sipërfaqe të dëmtuara 95(ha) të përllogaritura në Euro: **113.267.00 €,;**<br>- Dëmtimi i pronave individuale (fusha të shkatërruara, sera të dëmtuara, objekte ndihmëse) të përllogaritura në Euro: **95,328.00 €;**<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë rrugore(rrugët ,urat, trotuare, etj.) të përllogaritura në Euro: **369,742.00 €;**<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë kritike (energjia elektrike – KEDS, hekurudhë) të pallogaritura;<br>- Dëmet në biznese**; 74,650.00€;**<br>- Shuma të mëdha por të pa përllogaritura(KEDS);<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë kritike (ujësjellës dhe kanalizim, KRU), të përllogaritura në Euro: **211,284.00 €;**<br>- Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura është: **1,190.729.00 €;** |
| **Ndikimi në natyrë dhe mjedisi** | -Rritja e nivelit të ujit në lumenj dhe ujëra nëntokësorë mund të sjellë ndotje dhe humbje të kualitetit të ujit (duke i shtuar edhe sasinë e konsiderueshme të shkarkimit të ujërave të zeza);<br>- Humbja/dëmtimi i tokës bujqësore nga erozioni;etj. |

| | |
|---|---|
| **Ndërprerjet në jetën e përgjithshme** | - Ndërprerje e furnizimit me ujë të pijshëm,<br>- Funksionimi i infrastrukturës rrugore( ndërprerje të akseve të caktuara rrugore apo kalim me vështirësi).<br>- Ndërprerja e transportit hekurudhor |
| **Humbje në trashëgimi kulturore** | Jo |
| **Implikime politike** | Jo |
| **Ndikimi i përgjithshëm** | Rrezik i lartë |
| **PROBABILITETI - GJASAT** | |
| **Probabiliteti** | - Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësorë dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të lartë të mundshëm, duke marrë për bazë të dhënat historike, |
| **Paralajmërimi i hershëm** | -Fatkeqësia ishte pjesërisht e pritshme (bazuar në parashikimet meteorologjike) por pastaj gjërat u përkeqësuan dhe rëndoi në masë të madhe ngjarjen kryesore;<br>-Informimi publik për të reshurat ishte me kohë, sipas njoftimit të parashikimeve meteorologjike, me paralajmërime për mundësi të vërshimeve dhe probabilitetit për cenueshmëri;<br>- Informimi i publikut bëhet në përputhje me PRK ose planin komunal për reagim emergjent(PRE) përmes: mediave të shkruara dhe elektronike, njoftimet e shkruara, mesazhe SMS, rrjete sociale, web-faqe interneti, etj. |
| **Masat parand. gjatë periudhës së paralajmërimit të hershëm** | -Pas marrjes së Paralajmërimit nga IHMK për parashikimin e motit (reshjet e dendura), ngritet gatishmëria të lartë për të papriturat dhe aktivizohet Planifikimi Kontingjent për vërshimet si dhe ngritet gatishmëria e kapaciteteve humane dhe teknike të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim; |
| **Kohëzgjatja e pritshme e ngjarjes** | - Faza akute e ngjarjes zgjati 3 ditë.<br>- Koha e parashikuar e nevojshme për sanim të gjendjes është rreth 6 muaj |
| **Koordinimi** | -Instituti Meteorologjik i Kosovës dërgon njoftimin mbi parashikimin e motit në QOE -112 të AME-së për reshjet e dendura komplekse dhe të pafavorshme për ditët në vijim, sipas PSO njoftohen organet kompetente dhe administrative shtetërore, organet vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe strukturat për M&Sh për menaxhimin e situatës së pritshme emergjente sipas PRE;<br>-Bazuar në informacionet nga terreni për shtimin enorm të prurjeve lumore nga të reshurat e dendura, është aktivizuar QOE komunale/ Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili kryesohet nga Kryetari i Komunës apo i deleguari i tij.<br>-Koordinimi i aktiviteteve nga niveli qendror deri tek ai lokal dhe anasjelltas bëhet përmes QOE -112 në nivel rajonal;<br>- Duhet të bëhet aktivizimi i Komisionit lokal për mbledhjen e të dhënave mbi vlerësimin e dëmeve në terren të shkaktuara nga fatkeqësia /vërshimi, të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar; |

| | | |
|---|---|---|
| | | - Komisioni Qendror, bashkon raportet e komisioneve lokale dhe bën verifikimin e vërtetësisë së dëmeve të vlerësuara nga komisionet lokale dhe këtë raport ia dorëzon Qeverisë së RK për shqyrtim dhe miratim;<br>-Raportin e miratuar nga qeveria ia dorëzon Agjencisë/DKMSh-së në afat prej 15 ditëve;<br>-Është bërë kontakti dhe është kërkuar ndihma e humanitare nga mekanizmat vendorë e (organizata dhe OJQ humanitare).<br>- Është ofruar ndihmë emergjente nga shteti dhe persona të tjerë juridikë e fizikë për popullatën brenda mundësive dhe kapaciteteve;<br>- Menaxhim dhe koordinimi i situatës bëhet sipas PRK-së :/ përmes, QOE-112 rajonale dhe QOE lokale ); |

## Probabiliteti/Gjasat:

Sipas kritereve në tabelë, ngjarja e përmbytjes nga viti 2022 mund të klasifikohet si fatkeqësi të moderuara / të mundshme. Sipas të dhënave nga HS Berane, përmbytjet kanë rënë nga nëntori i vitit 2016.
ishte një periudhë kthimi prej T = 2 vjet, pra probabiliteti i ndodhjes p = 75%.

*Treguesit e probabilitetit*

| Probabiliteti / frekuenca | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kategorizimi** | **Cilësia** | **Probabiliteti/gjasat** | **Frekuenca** | **Përcaktimi** |
| 1 | E papërfillshme/<br>E pa mundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | |
| 2 | E vogël/<br>E pa besueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në<br>20 deri 100 vjet | |
| 3 | Mesatare/<br>E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në<br>2 deri 20 vjet | |
| 4 | **E madhe /<br>Gati e mundur** | **51-98 %** | **1 ngjarje në<br>1 deri 2 vjet** | **X** |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe /<br>E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

## Vlerësimi i pasojës:

### Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut

-Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, për fat të mirë nuk ka pasur viktima, por duke pasur parasysh numrin e banorëve në nevojë, rrezikun dhe pasojat, vërshimet vlerësohen(përllogariten) si katastrofike.
-Përveç kërcënimit të drejtpërdrejtë gjatë vërshimeve (përmbytjeve), vlerësohet si një përkeqësim afatgjatë i standardit jetësor në zonën e prekur nga vërshimet;

*Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:*

| Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi:* | *Pasojat:* | *Kriteret:* | *I përcaktuar:* |
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | |
| 4 | Kritike | 501-1500 | X |
| 5 | **Katastrofike** | **> 500** | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**
përcaktohen në raport me bruto-produktin e brendshëm të komunës së Kaçanikut.
-Demonstrimi i pasojave për stabilitetin social - dëm total material ndaj kritikës infrastrukturës
-Vlera e dëmeve materiale në infrastrukturë janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: **581,026.00 €**.
Pasojat në ekonomi të shkaktuara nga vërshimet, përllogariten në raport me bruto-produktin e GDP-së së komunës së Kaçanikut.

*Pasqyrimi i pasojave në ekonomi*

| Pasojat ekonomike | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | **X** |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

**Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social – dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike**
- Vlera e dëmeve materiale në infrastrukturën kritike janë përllogaritur në bazë të raportit të komisioneve lokale për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë shumën: **211,284.00 €;** ( duke mos futur në përllogaritje humbjet e KEDS dhe Hekurudhës);

*Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike*

| *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social- infrastruktura kritike* | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 1% GDP | |
| 2 | Të vogla | 1 - 3% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5 - 10% GDP | **X** |
| 4 | Kritike | 5 - 10% GDP | |
| 5 | **Katastrofike** | **>10% GDP** | |

*Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social - dëmi material i përgjithshëm i objekteve me rëndësi të veqantë:*

*Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social - dëmi material i përgjithshëm në objekte me rëndësi të veqantë:*

| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
|---|---|---|---|
| 1 | Të papërfillshme | < 0.5 % GDP | |
| 2 | Të vogla | 0.5 -1 % GDP | |
| 3 | Mesatare | 1 – 3 % GDP | |
| 4 | Kritike | 3 – 5 % GDP | |
| 5 | Katastrofike | > 5 % GDP | X |

### 1.1.1. Matricat:

Matrica e gjasës:

Matrica 1: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*



Matrica 2: *Rreziku për pasojat në ekonomi:*




Matrica 3a: *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:*



Matrica 4: ***Pasqyron rrezikun e  përgjithshëm***




## 6.5. ZJARRET

Sipas rregulloren nr. 25/2020 për Metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë, trajtimi i zjarreve bëhet në dy kategori edhe ate: si fatkeqësi apo fenomene natyrore dhe si fatkeqësi të shkaktuara nga faktori njeri ( zjarre të qëllimshme, të pa qëllimshme apo si fatkeqësi të shkaktuara nga proceset teknologjike). Zjarri është fatkeqësi e pa kontrolluar e cila mund të kërcënojë seriozisht jetën e njeriut, të shkaktojë dëme materiale dhe mjedisin.
Statistika e zjarreve te cilat kanë ndodhur gjatë periudhës 2010- 2024 tregojnë se ka pasur një numër te konsiderueshëm zjarresh kryesisht ne qendrën urbane, rurale gjithashtu gjate kësaj periudhe ka pasur zjarre në pyje, fusha, zjarre në ndërtesat e banimit familjar, në objekte afariste, zjarre në automjete të udhëtareve, në trafo për shpërndarjen e rrymës elektrike e tjera.
Janë prezentë zjarret në mjediset e pyllëzuara si pasoj e pakujdesisë së faktorit njeri.
Pyjet e Komunës së Kaçanikut janë të prirura për tu prekur nga zjarret gjatë gjithë vitit, e sidomos në pranverë dhe verë.

### 6.5.1. Karakteristikat e terrenit dhe vatrave potenciale të zjarreve,

Relievi i territorit të Kaçanikut është rezultat i bashkëveprimit të fuqive të brendshme dhe atyre te jashtme të cilat kanë modeluar atë. Pikënisja e bazamentit strukturor të territorit të Kaçanikut lidhet me ngritjet periferike të shprehura të maleve të Sharrit dhe Jezercit në jugperëndim dhe veriperëndim dhe atij të maleve të Karadakut në anën lindore si dhe uljes se vazhdueshme të strukturës grabenore të fushëgropës së Kosovës në anën veriore qe lidhet me tektoorogjeneza miocenike.
Në aspektin morfologjikë brenda territorit të Kaçanikut mund të diferencohen këto njësi morfologjike, malet e Sharrit dhe ato të Jezercit në pjesën jugperëndimor dhe veri perëndimore, malet e Karadakut në anën lindore si dhe pjesa më jugore e fushëgropës së Kosovës.

Shkaqet e zjarreve në komunën e Kaçanikut kanë karakter:
- Antropogjenik (pa kujdesia e njerëzve),
- Djegia e hamulloreve dhe kullotave (zjarrëvënia e qëllimshme),
- Zjarrëvënie e qëllimshme në pyjeve për interesa ( perfitime) personale apo vese pirromanie;
- Zjarre të shkaktuara nga natyra (shumë të rralla apo të pa mundshme)

Zonat më të atakuara nga zjarret janë fshatrat e zonave malore të cilat ekspozohen nga djegja e pyjeve, kurse zjarret fushore i ekzpozohen zonave të rrafshta, të cilat i ekspozohen rrezikut si shkak i djegjes së hamulloreve dhe barërishtave.

| **Historiku i zjarreve me intensitet të lartë në komunën e Kaçanikut** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Viti** | Periudha kohore | Lokacioni | Numri i zjarreve | Lloji i zjarrit | Sipërfaqet e djegura / ha | Vlera e dëmeve /€ |
| **2014** | Shkurt mars gusht | Kaçanik i Vjetër, Begracë | 79 | Maloro -fushor | 115 | 38,500.00 |
| **2015** | Korrik nëntor | Shtrazë | 85 | malor | 124 | 85,700.00 |
| **2016** | Prill Korrik | Kaçanik i Vjetër, Begracë | 57 | fushor | 110 | 14,350.00 |
| **2017** | Mars gusht | Lybeten | 99 | Maloro -fushor | 128 | 65,460.00 |
| **2018** | Prill nëntor | Begracë K. i Vjetër Llanisht | 64 | Malor- fushor | 120 | 49,600.00 |
| **2019** | Mars Korrik | Begracë Doganaj | 188 | fushor | 390 | 38,400.00 |
| **2020** | Mars Prill | Shtrazë Sllatinë | 95 | Malor- fushor | 117 | 41,200.00 |
| **2021** | Mars Maj Gusht Korrik | Kaçanik i Vjetër Doganaj Shtrazë Lybeten | 205 | Malor- fushor | 485 | 210,800.00 |
| **2022** | Mars Prill | Kovaçec Llanishtë Shtrazë Glloboshicë | 120 | Malor- fushor | 260 | 130,200.00 |
| **2023** | Shkurt Shtator Tetor | Kaçanik i Vjetër Doganaj Stagovë | 140 | Malor- fushor | 288 | 145,400.00 |
| **2024** | Shkurt Korrik Gusht | Doganaj Kovaçec Begracë Bob | 165 | Malor- fushor | 310 | 165,600.00 |

**Tabela 85:** Historiku i zjarreve malore-fushore gjatë viteve 2014 - 2024




**Grafiku:** Numri i zjarreve malore-fushore dhe sipërfaqja e djegur gjatë viteve 2014 - 2024

### 6.5.2. Kushtet klimatike,

Faktorët kryesore që i japin karakteristikat klimatike kësaj komune janë gjerësia gjeografike lartësia mbidetare, relievi etj. Kosova por edhe komuna e Kaçanikut ndodhen në gjerësi të mesme gjeografike prandaj kjo komunë ka klimë të mesme kontinentale. Në klimën e një vendi kanë ndikim faktorët mikroklimatikë që ndikojnë që secila hapësirë pak a shumë ti ketë disa specifika të vetat. Në komunën e Kaçanikut ndikim kryesor ka relievi përkatësisht malet me lartësinë e tyre. Në pjesët e larta dominon klima malore e cila është më e ashpër se klima e mesme kontinentale. Këto hapësira janë malet e Sharrit dhe malet e Karadakut.
Dallimet hipsometrike shprehin edhe dallime në klimën e vendbanimeve të komunës se Kaçanikut.
Në kushte normale duhet llogaritur që temperatura në mes pikës më të ultë dhe më të lartë dallimin në temperaturë mund ta kenë 11,7 0C ngase disniveli është 2102m. Ne territorin e komunës nuk ekziston stacion hidrometeorologjik prandaj të dhënat duhet të shfrytëzohen nga stacioni më i afërt Ferizajt.
Temperaturat në këtë komunë oscilojnë dhe kanë mjaft dallime mujore dhe sezonale. Për analizë do të shfrytëzohen temperaturat mesatare mujore 15 vjeçare, minimumet dhe maksimumet absolute. Temperatura mesatare është 10,2 °C, muaji me i ftoftë është janari me temperaturë mesatare -1,4 °C, muaji më i ngrohtë është korriku me 20,6 °C. Muaji më i ftoftë me temperaturë ekstreme është janari me -26 °C ndërsa muaji me temperaturë më të lartë është gushti me 37,3 °C.
Reshjet se bashku me temperaturën paraqesin tiparin primar klimatik të hapësirës. Sasia, forma e reshjeve dhe intensiteti i tyre janë karakteristika shumë të rëndësishme për hapësirën e një territori. Reshjet paraqesin vetëm një pjese të ciklit hidrologjik dhe ripërtritjes së ujit për një hapësire të dhëne sidomos për territorin e komunës se Kaçanikut. Sasia vjetore e reshjeve është 861,4 mm që është mbi mesataren e Kosovës për ketë periudhë (784mm). Sasia vjetore reshjeve është një fakt që tregon për disa modifikime dhe karakteristika të kësaj komune.

### 6.5.3. Zjarret fushore malore, urbane, zjarret si pasojëe proceseve tekniko-teknologjike

**Karakteristikat e zjarreve pyjore dhe fushore**

- Zjarret në pyje dhe kullota shpesh janë ngjarje të një shkalle më të vogël, në krahasim me ato që kanë ndikim dramatik mbi jetën dhe pronën. Përjashtim bëjnë zjarret që mbulojnë sipërfaqe të mëdha shkurresh ose pyje ku përfshihen edhe zona të banuara, pasi këto të fundit mund të shkaktojnë shkatërrim në një zonë të gjerë.
- Zonat më të atakuara nga zjarret fushore dhe malore janë fshatrat e zonave malore të cilat ekspozohen nga djegja e pyjeve, si dhe fshatrat e zonave të rrafshta, të cilat i ekspozohen rrezikut si shkak i djegjes së hamulloreve dhe barërishtave.
- Zjarret e shkaktuara në sipërfaqe të mëdha në pyjeve ose shkurre ku përfshihen edhe zona të banuara (vendbanime), mund të shkaktojnë cenueshmëri /rrezikshmëri të lartë për njerëzit brenda zonës, pasurisë së tyre, për pyjet dhe mjedisin brenda zonës së caktuar
- Shkaqet kryesore të zjarreve vijnë nga njerëzit, duke përfshi neglizhencën, aktivitetet bujqësore të pa-kontrolluara, si p.sh.: djegien e kullotave, stërnishtave, aksidentet dhe zjarrvëniet e qëllimshme etj.

### 6.5.4. Intenziteti, shpeshtësia e paraqitjes, kohë zgjatja,

Në Komunën e Kaçanikut për çdo vit ndodhin zjarre pyjore, viteve të fundit kemi pasur më shumë zjarre në zona të ndryshme, për çdo vit kemi kërcënime nga zjarret pyjore. koha e paraqitjes së zjarreve pyjore është sezona **vjeshtë**; muaji tetor–nëntor; **pranverë;** mars-prill **dhe verë**; korrik–gusht.

Zjarret pyjore kryesisht janë evidente në malet e Sharrit në jugperëndim dhe malet e Karadakut në anën lindore të territorit të Komunës së Kaçanikut.

Kohëzgjatja e mundshme e zjarreve gjatë sezonës së vjeshtës është 12 orë deri në 3ditë, ndërsa gjatë sezonës së verës është 3 deri 6 ditë.

| **Fletë pune e profilit të rrezikut për zjarre Pyjore dhe fushore (2019-2024)** | |
|---|---|
| **Madhësia e mundshme** ( Përqindja e komunitetit që mund të goditet): ( përcakto nivelin )<br>**Katastrofike**: ☐ më shumë se 50%<br>**Kritike**: ☐ 25 deri 50%<br>**E kufizuar**: ☒ 10 deri 25%<br>**E papërfillshme**: ☐ më pak se 10% | |
| **Frekuenca e ndodhjes:**<br>▪ Shumë e mundshme: mundësia afër 100% në vitin e ardhshëm;<br>▪ **X E mundshme**: mundësia midis 10 dhe 100% në vitin e ardhshëm; ose së paku një rast në 10 vitet e ardhshme;<br>▪ Ka gjasa: mundësia midis 1 dhe 10% në vitin e ardhshëm, ose së paku një rast në 100 vitet e ardhshme;<br>▪ I pa mundshëm: Mundësia më e vogël se 1% në 100 vitet e ardhshme. | **Modeli Sezonal:**<br>☐ Pranverë;<br>☒ Verë;<br>☐ Vjeshtë ;<br>☐ Dimër; |
| ▪ **Zonat e goditura**: Mali i Sharrit dhe mali i Karadakut | |

| |
|---|
| ▪ Kohëzgjatja: 6 ditë |
| ▪ **Shpejtësia e mundshme e mësymjes** (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit): |
| - Paralajmërim minimal (apo fare);   - Paralajmrim 12 deri 24 orë;<br>X Paralajmërim 6 deri 12 orë;   - Paralajmërim më shumë se 24 orë; |
| ▪ **Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:**<br>**- Instituti i hidrometeorologjisë;**<br>**- QOER-112/ Gjilan, etj;** |
| ▪ **A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë?**<br>**X ☐ Po**<br>▪ ☐ **Jo;** |




**Grafikoni :** Intervenimet e NJPZSH-së gjatë viteve 2012- 2024 në komunën e Kaçanikut

### 6.5.5. Sipërfaqet e përfshira nga zjarri

Zjarre pyjore dhe fushore të përmasave të mëdha/alarmante në Komunën e Kaçanikut ka pasur gjatë verës së vitit 2007, 2011 dhe 2012, por në përmasa shqetësuese ka pasur edhe në 10 vitet e fundit (2019, 2021, 2024), të cilat kanë përfshirë lokacionet pyjore dhe fushore:

Rastet e zjarreve të mëdha gjatë kësaj periudhe
**a.** Zjarr në masivin pyjor në malet e Sharrit me kohë zgjatje 12 04.2007 - 14.04.2007 në sipërfaqe prej 30 hektar dru ahu.
**b.** Zjarr në malet e Karadakut 23.08.2011 – 26.08.2011, në sipërfaqe prej 30 hektarësh dru bung dhe ahu.
**c.** Zjarr në masivin pyjor të malit Sharr 04.09.2012- 05.09.2012, në sipërfaqe prej 60 hektarësh, dru ahu.

| Viti: | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri i interven. të ERE | 79 | 85 | 57 | 99 | 64 | 188 | 95 | 205 | 120 | 140 | 165 |

**Tabela 86:** Të dhëna për reagimin e ERE në zjarret fushore-malore, vitet: 2014-2024 në komunën e Kaçanikut




**Grafiku:** Numri i intervenimeve në zjarret fushore-malore gjatë viteteve, 2014-2024 në komunën e Kaçanikut

### 6.5.6. Treguesit statistikor të pasojave në periudha kohore të zjarreve

Statistika e zjarreve te cilat kanë ndodhur gjatë periudhës 2010- 2024 tregojnë se ka pasur një numër te konsiderueshëm zjarresh kryesisht ne qendrën urbane dhe rurale.
Numri i përgjithshëm i zjarreve gjatë periudhës 2010 – 2024 është 2.817 nga këto raste ka pasë : zjarre në objektet e banimit familjare, zjarre në objektet publike shkolla, zjarre në objektet e biznesit privat - lokale afariste, zjarre në trafostacine për shpërndarjen e rrymës elektrike dhe në ormanët e rrymës elektrike, zjarre në automjete të udhëtarëve, zjarre në deponitë e mbeturinave, zjarre në pyje, fusha, ngastra bujqësore dhe ushqim i thatë i kafshëve.
Sipas historikut më shumë zjarre janë evidentuar në masivin pyjor të malit e Sharrit dhe në malet e Karadakut.
Pasojat nga zjarret:
- Viktima nga zjarret është shënuar = 1 rast
- Të lënduar nga zjarret janë shënuar = 11 raste




**Grafikoni :** zjarret gjatë viteve 2012-2024

### 6.5.7. Mbrojtja nga zjarri në sektorin e ndërtimit

- Analiza profesionale dhe vlerësimi profesional i ekpertëve përkatës të fushës për mbrojtje dhe shpëtim nga zjarri është pjesë përbërëse e Planeve Komunale Zhvillimore(PZhK) si dhe planeve Urbanistike. Në këto plane është e paraparë zbatimi i dispozitave ligjore si: Ligji i Ndërtimit, Ligji për Mbrojtje nga Zjarri, akteve nënligjore përkatëse, normave teknike, si dhe normave( kodeve) ndërkombëtare të pranuara.
- Në kuadër të projekteve të ndërtimit (objekteve specifike ) dhe atyre që zhvillojnë(deponojnë) aktivitet me materie të rrezikshme apo paraqesin rrezikshmëri të lartë, pjesë e projektit duhet të jetë edhe elaborati për mbrojtje nga zjarri.
- Pjesa urbane e qytetit tonë, kohëve të fundit ka një zgjërim dhe ndërtim të hovshëm, sidomos me objekte shumë-katëshe për banim, me objekte privato-publike dhe parqe industriale , ku një pjesë dërmuese e këtyre ndërtimeve nuk i përmbushin knaqshëm kërkesat dhe nevojat për mbrojtje nga zjarri, siç janë:
- Mungesa e qasjes së NJPZSh-ve me automjete të zjarrfikjes në objekte banimi;
- Mungesa e sistemit të lajmërimit dhe alarmit;
- Mungesa e rrugëve( hapsirave ) për grubullim dhe evakuim;
- Atesti i qëndrueshmërisë së konstruksionit të objekteve ndaj zjarrit;
- Mundësia e zgjerimit të zjarrit në objektet fqinjë dhe në ndërtesë,
- Mungesa e daljeve emergjente,
- Mungesa e hidranteve në objektet e lartëcekura ( hidrante jo-funksionale); etj.

**Masat parandaluese:**

Masat e propozuara nga Grupi Punues për hartimin e dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë për zjarret :

- Komunikimi me publikun, vetëdijësimi publik;
- Lëvrimi i sipërfaqeve tokësore pas korrje shirjeve;
- Hapja e rrugëve malore për intervenim;
- Zbatimi i masave ndëshkimore për zjarrëvënsit;
- Masat parandaluese për zjarret industriale
- Ngritjen e Njësisë Profesionale të Zjarrfikësve Industrial;
- Paisja me hidrante në të gjitha hapësirat e nevojshme;
- Lajmëruesit automatik të zjarrit/lajmërimi dhe alarmimi automatik;
- Atestimi i këtyre sistemeve;
- Sistemet pneumatike ;
- Jetësimi i një sistemi vrojtues dhe sinjalizues.

**Masat parandaluese të zjarreve në fusha (sezonale)**

Shtabi komunal në sezonën e korrje – shirjeve, sipas Ligjit të Mbrojtjes nga Zjarri, janë të obliguar që së paku 20 ditë para fillimit të korrje - shirjeve të hartoj planin operativ të mbrojtjes nga zjarri, në të cilën duhet të parashohin dhe të marrin këto masa:

- Organizimi i kujdestarisë: shërbimin e vëzhgimit, lidhjes dhe informimit në vijimësi të përhershëm gjatë korrje –shirjes;
- Autokombajnat të cilat marrin pjesë në korrje- shirje duhet të jenë teknikisht në rregull dhe të siguruar kundër shkaktimit të zjarrit me anën e hedhjes së xixave , nxehtësisë së madhe dhe mënyrave tjera.
- Autokombajnat duhet të jenë të pajisura me aparate për fikjen e zjarrit etj.

**Masat e parandalimit të zjarreve në pyje nga autoriteti pyjor**

Përgjegjësia për mbrojtjen e pyjeve u takon autoriteteve pyjore. Masat për menaxhimin e zjarreve nga autoriteti pyjor janë:

- Vërja në punë e një sistemi vrojtimi e sinjalizimi,
- Vigjilenca në raste zjarri gjatë periudhës së shtimit të rrezikut të zjarreve,
- Ndërtimi i pritave kundër zjarreve ,
- Pajisja e NjPZSH-së me mjete materialo-teknike për shuarjen e zjarreve në terrenet malore.
- Formimi i njësive zjarrfikëse të specializuara për shuarjen e zjarreve në terrenet malore.
- Vetëdijesimi i faktorit njeri për ruajtjen e pyjeve nga zjarret.
- Hapja e rrugëve të kalueshme nëpër pyje, që njësia e zjarrfikësve të afrohet sa më afër vatrave të zjarreve.
- Asnjë person pa leje paraprake s'mund të ndezë zjarr të hapur në pyje ose në tokat pyjore.

Sot për sot mungon një program i organizuar mirë për parandalimin e zjarreve në pyje

**Rekomandimet:**

-Hartimin dhe aprovimin e planeve reaguese emergjente lokale (PREL);
-Krijimin e procedurave standarde operative për reagim emergjent;
-Vendosjen e standardeve, udhëzimeve dhe protokolleve të nevojshme për koordinim dhe reagim emergjent të Shërbimeve reaguese emergjente dhe të akterëve tjerë të sigurisë;
-Identifikimi i nevojave dhe përcaktimi i prioriteteve për menaxhimin e zjarreve ;
-Ngritja (rritja) e kapaciteteve humane për reagim emergjent, përgatitja profesionale dhe certifikimi;
-Ngritja e kapaciteteve ( resurseve ) teknike dhe standardizimi i tyre;
-Të ngritet infrastruktura rrugore ( me qëllim të reagimit më të lehtë me mjete motorrike) në pyje dhe të të sigurohen burimet ujore, sa më afër vatrave potenciale të zjarreve për furnizim;
-Të bëhet sanimi dhe gjenerimi i sipërfaqeve pyjore, pas zjarreve të shkaktuara;
-Të krijohet baza e të dhënave elektronike, për pasojat nga zjarret(sipërfaqet e djegura, masa drusore, bimët aromatike, bimët mjekuese dhe dëmet ekologjike) në vlerë valutore Euro;
-Arritja e memorandumeve të mirëkuptimit me qëllim të ofrimit të ndihmës reciproke dhe bashkëpunimit me komunat fqinje, sektorin privat dhe OJQ humanitare, në rast se paraqitet nevoja;

## Hartëzimi i rreziqeve nga zjarret

### Skenari 1




**Harta 27:** Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarret pyjore në malin Sharr dhe në malin e Karadakut

**Skenari 1 -** Zjarret pyjore

| **Emri i skenarit:** | Zjarret pyjore |
|---|---|
| **Frekuenca e ndodhjes**: | |
| X☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>☐ E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>☐Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| ☐ E papërfillshme (më pak se 10%) X☐ E kufizuar( 10 deri 25%)<br>☐ Kritike: 25 deri 50% . ☐ Katastrofike: Më shumë se 50% | |
| Lloji i skenarit: | |
| X- Skenari 1; ☐ Skenari 2; ☐ Skenari 3; | |
| Ndikimi: | |
| ☐ I papërfillshëm; **X** ☐ I vogël ; ☐ I mesëm ; ☐ Katastrofike; | |
| Data e vlerësimit: | |
| **26/08./2023** | |

<table>
<tr><th colspan="2">KONTEKSTI</th></tr>
<tr><th>Parametrat:</th><th>Përmbajtja:</th></tr>
<tr><td>Vendi i ngjarjes (lokacioni)</td><td>Vendet më të rrezikuara nga zjarret pyjore dhe fushore janë fshatrat; Begracë, Kaçanik i Vjetër, Runjevë, Llanishtë, Korbliq, Strazhë, Sllatinë dhe Glloboçicë.<br>

<br>
Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarret pyjore në malin Sharr dhe në malin e Karadakut.</td></tr>
<tr><td>Kushtet meteorologjike</td><td>Muajt korrik dhe gusht janë karakterizuar me temperatura të larta sidomos me datën 21gusht temperaturat kanë arritur deri në 37°C.<br>Temperaturat e larta dhe erërat e forta gjatë muajve korrik dhe gusht në komunën e Kaçanikut kanë bërë që zjarret të përhapen në sipërfaqe të mëdha. Sipas analizave meteorologjike, temperaturat e deritanishme maksimale të evidentuar janë të krahasueshme me ato të vitit të kaluar.</td></tr>
<tr><td>Periudha e vitit:</td><td>20- 22 Gusht 2023</td></tr>
<tr><td>Lloji i ditës:</td><td>Ditë pune dhe vikendi</td></tr>
<tr><td>Analiza meteorologjike për kohën</td><td>-Mundësia për të ndodhur zjarre pyjore në këtë vit kalendarik është e madhe, në komunën e Kaçanikut për çdo vit kanë ndodhur zjarre pyjore, nëse e marrim 10 vjeçarin e fundit kemi pasur më shumë zjarre në zona të ndryshme, që d.m.th. se për çdo të dytin vit kemi pasur kërcënime nga zjarret pyjore. Zakonisht, koha e paraqitjes së zjarreve pyjore është periudha kohore e temperaturave të larta gjatë muajve korrik – gusht.<br>Vatrat potenciale të zjarrit pyjor janë kryesisht në malet e Sharrit në jugperëndim dhe malet e Karadakut në anën lindore të territorit të Komunës së Kaçanikut.<br>-Koha e paraqitjes së kësaj fatkeqësie ishte 21 gusht 2023.<br>Gjatë sezonës së verës, në periudhën qershor-shtator muaji me temperaturë më të lartë është muaji gusht me 37 °C.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | Si pasojë e zjarreve pyjore janë djegur dhjetra hektarë sipërfaqe, ku dëmet në pyje kanë arritur vlera të konsiderueshme në masë drunore.<br>Sipas IHMK me datën 22 gusht pritet rënie e temperaturave. |
| **Popullata** | Numri i familjeve të prekura nga zjarret pyjore në fshatin Strazhë është 6, kurse numri i banorëve ishte 36, prej tyre:<br>- Fëmijë -9;<br>- Të moshuar - 5;<br>- Invalid- 2;<br>- Gra- 9;<br>- Meshkuj- 11; |
| **Infrastruktura kritike ekzistuese** | Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga zjarret pyjore ka pasur dëme dhe pasoja në infrastrukturë, në këtë zonë.<br>- Humbja e materialit drunor dhe kullosa 26 ha;<br>- Humbja e prodhimeve tjera pyjore;<br>- Dëmet dhe shqetësimi i faunës së egër;<br>- Dëmtimi i peisazhit natyrorë;<br>- Përkeqësimi i klimës lokale. |
| **Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut)** | -Në pajtueshmëri të plotë me paralajmërimet e hershme nga IHMK të për temperaturat e larta , QOE-112 ka lëshuar informacion urgjent sipas procedurave standarde operative për organet kompetente shtetërore , në nivel qendror dhe lokal si akter për ndërmarrjen e masave për mbrojtje nga temperaturat e larta duke ngritur nivelin e gadishmërisë së Ekipeve të K-Sh<br>-Kryetari i komunës së Kaçanikut urgjentisht duhet të ndërmerr masat dhe aktivitetet e nevojshme për mbrojtje nga zjarri, sipas Planit të Reagimit Emergjent lokal, ndër të tjera, duke bërë edhe informimin publik, paralajmërimin e hershëm dhe alarmimin si dhe udhëzimet e nevojshme publike për evakuim.<br>-Masat parandaluese për mbrojtje nga zjarri nënkuptojnë të gjitha masat e nevojshme për zbutjen/zvogëlimin e rrezikut, duke filluar nga ato operacionale deri tek masat për sanimin e gjendjes.<br>-Mobilizimi i Ekipeve Reaguese Emergjente me të gjithë potencialin human dhe teknik duhet të jenë në gadishmëri të plotë për reagim në çdo kohë, duke u mbështetur me resurse reaguese lokale, siç janë Autoriteti Pyjor Komunal Kryqi i Kuq, Klubet e Alpinistëve, OJQ për mbrojtjen e ambientit, etj. |
| **INCIDENTI-NGJARJA** | |
| **Shkaku dhe shkaktari** | Nga temperaturat e larta të shkaktuara gjatë muajve korrik dhe gusht 2023 që përfshinë të teritorin e Komunës së Kaçanikut, në këtë rast të gjitha institucionet lokale, u alarmuan dhe vepruan në bazë të përgjegjësive ligjore për mbrojtje nga FNFT. Me datë: 18 gusht 2022, Instituti Hidrometeorlogjik i Kosoves (IHMK) lëshoi njoftim/komunikatë përmes web faqes http://ihmk-rks.net/?page=1,40,44 dhe facebook të sajë: https://www.facebook.com/ihmk.rks/ për informim të institucionove dhe publikut në lidhje me mundësinë e zjarreve në zona të caktuara të Kosovës. Në vazhdim është dhënë paralajmërimi për zjarre pyjore i parashikuar nga IHMK: |

Shkaqet dhe shkaktarët kryesorë të shpërthimeve të zjarreve pyjore janë: Temperaturat e larta të cilat po vazhdojnë edhe në ditët në vijim, duke përfshirë tërë territorin e vendit, me ngritje më të shprehur duke shkaktuar zjarre pyjore.










*Burimi Instituti hidrometeorologjik i Kosovës*

Të dhënat nga IHMK-ja dhe Accuweather tregojnë se vala e nxehtësisë që ka goditur Evropën, ka bërë që korriku i këtij viti të jetë më i nxehti në gjashtë vjetët e fundit.
Gjendja më e rënduar mund të paraqitet në disa fshatra të Komunës, si Llanishtë, Begracë, Kaçanik i Vjetër, Strazhë, Glloboçicë, dhe Nikoc.

| | |
|---|---|
| | Rëndimit të situatës i ka kontribuar edhe periudha e gjatë e thatësirave dhe erërat e forta.<br>-Sipas parashikimeve të IHMK-së, pritet që ditëve në vazhdim të ketë rënie të temperaturave të cilat do të ndikojnë në zvogëlimin e vatrave të e zjarrit. |
| **Ngjarja kryesore** | Thelbi, skenari, i nxitur nga një sërë shkaqesh deri te pasojat.<br>Roja e pyllit i cili ishte në detyrë afër fshatit Strazhë ka lajmëruar Njësinë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit për një zjarr, i cili është paraqitur në bjeshkën e fshatit Strazhë. Me të marrë njoftimin NJPZSH-ja në mënyrë emergjente i përgjigjen njoftimit për intervenim. Pas vlerësimit të situatës, është konstatuar se zjarri i ndihmuar edhe nga erërat e forta është duke depërtuar me shpejtësi në drejtim të shtëpive të banimit dhe në drejtim të antenave të sistemit të telekomunikimit.<br>-Janë ndërmarrë masa të krijohet një bllokadë natyrore – hapje e shtigjeve(kanaleve) për lokalizimin e zjarrit. Gjatë këtijë intervenimi arrihet që zjarri pjesërisht të lokalizohet, ndërsa nën ndikimin e erërave të forta shkon në drejtim të shtëpive të banimit me ç'rast digjen pjesërisht 3 shtëpi banimi dhe nji objekt ndihmës, në afërsi të malit, ndërsa me ndihmën e zjarrfikësve dhe vullnetarëve, arrijnë të evakuohen banorët e rrezikuar të këtij fshati. Gjatë evakuimit 2 persona janë dërguar në QKMF për trajtim shëndetësorë, kurse për një person me aftësi të kufizuar është kërkuar transport i veçantë. Pos djegjes së pjesërishme të 3 shtëpive, 2 të tjera janë dëmtuar pjesërisht dhe nji objekti ndihmës (objekt për ushqimin e kafshëve).<br>Për familjet e dëmtuara nga zjarri duhet tiu sigurohet strehim afatgjatë për 18 banorë, ndërsa për shtëpitë e dëmtuara duhet të sigurohen mjetet financiare për riparimin e tyre.<br>Për shkak të dëmtimit të 3 shtyllave elektrike, fshati ka mbetur pa rrymë, duke vështirësuar funksionimin normal të komunitetit.<br>-Për sanimin e gjendjes gjatë dhe pas zjarrit janë angazhuar edhe mekanizma institucional dhe publik, siq janë: NjPZSh ( me mekanizëm dhe pompa të ujit për fikjen e zjarrit, Drejtoria komunale e Shërbimeve Publike, vullnetarë autoriteti pyjor komunal etj. |
| **Pasojat primare dhe efektet anësore** | - Humbje e pasurisë në objekte banimi pjesërisht të dëmtuara nga zjarri 5 shtëpi;<br>- Dëmtim i përkohshëm apo eroziv i sipërfaqeve 26ha;<br>- Kultura bujqësore të dëmtuara (misër) 2ha;<br>- Dëmtimi i 3 shtyllave elektrike<br>- Dëmtimi i kullosave të kafshëve;<br>- Ndryshime në vegjetacion;<br>- Degradimi i tokës nga zjarri |
| **Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti** | - Pasojat e zjarrit në ambient dhe tokë pjellore në fshatin Strazhë;<br>- Paraqitja e rrëshqitjes së dheut/erozion;<br>- Mungesë e ujit të pijes si pasojë e dëmtimit të rrjetit apo ujit të turbullt në impiante te burimi i Strazhës;<br>- Kërcënimi për mundësinë e çfaqjes së ndonjë epidemije( si pasojë e kafshëve të egra të ngordhura;, |

| NDIKIMI- INDIKATORËT TREGUES | |
|---|---|
| **Rastet me fatalitet** | -Nuk ka pasur raste me fatalitet; |
| **Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar;** | - Bazuar në të dhënat e komisionit komunal për vlerësimine dëmeve, nga pasojat e zjarrit të gushtit 2022 janë prekur rreth 36 banorë;<br>- Nga pasojat e zjarrit 2 persona janë lënduar<br>- Situata e krijuar pas zjarrit është shqetësuese dhe paraqet rrezik nga ndonjë sëmundje si pasoj e ndotjes së ujit të pijshëm në puse; |
| **Munges e nevojave elementare** | - Si pasojë e zjarrit kemi dëmtime të rrugëve;<br>- Punëtorët nuk mund të shkojnë në punë,fëmijët në shkolla e kopshte;<br>- Kujdesi i ofruar shëndetësorë jo i duhuri;<br>- Banorët janë furnizuar me nevoja themelore: ushqim, veshë-mbathjes, shtrojë e mbulojë, mjete higjienike, energjia, etj/të pa mjaftueshme;<br>- Mungesa e ujit të pijshëm, etj. |
| **Të evakuarit** | Gjatë veprimeve operacionale të K-Sh më shumë se 16 persona janë të evakuuar( 2me aftësi të kufizuar) |
| **Ndikimi i përgjithshëm ekonomik** | Dëmet në njerëz( shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj) , Të/ pa evidentuara;<br>- Dëmet e shkaktuara në: Ekonomi familjare ( rreth 6 familje), të përllogaritura: 46,200.00 €;<br>- Dëmet e shkaktuara në bujqësi( sipërfaqe të mbjellura me misër) , të përllogaritura në Euro: 6,500.00 €;<br>- Dëmtimi i pronave individuale ( 1 objekte ndihmëse) të përllogaritura në Euro: 15,700.00 €;<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë kritike, (shtylla elektrike) shuma të vogla(3 shtylla elektrike) por të pa përllogaritura(KEDS);<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë kritike (ujësjellës dhe kanalizim, KRU, ShA), të përllogaritura në Euro: 8,500.00 €;<br>- Humbja e tregut për prodhuesit(ekonomik dhe bujqësorë), të pa përllogaritura, etj;<br>- Vlera e përafërt e dëmeve të pëllogaritura **76,960.00€;** |
| **Ndikimi në natyrë dhe mjedisi** | - Nga erërat e forta shpejtësia e zjarrit mund të sjellë pasoja duke shtuar sipërfaqen e djegur dhe dëmtuar natyrën;;<br>- Humbja/dëmtimi i tokës bujqësore nga erozioni;.<br>- Dëmtimi i burimeve të ujit; etj. |
| **Ndërprerjet në jetën e përgjithshme** | - Ndërprerje e furnizimit me energji elektrike<br>- Ndërprerje e furnizimit me ujë të pijshëm,<br>- Kalim me vështirësi i akseve të caktuara rrugore |
| **Humbjet në trashëgimi kulturore** | Jo |
| **Implikime politike** | Jo |
| **Pasojat primare dhe efektet anësore** | Humbje e pasurisë në objekte banimi (pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga zjarri),<br>Dëmtimi i rrjetit elektrik lokal, i prekur nga zjarri,<br>Humbje e materialit drunor dhe kullosat. |

| | |
|---|---|
| | Humbje e prodhimeve tjera pyjore,<br>Dëmtimi dhe shqetësimi i faunës së egër,<br>Dëmtimi i peisazhit natyror,<br>Përkeqësimi i klimës lokale. |
| **Ndikimi i përgjithshëm** | Rrezik i mesëm |
| **Probabiliteti - Gjasat** | |
| **Probabiliteti** | - Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësorë dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të vogël të mundshëm, duke marrë për bazë të dhënat historike dhe pasojave, |
| **Paralajmërimi i hershëm** | - Fatkeqësia ishte pjesërisht e pritshme (bazuar në parashikimet meteorologjike) por pastaj gjërat u përkeqësuan dhe rëndoi në masë ngjarjen kryesore;<br>-Informimi publik për të temperaturat e larta të përcjellura me erëra të forta ishte me kohë, sipas njoftimit të parashikimeve meteorologjike, me paralajmërime për mundësi të shkaktimit të zjarreve dhe probabilitetit për cenueshmëri;<br>- Informimi i publikut bëhet në përputhje me planin komunal për reagim emergjent(PRE) përmes: mediave të shkruara dhe elektronike, njoftimet e shkruara, mesazhe SMS, rrjete sociale, web-faqe interneti, etj. |
| **Masat parand. gjatë periudhës së paralajmërimit të hershëm** | -Pas marrjes së Paralajmërimit nga IHMK për temperaturat e larta, të shoqëruara me erëra të forta, ngritet gatishmëria për të papriturat, aktivizohet Planifikimi Kontigjent për zjarret, si dhe ngritet gatishmëria e kapaciteteve humane dhe teknike të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim. |
| **Kohëzgjatja e pritshme engjarjes** | -Faza akute e ngjarjes zgjati 1 ditë<br>-Koha e parashikuar e nevojshme për sanim të gjendjes deri 6 muaj |
| **Koordinimi** | Instituti meteorologjik i Kosovës dërgon njoftimin mbi parashikimin e motit në QOE -112 të AME-së për temperaturat e larta komplekse dhe të pafavorshme për ditët në vijim, sipas PSO njoftohen organet kompetente dhe administrative shtetërore, organet vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe strukturat për M&Sh për menaxhimin e situatës së pritshme emergjente, bazuar në PRE;<br>Bazuar në informacionet nga tereni, është konstatuar se zjarri është lokalizuar dhe nuk paraqet rrezik për banorët e kësaj zone.<br>Duhet të bëhet aktivizimi i Komisionit lokal për mbledhjen e të dhënave mbi vlerësimin e dëmeve në terren të shkaktuara nga fatkeqësia – zjarret pyjore, të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar;<br>Komisioni Qendror, bashkon raportet e komisioneve lokale dhe bën verifikimin e vërtetësisë së dëmeve të vlerësuara nga komisionet lokale dhe këtë raport ia dorëzon Qeverisë së RK për shqyrtim dhe miratim;<br>-Raportin e miratuar nga qeveria ia dorëzon DKMSh-së në afat prej 15 ditëve; |
| **Informata plotësuese** | Zjarri ka ndikuar negativ në mjedis duke pasur parasysh moshën qindra vjeçare të këtijë mali. |

| Probabiliteti / frekuenca | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kategorizimi** | **Cilësia** | **Probabiliteti/gjasat** | **Frekuenca** | **Përcaktimi** |
| 1 | E papërfillshme/ E pa mundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | |
| 2 | E vogël/ E pa besueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në 20 deri 100 vjet | |
| 3 | Mesatare/ E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në 2 deri 20 vjet | |
| 4 | **E madhe / Gati e mundur** | **51-98 %** | **1 ngjarje në 1 deri 2 vjet** | **X** |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe / E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

## Vlerësimi i pasojës:

**Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut**

-Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, për fat të mirë nuk ka pasur viktima, por duke pasur parasysh numrin e banorëve në nevojë, rrezikun dhe pasojat nga zjarri (përllogariten) si të vogla.

-Përveç kërcënimit të drejtpërdrejtë zjarri, vlerësohet si një përkeqësim afat shkurtër i standardit jetësor në zonën e prekur.

***Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:***

| Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi:* | *Pasojat:* | *Kriteret:* | *I përcaktuar:* |
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | **X** |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | |
| 4 | Kritike | 501-1500 | |
| 5 | **Katastrofike** | **> 500** | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

- Dëmet materiale në ekonomi familjare dhe biznese janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: **46,200.00€.**;

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

| Pasojat ekonomike | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | **X** |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

**Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social – dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike**

- Vlera e dëmeve materiale në infrastrukturë janë përllogaritur në bazë të raportit të komisionit lokal për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë shumën: **8,500.00 €;**
( duke mos futur në përllogaritje humbjet e KEDS);

***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike***

| *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social- infrastruktura kritike* | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | ***Pasojat*** | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| **1** | Të papërfillshme | < 1% GDP | |
| **2** | Të vogla | 1 - 3% GDP | **X** |
| **3** | Mesatare | 5 - 10% GDP | |
| **4** | Kritike | 5 - 10% GDP | |
| **5** | Katastrofike | >10% GDP | |

**Matrica e gjasës:**

**Matrica 1.** Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut



**Matrica 2:** Rreziku për pasojat në ekonomi




**Matrica3 :** Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin socia-dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturë kritike;



**Skenari 2 - Zjarret pujore**

| **Emri i skenarit:** | **Zjarret pyjore** |
|---|---|
| **Frekuenca e ndodhjes:** | |
| ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>X ☐ E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>☐Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| ☐ E papërfillshme (më pak se 10%)<br>X☐ Kritike: 25 deri 50% . | ☐ E kufizuar( 10 deri 25%)<br>☐ Katastrofike: Më shumë se 50% |
| Lloji i skenarit: | |
| ☐Skenari 1; | X ☐ **Skenari 2**; ☐ Skenari 3; |
| Ndikimi: | |
| ☐ I papërfillshëm; ☐I vogël ; | X ☐ I mesëm ; ☐ Katastrofike; |
| Data e vlerësimit: | |
| **26/08./2023** | |

## Hartëzimi i rreziqeve nga zjarret pyjore




**Harta 28: Skenari 2 -** Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarret pyjore në masivin e malit Sharr (Burimi i të dhënave DSHPE – Komuna e Kaçanikut)

## Konteksti

<table>
<tr><th>Parametrat</th><th>Përmbajtja</th></tr>
<tr><td>Vendi i ngjarjes (Lokacioni)</td><td>Vendet më të rrezikuara nga zjarret pyjore janë fshatrat; Strazhë, Sllatinë, Glloboçicë dhe Parku Nacional i malit Sharr.




Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarret pyjore në masivin e malit Sharr (Burimi i të dhënave DSHPE – Komuna e Kaçanikut)</td></tr>
<tr><td>Kushtet meteorologjike</td><td>Për dy muaj rresht nuk ka pasur të reshura dhe temperaturat nga data 20 deri 22 gusht 2023 kanë shënuar rritje deri më 38°C. Sipas analizave meteorologjike temperaturat e deritanishme maksimale të evidentuara janë të krahasueshme me ato të para 10 viteve më parë.</td></tr>
<tr><td>Periudha e vitit</td><td>Korrik – Gusht 2023</td></tr>
<tr><td>Lloji i ditës</td><td>Ditë pune dhe vikendi</td></tr>
<tr><td>Analiza meteorologjike për kohën</td><td>Zjarret pyjore në këtë periudhë të vitit kalendarik paraqiten në numër më të madh në komunën e Kaçanikut, për çdo vit kanë ndodhur zjarre pyjore, nëse e marrim 10 vjeçarin e fundit kemi pasur më shumë zjarre në zona të ndryshme, që d.m.th. se për çdo të dytin vit kemi pasur kërcënime nga zjarret pyjore. Zakonisht, koha e paraqitjes së zjarreve pyjore është periudha kohore e temperaturave të larta gjatë muajve korrik – shtator.<br>Vatrat potenciale të zjarrit pyjor janë kryesisht në malet e Sharrit në jugperëndim të territorit të Komunës së Kaçanikut.<br>Gjatë sezonës së verës, në periudhën qershor - gusht- muaji me temperaturë më të lartë është muaji gushtë me 38 °C.<br>Si pasojë e temperaturave të larta dhe erërave të forta, zjarri ka përfshirë sipërfaqe të mëdha të malit Sharr.<br>Zjarre pyjore me përmasa më të mëdha janë paraqitur në zonën kadastrale të fshatit, Sllatinë, Glloboçicë dhe Strazhë, me ç'rast janë djegur dhjetëra hektarë sipërfaqe, ku dëmi në pyje kanë arritur vlera të konsiderueshme në masë drunore.<br>Koha e paraqitjes së kësaj fatkeqësie ishte 21 gusht 2023.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | -Me fillimin e muajit shtator temperaturat kanë shënuar rënje duke zvogëluar në masë të madhe rrezikun nga zjarret. |
| **Popullata** | Numri i familjeve të prekura nga zjarret pyjore në fshatin Strazhë dhe Sllatinë është 9, kurse numri i banorëve është 51, prej tyre:<br>- Fëmijë -14;<br>- Të moshuar - 7;<br>- Invalid- 3;<br>- Gra- 13;<br>- Meshkuj- 14; |
| **Infrastruktura kritike ekzistuese** | Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga zjarret pyjore ka pasur dëme dhe pasoja në infrastrukturë, në këtë zonë.<br>- Humbja e materialit drunor dhe kullosa 130ha;<br>- Humbja e prodhimeve tjera pyjore;<br>- Dëmet dhe shqetësimi i faunës së egër;<br>- Dëmtimi i peizazhit natyror;<br>- Përkeqësimi i klimës lokale. |
| **Gatishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut)** | Në pajtueshmëri të plotë me paralajmërimet e hershme nga IHMK të për temperaturat e larta , QOE-112 ka lëshuar informacion urgjent sipas procedurave standarde operative për organet kompetente shtetërore , në nivel qendror dhe lokal si akter për ndërmarrjen e masave për mbrojtje nga temperaturat e larta duke ngritur nivelin e gatishmërisë së Ekipeve të K-Sh - Kryetari i Komunës së Kaçanikut urgjentisht ka ndërmarrë masat dhe aktivitetet e nevojshme për mbrojtje nga zjarri sipas Planit të Reagimit Emergjent Lokal, dhe Planit për mbrojtje nga zjarri për Komunën e Kaçanikut, duke shpallur gjendjen e emergjente dhe aktivizuar Qendrën Operative Emergjente lokale (QOEL) ndër të tjera, duke bërë edhe informimin publik dhe udhëzimet e nevojshme për evakuim dhe strehim të familjeve të dëmtuara nga zjarri.<br><br>- Masat parandaluese për mbrojtje nga zjarret nënkuptojnë të gjitha masat e nevojshme për zbutjen/zvogëlimin e rrezikut, duke filluar nga ato operacionale deri tek masat për sanimin e gjendjes.<br><br>-Mobilizimi i Ekipeve Reaguese Emergjente me të gjithë potencialin human dhe teknik duhet të jenë në gadishmëri të plotë për reagim në çdo kohë, duke u mbështetur edhe me resurse reaguese lokale, siq janë: Kryqi i Kuq Komunal(KKK), SMShN, Klubet e Alpinistëve, Dhuruesit e gjakut,OJQ për mbrojtjen e ambientit, etj. |
| **INCIDENTI - NGJARJA** | |
| **Shkaku dhe shkaktari** | Nga temperaturat e larta që mbretëruan gjatë muajit korrik dhe gusht 2022, u shkaktuan zjarre në disa zona të komunës së Kaçanikut, në këtë rast të gjitha institucionet lokale, u alarmuan dhe vepruan në bazë të përgjegjësive ligjore për mbrojtje nga FNFT. |

| | |
|---|---|
| | Me datë: 18 gusht 2023, Instituti Hidrometeorlogjik i Kosoves (IHMK) lëshoi njoftim përmes web faqes http://ihmk-rks.net/?page=1,40,44 dhe facebook të sajë: https://www.facebook.com/ihmk.rks/ për informim të institucionove dhe publikut në lidhje me mundësinë e zjarreve në zona të caktuara të Kosovës. Në vazhdim është dhënë paralajmërimi për zjarre pyjore i parashikuar nga IHMK: Temperaturat e larta pritet të fillojnë gjatë orëve të pasdites së datës 20/08/2023, me intensitet mesatarë deri të lartë, të cilat do të përfshinë edhe komunën e Kaçanikut. Kjo situatë do të vazhdoj për disa ditë (deri më: 22/08/2023), ku si pasojë e temperaturave të larta dhe erërave të forta , në disa zona mund të paraqiten zjarre pyjore, të cilat potencialisht shkaktojnë zgjerim të sipërfaqeve të djegura dhe do të paraqesin mundësi të përhapjes së shpejtë dhe vështirësi për vendbanimet e përfshira nga kjo fatkeqësi.<br>Rëndimit të situatës i kanë kontribuar edhe erërat e forta që kanë shpejtuar përhapjen e zjarrit.<br>Gjendja më e rënduar paraqitet në disa fshatra malor si: Strazhë, Sllatinë, Glloboçicë dhe Parkun Nacional të Malit Sharr.<br>Gjendja më e atakuar paraqitet në fshatin Strazhë pasi ky fshat është zonë turistike me kompleksin e pishave, vilave dhe disa restoranteve.<br>Situata vazhdon të rëndohet duke u zgjeruar zonat e përhapjes së zjarrit në disa pjesë të malit Sharr.<br>Sipas parashikimeve të IHMK-së, pritet që ditëve në vazhdim të ketë rënie të temperaturave në tërë vendin të cilat do të ndikojnë në shuarjen e zjarreve.<br>- Shkaqet dhe shkaktarët kryesor të shpërthimeve të zjarreve pyjore janë:<br>- Temperaturat e larta gjatë muajve të stinës së verës nga të cilat vjen deri te tharja e barishteve e shkurreve të cilat e mundësojnë zhvillimin dhe përhapjen e shpejt të zjarrit;<br>- Thatësirat; si dhe pakujdesia nga faktori njeri. |
| **Ngjarja kryesore** | Më: 21.08.2023 në lokacionin e fshatit Strazhë, zjarri ka përfshirë, 9 shtëpi banimi, Kompleksin e Pishave, në zonën turistike, kompleksin e vilave, restorant “Sharri”, restorant “Bulica”, dhe shkollën e ulët fillore paralele e ndarë e shkollës “Dituria“ e cila në momentin e paraqitjes së zjarrit ka pasur 11 nxënës. Personeli i shkollës (mësimdhënësit personeli teknik) janë angazhuar në procesin e evakuimit të menjëhershëm të nxënësve në një lokacion më të sigurt, duke mos mundur të angazhohen në mbrojtje të objektit shkollor, gjithashtu edhe personeli i restoranteve dhe vilave turistike janë angazhuar në fikje të zjarrit, deri në arritjen e ekipit të zjarrfikjes dhe shpëtimit të cilët për shkak të distancës së largët dhe konfiguracionit të terrenit arrijnë në një interval kohor prej 22 min. në vendngjarje.<br>Për shkak të furisë së madhe të zjarrit dhe largësisë së vendbanimit, zjarri me shpejtësi përfshin objektin e restorant ”Sharri” dhe objektin shkollor duke djegur restorantin dhe shkollën e këtij fshati. Ekipi i zjarrfikjes pas 2 orë intervenimi arrijnë ta shuajnë zjarrin, dhe rekomandonë banorët e fshatit që ta monitorojnë vendin e ngjarjes që zjarri mos të rindezët. Dëmet materiale të shkaktuara nga djegia e objektit të restaurantit “Sharri” dhe objektit shkollor janë të konsiderueshme, të shoqëruara me lëndime të tre personave gjatë intervenimit. |

| | |
|---|---|
| | -Janë ndërmarrë masat për zvogëlimin e rreziqeve, vërja në punë e një sistemi vrojtimi e sinjalizimi, ndërtimi i pritave kundër zjarrit, hapja e rrugëve të kalueshme nëpër pyje që njësia e zjarrfikësve të afrohet sa më afër vatrave të zjarreve ;<br>-Në rast të shpërthimit të zjarreve, të informojë njësinë e zjarrfikjes me kohë për intervenim sa më të shpejtë për lokalizimin e zjarrit dhe mos përhapjes së tij;<br>-Të evidentohen burimet e ujërave në terren për furnizim të mundshëm të zjarrfikësve;<br>-Operacionet e KSh kanë zhvilluar operacione të Shpëtimit të 9 familjeve të dëmtuara nga zjarri, evakuimin e 6 familjeve të përfshira nga zjarri dhe janë vendosur në vend-strehime të përkohshme, në disa lokacione Ivajë dhe Gajre. Në mungesë të objektit shkollor, mësimi për 11 nxënës të kësaj shkolle, për disa ditë është ndërprerë deri sa të bëhet zgjidhje nga strukturat Komunale për sistemimin e përkohshëm të tyre, në shkollat e fshatrave të afërt deri në zgjidhjen përfundimtare të kësaj emergjence.<br>-Për sanimin e gjendjes gjatë dhe pas zjarrit janë angazhuar edhe mekanizma institucional dhe publik, siç janë: NjPZSh ( me mekanizëm dhe pompa të ujit për fikjen e zjarrit, Drejtoria komunale e Shërbimeve Publike, vullnetarë autoriteti pyjor komunal etj<br>Për shkak të pengesave në rrugën Strazhë, Doganaj- Kaçanik është shfrytëzuar rruga alternative, Strazhë, Ivajë –Gajre Kaçanik |
| **Pasojat primare dhe efektet anësore** | - Humbje e pasurisë në objekte banimi pjesërisht të dëmtuara nga zjarri 9 shtëpi;<br>- Vështirësi për qarkullim në trafik nga tymi i dendur;<br>- Dëmtimi i rrjetit elektrik lokal, i prekur nga zjarri janë djegur 3 shtylla elektrike;<br>- Dëmtimi i shkollës plotësisht e djegur **65,400.00€**<br>- Dëmtimi i kompleksit të pishave 3 ha;<br>- Përkeqësimi i klimës lokale.<br>- Dëmtimi i bizneseve **45,800.00€**<br>- Vlera e përgjithshme e përllogaritur e dëmit **111,200.00€** |
| **Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti** | Vështirësi për qarkullim në trafik nga tymi i dendur në rrugën Doganaj Strazhë;<br>Mungesë e ujit të pijes si pasojë e dëmtimit të rrjetit apo ujit të turbullt në impiantin e fshatit Strazhë;<br>Pasojat e zjarrit në ambient dhe tokë pjellore 14 ha<br>Paraqitja e rrëshqitjes së dheut/erozion në rrugën Doganaj - Strazhë; |
| **NDIKIMI- INDIKATORËT TREGUES** | |
| **Rastet me fatalitet** | Nuk ka pasur raste me fatalitet |
| **Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar** | Bazuar në të dhënat e komisionit për vlerësimin e dëmeve , nga pasojat e zjarrit të 21 gushtit 2023 janë prekur rreth 51 banorë;<br>Tre(3) persona të lënduar;<br>Situata e krijuar pas zjarrit është shqetësuese dhe paraqet rrezik i shpërthimit epidemiologjik, sëmundjet e lëkurës, si dhe ndotja e ujit; |

| | |
|---|---|
| **Mungesë e nevojave elementare** | - Si pasojë e zjarreve kemi dëmtime të rrugëve,<br>- Fëmijët nuk mund të shkojnë, në shkolla e kopshte;<br>- Kujdesi i ofruar shëndetësorë jo i duhuri;<br>- Furnizimet e nevojave themelore: ushqimit, veshë-mbathjes, shtrojë e mbulojë, mjeteve higjienike, energjia, etj/të pa mjaftueshme;<br>- Mungesa e ujit të pijshëm, etj. |
| **Të evakuuarit** | -Janë kryer 4 veprime operacionale të K-Sh gjatë kohës së vërshimeve;<br>-Më shumë se 30 njerëz u evakuuan gjatë zjarrit në të gjitha rastet; |
| **Ndikimi i përgjithshëm ekonomik** | - Dëmet në njerëz (shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj.);<br>- Tre të lënduar.<br>- Dëmet e shkaktuara në objektin shkollor **65,400.00€**<br>- Humbje e pasurisë në objekte banimi ( pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara **95,350.00€**<br>- Dëmet në objektin e biznesit: **45, 800. 00 €**<br>- Humbje e materialit drunor dhe kullosat **87, 600.00€**<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë kritike (rrjeti elektrik), shuma të pa përllogaritura(KEDS<br>Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura është: **294,150.00€** |
| **Ndikimi në natyrë dhe mjedisi** | - Dëmtimi i peizazhit natyror,( Kompleksi i pishave);<br>- Dëmtimi dhe shqetësimi i faunës së egër;<br>- Dëmtimi i vegjetacionit;<br>- Ndotje dhe humbje të kualitetit të ujit;<br>- Humbja, dëmtimi i tokës bujqësore;<br>- Përkeqësimi i klimës lokale; |
| **Ndërprerjet në jetën e përgjithshme** | - Ndërprerja e mësimit në objektin shkollor;<br>- Ndërprerje të akseve të caktuara rrugore apo kalim me vështirësi;<br>- Ndërprerja e furnizimit të banorëve me rrymë;<br>- Ndërprerja e punës në objektin e biznesit; |
| **Humbje në trashëgimi kulturore** | Dëmtimi i kompleksit të pishave në Zonën Turistike – Strazhë; |
| **Implikime politike** | JO |
| **Ndikimi i përgjithshëm** | Rrezik i Mesëm |
| **PROBABILITETI-GJASAT** | |
| **Probabiliteti** | Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësorë dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të mesëm të mundshëm, duke marrë për bazë të dhënat historike dhe pasojave, |
| **Paralajmërimi i hershëm** | - Fatkeqësia ishte pjesërisht e pritshme (bazuar në parashikimet meteorologjike) por pastaj gjërat u përkeqësuan dhe rëndoi në masë të madhe ngjarjen kryesore;<br>-Informimi publik për të reshurat ishte me kohë, sipas njoftimit të parashikimeve meteorologjike, me paralajmërime për mundësi të temperaturave të larta dhe probabilitetit për cenueshmëri;<br>- Informimi i publikut bëhet në përputhje me planin komunal për reagim emergjent(PRE) përmes: mediave të shkruara dhe elektronike, njoftimet e shkruara, mesazhe SMS, rrjete sociale, web-faqe interneti, etj. |

| | |
|---|---|
| **Masat parand. gjatë periudhës së paralajmërimit të hershëm** | -Pas marrjes së Paralajmërimit nga IHMK për parashikimin e motit (temperaturat e larta), ngritet gatishmëria e lartë për të papriturat dhe aktivizohet Planifikimi Kontigjent për mbrojtje nga zjarri si dhe ngritët gatishmëria e kapaciteteve humane dhe teknike të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim;<br>- Të sigurohen të dhënat për sipërfaqet më të rrezikuara nga shpërthimi i zjarrit,<br>-Të bëhet sigurimi i makinave për angazhimin në hapjen e rrugëve për kalimin e automjeteve të zjarrfikjes dhe formimin e brezave mbrojtës.<br>-Të evidentohen burimet e ujërave në teren për furnizim të mundshëm të zjarrfikësve;<br>-Në bazë të vlerësimit të gjendjes, të përforcohen patrullimet dhe vëzhgimet në terren, të përgjegjësisë; |
| **Kohëzgjatja e pritshme e ngjarjes** | Faza akute e ngjarjes zgjati 3 ditë.<br>-Koha e parashikuar e nevojshme për sanim të gjendjes deri 6 muaj |
| **Koordinimi** | -Instituti meteorologjik i Kosovës dërgon njoftimin mbi parashikimin e motit në QOE -112 të AME-së për temperaturat e larta komplekse dhe të pafavorshme për ditët në vijim, sipas PSO njoftohen organet kompetente vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe strukturat për M&Sh për menaxhimin e situatës së pritshme emergjente, bazuar në PRE;<br>-Bazuar në informacionet nga tereni për shpejtësinë e përhapjes së zjarrit është aktivizuar QOE komunale dhe Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili kryesohet nga Kryetari i Komunës apo i deleguari i tij.<br>-Koordinimi i aktiviteteve nga niveli lokal dhe bëhet përmes QOE -112;<br>-Duhet të bëhet aktivizimi i Komisionit lokal për mbledhjen e të dhënave mbi vlerësimin e dëmeve në terren të shkaktuara nga fatkeqësia – zjarret pyjore, të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar;<br>-Komisioni Qendror, bashkon raportet e komisioneve lokale dhe bën verifikimin e vërtetësisë së dëmeve të vlerësuara nga komisionet lokale dhe këtë raport ia dorëzon Qeverisë së RK për shqyrtim dhe miratim;<br>-Raportin e miratuar nga qeveria ia dorëzon DKMSh-së në afat prej 15 ditëve; |
| | |

| Probabiliteti / frekuenca | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kategorizimi** | **Cilësia** | **Probabiliteti/gjasat** | **Frekuenca** | **Përcaktimi** |
| 1 | E papërfillshme/<br>E pa mundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | |
| 2 | E vogël/<br>E pa besueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në 20 deri 100 vjet | |
| 3 | Mesatare/<br>E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në 2 deri 20 vjet | X |
| 4 | **E madhe /<br>Gati e mundur** | **51-98 %** | **1 ngjarje në 1 deri 2 vjet** | |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe /<br>E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

## Vlerësimi i pasojës:

**Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut**

-Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, për fat të mirë nuk ka pasur viktima, por duke pasur parasysh numrin e banorëve në nevojë, rrezikun dhe pasojat nga zjarri përllogariten si serioze.

-Përveç kërcënimit të drejtpërdrejtë zjarri, vlerësohet si një përkeqësim afatgjatë i standardit jetësor në zonën e prekur.

***Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:***

| Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi:* | *Pasojat:* | *Kriteret:* | *I përcaktuar:* |
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | X |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | |
| 4 | Kritike | 501-1500 | |
| 5 | **Katastrofike** | **> 500** | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

- Dëmet materiale në ekonomi familjare dhe biznese janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: **141,150.00€.**;

- Humbje në infrastrukturë shkollore( pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara **65,400.00€**

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

| Pasojat ekonomike | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | X |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

**Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social – dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike**

- Vlera e dëmeve materiale në infrastrukturë janë përllogaritur në bazë të raportit të komisionit lokal për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë shumën: **65,400.00 €;**

( duke mos futur në përllogaritje humbjet e KEDS);

***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike***

| *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social- infrastruktura kritike* | | | |
|---|---|---|---|
| ***Kategorizimi*** | ***Pasojat*** | ***Kriteret*** | ***Përcaktimi*** |
| 1 | Të papërfillshme | < 1% GDP | |
| 2 | Të vogla | 1 - 3% GDP | **X** |
| 3 | Mesatare | 5 - 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 5 - 10% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >10% GDP | |

Matricat:

## Matrica e gjasës:

## Matrica 1: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*



Matrica 2: *Rreziku për pasojat në ekonomi:*




Matrica 3a: *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:*



**Skenari 3 -** Zjarret pyjore

| **Emri i skenarit:** | **Zjarret pyjore** |
|---|---|
| **Frekuenca e ndodhjes**: | |
| ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>☐ E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>X Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| ☐ E papërfillshme (më pak se 10%)<br>**X** ☐ Kritike: 25 deri 50% . | ☐ E kufizuar( 10 deri 25%)<br>☐ Katastrofike: Më shumë se 50% |
| Lloji i skenarit: | |
| ☐Skenari 1; ☐ Skenari 2; | **X** ☐ Skenari 3; |
| **Ndikimi**: | |
| ☐ I papërfillshëm; ☐I vogël ; | **X** ☐ I mesëm ; ☐ Katastrofike; |
| Data e vlerësimit: | |
| **26/08./2023** | |

Hartëzimi i rrezikut nga zjarret pyjore - skenarit 3




**Harta 29 : Skenari -3** Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarret pyjore në masivin e malit Sharr (Burimi i të dhënave DSHPE – Sektori i emergjencave -Komuna e Kaçanikut)

| Parametrat | Përmbajtja |
|---|---|
| **Vendi i ngjarjes (Lokacioni)** | Vendet më të rrezikuara nga zjarret pyjore janë fshatrat; Strazhë, Sllatinë, Glloboçicë.<br><br><br>Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarret pyjore në masivin e malit Sharr (Burimi i të dhënave DSHPE – Sektori i emergjencave -Komuna e Kaçanikut) |
| **Kushtet meteorologjike** | Muaji korrik dhe gusht 2023 është karakterizuar me temperatura të larta deri më 38°C. Sipas analizave meteorologjike temperatura e deritanishme maksimale të evidentuara janë të krahasueshme me ato të para 10 viteve më parë |
| **Periudha e vitit** | **17-21 gusht2023** |
| Lloji i ditës | Ditë pune dhe vikendi |
| **Analiza meteorologjike për kohën** | -Mundësia për të ndodhur zjarre pyjore në këtë vit kalendarik është e madhe, në komunën e Kaçanikut për çdo vit kanë ndodhur zjarre pyjore, nëse e marrim 10 vjeçarin e fundit kemi pasur më shumë zjarre në zona të ndryshme, që d.m.th. se për çdo të dytin vit kemi pasur kërcënime nga zjarret pyjore. Zakonisht, koha e paraqitjes së zjarreve pyjore është periudha kohore e temperaturave të larta gjatë muajve korrik – gusht.<br>-Koha e paraqitjes së kësaj fatkeqësie 17 gushti 2023.<br>-Vatrat potenciale të zjarrit pyjor janë kryesisht në malet e Sharrit në jugperëndim dhe malet e Karadakut në anën lindore të territorit të Komunës së Kaçanikut.<br>Gjatë sezonës së verës, në periudhën korrik- shtator, muaji me temperaturë më të lartë është muaji gushtë me 39°C.<br>Zjarre pyjore me përmasa më të mëdha janë paraqitur në zonën kadastrale të fshatit, Sllatinë, Glloboçicë dhe Strazhë, me ç'rast janë djegur qindra hektarë |

| | |
|---|---|
| | sipërfaqe, ku dëmet në pyje kanë arritur vlera të konsiderueshme në masë drunore.<br>Shkaqet më të shpeshta të zjarreve pyjore përveq temperaturave të larta, ka ndikuar edhe faktori njeri me shkaktimin e zjarreve nga pakujdesia apo me qëllim.<br>Me fillimin e muajit shtator temperaturat kanë shënuar rënie duke zvogëluar në mas të madhe rrezikun nga zjarret. |
| **Popullata** | Numri i familjeve të prekura nga zjarret pyjore në fshatin Strazhë dhe Sllatinë është 17, kurse numri i banorëve është 97, prej tyre:<br>- Fëmijë - 43;<br>- Të moshuar - 18;<br>- Invalid- 4;<br>- Gra- 15;<br>- Meshkuj- 17; |
| **Infrastruktura kritike ekzistuese** | Sipas urdhëresës administrative dhe bazuar në kriteret e paracaktuara për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga zjarret pyjore ka pasur dëme dhe pasoja në infrastrukturë, në këtë zonë.<br>- Humbja e materialit drunor dhe kullosa 120 ha ;<br>- Humbja e prodhimeve tjera pyjore;<br>- Dëmet dhe shqetësimi i faunës së egër;<br>- Dëmtimi i peisazhit natyrorë;<br>- Përkeqësimi i klimës lokale. |
| **Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut)** | - Në pajtueshmëri të plotë me paralajmërimet e hershme, IHMK ka lëshuar informacion urgjent sipas procedurave standarde operative, për organet kompetente shtetërore, në nivel qendror dhe lokal, si akter për ndërmarrjen e masave për mbrojtje nga temperaturat e larta, duke ngritur nivelin e gatishmërisë së Ekipeve të K-Sh.<br>- Kryetari i Komunës së Kaçanikut urgjentisht ka ndërmarrë masat dhe aktivitetet e nevojshme për mbrojtje nga zjarret, sipas Planit të Reagimit Emergjent lokal dhe Planit Komunal për Mbrojtje nga Zjarri duke shpallur gjendje emergjente, duke aktivizuar Qendrën Operative emergjente Lokale (QOEL), ndër të tjera, duke bërë informimin publik, alarmimin si dhe udhëzimet e nevojshme publike për evakuim.<br>- Masat parandaluese për mbrojtje nga zjarret pyjore nënkuptojnë të gjitha masat e nevojshme për zvogëlimin e rrezikut, duke filluar nga ato operacionale deri tek masat për sanimin e gjendjes.<br><br>- Mobilizimi i Ekipeve Reaguese Emergjente me të gjithë potencialin human dhe teknik duhet të jenë në gatishmëri të plotë për reagim në çdo kohë, duke u mbështetur edhe me resurse reaguese lokale, siq janë:.Kryqi i Kuq Komunal (KKK), Klubet e Alpinistëve, Dhuruesit e gjakut, OJQ për mbrojtjen e ambientit, kurse ndihmë është kërkuar përmes QOE-regjionale në AME dhe në nivelin Qendrorë me ekipet e kërkim shpëtimit të AME-së të FSK-së dhe komunave fqinje. . |
| **INCIDENTI - NGJARJA** | |
| **Shkaku dhe shkaktari** | Pas temperaturave të larta që mbretëruan gjatë muajit korrik dhe gusht 2022, |

u shkaktuan zjarre në disa zona të komunës së Kaçanikut, në këtë rast të gjitha institucionet lokale, u alarmuan dhe vepruan në bazë të përgjegjësive ligjore për mbojtje nga FNFT.

Me datë: 18 gusht 2023, Instituti Hidrometeorlogjik i Kosoves (IHMK) lëshoi njoftim përmes web faqes http://ihmk-rks.net/?page=1,40,44 dhe facebook të sajë: https://www.facebook.com/ihmk.rks/ për informim të institucionove dhe publikut në lidhje me mundësinë e zjarreve në zona të caktuara të Kosovës. Në vazhdim është dhënë paralajmërimi për zjarre pyjore i parashikuar nga IHMK:







Temperaturat sipas viteve në Kosovë 2002 - 2022



| | |
|---|---|
| | Grafikoni i temperaturave të vitit 2020,2021,2022,2023 për muajin maj, qershor dhe korrik<br><br>*Burimi Instituti hidrometeorologjik i Kosovës*<br>Temperaturat e larta 38°C pritet të fillojnë gjatë orëve të pasdites së datës 20/08/2023, me intensitet mesatarë deri të lartë, të cilat do të përfshinë edhe komunën e Kaçanikut. Kjo situatë do të vazhdoj për disa ditë (deri më: 22/08/2023), ku si pasojë e temperaturave të larta dhe erërave të forta , në disa zona mund të paraqiten zjarre pyjore, të cilat potencialisht shkaktojnë zgjerim të sipërfaqeve të djegura dhe do të paraqesin mundësi të përhapjes së shpejtë dhe vështirësi për vendbanimet e përfshira nga kjo fatkeqësi.<br>Rëndimit të situatës i kanë kontribuar edhe erërat e forta që kanë shpejtuar përhapjen e zjarrit.<br>Gjendja më e rënduar paraqitet në disa fshatra malor si: Strazhë, Sllatinë, Glloboçicë dhe Parkun Nacional të Malit Sharr.<br>Gjendja më e atakuar paraqitet në fshatin Strazhë pasi ky fshat është zonë turistike me kompleksin e pishave, vilave dhe disa restoranteve.<br>Situata vazhdon të rëndohet duke u zgjeruar zonat e përhapjes së zjarrit në disa pjesë të malit Sharr.<br>Sipas parashikimeve të IHMK-së, pritet që ditëve në vazhdim të ketë rënie të temperaturave në tërë vendin të cilat do të ndikojnë në zvogëlimin e vatrave të zjarrit. |
| **Lokacioni** | **Strazhë, Sllatinë, Glloboçicë** |
| **Kushtet meteorologjike** | Në muajin korrik dhe gusht 2022 komuna e Kaçanikut është përfshirë nga temperaturat e larta 37°C deri 39°C gjatë dy muajve nuk ka pasur të reshura Sipas analizave meteorologjike, temperaturat e deritanishme maksimale të evidentuara janë të krahasueshme me ato të para 10 viteve më parë. |
| **Lloji i ditës** | Ditë pune |
| **Ora** | **15:30** |
| **Dendësia e Popullatës** | Largësia e zonës pyjore nga fshati është 30m, shtëpitë janë të grumbulluara gjë që paraqet rrezik të madhë për banorët e kësaj zone. |
| **Lloji i terrenit** | Konfiguracioni i terrenit është i vështirë për intervenime, drunjtë janë të gjatë dhe ka shumë mbetje drunore të thara që paraqesin rrezik për ndezje të zjarrit. |
| **Infrastruktura kritike** | Dëmtimi i parkut Nacional i malit Sharr 1640 ha,.<br>Sistemi i ujit i dëmtuar ( primare dhe sekondare), afërsisht 5 km. |
| **Informata tjera** | Zjarri ka qenë i intenzitetit të madh duke rrezikuar vendbanimin, ekipet emergjente, bagëtitë, florën dhe faunën, ndikim negativ në ekonomi dhe mjedis duke pasur parasysh moshën qindra vjeçare të këtij mali. |
| **Shkaku** | |
| **Shkaku i zjarrit** | Shkaktari kryesor i shpërthimit të zjarrit është pakujdesia e ndezjes së zjarrit nga faktori njeri. |
| **Ngjarja primare** | Ngjarja primare përfshinë gabimet njerëzore, thatësirat, temperaturat e larta, shpejtësia e përhapjes së zjarrit për shkak të llojit të drunjëve, vjetërsisë së tyre, mbetjeve drunore që gjenden me shumicë në këtë mal. |
| **Ngjarja sekundare** | Ngjarja sekondare përfshinë, dëmtimin e florës dhe faunës, bimëve aromatike dhe mjekuese, humbjet ekonomike, ndikim negativ mjedisor etj. |
| **NGJARJA** | |

| | |
|---|---|
| **Kohëzgjatja e mundshme** | Kohëzgjatja e mundëshme është 3 ditë |
| **Zona që ka gjasa të goditet më së shumti** | Zona e prekur e pyjeve të mesme në sipërfaqe 1640 (ha)<br>Për shkak të afërsisë së malit (30m) me fshatin Strazhë, Sllatinë dhe Glloboçicë, ekziston mundësia që zjarri të përhapet shpejt dhe të rrezikohen këto tre fshatra. |
| **Modeli sezonal** | Stina e verës, temperaturat e larta në muajin gusht dhe mungesa e të reshurave për një periudhë të gjatë, kanë ndikuar negativ dhe me pasoja të mëdha. |
| **Shpejtësia e mundshme e momentit fillestar** | Kushtet meteorologjike mund të ndikojnë negativisht dhe të rrisin rrezikun e zjarreve pyjore pa supozuar lokacionin aktual, andaj përgjigja fillon me njoftimin e parë për zjarrin nga njësitet reaguese. |
| **Sistemi ekzistues i paralajmërimit të hershëm** | Sistemi ekzistues i paralajmërimit të hershëm është instituti meteorologjik i Kosovës i cili dërgon njoftime mbi parashikimin e motit në QOE – 112 të AME-së për temperatura të larta komplekse dhe të pafavorshme;<br>Për ditët në vijim njoftohen organet kompetente shtetërore, organet vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe struktura për menaxhimin e situatës së pritshme emergjente. |
| **Ngjarja kryesore** | Më 21.08.2023 Roja e pyllit gjatë vëzhgimit të terenit ka lajmëruar Njesinë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, se në fshatin Strazhë, zjarri ka rrezikuar 17 shtëpi banimi, kompleksin e Pishave në zonën turistike, kompleksin e vilave, restorant "Sharri," restorant "Bulica," objektin e shkollës së ulët fillore "'Dituria" me 35 nxënës dhe antenën e sistemit të telekomunikimit. Duke parë se zjarri është duke depërtuar me shpejtësi, tentohet që të krijohet një bllokadë natyrore – hapja e shtigjeve për lokalizimin e zjarrit. Ndërkohë arrihet që zjarri pjesërisht të lokalizohet, mirëpo nën ndikimin e erë së madhe, zjarri shkon në drejtim të shtëpive dhe restorantit "Sharri" me ç'rast digjen 17 shtëpi, restorant "Sharri" dhe rest.Bulica. Personeli i shkollës (mësimdhënësit personeli teknik) janë angazhuar në procesin e evakuimit të menjëhershëm të nxënësve në një lokacion më të sigurt, duke mos mundur të angazhohen në mbrojtje të objektit shkollor, ndërsa personeli i restoranteve dhe vilave turistike janë angazhuar në evakuim dhe fikje të zjarrit deri në arritjen e ekipit të zjarrfikësve. Ekipi i zjarrfikjes pas 8 orë intervenimi arrijnë ta lokalizojnë zjarrin. Dëmet materiale të shkaktuara nga djegia e objektit të restorantit "Sharri" dhe objektit shkollor janë të jashtëzakonshme, të shoqëruara me lëndime të 6 personave, gjatë intervenimit, të cilët janë dërguar në qendrën mjekësore, pasi që ishin me lëndime të rënda shëndetësore.<br>-Janë ndërmarrë masat për zvogëlimin e rreziqeve, vërja në punë e një sistemi vrojtimi e sinjalizimi, ndërtimi i pritave kundër zjarrit, hapja e rrugëve të kalueshme nëpër pyje që njësia e zjarrfikësve të afrohet sa më afër vatrave të zjarreve.<br>-Operacionet e KSh të FSK- së kanë zhvilluar operacione të Shpëtimit të 17 familjeve të dëmtuara nga zjarri, evakuimin e 12 familjeve të përfshira nga zjarri duke i vendosur në vend-strehime të përkohshme, në disa lokacione, Ivajë dhe Gajre.<br>Për shkak të pengesave në rrugën Strazhë, Doganaj, Kaçanik është shfrytëzuar rruga alternative, Strazhë, Ivajë –Gajre Kaçanik |

| | |
|---|---|
| | Në mungesë të objektit shkollor, mësimi për nxënësit e kësaj shkolle është ndërprerë, deri sa të bëhet zgjidhje nga strukturat komunale për sistemimin e tyre në shkollat e fshatrave të afërt, deri në zgjidhjen përfundimtare të kësaj emergjence.<br>-Për sanimin e gjendjes gjatë dhe pas zjarrit janë angazhuar edhe mekanizma institucional, qeveritarë, publik, siç janë: FSK, AME, NjPZSh (me mekanizëm dhe pompa me presion të lartë), Drejtoria komunale e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Vullnetarë, Kryqi i kuq komunal,, Emergjencat shëndetësore ( biznesi privat me makineri), etj. |
| **Pasojat primare dhe efektet anësore** | Humbje e pasurisë në objekte banimi, biznesi dhe në objektin e shkollës (pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga zjarri):<br>- Humbje e pasurisë në objekte banimi (pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga zjarri 17 shtëpi<br>- Dëmtimi i rrjetit elektrik lokal, i prekur nga zjarri, të pa llogaritura(KEDS)<br>- Vështirësi për qarkullim në trafik nga tymi i dendur dhe rrëzimi i drunjve në rrugë.<br>- Humbje e materialit drunor dhe kullosat.1240 ha<br>- Dëmtimi i bizneseve **75, 800. 00 €**<br>- Dëmtimi i shkollës plotësisht e djegur "Dituria " në vlerë **85,300.00€**<br>- Dëmtimi i peisazhit natyror 80ha<br>- Përkeqësimi i klimës lokale.<br>- Vlera e përgjithshme e përllogaritur e dëmit **191,100.00€** |
| **Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti** | Bllokimi për qarkullim në trafik nga tymi i dendur dhe rrëzimi i drunjve në rrugën Doganaj Strazhë;<br>Mungesë e ujit të pijes si pasojë e dëmtimit të rrjetit apo ujit të turbullt në impiantin e fshatit Strazhë;<br>Mungesa e rrymës elektrike<br>Pasojat e zjarrit në ambient dhe tokë pjellore 80 ha<br>Paraqitja e rrëshqitjes së dheut/erozion në rrugën Doganaj - Strazhë; |
| **Ndikimi- Indikatorët tregues** | |
| **Rastet me fatalitet** | Nuk ka pasur raste me fatalitet |
| **Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar** | Bazuar në të dhënat e komisionit për vlerësimin e dëmeve , nga pasojat e zjarrit të 21 gushtit 2023 janë prekur rreth 97 banorë;<br>Gjashtë persona të lënduar<br>Situata e krijuar pas zjarrit është shqetësuese dhe paraqet rrezik i shpërthimit epidemiologjik, sëmundjet e lëkurës, vështirësi në frymëmarrje si dhe ndotja e ujit; |
| **Mungesë e nevojave elementare** | Si pasojë e zjarreve kemi dëmtime të rrugëve,<br>- Fëmijët nuk mund të shkojnë, në shkolla e kopshte;<br>- Kujdesi i ofruar shëndetësorë jo i duhuri;<br>- Furnizimet e nevojave themelore: ushqimit, veshë-mbathjes, shtrojë e mbulojë, mjeteve higjienike, energjia, etj/të pa mjaftueshme;<br>- Mungesa e ujit të pijshëm, etj. |
| **Të evokuarit** | Janë kryer 7 veprime operacionale të K-Sh gjatë kohës së zjarrit; |

| | |
|---|---|
| | 35 nxënës të evaukuar përkohësisht në vend të sigurt deri në kalim të rrezikut. |
| **Ndikimi i përgjithshëm ekonomik** | - Dëmet në njerëz(shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj.) Gjashtë persona të lënduar.<br>- Dëmet e shkaktuara në objektin shkollor **85,300.00€**<br>- Humbje e materialit drunor dhe kullosat. **185,300.00€**<br>- Dëmtimi i bizneseve **75, 800. 00 €**<br>- Dëmet e shkaktuara në objekte banimi (17 shtëpi të djegura), **415,700.00€**<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë kritike (energjia elektrike), shuma të mëdha por të pa përllogaritura(KEDS<br>- Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura është: **762,100.00€** |
| **Ndikimi në natyrë dhe mjedisi** | - Dëmtimi i peisazhit natyror,( Kompleksi i pishave);<br>- Dëmtimi dhe shqetësimi i faunës së egër;<br>- Dëmtimi i vegjetacionit;<br>- Ndotje dhe humbje të kualitetit të ujit;<br>- Humbja, dëmtimi i tokës bujqësore;<br>- Përkeqësimi i klimës lokale; |
| **Ndërprerjet në jetën e përgjithshme** | - Ndërprerja e mësimit në objektin shkollor;<br>- Ndërprerja e furnizimit me rrymë elektrike;<br>- Ndërprerja e punës në objektin e biznesit;<br>- Ndërprerja e akseve rrugore. |
| **Humbje në trashigimi kulturore** | - Dëmtii i Parkut Nacional i malit Sharr dhe Kompleksi i pishave në fshatin Strazhë . |
| **Implikime politike** | - Nuk ka |
| **Ndikimi i përgjithshëm** | Rrezik i lartë |
| | **PROBABILITETI-GJASAT** |
| **Probabiliteti** | Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësor, dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të lartë të mundshëm duke marrë për bazë . |
| **Paralajmërimi i hershëm** | - Fatkeqësia ishte pjesërisht e pritshme (bazuar në parashikimet meteorologjike) por pastaj gjërat u përkeqësuan dhe rëndoi në masë të madhe ngjarjen kryesore;<br>-Informimi publik për temperaturat e larta ishte me kohë, sipas njoftimit të parashikimeve meteorologjike, me paralajmërime për mundësi të zjarreve dhe probabilitetit për cenueshmëri;<br>- Informimi i publikut bëhet në përputhje me planin komunal për reagim emergjent(PRE) përmes: mediave të shkruara dhe elektronike, njoftimet e shkruara, mesazhe SMS, rrjete sociale, web-faqe interneti, etj. |
| **Masat parandaluese gjatë periudhës së paralajmërimit të hershëm** | Pas marrjes së Paralajmërimit nga HMK-ja për parashikimin e motit(temperaturat e larta të shoqëruar me erëra të forta), ngritët gatishmëria e lartë për të papriturat dhe aktivizohet Plani Kontingjent për mbrojtje nga zjarri si dhe ngritët gatishmëria e kapaciteteve humane dhe teknike e strukturave për mbrojtje dhe shpëtim. |
| **Kohëzgjatja e pritshme e ngjarjes** | Faza akute e ngjarjes zgjati 3 ditë.<br>-Koha e parashikuar e nevojshme për sanim të gjendjes deri 6 muaj |
| **Koordinimi** | Instituti meteorologjik i Kosovës dërgon njoftimin mbi parashikimin e motit në QOE -112 të AME-së për temperaturat e larta, komplekse dhe të |

| | |
|---|---|
| | pafavorshme për ditët në vijim, sipas PSO njoftohen organet kompetente dhe administrative shtetërore, organet vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe strukturat për M&Sh për menaxhimin e situatës së pritshme emergjente, bazuar në PRE;<br>-Bazuar në informacionet nga terreni për rritjen e vatrave të zjarrit, aktivizohet QOE komunale / Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili kryesohet nga Kryetari i Komunës apo i deleguari i tij.<br>-Duhet të bëhet aktivizimi i Komisionit lokal për mbledhjen e të dhënave mbi vlerësimin e dëmeve në terren të shkaktuara nga fatkeqësia /zjarri, të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar;<br>Pas kërkesës për ndihmë nga institucionet qeveritare, është ofruar ndihma emergjente nga shteti dhe persona të tjerë juridikë për popullatën brenda mundësive dhe kapaciteteve.<br>-Menaxhimin dhe koordinimi i incidentit bëhet përmes QOE – 112 rajonale dhe QOE lokale. |

| Probabiliteti / frekuenca | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kategorizimi** | **Cilësia** | **Probabiliteti/gjasat** | **Frekuenca** | **Përcaktimi** |
| **1** | E papërfillshme/<br>E pa mundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | |
| **2** | E vogël/<br>E pa besueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në<br>20 deri 100 vjet | |
| **3** | Mesatare/<br>E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në<br>2 deri 20 vjet | **X** |
| **4** | **E madhe /<br>Gati e mundur** | **51-98 %** | **1 ngjarje në<br>1 deri 2 vjet** | |
| **5** | Jashtëzakonisht e madhe /<br>E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

**Vlerësimi i pasojës:**
**Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut**
-Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, për fat të mirë nuk ka pasur viktima, por duke pasur parasysh numrin e banorëve në nevojë, rrezikun dhe pasojat, pasojat nga zjarri (përllogariten) si serioze.

-Përveç kërcënimit të drejtpërdrejtë zjarri, vlerësohet si një përkeqësim afatgjatë i standardit jetësor në zonën e prekur.

*Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:*

| Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut | | | |
|---|---|---|---|
| ***Kategorizimi:*** | ***Pasojat:*** | ***Kriteret:*** | ***I përcaktuar:*** |
| **1** | Të vogla/ minimale | < 50% | |
| **2** | Të vogla | 50 - 200 | |
| **3** | Mesatare | 201 - 500 | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 4 | Kritike | 501-1500 | X |
| 5 | **Katastrofike** | **> 500** | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

- Dëmet materiale në ekonomi familjare dhe biznese janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: **491,500.00€.**;
- Humbje në infrastrukturë shkollore( pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara **85,300.00€**

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

| **Pasojat ekonomike** | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | X |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

**Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social – dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike**

- Vlera e dëmeve materiale në infrastrukturë janë përllogaritur në bazë të raportit të komisionit lokal për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë shumën: **65,400.00 €;**

( duke mos futur në përllogaritje humbjet e KEDS);

***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike***

| *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social- infrastruktura kritike* | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 1% GDP | |
| 2 | Të vogla | 1 - 3% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5 - 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 5 - 10% GDP | **X** |
| 5 | Katastrofike | >10% GDP | |

Matricat:

## Matrica e gjasës:

### Matrica 1: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*




### Matrica 2: *Rreziku për pasojat në ekonomi:*



E pamundur

E pa besueshme

E besueshme

Gati e mundur

E sigurt

Matrica 3: ***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:***



# 6.6. TËRMETET

## 6.6.1. Karakteristikat sizmike të zonave dhe rreziku sizmik

Tërmeti pasqyron luhatjen e pllakave të tokës të nxitura nga shkaqe natyrore ose artificiale e që janë pasojë e lirimit të brendshëm të energjisë së tokës.
Tërmeti është fenomen i cili shkaktohet nga çlirimi i papritur i energjisë së grumbulluar, i cili shkakton krijimin e valëve sizmike (dallgëve sizmike). Në sipërfaqen e tokës, tërmeti shfaqet në dridhjet ose zhvendosjet e tokës (truallit) dhe nganjëherë edhe në krijimin e dallgëve detare, tsunami. Në të gjitha këto raste, tërmeti mund të shkaktojë dëmtime të mëdha njerëzore dhe materiale.

Nga pikëpamja sizmologjike territori i Komunes sonë paraqet aktivitet sizmik relativisht të lartë, i cili është goditur në të kaluarën dhe mund të goditet edhe në të ardhmen nga tërmetet e forta. Territori i Komunës sonë, në të kaluaren është përfshirë nga një mori tërmetesh të cilat përgjithësisht kanë pasur karakter autokton, ku si karakteristikë e veqantë mund të themi se janë vatrat e cekëta, të cilat gjenerohen në afërsi të kore së tokës, maksimumi i thellësisë së vatrave mund të jetë 15 - 20 km thellë në nëntokë. Studimet e sizmicitetit varen shumë nga informacioni që disponohet nga plotësia dhe besueshmëria e të dhënave mbi tërmetet që paraqiten në katalogun e tërmeteve. Ngjarjet sizmike tregojnë se brenda 20 viteve të fundit vendi ynë është goditur me tri tërmete me magnitude mesatare, me madhësi 4.8-5.7 , me viktima njerëzore dhe dëme materiale.
Territori i komunës së Kaçanikut, lidhet me ekzistencën e hipo-qendrës së tërmeteve autoktone me të cilat karakterizohen rajonet e gjëra të terreneve si vijon: Ferizaj-Gjilan-Viti-Kaçanik. Thellësia e hipoqendrave të këtyre tërmeteve është e ndryshme, por nuk i kalon 15 km. Duke analizuar hartën sizmike të Kosovës rrjedh se brenda territorit të komunës së Kaçanikut kalojnë izoseiste prej IX ballësh dhe ajo prej VIII ballësh
Rreth 90% të territorit të Kaçanikut shtrihet në zonat me rrezikshmëri nga tërmeti 8 shkallë të Rihterit, si dhe rreth 10% prej 9 shkallë të Rihterit në veri të komunës, në fshatin Begracë

## 6.6.2. Vendbanimet e rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve

Duke u bazuar në të dhënat seizmike nga e kaluara e deri me sot, territori i Komunës së Kaçanikut, ka qenë i përfshirë nga një mori tërmetesh te cilat përgjithësisht kanë pasur karakter autokton.vendbanimet më të rrezikuara janë fshati Begracë, Kaçanik i Vjetër dhe zona urbane e Komunës së Kaçanikut. Vlen të përmendet tërmeti në Ferizaj, me 26 shkurt 1755 me intensitet epiqendre I - IX ballë shkalla MSK-64 dhe magnitudë 6.1 shkalla Riter.
Pastaj, ai i vitit 1921, me intensitet prej IX ballë MSK-64, i cili goditi rajonin Ferizaj-Viti-Gjilan, në Shkup me 1963, i cili ka përfshirë edhe territorin e komunës së Kaçanikut.

Territori i komunës së Kaçanikut në aspektin seizmik karakterizohet si hapësirë jo shumë aktive duke u bazuar në atë se brenda kësaj hapësire kemi një gërshetim, përkatësisht kontaktin tektonik pothuaj të tri zonave tektonike (Zona e Vardarit, Drenicës (Drino-Ivanjicës) dhe e Sharr-Korabit të cilat kanë qenë aktive sidomos gjatë periudhës së Pliocenit.

**Harta 30:** *Vendbanimet e rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve, Kaçanikut,* ***aneksi i hartave***

| Nr. | Vendbanimi | Gjithësej | Meshkuj | Femra |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Begracë | 2116 | 1054 | 1062 |
| 2 | Kaçanik i Vjetër | 1940 | 963 | 977 |
| 3 | Stagovë | 1160 | 604 | 556 |
| 4 | Runjevë | 698 | 357 | 341 |
| 5 | Kaçanik (zona urbane) | 10393 | 5301 | 5092 |
| 6 | Nikaj | 778 | 388 | 390 |
| 7 | Biçec | 1696 | 858 | 838 |
| 8 | Kovaçec | 1030 | 536 | 434 |
| 9 | Runjevë | 698 | 357 | 341 |
| 10 | Bob | 1796 | 920 | 876 |

**Tabela 87:** Vendbanimet e rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve

### 6.6.3. Rrezikshmëria e zonave të caktuara

Zonat më të rrezikuara në Komunën e Kaçanikut janë:

- Zonat me densitet të lartë të popullsisë, kujdes të veçantë duhet kushtuar ndërtimeve të larta >P+3, që gjinden në zonën urbane dhe rurale të qytetit, objekteve industriale dhe infrastrukturës rrugore, sidomos urave në autostradën "Arbër Xhaferi"
- Zonat e caktuara të objekteve me ndërtime të dobëta në aspektin e kualitetit të materialit ndërtimor;
- Zonat e pastudjuara në aspektin e fizibilitetit dhe qëndrueshmërisë së tokës, etj.;

Ndërtimet e infrastrukturës dhe objekteve të banimit duhet ti përmbahen shkallës së intensitetit të dridhjeve për minimizimin e fatkeqësisë në raste rreziku.
Komuna e Kaçanikut gjindet në zonën sizmogjene Ferizaj-Viti-Gjilan me magnitude maksimale M=6.1 Shkalla Riter, fshati Begracë dhe Kaçanik i Vjetër, sipas statistikave ka qenë zonë me shkallë të lartë të intensitetit të dridhjeve sizmike.

**Harta 31:** *Harta e rrezikut sizmik për territorin e Kosovës*, ***aneksi i hartave***

### 6.6.4. Shpeshtësia, intensiteti dhe epiqendra e tërmetit (dridhjeve)

Të dhënat nga shërbimet seizmologjike nga rajoni dhe rrjeti seizmologjik i Kosovës për tërmetet që kanë prekur territorin e Kosovës ekzistojnë gjatë periudhës 1900-2014. Ndër tërmetet më të fuqishme që kanë goditur vendin tonë, në 23 vitet e fundit mund të përmendim;

1. Tërmeti i Gjilanit 24.04.2002, **Mag.5.7, intensiteti VIII**
2. Tërmeti i Istogut 10.03.2010, **Mag.5.2, intensiteti VII**
3. Tërmeti i Vushtrrisë 18.11.2013**, Mag.4.8, intensiteti VI1\2**

| Lokacioni i Tërmetit | Magnitudë | Itensiteti |
|---|---|---|
| **Prizreni 1456** | MS=6.1 | VIII1/2 |
| **Peja 1662** | MW=6.0 | VIII1/2 |
| **Ferizaj-Viti 1921** | MI=6.1 | IX |
| **Viti 1921** | MI=5.4 | VIII |
| **Gjilan 1921** | MI=5.0 | VIII |
| **Kaçanik** | **MI=5.6** | **VIII** |
| **Gjakova 1992** | MI=5.3 | VII1/2 |
| **Prizren 1945** | MI=5.0 | VII |
| **Klina 1947** | MI=5.2 | VIII |
| **Kopaonik 1980** | MW=5.7 | VIII |
| **Gjilani 2002** | MW=5.7 | VII-VIII |
| **Istog 2010** | MI=5.2 | VII |
| **Vushtrri 2013** | MI=4.8 | VI |

**Tabela 88 :** Disa nga tërmetet më të forta që kanë goditur teritorin e Kosovës ndër vite!

Nëse e analizojmë hartën seizmike të Kosovës, shihet çartë se territori i komunës së Kaçanikut, lidhet me ekzistencën e hipo-qendrës së tërmeteve autoktone me të cilat karakterizohen rajonet e gjëra të terreneve si vijon: Ferizaj-Gjilan-Viti-Kaçanik. Thellësia e hipoqendrave të këtyre tërmeteve është e ndryshme, por nuk i kalon 15 km.
Rreth 90% të territorit të Kaçanikut shtrihet në zonat me rrezikshmëri nga tërmeti 8 shkallë të Rihterit, si dhe rreth 10% prej 9 shkallë të Rihterit në veri të komunës, në fshatin Begracë

Kjo zonë e burimeve sizmike ka gjeneruar në të kaluarën dhe mund të gjenerojë edhe në të ardhmen tërmete të forta.

### 6.6.5. Pasojat e tërmeteve sipas zonave sizmike

Komuna e Kaçanikut nuk është vatër e shpeshtë sizmike por, në rastin e ndodhjes së tërmetit, pasojat do të jenë katastrofike, duke pas parasysh nivelin e dobët të ndërtimit, pastaj dendësinë e madhe të banorëve në km², mundësia e fatkeqësive sekondare infrastrukturën e dobët të paralajmërimit të hershëm si dhe aftësia e kufizuar e njësive reaguese për këtë lloj fatkeqësie. Kjo sipërfaqe dhe ky numër i popullsisë, gjatë tërmeteve mund të ketë pasoja kritike si: vdekje dhe lëndime, evakuime, shkatërrime të mëdha të ndërtesave, ndërprerje komunikacioni, bllokim rrugësh. Gjithashtu numri i të rrezikuarve do të shtohet si pasojë e rreziqeve sekondare, si eksplodimet, zjarret, vërshimet dhe epidemitë.

### 6.6.6. Informimi, sensibilizimi dhe trajnimi i popullatës në raste të tërmeteve

Me qëllim të ngritjes së gatishmërisë dhe zvogëlimit të rrezikut nga tërmetet në shkolla, Agjencia e Menaxhimit Emergjent (AME), në bashkëpunim me Komunën e Kaçanikut- Sektori i Emergjencave, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, Policia e Kosovës, Njesia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, dhe Shërbimi Emergjent i QKMF-së, organizoi stërvitje me Simulator (automjet ku simulohet tërmeti).




**Foto 17:** Organizimi i stërvitjes shkollore për vetëdijesim dhe mbrojtje nga tërmeti 18.04.2019 në Kaçanik

Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte sensibilizimi, njohja dhe trajnimi s nxënësve se si duhet të sillen dhe të mbrohen në rastet e tërmeteve.
Automjeti me Simulator ka qëndruar në Kosovë, në kuadër të bashkëpunimit të AME-së me AFAD-in Turk. Ky aktivitet u realizua në oborrin e Shkollës së Mesme Profesionale " Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" në Kaçanik.

**Masat parandaluese;**

-Ndërmarrja e masave parandaluese, me qëllim të zvogëlimit/zbutjes së rrezikut sizmik janë e vetmja mënyrë efektive për t'u mbrojtur nga tërmetet:

- Rregullat për ndërtime seizmike;
- Ligje dhe rregullore bashkëkohore për ndërtimet sipas Eurokode 8;
- Mbikqyrjen strikte të zbatimit të rregulloreve;
- Kontrollet periodike të hartave sizmike;
- Implementimi i studimit të mikro-zonimit për zonën urbane;
- Përpunimi i hartës së rrezikut sizmik të vendit në bazë të të dhënave sizmike për nivele të ndryshme të rrezikut sizmik, të pranueshme për planifikim, projektimin dhe ndërtimin;




**Harta 32**: Harta e sizmicitetit për territorin e Kosovës **-** Epiqendrat e tërmeteve me Mag.>3.5 nga viti 1456 deri 31.12.2014




**Harta 33:** Harta e rrezikut sizmik për territorin e Kosovës

Zonat kryesore burimore sizmike:

1. Zona sizmogjene Prizren-Pejë;
2. Zona sizmogjene Ferizaj-Viti –Gjilan;
3. Zona sizmogjene e Kopaunikut;

**Skenari 1** – Tërmetet

| **Emri i skenarit:** | **Tërmetet** |
|---|---|
| **Frekuenca e ndodhjes:** | |
| ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>**X** ☐ E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>☐Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| **X** ☐ E papërfillshme (më pak se 10%)<br>☐ Kritike: 25 deri 50% . | ☐ E kufizuar( 10 deri 25%)<br>☐ Katastrofike: Më shumë se 50% |
| Lloji i skenarit: | |
| **X** ☐**Skenari 1**; ☐ Skenari 2; | ☐ Skenari 3; |
| Ndikimi: | |
| **X** ☐ I papërfillshëm; ☐I vogël ; | ☐ I mesëm ; ☐ Katastrofike; |
| Data e vlerësimit: | |
| **10/02./2023** | |

| Parametrat | Përmbajtja |
|---|---|
| **Vendi i ngjarjes (Lokacioni)** | Tërë territori i Kaçanikut në veçanti veriu i komunës, fshati Begracë ku tërmeti do të jetë 4.2 shkallë të Rihterit.<br><br> |
| **Kushtet meteorologjike** | Temperatura e ulëta |
| **Periudha e vitit** | **2 Shkurt 2023** |
| **Lloji i ditës** | Ditë vikendi |
| **Popullata** | Tërmeti ka qenë 4.2 shkallë të Rihterit.që do të thotë se shkalla e goditjes ka qenë e ulët (pa pasoja në njerëz, dalja nga objektet e banimit, panik te popullata. |
| **Dëmet Ekonomike** | Nuk ka pasur dëme në pasuri private dhe publike. |
| **Ambienti** | Në objekte dhe në rrjetin energjetik nuk ka pasur dëme dhe nuk ka pasur ndikim negativ në ambientin dhe dëmtim të mjedisit . |
| **Infrastruktura kritike** | Sistemi energjetik, ujësjellësit infrastruktura rrugore (urat, tunelet) Rrugët për furnizim me ushqim nuk janë dëmtuar etj). |
| **Kapaciteti reagues** | Kapacitetet reaguese në nivelin lokal janë: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit |
| **NGJARJA** | |
| **Kohëzgjatja e mundshme** | Kohëzgjatja e mundshme është 2- 4 sekonda |

| | |
|---|---|
| **Modeli sezonal** | I pa parashikuar |
| **Ngjarja kryesore** | Me datën 02 shkurt 2023 një tërmet ka goditur banorët e fshatit Begracë të komunës së Kaçanikut, në epiqendër kishte mgnitudë momentale prej 4.2 ballësh.<br>Ndonëse dridhjet janë ndier edhe në disa fshatra dhe vetë qytetin e Kaçanikut, ato nuk kanë shkaktuar ndonjë dëm material.<br>Pos panikut të banorëve, dëme tjera në infrastrukturë rrugore objekte banimi, mjedis dhe infrastrukturë kritike nuk ka pasur. |
| **Pasojat e mundshme** | Tërmeti ka qenë 4.2 shkallë të Rihterit.që do të thotë se shkalla e goditjes ka qenë e vogël (nuk ka pasur të vdekur dhe të lënduar, pos panikut te qytetarët. |
| **Ngjarjet sekondare** | Janë (zjarret, shembjet, rrjedhja e kanalizimeve dhe e prodhimeve toksike etj).. Efektet sekondare të kësaj fatkeqësie, nuk ka pasur ( urat në Magjistrale dhe urat në vijën hekurudhore Ferizaj - Hani i Elezit janë në gjendje të rregullt . |
| **Rastet me fatalitet** | Raste me fatalitet nuk ka pasur pos panikut të popullatës |
| **Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar** | Persona të lënduar dhe të sëmurë apo të rrezikuar nuk pasur. |
| **Mungesë e nevojave elementare** | Furnizimi me ushqim ka qenë i rregullt, banorëve të frikësuar nga tërmeti iu është ofruar ndihmë psikologjike nga personat përgjegjës. |
| **Ndikimi i përgjithshëm ekonomik** | - Dëmet në njerëz( Panik në popullatë )<br>- Dëmet në objekte banimi, objekte shkollore, objekte biznesi, objekte kulturore, institucione publike, Objekte shëndetësore etj. nuk ka pasur. |
| **Ndërprerjet në jetën e përgjithshme** | Nuk ka pasur ndërprerje në jetën e përgjithshme të banorëve. |
| **Humbje në trashigimi kulturore** | Në Trashëgiminë Kulturore nuk janë shkaktuar dëme. |
| **Implikime politike** | Nuk ka |
| **Ndikimi i përgjithshëm** | Rrezik i ulët |
| **Probabiliteti** | Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësor, dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të ulët të mundshëm. |
| **Masat Parandaluese** | Masat parandaluese që duhen të ndërmerren në rajonet me aktivitet sizmik:<br>- Përpunimi i hartës së rrezikut sizmik të vendit në bazë të të dhënave sizmike për nivele të ndryshme të rrezikut sizmik, të pranueshme për planifikim, projektimin dhe ndërtimin;<br>- Përpunimi i hartave të mikrozonimit sizmik për zonat urbane të rëndësishme;<br>- Përpunimi i një harte të Riskut Sizmik;<br>- Përpunimi i ligjeve dhe rregulloreve për masa kundër tërmeteve me shkallë të madhe;. |

| Probabiliteti / frekuenca | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kategorizimi** | **Cilësia** | **Probabiliteti/gjasat** | **Frekuenca** | **Përcaktimi** |
| 1 | E papërfillshme/ E pa mundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | |
| 2 | E vogël/ E pa besueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në 20 deri 100 vjet | X |
| 3 | Mesatare/ E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në 2 deri 20 vjet | |
| 4 | **E madhe / Gati e mundur** | **51-98 %** | **1 ngjarje në 1 deri 2 vjet** | |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe / E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

## Vlerësimi i pasojës:

**Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut**

-Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, për fat të mirë nuk ka pasur të lënduar dhe viktima në njerëz, rreziku dhe pasojat, (përllogariten) si të pa përfillshme.

-Pos panikut, dëme në shëndetin e njeriut nuk ka pasur.

***Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:***

| Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi:* | *Pasojat:* | *Kriteret:* | *I përcaktuar:* |
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | X |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | |
| 4 | Kritike | 501-1500 | |
| 5 | **Katastrofike** | **> 500** | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

- Dëmet materiale në ekonomi familjare dhe biznese sipas raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve nuk ka pasur.;

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

| Pasojat ekonomike | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | X |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

**Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social – dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike.**

- Dëme për stabilitetin social n uk ka pasur
- Dëme materiale në infrastrukturë kritike nuk janë shkaktuar

***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike***

| *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social- infrastruktura kritike* | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 1% GDP | X |
| 2 | Të vogla | 1 - 3% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5 - 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 5 - 10% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >10% GDP | |

Matricat:

## Matrica e gjasës:

## Matrica 1: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*



Matrica 2: *Rreziku për pasojat në ekonomi:*




Matrica 3a: *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:*



**Hartëzimi i rrezikut nga tërmeti - skenari 2**




**Harta 34**: Epiqendra e tërmetit në fshatin Begracë – skenari 2

**Skenari 2 – Tërmetet**

<table>
<tr><td>Emri i skenarit:</td><td colspan="3">Tërmetet</td></tr>
<tr><td colspan="4" align="center">Frekuenca e ndodhjes:</td></tr>
<tr><td colspan="4">☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>☐ E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>X☐Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);</td></tr>
<tr><td colspan="4" align="center">Madhësia e mundshme:</td></tr>
<tr><td colspan="2">☐ E papërfillshme (më pak se 10%)<br>X ☐ Kritike: 25 deri 50% .</td><td colspan="2">☐ E kufizuar (10 deri 25%)<br>☐ Katastrofike: Më shumë se 50%</td></tr>
<tr><td colspan="4" align="center">Lloji i skenarit:</td></tr>
<tr><td>☐Skenari 1;</td><td colspan="2">X ☐ Skenari 2;</td><td>☐ Skenari 3;</td></tr>
<tr><td colspan="4" align="center">Ndikimi:</td></tr>
<tr><td>☐ I papërfillshëm;</td><td>☐I vogël ;</td><td>X☐ I mesëm ;</td><td>☐ Katastrofike;</td></tr>
<tr><td colspan="4">Data e vlerësimit:</td></tr>
<tr><td colspan="4">10/02./2023</td></tr>
</table>

| Parametrat | Përmbajtja |
|---|---|
| **Vendi i ngjarjes (Lokacioni)** | Me epiqendër, fshati Begracë dhe një pjesë e fshatrave Kaçanik i Vjetër, Stagovë, Dubravë, Nikaj, Biçec, Kovaçec, Runjevë, Bob dhe pjesën urbane të qytetit të Kaçanikut. Tërmeti ka qenë 6.5 shkallë të Rihterit<br><br><br>Harta : Epiqendra e tërmetit në fshatin Begracë |
| **Kushtet meteorologjike** | Temperaturat e ulëta të përcjellura me ngrica.<br>Sipas analizave sizmologjike ky tërmet është krahasuar me tërmetin e para 100 viteve i ndodhur në Kaçanik- Viti më 03 tetor 1921.<br>Dridhjet nga tërmeti kanë vazhduar edhe me datën 3 shkurt 2023 |
| **Periudha e vitit** | **2-3 Shkurt 2023** |
| **Lloji i ditës** | Ditë vikendi |
| **Analiza sizmologjike për dtët në vijim** | Mundësia për tu përsëritur dridhjet është madhe sidomos në fshatrat Begracë dhe Kaçanik i Vjetër. Koha e paraqitjes së tërmetit ka qenë 2 shkurti i vitit 2023. Si pasojë e temperaturave të ulëta dhe ngricave është vështirësuar dhënia e ndihmës dhe Kërkim Shpëtimi për banorët e prekur nga kjo fatkeqësi. Sipas historikut, tërmetet e veidentuara janë të krahasueshme me ato para 100 viteve ma parë. |
| **Popullata** | Tërmeti ka qenë 6.5 shkallë të Rihterit.që do të thotë se shkalla e goditjes ka qenë e ashpër (dhjetëra të vdekur dhe qindra të lënduar, si pasojë e shembjes së shtëpive, zjarreve, avarive elektrik etj.).<br>Numri i familjeve të prekura nga tërmeti është :68 me 408 anëtar<br>- Fëmijë - 217<br>- Meshkuj – 74<br>- Gra - 72<br>- Të moshuar - 40<br>- Të hendikepuar - 5 |
| **Infrastruktura kritike ekzistuese** | - Struktura rrugore;<br>- Rruga magjistrale, autoudha 2Km<br>- Rrugët lokale 16Km<br>- 1 tunelë;<br>- Sistemi i ujit i dëmtuar( primare dhe sekondare), afërsisht 2Km<br>- 3 ura |

| | |
|---|---|
| **Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut)** | - Në pajtueshmëri të plotë me Planin e Reagimit Kombëtar dhe Planin e Reagimit Emergjent Komunal, Kryetari i Komunës së Kaçanikut urgjentisht ka ndërmarrë masat dhe aktivitetet e nevojshme për K-Sh nga fatkeqësia e ndodhur sipas Planit të Reagimit Emergjent Lokal duke shpallur gjendjen e emergjente dhe duke aktivizuar Qendrën Operaive Emergjente lokale (QOEL) ndër të tjera, duke bërë edhe informimin publik dhe udhëzimet e nevojshme për evakuim dhe strehim të familjeve të dëmtuara nga tërmeti.<br>-Masat parandaluese për mbrojtje nga tërmetet nënkuptojnë të gjitha masat e nevojshme për zbutjen/zvogëlimin e rrezikut, duke filluar nga ato operacionale deri tek masat për sanimin e gjendjes.<br>-Mobilizimi i Ekipeve Reaguese Emergjente me të gjithë potencialin human dhe teknik duhet të jenë në gadishmëri të plotë për reagim në çdo kohë, duke u mbështetur edhe me resurse reaguese lokale, siç janë: Kryqi i Kuq Komunal(KKK), Klubet e Alpinistëve, Vullnetarët, Dhuruesit e gjakut, OJQ për mbrojtjen e ambientit, etj. |
| **NGJARJA** | |
| **Kohëzgjatja e mundshme** | Kohëzgjatja e mundshme është 2- 6 sekonda |
| **Zona që ka gjasa të goditet më së shumti** | Fshati Begracë, Kaçanik i Vjetër, Stagovë, Runjevë dhe qendra urbane e Kaçanikut. |
| **Modeli sezonal** | I pa parashikuar |
| **Ngjarja kryesore** | Me 2 shkurt 2023 një tërmet i magnitudës 6.5 të shkallës se Richterit ka goditur fshatin Begracë dhe pjesën urbane të Kaçanikut, dridhjet kanë vazhduar edhe me 2 dhe 3 shkurt duke goditur në mënyrë të ashpër banorët e qytetit, dhe fshatrave për rreth. Pasojat me fatalitet dhjetëra të vdekur, qindra të lënduar, qindra të ngujuar dhe të zhdukur, dëmet tjera janë: shembja e ndërtesave të banimit dhe institucioneve publike, dëmet në infrastrukturë rrugore, infrastrukturë kritike, çrregullimet në ambient (rrjedha e ujit, rrëshqitja e terrenit etj.).<br>Është shkatërruar në masë të madhe pasuria private dhe publike, objekte kolektive ku frekuentojnë numër i madh njerëzish, si shkolla, ambulanca, administrata komunale, posta, shtëpia e kulturës, policia etj.<br>-Operacionet e KSh kanë zhvilluar operacione të Shpëtimit të 30 familjeve të ngujuara në rrënoja, evakuimin e 38 familjeve të dëmtuara nga tërmeti të cilat janë vendosur në vend-strehime të përkohshme, në disa lokacione; Palestra sportive, objekti i ish Sanatoriumit, Restoran Fontana, Restoran Mani, Restoran Beni.<br>Për sanimin e gjendjes gjatë dhe pas Tërmetit janë angazhuar mekanizmat institucional dhe publik, siq janë: NjPZSh, Drejtoria komunale e Shërbimeve Publike me kompanitë kontraktuese për raste emergjente biznesi privat me makineri, Kryqi i kuq komunal, Vullnetarët dhe OJQ-të etj. |
| **Pasojat e primare dhe efektet anësore** | Humbje e pasurisë në objekte banimi plotësisht të dëmtuara nga tërmeti 38 shtëpi:<br>Dëmtimi i infrastrukturës rrugore (ura të dëmtuara 3,rrugë të dëmtuara 18km),<br>Ura lokale 3,<br>Ura në vijën hekurudhore Kaçanik – Ferizaj -1, |

| | |
|---|---|
| | Shtëpi të shkatruara (dëmtimi i plotë i orendive shtëpiake 35 shtëpi )<br>Sistemi i ujit i dëmtuar ( primare dhe sekondare), afërsisht - 2km,<br>Dëmtimi i krerëve të kafshëve dhe ushqimi për to,<br>Dëmtimi i bizneseve **430,500.00€** |
| **Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino efekti** | - Vështirësi për qarkullim në trafik;<br>- Mungesë e ujit të pijes si pasojë e dëmtimit të rrjetit apo ujit të turbullt në rezevoare.<br>- Kërcënimi për mundësinë e çfaqjes së ndonjë epidemije( si pasojë e kafshëve të ngordhura, nga shkarkimet e gropave septike, (Begracë<br>- Zjarret, shembjet, rrjedhja e kanalizimeve dhe e prodhimeve toksike etj).<br>- Dyshohet se janë dëmtuar urat në Autostradë, Magjistrale dhe urat në vijën hekurudhore Ferizaj - Hani i Elezit të cilat nëse shembën do të rrezikojnë komunikacionin rrugor dhe hekurudhorë. |
| **Rastet me fatalitet** | 12 persona me fatalitet |
| **Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar** | Qindra të lënduar, të sëmurë dhe të ngujuar.. |
| **Mungesë e nevojave elementare** | Furnizimi me ushqim, ndihma e të ngujuarve, lënduarve, sëmurëve si dhe gjetja e strehimit dhe akomodimit të banorëve të prekur nga tërmeti. |
| **Të evokuarit** | Të evakuuar 38 familje me 194 banorë |
| **Ndikimi i përgjithshëm ekonomik** | - Dëmet në njerëz(shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj.)<br>- Dëmet e shkaktuara në: Ekonomi familjare 38 familje me 408 banorë ), të përllogaritura: **630,500.00€** ;<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë kritike (energjia elektrike),<br>shuma të mëdha por të pa përllogaritura(KEDS);<br>- Dëmet e shkaktuara në objekte, objekte shkollore, objekte kulturore, institucione publike, Objekte shëndetësore etj.**1,380,0000.00€**<br>- Dëmtimi i bizneseve **430,800.00€**<br>- Dëmet e shkaktuara në:Infrastrukturë rrugore(rrugët,urat,trotuare,etj)<br>- të përllogaritura në Euro:**1,250.000.00€**<br>- Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura është: **3,691.300.00€** |
| **Ndërprerjet në jetën e përgjithshme** | - Ndërprerja e furnizimit me rrymë elektrike,<br>- Ndërprerja e furnizimit me ujë të pijshëm,<br>- Ndërprerja e akseve rrugore apo kalimi me vështirësi,<br>- Furnizimi me ushqim i vështirësuar,<br>- Infrastruktura rrugore e dëmtuar (urat, tunelet),<br>- Dëmtimi i kanalizimeve. |
| **Humbje në trashigimi kulturore** | Një pjesë e Trashëgimisë Kulturore është shkatërruar dhe është kapluar nga zjarri. |
| **Implikime politike** | Nuk ka |

| | |
|---|---|
| **Ndikimi i përgjithshëm** | Rrezik i lartë |
| **Probabiliteti** | Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësor, dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të lartë të mundshëm. |
| **Masat Parandaluese** | Masat parandaluese që duhen të ndërmerren në rajonet me aktivitet sizmik:<br>- Përpunimi i hartës së rrezikut sizmik të vendit në bazë të të dhënave sizmike për nivele të ndryshme të rrezikut sizmik, të pranueshme për planifikim, projektimin dhe ndërtimin;<br>- Përpunimi i hartave të mikrozonimit sizmik për zonat urbane të rëndësishme;<br>- Përpunimi i një harte të Riskut Sizmik;<br>- Përpunimi i ligjeve dhe rregulloreve për masa kundër tërmeteve me shkallë të madhe;. |
| **Kohëzgjatja e mundshme** | Kohëzgjatja e mundshme është 2- 6 sekonda<br>-Koha e parashikuar e nevojshme për sanim të gjendjes 12muaj |
| **Koordinimi** | Pas ndodhjes së tërmetit organet komunale përgjegjëse për situata emergjente sipas Procedurave Standarde Operative(PSO) njoftojnë organet kompetente vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe strukturat për M&Sh për menaxhimin e situatës emergjente, bazuar në Planin e reagimit Emergjent, lokal aktivizohet QOE komunale / shpallet gjendje emergjente, takohet Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili kryesohet nga Kryetari i Komunës apo i deleguari i tij.<br>-Koordinimi i aktiviteteve nga niveli lokal bëhet përmes QOE lokale ;<br>-Duhet të bëhet aktivizimi i Komisionit lokal për mbledhjen e të dhënave mbi vlerësimin e dëmeve në terren të shkaktuara nga fatkeqësia – tërmeti, të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar;<br>-Komisioni Qendror, bashkon raportet e komisioneve lokale dhe bën verifikimin e vërtetësisë së dëmeve të vlerësuara nga komisionet lokale dhe këtë raport ia dorëzon Qeverisë së RK për shqyrtim dhe miratim;<br>-Raportin e miratuar nga qeveria ia dorëzon DKMSh-së në afat prej 15 ditëve; |

| **Probabiliteti / frekuenca** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kategorizimi** | **Cilësia** | **Probabiliteti/gjasat** | **Frekuenca** | **Përcaktimi** |
| **1** | E papërfillshme/<br>E pa mundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | |
| **2** | E vogël/<br>E pa besueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në<br>20 deri 100 vjet | X |
| **3** | Mesatare/<br>E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në<br>2 deri 20 vjet | |
| **4** | **E madhe /<br>Gati e mundur** | **51-98 %** | **1 ngjarje në<br>1 deri 2 vjet** | |
| **5** | Jashtëzakonisht e madhe /<br>E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

## Vlerësimi i pasojës:

**Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut**

-Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, për fat të mirë nuk ka pasur viktima, por duke pasur parasysh numrin e banorëve në nevojë, rrezikun dhe pasojat, pasojat nga tërmeti përllogariten si serioze.

-Përveç kërcënimit të drejtpërdrejtë nga tërmeti, vlerësohet si një përkeqësim afatgjatë i standardit jetësor në zonën e prekur.

*Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:*

| Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi:* | *Pasojat:* | *Kriteret:* | *I përcaktuar:* |
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | X |
| 4 | Kritike | 501-1500 | |
| 5 | **Katastrofike** | **> 500** | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

- Dëmet materiale në ekonomi familjare dhe biznese janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: **141,150.00€.**;

- Humbje në infrastrukturë shkollore( pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara **65,400.00€**

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

| Pasojat ekonomike | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | X |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

**Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social – dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike**

- Vlera e dëmeve materiale në infrastrukturë janë përllogaritur në bazë të raportit të komisionit lokal për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë shumën: **65,400.00 €;**

( duke mos futur në përllogaritje humbjet e KEDS);

***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike***

| *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social- infrastruktura kritike* | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | ***Pasojat*** | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 1% GDP | |
| 2 | Të vogla | 1 - 3% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5 - 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 5 - 10% GDP | X |
| 5 | Katastrofike | >10% GDP | |

Matricat:

Matrica e gjasës:

Matrica 1: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*



Matrica 2: *Rreziku për pasojat në ekonomi:*




Matrica 3a: *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:*



**Skenari 3 -** Tërmetet

| | |
|---|---|
| **Emri i skenarit:** | Tërmetet |
| **Frekuenca e ndodhjes:** | |
| ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>☐ E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>**X** ☐Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| ☐ E papërfillshme (më pak se 10%)<br>☐ Kritike: 25 deri 50% . | ☐ E kufizuar (10 deri 25%)<br>**X** ☐ Katastrofike: Më shumë se 50% |
| Lloji i skenarit: | |
| ☐Skenari 1; ☐ Skenari 2; | **X**☐ **Skenari 3**; |
| Ndikimi: | |
| ☐ I papërfillshëm; ☐I vogël ; | ☐ I mesëm ; **X** ☐ Katastrofike; |
| Data e vlerësimit: | |
| **10/02./2023** | |

**Konteksti**

| **Parametrat** | **Përmbajtja** |
|---|---|
| **Vendi i ngjarjes (Lokacioni)** | Tërmeti ka goditur Komunën e Kaçanikut me epiqendër në fshatin Begracë dhe pjesën urbane të qytetit të Kaçanikut. Tërmeti është 7.2 shkallë të Rihterit<br><br><br>Harta : Epiqendra e tërmetit në fshatin Begracë |
| **Kushtet meteorologjike** | Temperatura e ulëta dhe erëra të forta |

| | |
|---|---|
| **Periudha e vitit** | **Shkurt 2023** |
| **Lloji i ditës** | Ditë vikendi |
| **Popullata** | Tërmeti ka qenë 7.2 shkallë të Rihterit.që do të thotë se shkalla e goditjes ka qenë e ashpër (qindra të vdekur dhe të lënduar, si pasojë e shembjes së shtëpive, ndërtesave, zjarreve, avarive elektrike etj.)<br>Numri i familjeve të prekura nga tërmeti është; 130 me 780 banorë.<br>- Fëmijë – 430<br>- Meshkuj – 145<br>- Gra - 137<br>- Të moshuar – 45<br>- Të hendikepuar - 23 |
| **Infrastruktura kritike** | |
| **Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut)** | Në pajtueshmëri të plotë me Planin e Reagimit Kombëtar dhe Planin e Reagimit Emergjent Komunal, Kryetari i Komunës së Kaçanikut urgjentisht ka ndërmarrë masat dhe aktivitetet e nevojshme për K-Sh nga fatkeqësia e ndodhur sipas Planit të Reagimit Emergjent Lokal duke shpallur gjendjen e emergjente dhe aktivizuar Qendrën Operaive Emergjente lokale (QOEL) ndër të tjera, duke bërë edhe informimin publik dhe udhëzimet e nevojshme për evakuim dhe strehim të familjeve të dëmtuara nga tërmeti.<br>-Masat parandaluese për mbrojtje nga tërmetet nënkuptojnë të gjitha masat e nevojshme për zbutjen/zvogëlimin e rrezikut, duke filluar nga ato operacionale deri tek masat për sanimin e gjendjes.<br>- Mobilizimi i Ekipeve Reaguese Emergjente me të gjithë potencialin human dhe teknik duhet të jenë në gatishmëri të plotë për reagim në çdo kohë, duke u mbështetur edhe me resurse reaguese lokale, siq janë:.Kryqi i Kuq Komunal (KKK), Klubet e Alpinistëve, Dhuruesit e gjakut, OJQ për mbrojtjen e ambientit kurse ndihmë është kërkuar përmes QOE- regjionale në AME dhe në nivelin Qendrorë. |
| **NGJARJA** | |
| **Kohëzgjatja e mundshme** | Kohëzgjatja e mundshme është 2- 10 sekonda |
| **Zona që ka gjasa të goditet më së shumti** | Fshati Begracë dhe pjesa urbane e qyteti të Kaçanikut |
| **Modeli sezonal** | I pa parashikuar |
| **Ngjarja kryesore** | Një tërmet i magnitudës 7.2 të shkallës se Richterit ka goditur një pjesë të madhe të rajonit të Ferizajt dhe Kaçanikut, për dy ditë rresht, 2 dhe 3 shkurt, ka goditur në mënyrë të ashpër banorët e qytetit, fshatrat, rrugët dhe fabrikat duke shkaktuar: qindra të vdekur, mijëra të lënduar, mijëra të ngujuar dhe të zhdukur, dëmet tjera janë: Shembja e ndërtesave të banimit dhe të atyre publike, dëmet në infrastrukturë dhe transport, çrregullimet në ambient (rrjedha e ujit, rrëshqitja e terrenit).<br>Është shkatërruar në masë të madhe pasuria private dhe publike, objekte kolektive ku frekuentojnë numër i madh njerëzish, si shkolla, ambulanca, objekti i komunës posta, shtëpia e kulturës, policia etj.<br>-Operacionet e KSh kanë zhvilluar operacione të shpëtimit të 60 familjeve të ngujuara , evakuimin e 70 familjeve të prekur nga tërmeti të cilët janë vendosur në vend-strehime të përkohshme, në disa lokacione, Palestra |

| | |
|---|---|
| | sportive; objekti i ish Sanatoriumit; Restoran Fontana; Restoran Mani; Restoran Beni.<br>-Për sanimin e gjendjes gjatë dhe pas vërshimeve janë angazhuar edhe mekanizma institucional dhe publik, siq janë: NjPZSh ( me mekanizëm dhe pompa me presion të lartë, Drejtoria komunale e Shërbimeve Publike( biznesi privat me makineri), etj. |
| **Pasojat primare dhe efektet anësore** | Humbje e pasurisë në objekte banimi plotësisht të dëmtuara nga tërmeti 40 shtëpi banimi<br>-Dëmtim i Infrstrukturës rrugore, ura të dëmtuara 6 rrugë të dëmtuara 16km<br>- Dëmtim i Infrastrukturës kritike( sistemi i ujësjellësit, sistemi energjetik);<br>- Shtëpi të dëmtuar plotësisht me orendi shtëpiake 70 shtëpi.);<br>- Dëmtimi i krerëve të kafshëve dhe ushqimi për to 18;<br>-Dëmtimi i bizneseve **950,800.00€;**<br>-Vlera e përgjithshme e përllogaritur e dëmit **950,800.00€;** €; |
| **Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti** | -Vështërësi për qarkullim në trafik, dëmtimi i urave dhe rrugëve;<br>-Mungesë e ujit të pijes si pasojë e dëmtimit të rrjetit apo ujit të turbullt në rezervoarin e qytetit nëfsh. Bob;<br>-Kërcënimi për mundësinë e çfaqjes së ndonjë epidemije( si pasojë e kafshëve të ngordhura, nga dëmtimi i sistemit të kanalizimit etj.;<br>-Pasojat e tërmetit në ambient dhe tokë nga zjarret, ujërat e zeza dhe ndotjet e ndryshme ; |
| **Ndikimi- Indikatorët tregues** | |
| **Rastet me fatalitet** | Mbi njqindë persona të vdekur |
| **Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar** | Qindra të lënduar, të sëmurë, të ngujuar dhe të rrezikuar për jetë. |
| **Mungesë e nevojave elementare** | Furnizimi me ushqim, ujë, ndihma e të lënduarve si dhe gjetja e strehimit dhe akomodimit të banorëve të prekur nga tërmeti. |
| **Të evakuarit** | -Më shumë se 360 njerëz u evakuuan si pasojë e tërmetit |
| **Ndikimi i përgjithshëm ekonomik** | - Dëmet në njerëz(shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj.) të paevidentuara;<br>- Dëmet e shkaktuara në: Ekonomi familjare ( rreth 70 familje), të përllogaritura: **1,250,400.00 €;**<br>- Dëmet e shkaktuara në:Infrastrukturë rrugore(rrugët,urat,trotuare,etj) të përllogaritura në Euro: **2,360,400.00 €;**<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë kritike (energjia elektrike), shuma të mëdha por të pa përllogaritura(KEDS);<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë kritike (ujësjellës dhe kanalizim, KRU, ShA), të përllogaritura në Euro**: 350,400.00 €;**<br>- Dëmet e shkaktuara në automjete, të pa përllogaritura( Agjensitë e sigurimeve);<br>- Humbja e tregut për prodhuesit(ekonomik dhe bujqësorë), të pa përllogaritura, etj;<br>- - Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura është:**3,961,200.00 €;** |

| | |
|---|---|
| **Ndërprerjet në jetëne përgjithshme** | - Ndërprerja e furnizimit me rrymë elektrike,<br>- Ndërprerja e furnizimit me ujë të pijshëm,<br>- Ndërprerja e akseve rrugore apo kalimi me vështirësi,<br>- Furnizimi me ushqim shumë i vështirësuar,<br>- Infrastruktura rrugore e shkatërruar (urat, tunelet), |
| **Humbje në trashigimi kulturore** | - Pjesa e Trashëgimisë Kulturore është shkatërruar dhe është kapluar nga zjarri. Xhamia e dëmtuar , Kalaja e qytetit, shtëpia e kulturës etj. |
| **Implikime politike** | - Nuk ka |
| **Ndikimii përgjithshëm** | Rrezik i lartë |
| **Probabiliteti** | Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësor, dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të lartë të mundshëm. |
| **Koordinimi** | Pas ndodhjes së tërmetit organet komunale përgjegjëse për situata emergjente sipas Procedurave Standarde Operative(PSO) njoftojnë organet kompetente dhe administrative shtetërore, organet vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe strukturat për M&Sh për menaxhimin e situatës emergjente, bazuar në Planin e reagimit Emergjent (PRE) kurse në nivel lokal aktivizohet QOE komunale / Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili kryesohet nga Kryetari i Komunës apo i deleguari i tij.<br>-Koordinimi i aktiviteteve nga niveli qëndror deri tek ai lokal dhe anasjelltas bëhet përmes QOE -112 në nivel rajonal;<br>-Duhet të bëhet aktivizimi i Komisionit qëndror dhe ai lokal për mbledhjen e të dhënave mbi vlerësimin e dëmeve në terren të shkaktuara nga fatkeqësia /tërmeti, të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar;<br>- Komisioni Qendror, bashkon raportet e komisioneve lokale dhe bën verifikimin e vërtetësisë së dëmeve të vlerësuara nga komisionet lokale dhe këtë raport ia dorëzon Qeverisë së RK për shqyrtim dhe miratim;<br>-Raportin e miratuar nga qeveria ia dorëzon Agjencisë/DKMSh-së në afat prej 15 ditëve;<br>-Për shkak të dëmeve të mëdha, vështirësisë për të reaguar, pamjaftueshmërisë së resurseve humane dhe materiale, është bërë kërkesë për ndihmë në organet qeveritare.<br>Pas kërkesës për ndihmë nga institucionet qeveritare, është ofruar ndihma emergjente nga shteti dhe persona të tjerë juridikë për popullatën brenda mundësive dhe kapaciteteve.<br>-Menaxhimin dhe koordinimi i incidentit bëhet përmes QOE – 112 rajonale dhe QOE lokale. |

## Vlerësimi i pasojës:

**Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut**
-Të dhënat për numrin e banorëve me fatalitet, të lënduar, të ngujuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, për fat të keqë ka pasur viktima, por duke pasur parasysh numrin e banorëve në nevojë, rrezikun dhe pasojat nga tërmeti, dëmet përllogariten si katastrofike..

-Përveç kërcënimit të drejtpërdrejtë tërmeti, vlerësohet si një përkeqësim afatgjatë i standardit jetësor në zonën e prekur.

| Probabiliteti / frekuenca | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kategorizimi** | **Cilësia** | **Probabiliteti/gjasat** | **Frekuenca** | **Përcaktimi** |
| 1 | E papërfillshme/ E pa mundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | |
| 2 | E vogël/ E pa besueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në 20 deri 100 vjet | X |
| 3 | Mesatare/ E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në 2 deri 20 vjet | |
| 4 | **E madhe / Gati e mundur** | **51-98 %** | **1 ngjarje në 1 deri 2 vjet** | |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe / E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

*Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:*

| Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi:* | *Pasojat:* | *Kriteret:* | *I përcaktuar:* |
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | |
| 4 | Kritike | 501-1500 | X |
| 5 | **Katastrofike** | **> 500** | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**
- Dëmet materiale në ekonomi familjare dhe biznese janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: **141,150.00€.**;
- Humbje në infrastrukturë shkollore pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara **65,400.00€**

| Pasojat ekonomike | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | X |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social – dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike***

- Vlera e dëmeve materiale në infrastrukturë janë përllogaritur në bazë të raportit të komisionit lokal për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë shumën: **65,400.00 €;**
( duke mos futur në përllogaritje humbjet e KEDS);

***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike***

| *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social- infrastruktura kritike* | | | |
|---|---|---|---|
| ***Kategorizimi*** | ***Pasojat*** | ***Kriteret*** | ***Përcaktimi*** |
| **1** | Të papërfillshme | < 1% GDP | |
| **2** | Të vogla | 1 - 3% GDP | |
| **3** | Mesatare | 5 - 10% GDP | |
| **4** | Kritike | 5 - 10% GDP | |
| **5** | Katastrofike | >10% GDP | **X** |

Matrica e gjasës:

Matrica 1: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*



Matrica 2: *Rreziku për pasojat në ekonomi:*




Matrica 3a: *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:*



## 6.7. RRËSHQITJET DHE EROZIONET

### 6.7.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonave potenciale të rrëshqitjes dhe erozioneve,

Rrëshqitja e dheut në territorin e komunës së Kaçanikut është evidente në lagjen “Dushkaja”, “Migjeni”, “Idriz Seferi” dhe te “Guri i Shpumë” në magjistralen Prishtinë - Shkup për shkak të përbërjes pedologjike të tokës
Kjo dukuri është e shprehur në disa pjesë të sipërfaqeve tokësore në komunë, e sidomos tek formacionet shkëmbore që janë prezentë në anën e djathtë të lumit Neredime në hyrje të qytetit si dhe në dalje të qytetit, ku janë shkaktuar dëme të mëdha në mbylljen e rrugës Prishtinë- Shkup.
Rrëshqitjet natyrore si edhe ato te provokuara nga faktori njeri duhet identifikohen me një projekt të veçantë si dhe të merren masat adekuate, sidomos në ndërtim të objekteve të banimit dhe infrastrukturë.
Arsyet, shkaqet e të gjitha rrëshqitjeve të dheut në komunën e Kaçanikut kanë qenë, dhe janë shkaktuar nga ujërat nëntokësor, reshjet e shumta atmosferike dhe nga faktori njeri.

### 6.7.2. Kushtet klimatike, intensitetin, shpeshtësinë e paraqitjes

Gjatë reshjeve të mëdha të shiut që ndodhën më 8 qershorit 2011 në komunën tonë, sidomos në pjesën lindore të territorit erdhi deri te shembja e një pjese të dheut, ku shkaktar pos reshjeve të mëdha ishte edhe faktori njeri për shkak të mos marrjes së masave preventive.
Rrëshqitjet e shumta të ndodhura gjatë vitit 2017- 2018, tregojnë më së miri se në lidhjen e njeriut me mjedisin ka gjëra që nuk shkojnë. Kaçaniku përfshihet në grupin e vendeve që kërcënohen shumë nga ky rrezik natyror. Këtë proces natyror e favorizon shumë relievi i ri, pjerrësia e shpateve kodrinorë e malorë, prania e shkëmbinjve argjilorë, të cilët nuk e përshkojnë ujin, dhe ujërat sipërfaqësore apo të shiut. Shirat që zgjatën disa dite në pranverë, nxisin në shumë pjesë procesin e rrëshqitjeve. Shumë sektorë të rrugëve bllokohen nga dherat e rrëshqitura, shumë fshatra preken nga rrëshqitjet dhe mjaft shtëpi bëhen të pa banueshme.

### 6.7.3. Përshkrimi i strukturave gjeologjike të tokës (rrëshqitjet aktive dhe pasive);

Në ndërtimin gjeologjik të komunës së Kaçanikut marrin pjesë formacionet e Palezoiku, Triasiku, Jurasiku, Kretaku i Sipërm, Neogjenit dhe sedimentet e Kuaternarit
**Palezoiku -** Formacionet me të vjetra janë ato të palezoikut të cilat kanë një shtrirje më të gjerë në pjesët perëndimore dhe jugore të Kaçanikut e që shtrihen në një brez të gjerë me shtrirje nga lokaliteti Bajnicë në veri-perëndim e deri te lokalitete Glloboçicë-Kotlinë në jug-perëndim, por edhe në pjesën jugore të hapësirës në lokalitetet Kaçanik, Bob, Gjurgjedell etj.
**Triasiku -** përfaqësohet me gëlqeror të metamorfizuar. Shkëmbinjtë, gëlqeroret e metamorfizuar i takojnë triasikut të mesëm dhe të ulët dhe janë në pjesën jug-perëndimore dhe perëndimore të territorit të Kaçanikut (Glloboçicë, Sllatinë).
**Jurasiku -** përfaqësohet me serpentinite dhe periodite (harzburgitet) që paraqitet përgjatë dis-lokacioneve në formë të një brezi të ngushtë veri-jug në sipërfaqe të vogla.
**Kretasiku -** Në territorin e komunës së Kaçanikut është mjaftë i zhvilluar dhe kanë shtrirje VVP-JJL dhe ndërtojnë pjesën qendrore dhe lindore të komunës së Kaçanikut Nikaj, Kovaçec, Nikoc, Korbliq etj.)

### 6.7.4. Sipërfaqet e përfshira, dhe zonat potenciale të rrezikut;

Sipërfaqet e përfshira nga rrëshqitja e dheut në komunën e Kaçanikut zakonisht janë në zonat rurale, por ka edhe në qendrën urbane të komunës sonë.
Shembulli më i fundit është rrëshqitja e tokës në fshatin Kovaçec , Biçec dhe në lagjen Dushkaja, Kaçanik etj. Viktima në njerëz nuk ka pasur pasi rrëshqitjet kanë qenë të ngadalshme dhe kanë ndodhur kryesisht ditën, që banorët e kanë shfrytëzuar mundësinë për të dalë nga shtëpitë e tyre.. Rrëshqitjet janë të pranishme pothuaj në të gjitha zonat rurale të qytetit tonë. Hapja e tarracave, kanaleve, transheve, rrugëve etj. rrallë janë shoqëruar me masat përkatëse mbrojtëse, ose nuk kanë respektuar veçoritë dhe mundësitë e relievit ku ato janë vendosur, ndaj rrëshqitjet janë bërë rrezik real, jo vetëm për këto objekte, por edhe për vet jetën e banorëve.

Territori i komunës së Kaçanikut karakterizohet me një pjesëmarrje të sipërfaqeve erozive sipas këtyre kategorive: Sipërfaqet të cilat i janë nënshtruar erozionit shumë të dobët kapin një hapësirë prej 1510 /ha, përkatësisht rreth 7.1% të territorit të kësaj komune.
Këto sipërfaqe shtrihen kryesisht në pjesën verilindore përkatësisht në lokalitetet Bajnicë, Duraj, Elezaj, Koxhaj etj. Territoret me erozion të dobët kapin sipërfaqe prej 7121 /ha përkatësisht rreth 33.7 % të komunës së Kaçanikut. Shtrihen në lokalitetet Semajë, Kaçanik i Vjetër. Vatë-Dubravë, Sllatinë, Biçec etj. Erozioni i mesëm shtrihet në një sipërfaqe prej 5846 /ha përkatësisht në 27.7 % të territorit të komunës së Kaçanikut. Ky lloj erozioni shtrihet në lokalitetet Nikoc, Begracë, Glloboçicë, Kotlinë, Ivajë dhe pjesën JP të Sllatinës.
Hapësirat me erozion të fortë në komunën e Kaçanikut kapin sipërfaqe prej 4630 /ha përkatësisht 21.9 %. Këtë pjesëmarrje relativisht të madhe të këtij erozioni e hasim në pjesën qendrore dhe JL të komunës. Shtrirje më të madhe ka në lokalitetet, Kaçanik, Korbliq, Dreogllavë, Stagovë Glloboçicë etj.
Erozioni është njëra prej komponentëve që duhet trajtuar për shkak se rrezikon sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën, por edhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara nga faktori antropogjen. Kjo dukuri është prezent pothuaj në tërë territorin e komunës së Kaçanikut, në forma dhe madhësi të ndryshme.
Procesi erozionit është i pranishëm në 60% të pellgut të Lumit Lepenc i cili brenda vitit depoziton rreth 1800m³ /km² 18[8]

| **Erozion shumë i dobët** | **1510** | **7.1** |
|---|---|---|
| **Erozion i dobët** | 7121 | **33.7** |
| **Erozion i mesëm** | 5846 | **27.7** |
| **Erozion i fortë** | 4630 | **21.9** |
| **Erozion shumë i fortë** | 1983 | **9.4** |
| | | |

**Tabela 89 :** Shkalla e erozionit

[8] Dr Riza Qavolli, Gjeografia regjionale e Kosovës f 224 Prishtinë 1997

### 6.7.5. Pasojat nga rrëshqitjet dhe erozionet

Rrëshqitja dhe Erozioni janë komponent që duhet trajtuar për shkak se rrezikonjnë sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën, por edhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara nga faktori antropogjen. Në bazë të kushteve fiziko- gjeologjike dhe klimatologjike dhe faktorët tjerë, të cilët kanë ndikim në krijimin e shembjeve dhe erozionit të tokës, në komunën tone kjo dukuri nuk është me përmasa të mëdha që mund të sjellë pasoja me fatalitet. Një rol të rëndësishëm në përshpejtimin e tij në shumë raste e ka luajtur edhe faktori antropogjen si rezultat i mos shfrytëzimit racional të tokave bujqësore, prerjes së pa kontrolluar të pyjeve, por edhe gjatë shfrytëzimit të pa kontrolluar të materialeve inerte dhe ndërtimore, prandaj si rezultat i këtyre mangësive mund të sjellin këto pasoja:

- Rrezikimi i jetës së njerëzve (kalimtarëve) në momentin e arritjes së pikës kritike .
- Shembja e disa shtëpive të ndërtuar me material të dobët dhe rrezikimi i pajisjeve të amvisërisë dhe inventarit shtëpiak.
- Degradimi, dëmtimi dhe ndikimi i faktorit njeri në sipërfaqet e tokës
- Dëmtimi i sistemit energjetik, ujësjellësit, infrastrukturës rrugore.
- Dëmtim i pasurisë private dhe publike
- Dëmtim i florës, faunës.
- Dëmtimi dhe shkatërrimi i pyjeve dhe parqeve.



**Foto 27:** Erozioni te Reka e Kafexhisë



**Foto 28:** Ekspert nga AME, gjatë inspektimit të terrenit nga erozioni te Reka e Kafexhisë në Lybeten



**Foto 19:** Qarja e tokës dt.19.04.2018 në Kovaçec



**Foto 20 :** Shembja e dheut dhe Gurëve në rrugën Magjistrale



**Foto 21 :** Qarja e tokës në rrugën “Idriz Seferi” 06.01.2018



**Foto 22 :** Bllokimi i rrugës në Magjistralen Kaçanik - Hani i Elezit nga rrëshqitja e dheut 22 janar 2005

Një ndër rrëshqitjet e tokës që është vlerësuar me **shkallën e rrezikshmërisë shumë të lartë e që është kërkuar, intervenim i menjëhershëm në nivel qendror,** ka ndodhur në Magjistrale Kaçanik – Shkup, (Guri i Shpumë) me dt.22.01.2005.

Rrëshqitja tjetër e tokës që është vlerësuar me shkallën e rrezikshmërisë **shumë të lartë** e që është **kërkuar, intervenim në nivel qendror,**
(nga ekspertët e AME-së) ka ndodhur në një pjesë të Dushkajës që ishte prej kohe e evidentuar si zonë e rrezikshme për ndërtim.
Arsyet, shkaqet e të gjitha rrëshqitjeve të dheut në komunën e Kaçanikut kanë qenë, dhe janë shkaktuar nga ujërat nëntokësor, reshjet e shumta atmosferike dhe nga faktori njeri.



**Foto 23:** Shembja e murit mrojtës në shkolën fillore Dushkajë



**Foto 24:** Shembja e dheut dhe dëmtimi i shtyllës gjatë ndërtimit të urës në Autostraadën "Arbën Xhaferi"



**Foto 25:** Shembja e gurëve në rrugën "Rizvan Bela" Gjyrgjedell 15.03.201



**Foto26:** Rrëshqitje e dheut në Dushkajë 13.03.2015

**Masat parandaluese**;

**Në bazë të analizave propozohen masat antierozive :**
Me qëllim të pengimit të rrëshqitjeve të dheut dhe erozionit, ruajtjes së tokave bujqësore, ruajtjes së ambientit, ruajtjes së shëndetit të njerëzve dhe pasurisë së tyre, sektori i emergjencave pranë Drejtorisë` së Shërbimeve Publike propozon që të ndërmirren këto masa preventive:

- Ndërtimi i brezave mbrojtës në shpatijet e rrëpishme;
- Ndërtimi i mureve rezistuese;
- Pastrimi i shtretërve të lumenjëve nga mbeturinat;
- Ndalimi i hedhjes së mbeturinave përgjat rrjedhjes së tyre;
- Ndalimi i shfrytëzimit pa kriter i rërs dhe zhavorrit nga shtretërit e lumenjëve;
- Meliorimi i kullosave;
- Meliorimi i pyjeve;
- Ndërtimi i formave tjera antierozive;
- Propozohet që këto sipërfaqe të pyllëzohen në bashkëpunim me MBPZHR-Agjencionin e pyjeve, ku ekspertët e pylltarisë përcaktojnë varietetet e pyjeve që duhet të mbillen me qëllim që të parandalojnë rritjen e shkallës së erozionit;
- Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerjet e pa kontrolluara dhe nga zjarret;
- Ndalimi i kullotjes në masivet e varfëra me bimësi;
- Pyllëzimi i viseve të zhveshura dhe atyre të degraduara;
- Ndalimi i shfrytëzimit të mirave materiale që shkaktojnë rrëshqitje të dheut;
- Ndërtimi i mureve mbrojtëse gjatë ndërtimit të rrugëve;
- Pastrimi i pendave në shtretërit e lumenjve dhe përrenjve nga gurët, zhavorri, rëra dhe materialet tjera;.
- Inspektimi në terren i objekteve të evidentuara në këtë vlerësim nga inspektorët komunal të urbanizmit, bujqësisë dhe ambientitsi dhe propozimi i masave sanuese dhe sanksionuese.

**Masat parandaluese nga rrëshqitja e dheut**

- Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerjet e pa kontrolluara dhe nga zjarret,
- Ndalimi i kullotjes në masivet e varfëra me bimësi,
- Pyllëzimi i viseve të zhveshura dhe atyre të degraduara,
- Ndalimi i shfrytëzimit të mirave materiale që shkaktojnë rrëshqitje të dheut,
- Ndërtimi i mureve mbrojtëse gjatë ndërtimit të rrugëve

**Veprimet antierozive**
Për të penguar vazhdimin e këtij fenomeni negativ duhet të merren këto veprime hidroteknike, bujqësore dhe biologjike

**Masat hidroteknike**
• Ndërtimi i teracave, gabioneve dhe pendave në shtretërit e përroskave dhe përrenjëve si masa mbrojtëse hidroteknike për ta minimizuar fuqinë gërryese,
• Ndërtimi i argjinaturave në brigjet e lumenjëve si masë parandaluese e gërryerjes,
• Mbjellja e fidaneve pyjore në shtretërit e lumenjëve,
• Ndalimi i nxjerrjes së inerteve në shtretërit e lumenjëve.

**Masat bujqësore**

• Të mirëmbahen tokat bujqësore
• Të aplikohen drejtë praktikat bujqësore
• Përdorimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit të bëhet në bazë të udhëzimeve të ekspertëve
• Rritja e investimeve për mbrojtjen e tokës në brigjet e lumenjve.

**Masat biologjike**

• Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerjet e pa kontrolluara dhe nga zjarri
• Ndalimi i kullotjes në masivet e varfëra me bimësi
• Pyllëzimi i viseve të zhveshura dhe atyre të degraduara
• Krijimi i brezave të gjelbër në ato rajone ku shkalla e erozionit është e lartë.
• Erozioni duhet të kufizohet në brigjet e lumenjëve kryesor me mbjelljen e drunjtëve që do të mbulonin brezin prej 10 m largësi nga lumi
• Shfrytëzimi i tokave bujqësore në fushat lumore të lumenjëve kryesor duhet të kufizohet me kullota të përhershme ose pyje.



**Foto 29 :** Masat antierozive te Reka e Kafegjisë –Lypeten



**Foto 30:** Masat e ndërmarra kundër erozionit nga kompania Bechtel Enca në përroin e fshatit Kukaj




**Harta 35:** Erozioni në Komunën e Kaçanikut




**Harta 36:** Lokacionet e rrezikuara nga shembja e dheut në Komunën e Kaçanikut

**Skenari-1 – Rrëshqitja e tokës**

| | |
|---|---|
| Emri i skenarit: | Rrëshqitje e tokës |
| *Frekuenca e ndodhjes:* | |
| X ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>☐ E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>☐ Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| X ☐ E papërfillshme (më pak se 10%) ☐ E kufizuar( 10 deri 25%)<br>☐Kritike: 25 deri 50% . ☐ Katastrofike: Më shumë se 50% | |
| Lloji i skenarit: | |
| **X ☐ Skenari 1;** ☐ Skenari 2; ☐ Skenari 3; | |
| Ndikimi: | |
| ☐ I papërfillshëm; **X** ☐ I vogël ; ☐ I mesëm ; ☐ Katastrofike; | |
| Data e vlerësimit: | |
| **28/03/20223** | |

| KONTEKSTI | |
|---|---|
| Parametrat: | Përmbajtja: |
| **Vendi i ngjarjes (lokacioni)** | Lokacioni i rrezikuara nga rrëshqitja e tokës është: Lagje Dushkaja, (Te Kisi) që gjendet në veri të qytetit të Kaçanikut, që përshkon vijën , hekurudhore deri te stacioni i trenit.<br><br><br>Sipërfaqja e rrezikuar nga rrëshqitja e tokës (Dushkajë – te KISI) |
| **Kushtet meteorologjike** | Për tri ditë rresht, nga data 25.03.2023 - 28.03.2023 në komunën e Kaçanikut ka pasur të reshura të shiut. Sipas analizave meteorologjike, reshjet e deritanishme do të vazhdojnë edhe në ditët në vijin. |
| **Periudha e vitit:** | 25-28mars 2023 |
| **Lloji i ditës:** | Ditë pune dhe vikendi |
| **Analiza meteorologjike për kohën** | -Mundësia për të ndodhur rrëshqitje në këtë vit kalendarik është e madhe në komunën e Kaçanikut për çdo 2 vite kanë ndodhur rrëshqitje , kurse nëse e marrim 10 vjeçarin e fundit kemi pasur 5 shembje të dheut në zona të ndryshme, që d.m.th. se për çdo të tretin vit kemi pasur kërcënime nga rrëshqitjet (2005, 2008, 2011, 2014, 2017, 2018, 2020, 2023).<br>-Koha e paraqitjes së rrëshqitjes së tokës ishte 28 marsi 2023<br>-Si pasojë e të reshurave të mëdha në mars 2023, ka pasur rrëshqitje në disa vendbanime të komunës së Kaçanikut. |
| **Popullata** | Nuk është rrezikuar popullata një pjesë e murit mbrojtës është dëmtuar |
| **Infrastruktura kritike ekzistuese** | Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga rrëshqitja e dheut nuk ka pasur dëme të kosiderueshme dhe pasoja në infrastrukturë, në këtë zonë. |

| | |
|---|---|
| **Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut)** | - Në pajtueshmëri të plotë me paralajmërimet e hershme nga IHMK të RK për sasinë e reshjeve të shiut, QOE-112 ka lëshuar informacion urgjent sipas procedurave standarde operative për organnet kompetente shtetërore , në nivel qëndror dhe lokal si akter për ndërmarrjen e masave për mbrojtje nga vërshimet, duke ngritur nivelin e gadishmërisë së Ekipeve të K-Sh.<br>- Në nivelin lokal, Kryetari i Komunës do të aktivizojë Komitetin për Mbrojtje dhe Shpëtim (KMSH), të ndërmerr masat dhe aktivitetet e nevojshme për K-Sh nga rrëshqitja e dheut, duke bërë edhe informimin publik, paralajmërimin e hershëm dhe alarmimin si dhe udhëzimet e nevojshme publike për evakuim.<br>- Masat parandaluese për mbrojtje nga vërshimet nënkuptojnë të gjitha masat e nevojshme për zbutjen/zvogëlimin e rrezikut, duke filluar nga ato operacionale deri tek masat për sanimin e gjendjes.<br>-Mobilizimi i Ekipin e Reagimit Emergjent( ERE), dhe kompani të kontraktuara nga Komuna e Kaçanikut për intervenime emergjente në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera. |
| **Shkaku dhe shkaktari** | Pas reshjeve intensive të shiut gjatë orëve të pasditës jemi njoftuar nga banorët e lagjes Dushkaja të Kaçanikut, ku kemi marrë informacion se në këtë lagje është shkaktuar rrëshqitje e dheut.<br>Shkaqet e rrëshqitjes së dheut kanë qenë, si në vijim:<br>- Reshjet e pandërprera të shiut;<br>- Ndërtimet pa kriter;<br>- Përbërja pedologjike e tokës;<br>- Ndikimi i faktorit njeri.<br>- Zona e rrëshqitjes së dheut përfshinë murin mbrojtës dhe oborrin e kësaj shkolle.<br><br>- IHMK varësisht nga zhvillimet e cikloneve do të ofrojë njoftime me buletinin meteorologjik, me qëllim që të mbahen të informuar institucionet dhe qytetarët me parashikimet meteorologjike. |
| **Ngjarja kryesore** | - Më: **28/03./2023**, shembja e tokës është paraqitur në disa pjesë të sipërfaqeve tokësore në lagjen e Dushkajës, e sidomos tek (Lloqi i Kisit) ku është ndërtuar Shkolla e re fillore.<br>Gjatë reshjeve të mëdha të shiut që ndodhën me 25-28mars 2022 në komunën tonë, ka ardhur deri te rrëshqitja e tokës në pjesën e Dushkajës saktësisht te **Lloqi i Kisit** ; ku shkaktar pos reshjeve të mëdha të shiut, ishte edhe përbërja pedologjike e tokës dhe faktori njeri për mos marrje të masave preventive gjatë punëve për ndërtimin e objekti shkollor.<br>Pas ndërprerjeve të reshjeve me 29 mars rrëshqitja e tokës ka filluar të stabilizohet, ndërsa ekipet emergjente kanë ndërmarrë masat për zvogëlimin e rreziqeve. |
| **Pasojat primare dhe efektet anësore** | Pjesërisht është dëmtuar muri mbrojtës nga rrëshqitja e dheut. |
| **Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti** | - Vështirësi për qarkullim në trafik nuk ka pasur;<br>- Pasojat e rrëshqitjeve në ambien. |

| | |
|---|---|
| **Rastet me fatalitet** | -Nuk ka pasur raste me fatalitet |
| **Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar;** | Nuk ka banorë të lënduar apo të sëmurë. |
| **Mungesë e nevojave elementare** | - Si pasojë e rrëshqitjeve kemi dëmtimët të murit mbrojtës;<br>- Mungesë e ujit tëpijshëm; |
| **Të evakuuarit** | Nuk ka pasur raste për të cilët është dashur të organizohet evakuimi. |
| **Ndikimi i përgjithshëm ekonomik** | - Dëmet e shkaktuara në objektin shkollor janëtë vogla;<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë kritike (energjia elektrike), shuma të pa përllogaritura(KEDS); |
| **Ndikimi në natyrë dhe Mjedisi** | -Rritja e sipërfaqes së rrëshqitjes së dheut mund të sjellë ndotje dhe humbje të kualitetit të ujit (duke i shtuar edhe sasinë e konsiderueshme të shkarkimit të ujërave të zeza);<br>- Humbja/dëmtimi i tokës bujqësore nga rrëshqitja e dheut; etj. |
| **Ndërprerjet në jetën e përgjithshme** | - Ndërprerje e furnizimit me ujë të pijshëm,<br>- Funksionimi i infrastrukturës rrugore(kalim me vështirësi)<br>- Fëmijët për shkak të sigurisë nuk mund të vijojnë mësimin për 2 ditë ; |
| **Humbje në trashëgimi kulturore** | Jo |
| **Implikime politike** | Jo |
| **Ndikimi i përgjithshëm** | Rrezik i vogël |
| **Probabiliteti** | - Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësorë dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të vogël të mundshëm, duke marrë për bazë të dhënat historike, |
| **Paralajmërimi i hershëm** | -Fatkeqësia ishte pjesërisht e pritshme (bazuar në parashikimet meteorologjike)<br>-Informimi publik për të reshurat (të cilat mund të sjellin rrëshqitje të tokës ) ishte me kohë, sipas njoftimit të parashikimeve meteorologjike, me paralajmërime për mundësi të rrëshqitjeve dhe probabilitetit për cenueshmëri;<br>- Informimi i publikut bëhet në përputhj me planin për reagim emergjent komunal (PRE) përmes: mediave të shkruara dhe elektronike, njoftimet e shkruara, mesazhe SMS, rrjete sociale, web-faqe interneti, etj. |
| **Masat parand. gjatë periudhës së paralajmërimit të hershëm** | -Pas marrjes së Paralajmërimit nga IHMK për parashikimin e motit (reshjet e dendura), ngritët gatishmëria e lartë për të papriturat dhe aktivizohet Planifikimi Kontigjent për rrëshqitje të dheut si dhe ngritët gatishmëria e kapaciteteve humane dhe teknike të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim; |
| **Kohëzgjatja e pritshme e ngjarjes** | -Faza akute e ngjarjes zgjati 1 ditë.<br>-Koha e parashikuar e nevojshme për sanim të gjendjes është rreth 3 muaj |
| **Koordinimi** | -Instituti meteorologjik i Kosovës dërgon njoftimin mbi parashikimin e motit në QOE -112 të AME-së për reshjet e dendura komplekse dhe të pafavorshme për ditët në vijim, sipas PSO njoftohen organet kompetente dhe administrative , organet vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe |

| | |
|---|---|
| | strukturat për M&Sh për menaxhimin e situatës së pritshme emergjente sipas PRE;<br>-Mobilizimi i Ekipeve Reaguese Emergjente me të gjithë potencialin human dhe teknik duhet të jenë në gadishmëri të plotë për reagim në çdo kohë, duke u mbështetur me resurse reaguese lokale, siq janë: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës Njësisë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, Policin e Kosovës,Shërbimi emergjent medikal, -Menaxhimi dhe koordinimi i situatës në nivelin lokal bëhet sipas PRE komunal ; |

| Probabiliteti / frekuenca | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kategorizimi** | **Cilësia** | **Probabiliteti/gjasat** | **Frekuenca** | **Përcaktimi** |
| 1 | E papërfillshme/ E pa mundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | |
| 2 | E vogël/ E pa besueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në 20 deri 100 vjet | |
| 3 | Mesatare/ E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në 2 deri 20 vjet | |
| 4 | **E madhe / Gati e mundur** | **51-98 %** | **1 ngjarje në 1 deri 2 vjet** | **X** |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe / E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

## Vlerësimi i pasojës:

**Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut**
-Të dhënat për dëmet në objektin shkollor nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, për fat të mirë nuk ka pasur dëme, por duke pasur parasysh, rrezikun dhe pasojat nga rrëshqitja dheut përllogariten si të papërfillshme.

- Kërcënim të drejtpërdrejtë nga rrëshqitja e dheut nuk ka pasur, vlerësohet se standardi jetësor në zonën nuk është prekur.

*Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut*

| Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi:* | *Pasojat:* | *Kriteret:* | *I përcaktuar:* |
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | X |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | |
| 4 | Kritike | 501-1500 | |
| 5 | **Katastrofike** | **> 500** | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

- Dëmet materiale të papërfillshme
- Humbje në infrastrukturë shkollore të pa përfishme

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

| Pasojat ekonomike | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | X |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike***

| *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social- infrastruktura kritike* | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 1% GDP | X |
| 2 | Të vogla | 1 - 3% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5 - 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 5 - 10% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >10% GDP | |

**Matrica 1**: *Rreziku për **jetën dhe shëndetin e njeriut:***



**Matrica 2:** ***Rreziku për pasojat në ekonomi:***




**Matrica 3:** ***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:***



**Skenari 2- Rrëshqitja e dheut**

| | |
|---|---|
| Emri i skenarit: | Rrëshqitja e dheut |
| *Frekuenca e ndodhjes:* | |
| ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>**X** E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>☐ Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| ☐ E papërfillshme (më pak se 10%) ☐ E kufizuar( 10 deri 25%)<br>**X** Kritike: 25 deri 50% . ☐ Katastrofike: Më shumë se 50% | |
| Lloji i skenarit: | |
| ☐ Skenari 1; **X** ☐**Skenari 2**; ☐ Skenari 3; | |
| Ndikimi: | |
| ☐ I papërfillshëm; ☐ I vogël ; **X** ☐ I mesëm ; ☐ Katastrofike; | |
| Data e vlerësimit: | |
| **19/04/2023** | |

| KONTEKSTI | |
|---|---|
| Parametrat: | **Përmbajtja:** |
| **Vendi i ngjarjes (lokacioni)** | Fshati, Kovaçec( lagjen Burrnik) , dhe pjesa e autostradës" Arbën Xhaferi"<br><br><br>**Harta 37:** Rrëshqitja e dheut në fshatin, Kovaçec- lagja Burrnik |
| **Kushtet meteorologjike** | Për tri ditë rresht, nga :16.04.2023, e deri më 19.04.2023 ka pasur të reshura me dendësi të madhe. Sipas analizave meteorologjike, reshjet e deritanishme maksimale të evidentuara janë të krahasueshme me ato të para, 3 viteve më parë. |
| **Periudha e vitit:** | 16-19 Prill 2023 |
| **Lloji i ditës:** | Ditë pune dhe vikendi |
| **Analiza meteorologjike për kohën** | -Mundësia për të ndodhur rrëshqitje të dheut në këtë vit kalendarik është e madhe në komunën e Kaçanikut. Për çdo 3 vite kanë ndodhur rrëshqitje, kurse nëse e marrim 10 vjeçarin e fundit kemi pasur 3 apo 4 shembje të dheut në zona të ndryshme të komunës së Kaçanikut, që dmth. se për çdo të tretin vit kemi pasur kërcënime nga shembja e dheut. Vitet që kanë ndodhur shembje të dheut janë: viti 2005, 2011, 2014,2016, 2018, 2021,2023.<br>Si pasojë e të reshurave të mëdha në prill 2022, shembje të dheut janë shkaktuar në disa lokacione të komunës. |
| **Popullata** | Numri i familjeve të prekura nga rrëshqitja e dheut në zonën e prekur nga rrëshqitja e dheut, në fshatin Kovaçec –lagja Burrnik është 4, kurse numri i banorëve 27, prej tyre:<br>- Fëmijë- 13;<br>- Të moshuar 2;<br>- Invalid: 0;<br>- Gra; 5;<br>- Meshkuj: 7; |

| | |
|---|---|
| **Infrastruktura kritike ekzistuese** | - Bazuar në kriteret e paracaktuara sipas urdhëresës administrative për rregullimin e infrastrukturës në zonën e përfshirë nga rrëshqitja e dheut ka pasur dëme dhe pasoja në infrastrukturë;<br>- Struktura rrugore;<br>- Rruga lokale për në lagjen Burrnik - bllokimi i rrugës nga shembja e dheut në gjatësi 150m ;<br>- Dëmtimi i Autostradës "Arbër Xhaferi". |
| **Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut)** | - Në pajtueshmëri të plotë me paralajmërimet e hershme nga IHMK për sasinë e reshjeve të shiut, QOER-112 ka lëshuar informacion sipas procedurave standarde operative për organnet kompetente, në nivel lokal si akter për ndërmarrjen e masave për mbrojtje nga vërshimet, duke ngritur nivelin e gadishmërisë së Ekipeve të Reagimit Emergjent.<br>-Në nivelin lokal, Kryetari i Komunës së Kaçanikut do të aktivizojë Komitetin për Mbrojtje dhe Shpëtim (KMSH), të shpallë gjendje emergjente, të aktivizojë Qendrën Operative Emergjente Lokale (QOEL), të ndërmerr masat dhe aktivitetet e nevojshme për K-Sh, nga rrëshqitjet e dheut, duke bërë edhe informimin publik, paralajmërimin e hershëm dhe alarmimin si dhe udhëzimet e nevojshme publike për evakuim.<br>-Masat parandaluese për mbrojtje nga rrëshqitja e dheut nënkuptojnë të gjitha masat e nevojshme për zvogëlimin e rrezikut, duke filluar nga ato operacionale deri tek masat për sanimin e gjendjes.<br>-Mobilizimi i Ekipeve Reaguese Emergjente me të gjithë potencialin human dhe teknik, duhet të jenë në gatishmëri të plotë për reagim në çdo kohë, duke u mbështetur edhe me resurse reaguese lokale, siç janë: Kryqi i Kuq Komunal (KKK, Klubet e Alpinistëve, Dhuruesit e gjakut, OJQ për mbrojtjen e ambientit dhe kompanitë të kontraktuara nga Komuna e Kaçanikut për intervenime emergjente në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera. |
| **INCIDENTI-NGJARJA** | |
| **Shkaku dhe shkaktari** | - Pas reshjeve intensive të shiut gjatë periudhës 16-19 prill 20223 në lagjen Burrnik të fshatit Kovaçec, është shkaktuar shembje e dheut dhe janë rrezikuar disa familje<br>Në këtë rast institucionet e lokale, u alarmuan dhe vepruan në bazë të përgjegjësive ligjore për mbrojtje nga FNFT.<br>Shkaqet e rrëshqitjes së dheut kanë qenë, si në vijim:<br>- Reshjet e pandërprera të shiut, dhe shkrirja e borës;<br>- Ndërtimet pa kriter i objekteve;<br>- Mosmarrja e masave preventive gjatë punimeve në autostradën "Arbër Xhaferi"<br>- Përbërja pedologjike e tokës;<br>- Ndikimi i faktorit njeri.<br>Zona e rrëshqitjes së dheut përfshinë objektet familjare të lagjes Burrnik në fshatin Kovaçec gjithësej të goditura janë 4 shtëpi.<br>Sipas parashikimeve të IHMK-së, pritet që ditëve në vazhdim të ketë reshje në tërë vendin por më të theksuara përsëri në territorin e komunës osnë, që do ta rëndojnë edhe më shumë situatën.<br>-Nga reshjet e mëdha kemi ngujim të popullsisë së këtyre vendbanimeve dhe ndërprerje të lëvizjes së banorëve në këtë lagje. |

| | |
|---|---|
| | Situata po vazhdon të rëndohet duke u zgjeruar zonat e rrëshqitjes për shkak të konfiguracionit të terrenit dhe ujërave nëntokësorë<br>Pas ndërprerjeve të shiut toka ka filluar të stabilizohet. |
| **Ngjarja kryesore** | - M e datën 18 prill 2023, në lagjen Burrnik të Fshatit Kovaçec gjatë punimeve në Autostradën "Arbër Xhaferi" ka ardhur deri te rrëshqitja e dheut me ç'rastë janë rrezikuar banorët e kësaj lagje. Në këtë situatë përveç përshkrimit të situatës nga varianti 1 (një),situata vjen duke u përkeqësuar pasi është konstatuar dëmtimi i 4 (katër) shtëpive dhe rrezikimi i banorëve të cilëve iu ka ofruar ndihma dhe është konstatuar se urgjentisht duhet të bëhet evakuimi i tyre në vende të sigurta. Në kontekst të situatës duhet të ndërmerren masa për ndalimin e përkohshëm të punës pasi që 4 shtëpi, si pasoj e qarjes së tokës kanë pësuar dëmtime të mëdha. Familjarët që janë në rrezik në këto shtëpi (gjithsejtë 27) veta, duhet të strehohen dhe akomodohen në vend të caktuar duke i siguruar ushqim, veshëmbathje dhe gjëra tjera të domosdoshme për jetë. Përveq dëmeve në ekonomi familjare dëme ka edhe në objekte ndimëse.<br>-Janë ndërmarrë masat për zvogëlimin e rreziqeve, vendosja e pilotave (hunj të betonit) për stabilizimin e tokës nga shembja e dheut, rregullimi i rrugës dhe fonksionimi i saj për banorët tjerë të kësaj lagje, mbrojtja e sistemit të ujit të pijshëm etj.<br>-Për sanimin e gjendjes, gjatë dhe pas rrëshqitjes së dheut është angazhuar Kompania Bechtel-Enka e cila e ka shkaktuar fatkeqësinë, gjatë punimeve në Autostradë. |
| **Pasojat primare dhe efektet anësore** | - Humbje e pasurisë në objekte banimi ( pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara nga shembja e dheut):<br>- Dëmtim i Infrastrukturës rrugore 150m<br>- Dëmtim i Infrastrukturës kritike( sistemi i ujësjellësit,);<br>- Shtëpi të shkatërruara ( dëmtim i plotë i orendive shtëpiake: 4 shtëpi);<br>- Sipërfaqja e tokave bujqësore ( kultura bujqësore të dëmtuara): 5 (ha)<br>- Dëmtimi i objekteve ndihmëse për kafshëve dhe ushqimi për to:<br>-Vlera e përgjithshme e përllogaritur e dëmit, **425,470.00 €**; |
| **Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti** | -Vështirësi për qarkullim në trafik ( dëmtimi i rrugës lokale, që lidh lagjen Burrnik të fshatit Kovaçec me qytetin e Kaçanikut;<br>-Paraqitja e rrëshqitjes së dheut në gjatësi prej 150m në lagjen Burrnik të fshatin Kovaçec;<br>-Mungesë e ujit të pijes si pasojë e dëmtimit të rrjetit apo ujit të turbullt në impiante, ndotjen apo kontaminimin e ujit të pijes për shkak të mundësisë së depërtimit në rrjetin e ujësjellësit dhe infeksionet e mundshme, kërkesat për trajtim medikal, por pa fatalitet në njerëz;.<br>-Pasojat e rrëshqitjeve në ambient dhe tokë pjellore ( janë dëmtuar lavërtari, perime kulturë, pemëtari); |
| **NDIKIMI- INDIKATORËT TREGUES** | |
| **Rastet me fatalitet** | -Nuk ka pasur raste me fatalitet; |
| **Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar;** | -Bazuar në të dhënat e Komisionit për vlerësimin e dëmeve në Amvisëri dhe ekonomi Familjare të formuar nga Kryetari i Komunës, me dt.22.04.2023 nga pasojat e rrëshqitjes së dheut të prillit 2023 janë prekur 4 ekonomi familjare me 27 banorë); |

| | |
|---|---|
| | Të lënduar nuk ka, por ekziston rreziku derisa të evakuohen familjet.<br>-Situata e krijuar pas rrëshqitjes së dheut është shqetësuese për shkak se familjarët kanë pësuar trauma, sidomos fëmijët dhe gratë, (sipas informatave që kemi nga QKMF disa banorë të kësaj lagje kanë kërkuar ndihmë në këtë qendër. |
| **Mungesë e nevojave elementare** | - Si pasojë e rrëshqitjeve kemi dëmtime të rrugëve,<br>- Punëtorët nuk mund të shkojnë në punë, fëmijët në shkolla e kopshte;<br>- Kujdesi i ofruar shëndetësorë jo i duhuri;<br>- Furnizimet e nevojave themelore: ushqimit, veshë-mbathjes, shtrojë e mbulojë, mjeteve higjienike, energjia, etj./ të pa mjaftueshme;<br>- Mungesa e ujit të pijshëm, etj. |
| **Të evakuarit** | -Të evakuar janë 4 familje me 27 banorë, të cilët janë sistemuar përkohësisht te familjarët e tyre deri sa të bëhet një zgjidhje tjetër. |
| **Ndikimi i përgjithshëm ekonomik** | - Dëmet në njerëz( shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj.) ;<br>- Dëmet e shkaktuara në: Ekonomi familjare ( 4 objekte banimi të shkatërruara, të cilat nuk janë të banueshme), të përllogaritura: **408,452.00€**<br>- Dëmet e shkaktuara në bujqësi( sipërfaqe të mbjella me të lashta), në sipërfaqe të dëmtuara 5 (ha), fusha të shkatërruara, sera të dëmtuara,<br>- Objekte ndihmëse të përllogaritura në Euro: **9.618.00 €,;**<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë rrugore (rrugë lokale.) të pallogaritura (obligim i kompanisë Bechtel Enka)**;**<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë kritike (energjia elektrike – KEDS) të pallogaritura; shuma të mëdha por të pa përllogaritura (KEDS);<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë kritike (ujësjellës dhe kanalizim, KRU), të llogaritura në Euro: **7,400.00 €;**<br>- Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura është: **425,470.00 €;** |
| **Ndikimi në natyrë dhe mjedisi** | - Ujërat nëntokësorë mund të sjellin ndotje dhe humbje të kualitetit të ujit (duke i shtuar edhe sasinë e konsiderueshme të shkarkimit të ujërave të zeza);<br>- Humbja/dëmtimi i tokës bujqësore nga shembja e dheut;etj. |
| **Ndërprerjet në jetën e përgjithshme** | - Ndërprerje e furnizimit me ujë të pijshëm,<br>- Funksionimi i infrastrukturës rrugore( ndërprerje të akseve të caktuara rrugore apo kalim me vështirësi). |
| **Humbje në trashëgimi kulturore** | Jo |
| **Implikime politike** | Jo |
| **Ndikimi i përgjithshëm** | Rrezik i mesëm |
| **PROBABILITETI-GJASAT** | |
| **Probabiliteti** | - Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësorë dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të mesëm të mundshëm, duke marrë për bazë të dhënat historike; |

| | |
|---|---|
| **Paralajmërimi i hershëm** | -Fatkeqësia ishte pjesërisht e pritshme (bazuar në punët që po kryheshin në autostradën "Arbër Xhaferi") por pastaj gjërat u përkeqësuan dhe rëndoi në masë të madhe ngjarjen kryesore;<br>-Informimi publik ishte me kohë, për mundësi të shembjes së dheut dhe probabilitetit për cenueshmëri;<br>- Informimi i publikut bëhet në përputhje me PRK ose Planin Komunal për reagim emergjent(PRE) përmes: mediave të shkruara dhe elektronike, njoftimet e shkruara, mesazhe SMS, rrjete sociale, web-faqe interneti, etj. |
| **Masat parand. gjatë periudhës së paralajmërimit të hershëm** | -Pas marrjes së Paralajmërimit nga banorët e lagjes për parashikimin e rrëshqitjes së dheut, ngritët gatishmëria e lartë për të papriturat dhe aktivizohet Planifikimi Kontingjent për rrëshqitje të dheut si dhe ngritët gatishmëria e kapaciteteve humane dhe teknike të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim; |
| **Kohëzgjatja e pritshme e ngjarjes** | -Faza akute e ngjarjes zgjati 3 ditë.<br>-Koha e parashikuar e nevojshme për sanim të gjendjes është rreth 6 muaj |
| **Koordinimi** | - Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave – Sektori i emergjencave lajmëron QOE rajonale -112 të AME-së për shembjen e dheut dhe kompleksivitetin dhe kushtet e pafavorshme për ditët në vijim. Sipas PSO njoftohen organet kompetente dhe administrative komunale, organet vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe strukturat për M&Sh për menaxhimin e situatës së pritshme emergjente sipas PRE lokal;<br>-Bazuar në informacionet nga terreni për shtimin enorm të shembjeve të dheut dhe të ndikuar nga të reshurat e dendura, është aktivizuar QOE komunale/ Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili kryesohet nga Kryetari i Komunës apo i deleguari i tij.<br>-Koordinimi i aktiviteteve nga niveli qendror deri tek ai lokal dhe anasjelltas bëhet përmes QOE -112 në nivel rajonal;<br>-Duhet të bëhet aktivizimi i Komisionit lokal për mbledhjen e të dhënave mbi vlerësimin e dëmeve në terren të shkaktuara nga fatkeqësia /vërshimi, të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar;<br>- Komisioni Qendror, bashkon raportet e komisioneve lokale dhe bën verifikimin e vërtetësisë së dëmeve të vlerësuara nga komisionet lokale dhe këtë raport ia dorëzon Qeverisë së RK për shqyrtim dhe miratim;<br>-Raportin e miratuar nga qeveria ia dorëzon Agjencisë/DKMSh-së në afat prej 15 ditëve;<br>Menaxhimin dhe koordinimi i incidentit bëhet përmes QOE lokale. |

| Probabiliteti / frekuenca | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kategorizimi** | **Cilësia** | **Probabiliteti/gjasat** | **Frekuenca** | **Përcaktimi** |
| 1 | E papërfillshme/<br>E pa mundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | |
| 2 | E vogël/<br>E pa besueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në<br>20 deri 100 vjet | |
| 3 | Mesatare/<br>E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në<br>2 deri 20 vjet | X |
| 4 | **E madhe /<br>Gati e mundur** | **51-98 %** | **1 ngjarje në<br>1 deri 2 vjet** | |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe /<br>E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

## Vlerësimi i pasojës:

**Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut**

-Të dhënat për numrin e banorëve të rrezikuar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, për fat të mirë nuk ka pasur viktima, por duke pasur parasysh numrin e banorëve në nevojë, rrezikun dhe pasojat, pasojat nga térmeti përllogariten si serioze.

-Përveç kërcënimit të drejtpërdrejtë nga térmeti, vlerësohet si një përkeqësim afatgjatë i standardit jetësor në zonën e prekur.

*Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:*

| Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi:* | *Pasojat:* | *Kriteret:* | *I përcaktuar:* |
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | X |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | |
| 4 | Kritike | 501-1500 | |
| 5 | **Katastrofike** | **> 500** | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

- Dëmet materiale në ekonomi familjare (shtëpi plotësisht të dëmtuara)janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë vlerën: **408,452.00€.**;
- Humbje në objekte ndihmës pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara **9,618.00€**

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

| Pasojat ekonomike | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | X |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

**Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social – dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike**

- Vlera e dëmeve materiale në infrastrukturë janë përllogaritur në bazë të raportit të komisionit lokal për vlerësimin e dëmeve dhe arrijnë shumën: **7,400.00 €;**
( duke mos futur në përllogaritje humbjet e KEDS);

***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike***

| *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social- infrastruktura kritike* | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 1% GDP | |
| 2 | Të vogla | 1 - 3% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5 - 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 5 - 10% GDP | X |
| 5 | Katastrofike | >10% GDP | |

Matrica 1: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*




Matrica 2: *Rreziku për pasojat në ekonomi:*



Matrica 3a: *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:*




Matrica 4: *Pasqyron rrezikun e përgjithshëm*



## 6.8. RESHJET E DËBORËS DHE NGRICAT

### 6.8.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonave potenciale me të reshura të dendura të dëborës dhe ngricave,

Duke u bazuar në pozitën gjeografike dhe klimatike, territori i komunës së Kaçanikut karakterizohet me temperatura ekstreme te ulëta gjatë sezonës së dimrit, kështu që dimrat shoqërohen me të reshura relativisht të mëdha të borës për rrethanat kosovare, dhe me temperatura të ulëta deri në -20°C
Gjatë muajit shkurt të 2012 dhjetëra fshatra mbetën të bllokuara, për shkak të borës dhe ngricave ku temperatura ishte disa gradë nën zero, dhe se është raportuar për situatë mjaft emergjente, veç izolimit, bllokimit të rrugëve, nga trashësia e borës e cila i ka kaluar mbi një metër, janë rrezikuar edhe nga mungesa e ushqimit si banorët ashtu edhe kafshët. Situata më problematike paraqitet në fshatrat Ivajë, Gjyrgjedell, Strazhë, Glloboçicë, Gajre, Kotlinë, Sllatinë, Semajë, Gajre, Korbliq dhe Drenagllavë.

### 6.8.2.Intensiteti i reshjeve, shpeshtësia e paraqitjes, temperaturat ekstreme

Mesatarisht ditë me borë janë 30,6 ditë, ndërsa dite me mbulesë bore janë 47 ditë gati një muaj e gjysme, pjesa me e madhe vitit është pa mbulesë bore. Muaji që ka mbulesë bore më së shumti është janari me 14,9 ditë. Shtresa maksimale e bores është mjaft e lartë edhe pse e rrallë megjithatë ndodhë ngase shkakton një varg problemesh në jetën e përditshme. Ne muajin janar trashësia maksimale e borës mund të jetë edhe 64 cm që jep sinjal te çartë se mund ta paralizoj jetën e atij territori, në pjesën e Sharrit shtresa mbi 1-2 m është dukuri normale.
Në analizën e hartës së përhapjes së ditëve me shtresë bore del se në këtë komunë sillet prej 50 ditë në pjesët e ulëta ndërsa arrin në 70 ditë në viset e larta malore.
Mesatarisht dita e parë me bore paraqitet 30 nëntor ndërsa dita me e hershme me 5 nëntor. Zakonisht dita e fundit me borë paraqitet 23 Mars, ndërsa me e vonshmja deri me 27 Prill. Këto të dhëna janë për qytetin e Kaçanikut që ka lartësi relativisht të ulët mbidetare, në pjesët e larta malore nënkuptohet që zgjasin edhe më gjatë.
Periudha e borës në këtë lokalitet zgjatë mesatarisht prej Nëntorit deri në Prill.



**Foto 31:** Largimi i borës, rruga për në fshatin Drenogllavë

Dendësia më e madhe me të reshura në formë bore është në muajin Janar me mesatare prej 6.5 ditë gjatë muajit, ndërsa dendësia mesatare vjetore e ditëve me borë është 21.3 ditë. Sipërfaqja e territorit të komunës është përafërsisht 42.4 ditë e mbuluar me shtresë bore, respektivisht 11.6% të ditëve të një viti. Temperaturat ekstreme të ulëta paraqiten në muajin janar deri në - 20°C

### 6.8.3. Pasojat nga dëbora dhe ngrica

Bora, përveç se krijon vështirësi në qarkullimin rrugor, ajo në masë të madhe ndikon edhe në dëmtimin e shtyllave dhe largpërçueseve të rrjetit elektrik që si dukuri për komunën e Kaçanikut për shkak të reshurave të shumta, është shumë prezentë me mundësi që ato të ndodhin kudo, dmth.pa një identifikim të qartë të lokacionit.
Nga fenomeni i borës kemi raste të dëmtimit të konstruksionit të shtëpive (sidomos tek ndërtimet e vjetra me material të dobët), dëmtimit të objekteve të improvizuara si: depo të ndryshme, anekse të pa standardizuara të objekteve, stalla bagëtish, objekte ndihmëse për vendosjen e ushqimit të kafshëve, ahure etj. të cilat paraqiten sidomos në pjesët rurale të komunës. Ngricat më të mëdha paraqiten gjatë muajve, Nëntor–Dhjetor–Janar-Shkurt, mesatarisht 42.4 ditë të mbuluara me borë dhe me 63,3 ditë me mëngjese nën -°C. Ndryshimet më të mëdha shprehen në muajin shkurt, sepse diferenca e temperaturave të ulëta dhe të larta mund të arrijë deri në 10.8 ° C.[9]

Ngricat më tepër ndikojnë në vështirësimin e qarkullimit të automjeteve, sidomos rrezikohet siguria në komunikacion, veçanërisht sidomos në pikat më kritike të infrastrukturës rrugore.
Në qoftë se merret në konsideratë edhe mundësia e formimit të akullit, atëherë është evidente bllokimi dhe vështirësimi i qarkullimit rrugor i njerëzve dhe mallrave e në mënyre edhe më të theksuar nëpër fshatrat e zonave të thella siç është zona kufitare rreth fshatrave Korbëliq dhe Glloboqicë.
Ngricat gjithsesi ndikojnë edhe në dëmtimin (çarjen) e rrugëve të asfaltuara dhe nga ngrirja-shkrirja e masës së tokës vende-vende paraqitet edhe erozion-shembje që implikon marrjen e masave për ngritjen e mureve mbrojtëse (rruga magjistrale Prishtinë – Shkup në dalje të Kaçanikut).



**Foto 32:** Ngricat, rruga Kaçanik - Gajre

**Masat parandaluese;**

Gjatë stinës së dimrit rruga magjistrale Prishtinë – Hani i Elezit dhe rrugët rajonale Doganaj – Glloboçicë, dhe Doganaj –Shtërpcë paraqesin rrezik nga rrokullisja e gurëve, që shpesh herë vjen deri te bllokimi i komunikacionit në këto akse rrugore.
Andaj, kompania e mirëmbajtjes së rrugëve dimërore dhe verore (kompania e kontraktuar nga Ministria e Infrastrukturës) duhet që hapësirat ku paraqiten këto rrokullisje të gurëve ti veshë me rrjeta për pengimin e rrokullisje së gurëve dhe mënjanimin e rrezikut. Po ashtu Autostrada "Arbën Xhaferi" për shkak se rruga e ndërtuar në ura paraqet rrezik nga ngricat që shkaktohen nga lumi Lepenc, udhëzohet, që mirëmbajtja të jetë e rregullt dhe e shpeshtë. Sa i përket rrugëve lokale që menaxhohen nga komuna janë marrë masa parandaluese duke angazhuar kompaninë për mirëmbajtjen e rrugëve verore dhe dimërore.

[9] Plani Zhvillimor Komunal i Kaçanikut -KUSHTET KLIMATIKE, VALORIZIMI KLIMATIK, KARAKTERISTIKAT

**Harta e rreziqeve;**




**Harta 38:** Rrugët e rrezikuara nga bora dhe ngricat

## 6.9. BRESHËRI

### 6.9.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale të prekura nga breshëri.

**Breshëri** është reshje atmosferike që formohet me lëvizjen e shpejtë të lëvizjeve vertikale të ajrit dhe ftohjen e shpejtë të tij. Për formimin e rrufesë dhe breshërit, libri "Meteorologjia Sot" thotë se reja bëhet e elektrizuar ndërsa breshëri bie nëpër një rajon në renë e pikave të super-ftohta dhe kristaleve të akullta. Në komunën e Kaçanikut stuhitë e breshërit ndodhin zakonisht në verën e hershme mes stinës së pranverës dhe vjeshtës. Stuhitë e breshërit më tepër janë të kushtëzuara nga konfiguracioni i relievit, gjegjësisht afërsia e masivëve malore (malet e Sharrit dhe Karadakut) e përbërë prej Grykës së Kaçanikut (grykës së lumit Lepenc). Kohëzgjatja e stuhisë së breshërit sillet prej disa minutash deri në një orë.
Zonat potenciale janë fshatrat: Kotlinë, Gajre, Ivajë, Dubravë, Biçec, Begracë, Glloboçicë dhe Elezaj.

### 6.9.2.Shpeshtësia e paraqitjes dhe muajt kritik

Muajt më kritik të paraqitjes së breshërit dhe dëmet që janë shkaktuar në komunën e Kaçanikut janë zakonisht muaji maj, qershor dhe korrik**.**
Breshëri në fshatin Kotlinë, Biçec dhe Elezaj në muajin korrik 2015 ka filluar në orët e pasditës dhe ka zgjatur 20 minuta, duke vazhduar me reshje të rrëmbyeshme duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në kultura bujqësore.
Breshëri në fshatrat Kotlinë, Begracë dhe Llanishtë ka filluar në mesditën e datës 27.05.2021 dhe ka zgjatur 15 minuta duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në pemëtari dhe kultura tjera bujqësore.
Me datën 26.07.2023 në fshatin Biçec nga breshëri janë shkaktuar dëm**e** të konsiderueshme në pemëtari dhe kultura tjera bujqësore. Të gjitha këto dëme janë të evidentuara nga Komisionet kounale dhe të paraqitura në tabela.

### 6.9.3.Pasojat nga breshëri

Gjatë vlerësimit të dëmeve nga komisionet komunale në mënyrë tabelare janë paraqitur dëmet në kultura bujqësore.

| Nr. | Kultura bujqësore | Hektar(ha) | Shuma e dëmeve € |
|---|---|---|---|
| 1 | Misër | 36 | 9,960 |
| 2 | Grurë | 6 | 2,880 |
| 3 | Fasule | 36 | 38,000 |
| 4 | Patate | 8 | 28,800 |
| 5 | Dredhëz | 1.5 | 18.200 |
| 6 | Perime tjera | 3.5 | 45,000 |
| | **Totali** | **91** | **142,840.00€** |

**Tabela 90:** Dëmet e përgjithshme nga breshëri në kultura bujqësore në korrik - 2015

| Nr. | Kultura bujqësore | Trupa të pemëve | Shuma e dëmeve € |
|---|---|---|---|
| 1 | Mollë | 5.000 | 60.000 |
| 2 | Dardhë | 800 | 20.000 |
| 3 | Vishnje, qershi, pjeshkë dhe muqmullë | 2400 | 19.200 |
| 4 | Arra | 1300 | 58.500 |
| | **Totali** | **9500** | **157,700.00€** |

**Tabela 91:** Dëmet e përgjithshme në pemëtari në fshatrat e komunës së Kaçanikut- korrik 2015

| Nr. | Kultura e dëmtuar | Shkaktari i dëmit | Sipërfaqja në hektar (ha) | Përqindja e dëmit % | Vlera e dëmit në € |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Mollë | Breshëri | 0.56 | 40 | 1,248.8 |
| 2 | Mjedër | Breshëri | 0.17 | 20 | 507.19 |
| | | Totali | 0.73(ha) | | 1,755.99 € |

**Tabela 92:** Dëmet e shkaktuara nga breshëri në plantacion me pemë, mollë dhe mjedër në fshatin Biçec **me dt. 26.07.2023**

| Nr. | Kultura e dëmtuar | Shkaktari i dëmit | Sipërfaqe e dëmtuar në (ha) | Përqindja e dëmit % | Vlera totale € |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Pemë-mollë | Breshëri | 2.6 | 50 | 6,138 |
| 2 | Dardhë | Breshëri | 0.10 | 50 | 339.4 |
| 3 | Arrë | Breshëri | 0.10 | 50 | 246.2 |
| 4 | Patate | Breshëri | 0.40 | 50 | 560 |
| 5 | fasule | Breshëri | 2.7 | 50 | 6..357 |
| 6 | Misër | Breshëri | 8.6 | 40 | 2.153 |
| 7 | Lajthi | Breshëri | 2.21 | 50 | 2.950 |
| 8 | Kunguj | Breshëri | 0.93 | 50 | 3.289 |
| | Totali | | 17.64(ha) | 50% | 22,032.6€ |

**Tabela 93:** Pasojat nga breshëri në kultura bujëqësore, në fshatrat, Kotlinë, Begracë dhe Llanishtë me **dt.27.05.2021**



**Foto 32:** Pasojat në bujqësi nga stuhia dhe breshëri



**Foto 33:** Dëmet e shkaktuara në kulturat bujqësore nga stuhia dhe breshëri në disa fshatra të komunës së Kaçanikut

### 6.9.4. Harta e rreziqeve

**Harta:** Sipërfaqet e rrezikuara nga Breshëri në fshatrat e Komunës e Kaçanikut




**Harta 39**: Sipërfaqet e rrezikuara nga Breshëri në Komunën e Kaçanikut

# 6.10. ORTEKËT

## 6.10.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale

Ortekët janë dukuri tipike për relievin e llojit alpin, që paraqiten në terrenet e thepisura 45°, siç është relievi i vargmaleve të Malit Sharr dhe malit të Karadakut.

**Faktorët që shkaktojnë ortekun:**

- Kushtët atmosferike,
- Tempëratura,
- Pjerrtësija e këndit
- Drejtimi i pjerrtësisë,
- Drejtimi i erës
- Bimësia

**Shkaktarët e ortekut janë:**

- lloji i dëborës
- kthesa / pjerrtësia e shpatit,
- forma dhe lloji i tokës
- pozicioni i shtresave të dëborës,
- Kushtet meteorologjike – ndikimi i erës

**Llojet e orteqeve**

- **Orteku nga dëbora e shkapërderdhur** (dëbora e shkrirë) është lloji më i rrezikshëm i orteqeve.
- **Orteku nga dëbora e ngjeshur** është i rrezikshmëm dhe i paparashikueshëm. Të gjitha shtresat e dëborës reagojnë si një shtresë e vetme. Dëbora mund të ndahet në blloqe të vogla gjatë rënies, ose poshtë shpatit, mund të rrëshqasin blloqe të mëdha akujsh.



**Foto 34:** Orteqet



**Foto 35:** Orteqet

## 6.10.2. Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve

Në komunën e Kaçanikut deri më tani nuk ka pasur raste ku janë rrezikuar banorët nga orteqet. Duke u bazuar në konfiguracionin e terrenit mund të themi që vendbanimet më të rrezikuara janë fshatrat; Sllatinë,Gajre, Ivajë Korbliq dhe në zonën e thellë malore saktësisht te Reka e Kafexhisë ku mund të rrezikohet burimi i ujit të pijes për komunën e Kaçanikut.

## 6.10.3. Treguesit statistikor të pasojave nga ortekët

Deri më tani nuk ka pasur raste të orteqeve që është rrezikuar popullata në komunën e Kaçanikut.

**Masat parandaluese**;

- Mbrojtja e zonave të banuara mund të jetë aktive dhe pasive
- Mbrojtja aktive përfshin nxitjen artificiale ( me anë të eksplozivëve)të ortekëve në shtresat e ulëta të dëborës.
- Mbrojtja pasive përfshin vendosjen e mureve (mureve nga betoni, gambionave, pyllëzimit etj.) në zonat e rrezikshme të cilat mund të ndryshojnë rrjedhjen e ortekut ose ta pengojnë atë.

### 6.10.4. Harta e rreziqeve




**Harta 40:** Sipërfaqet e rrezikuara nga Orteqet në Komunën e Kaçanikut

**Skenari – 1**

| Emri i skenarit: | Rreziku nga Ortekët |
|---|---|
| *Frekuenca e ndodhjes:* | |
| ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>☐E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>X ☐ Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| X ☐ E papërfillshme (më pak se 10%) ☐ E kufizuar( 10 deri 25%)<br>☐Kritike: 25 deri 50% . ☐ Katastrofike: Më shumë se 50% | |
| Lloji i skenarit: | |
| X ☐ **Skenari 1;** ☐ Skenari 2; ☐ Skenari 3; | |
| Ndikimi: | |
| ☐ I papërfillshëm; X ☐ I vogël ; ☐ I mesëm ; ☐ Katastrofike; | |
| Data e vlerësimit: | |
| **26/02/2023** | |

**Konteksti**

| Parametrat | Përmbajtja |
|---|---|
| **Vendi i ngjarjes (Lokacioni)** | Sipërfaqet e rrezikuara nga orteqet në komunën e Kaçanikut janë fshatrat; Sllatinë,Gajre, Ivajë Korbliq dhe në zonën e thellë malore saktësisht te Reka e Kafexhisë ku mund të rrezikohet burimi i ujit të pijes për komunën e Kaçanikut. |
| **Kushtet meteorologjike** | Për tri ditë rresht, nga :15.01.2023 deri më18.01.2023, në komunën e Kaçanik, ka pasur të reshura të borës me dendësi të madhe dhe erëra të forta.<br>Sipas analizave meteorologjike, reshjet e deritanishme maksimale të evidentuara janë të krahasueshme me ato të para 100 viteve më parë |
| **Periudha e vitit** | **15-18 Janar 2023** |
| **Lloji i ditës** | Ditë pue dhe vikendi |
| **Analiza meteorologjike për kohën** | Mundësia për të ndodhur orteqe në këtë vit kalendarik është e madhe në komunën e Kaçanikut. Për çdo 3 vite ka pasur reshje të mëdha të |

| | |
|---|---|
| | borës kurse nëse e marrim 100vjeçarin e fundit kemi pasur orteqe në disa lokacione të komunës së Kaçanikut.<br>Koha e paraqitjes së kësaj fatkeqësie është 18 janar 2023<br>Si pasojë e të reshurave të mëdha të borës, orteqet kanë rrezikuar disa burime të ujit në disa lokacione të komunës, më i rrezikuar ka qenë oda e ujëmbledhësit kryesorë i sistemit të ujësjellësit të qytetit te Reka e Kafexhisë në Lybeten.<br>Në datë 18 janar 2023 janë ndëprerë të reshurat e borës dhe është e ulur rreziku nga orteqet. |
| **Popullata** | Zona ku ka ndodhur orteku është e pa banuar. |
| **Infrastruktura kritike** | Dëmtime të vogla në odën e ujëmbledhësit te Reka e Kafexhisë. (Sasia e madhe e borës nga orteku mbi ujëmbledhësin) |
| **Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut)** | - Në pajtueshmëri të plotë me paralajmërimet e hershme nga IHMK për sasinë e reshjeve tëpandërprera të borës, QOE-112 ka lëshuar informacion urgjent sipas procedurave standarde operative për organnet kompetente në nivel lokal si akter për ndërmarrjen e masave për mbrojtje nga orteqet, duke ngritur nivelin e gadishmërisë së ekipeve të reagimit emergjent.<br>-Kryetari i komunës së Kaçanikut, urgjentisht duhet të ndërmerr masat dhe aktivitetet e nevojshme për sanimin e gjendjes nga orteqet sipas Planit të Reagimit Emergjent lokal, ndër të tjera, duke bërë edhe informimin publik, paralajmërimin e hershëm dhe alarmimin si dhe udhëzimet e nevojshme publike për ndërmarrjen e masave për mbrojtje nga orteqet..<br>-Masat parandaluese për mbrojtje nga orteqet nënkuptojnë të gjitha masat e nevojshme për zbutjen, zvogëlimin e rrezikut, duke filluar nga ato operacionale deri tek masat për sanimin e gjendjes.<br>-Mobilizimi i Ekipeve Reaguese Emergjente me të gjithë potencialin human dhe teknik duhet të jenë në gadishmëri të plotë për reagim në çdo kohë, duke u mbështetur edhe me resurse reaguese lokale, siq janë: Kryqi i Kuq Komunal(KKK), ERE të SMShN, Klubet e Alpinistëve, OJQ për mbrojtjen e ambientit, etj. |
| **Shkaku dhe shkaktari** | Pas reshjeve intensive të borës gjatë periudhës 15 -18 janar 2023 të cilat shkaktuan orteqe te Reka e Kafegjisë, janë aktivizuar institucionet lokale, u alarmuan dhe vepruan në bazë përgjegjësive ligjore për mbrojtje nga FNFT.<br>- Reshjet e borës, të cilat po vazhdojnë pa ndërpre, më shumë se 48h, duke përfshirë tërë territorin e komunës, me intensitet më të shprehurjanë në pjesën perëndimore të sajë, ku të reshurat dhe erërat e forta kanë shkaktuar orteqe .<br>-Rëndimit të situatës i kanë kontribuar edhe erërat e forta .<br>Gjendja më e rënduar paraqitet në Lybeten(Reka e Kafexhisë).<br>Pas ndërprerjes së të reshurave me 19 janar gjendja është stabilizuar. |
| **NGJARJA** | |
| **Kohëzgjatja e mundshme** | Kohëzgjatja e mundshme është 1 ditë |
| **Zona që ka gjasa të goditet më së shumti** | Zona perndimore e komunës së Kaçanikut, saktësishtë në Lybeten, te burimi i ujit (Reka e Kafexhisë) dhe fshatrat, Sllatinë, Gajre, Ivajë Korbliq. |

| | |
|---|---|
| **Ngjarja kryesore** | Me 18 janar 2023 nga reshjet e dendura të borës dhe erërave të forta orteku ka rrezikuar odën ujëmbledhëse të sistemit të ujësjellësit.<br>Janë ndërmarrë masat për zvogëlimin e rrezikut duke ndërtuar gabione, mure mbrojtëse dhe prita kundër orteqeve.;<br>Intervenimi për largimin e borës është zhvilluar nga KRU Bifurkacioni dhe kompanitë e kontraktuara nga Komuna për raste emergjente.<br>Për sanimin e gjendjes gjatë dhe pas ortekut janë angazhuar edhe mekanizma institucional dhe publik, siq janë: NjPZSh, Drejtoria komunale e Shërbimeve Publike dhe kompanitë e kontraktuara nga Komuna për raste emergjente etj. |
| **Pasojat primare dhe efektet anësore** | - Dëmtim i përkohshëm i nga orteku sipërfaqeve pyjore 3 ha;<br>- Dëmtim i Infrastrukturës kritike( oda e ujëmbledhësit,); |
| **Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti** | Paraqitja e rrëshqitjes së dheut/orteku 3 ha;<br>Pasojat nga orteku në ambient; |
| **Ndikimi- Indikatorët tregues** | |
| **Rastet me fatalitet** | Nuk ka persona me fatalitet |
| **Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar** | Nuk ka persona të lënduar dhe të rrezikuar |
| **Mungesë e nevojave elementare** | Mungesë e përkohshme e ujit tëpijshëm |
| **Ndikimi i përgjithshëm ekonomik** | -Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë kritike (ujësjellës dhe , KRU), të përllogaritura në Euro: 11,000.00€;<br>- Dëmtimi i gypit tëujësjellësit Ø200 me gjatësi 30m –1,200.00€;<br>- Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura është: 12,200.00€; |
| **Implikime politike** | - Nuk ka |
| **Ndikimii përgjithshëm** | Rrezik i vogël |
| **Koordinimi** | -Instituti meteorologjik i Kosovës dërgon njoftimin mbi parashikimin e motit në QOE -112 të AME-së për reshjet e dendura komplekse dhe të pafavorshme për ditët në vijim, sipas PSO njoftohen organet kompetente dhe administrative shtetërore, organet vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe strukturat për M&Sh për menaxhimin e situatës së pritshme emergjente, bazuar në PRE;<br>Duhet të bëhet aktivizimi i Komisionit lokal për mbledhjen e të dhënave mbi vlerësimin e dëmeve në terren të shkaktuara nga fatkeqësia /orteku, të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar; |
| **Probabiliteti** | Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësor, dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të vogël të mundshëm. |

| Probabiliteti / frekuenca | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kategorizimi** | **Cilësia** | **Probabiliteti/gjasat** | **Frekuenca** | **Përcaktimi** |
| 1 | E papërfillshme/ E pa mundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | **X** |
| 2 | E vogël/ E pa besueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në 20 deri 100 vjet | |
| 3 | Mesatare/ E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në 2 deri 20 vjet | |
| 4 | **E madhe / Gati e mundur** | **51-98 %** | **1 ngjarje në 1 deri 2 vjet** | |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe / E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

## Vlerësimi i pasojës:

**Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut**

-Të dhënat për dëmet nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, nga orteku përllogariten si të vogla-minimale.

- Kërcënim të drejtpërdrejtë nga orteku nuk ka pasur, vlerësohet se standardi jetësor në zonën nuk është prekur.

*Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut*

| Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi:* | *Pasojat:* | *Kriteret:* | *I përcaktuar:* |
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | **X** |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | |
| 4 | Kritike | 501-1500 | |
| 5 | **Katastrofike** | **> 500** | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

| Pasojat ekonomike | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | **X** |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike***

| *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social- infrastruktura kritike* | | | |
|---|---|---|---|
| ***Kategorizimi*** | ***Pasojat*** | ***Kriteret*** | ***Përcaktimi*** |
| **1** | Të papërfillshme | < 1% GDP | **X** |
| **2** | Të vogla | 1 - 3% GDP | |
| **3** | Mesatare | 5 - 10% GDP | |
| **4** | Kritike | 5 - 10% GDP | |
| **5** | Katastrofike | >10% GDP | |

**Matrica 1**: *Rreziku për* ***jetën dhe shëndetin e njeriut:***



**Matrica 2:** ***Rreziku për pasojat në ekonomi:***




**Matrica 3:** ***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:***



## 6.11. ERËRAT E FUQISHME DHE STUHITË

### 6.11.1. Karakteristikat e terenit dhe zonat potenciale



Erërat me drejtimin e lëvizjes dhe shpejtësinë e tyre janë faktor i rëndësishëm në formimin e kushteve të jetës. Erërat e thata dhe të ngrohta ndikojnë në rritjen e avullimit dhe humbjen e lagështisë nga toka dhe bimët.

Erërat në komunën e Kaçanikut janë kryesisht në drejtim veri - perendimore (NW) dhe Jug-lindore (SE). Shpejtësia maximale e erërave për këtë lokalitet janë të drejtimit jug-lindore (SE).

Më së tepërmi paraqiten në periudhën pranverore (mars-prill)dhe në vjeshtë- dimër sidomos në muajin nëntor– janar.

**Foto 36:** Dëmet e shkaktuara nga stuhia në shkollën fillore ”Nazmi Osmani” në fshatin Elezaj

Në teritorin tonë erërat më tepër janë të kushtëzuara nga konfiguracioni i relievit, gjegjësisht afërsia e masive malore (malet e Sharrit dhe Karadakut) e përbërë prej Grykës sës Kaçanikut (grykës së lumit Lepenc).
Gjatë stuhisë së erërave të forta është shkatërruar tërësisht kulmi i shkollës fillore "Nazmi Osmani "

### 6.11.2. Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve

Erërat e forta dhe tufanët me përmasa shkatërruese në territorin tonë janë dukuri e rrallë,
Ndikimi i stuhive dhe goditjeve tjera të ajrit rrezikon më tepër territoret e hapura; (Fusha e Pajtimit) ku shpejtësia e erës mund të arrijë mbi 100 km/ore me ç‘rast janë të paevitueshme shkaktimi i dëmeve të kësaj natyre.
Erërat dhe stuhitë përfshijnë gjithë territorin duke rrezikuar të gjithë banorët e Komunës së Kaçanikut veçanërisht fshatrat Dubravë, Elezaj, Sllatinë dhe Kaçanik i Vjetër.

### 6.11.3. Treguesit statistikor të pasojave nga erërat e fuqishme dhe stuhitë

Viteve të fundit nga stuhitë e mëdha, është bërë dëmtimi e shtyllave elektrike dhe rrjetit të saj, shembja e pullazeve, dëmtimi i shtëpive nga materiali i dobët si dhe fluturimi i gjësendeve të forta e metalike të pa përforcuara, të cilat mund të rrezikojnë jetën e qytetareve dhe kalimtarëve të rastit etj. Stuhitë, përveç pasojave të cekura më lartë mund të shkaktojnë edhe dëme të intensiteteve të ndryshme në bujqësi.
Dëme nga stuhia dhe erërat ka pasur në fshatin Dubravë dhe Elezaj me datën 23.10.2015 ndërsa me datën 17.01.2023 po ashtu në fshatin Dubravë janë shkaktuar dëme të mëdha në kulmin e shkollës fillore”Kadri Zeka”
Gjatë stuhisë së erërave të forta është shkatërruar tërësisht kulmi i shkollës fillore "Nazmi Osmani "

Sipas historikut dëmet më të mëdha nga erërat dhe stuhitë janë paraqitur në fshatrat; Dubravë, Vatë, Elezaj, Sllatinë dhe në Kaçanik të Vjetër.



**Foto 37:** Dëmet nga stuhia dhe erërat në fshatin Dubravë 23.10.2015




**Grafiku :** Trandafili i erës

Me së shumti fryejnë erërat veriperëndimore, juglindore dhe ato veriore. Në grafikon drejtimet janë të shprehura në promil në mënyre që të eliminohet numri jo i njëjte i ditëve gjatë muajve. Ditët e qeta pa erë janë 120 ‰ që nuk janë futur në grafikon ngase çrregullojnë anët kryesore të botës.




**Grafiku:** Shpejtësia e erës

Shpejtësi me të madhe mesatare kanë erërat juglindore me 4 m/s dhe jugore me 3 m/s. Shpejtësinë më të ultë e kanë erërat verilindore. Shpejtësia maksimale është te erërat juglindore deri 22,6 m/s, juglindore 18,6 m/s. Në viset e larta që janë të ekspozuara shpejtësia e erës duhet të jetë me e madhe sidomos në rrëzat e Sharrit.

Efektet e stuhive dhe erërave janë të shumta siç janë:

- Dëmtimi dhe rrëzimi i pullazeve,
- Shkulja e drunjëve-pemëve,
- Shkatërrimi i rrjetit elektrik dhe të telefonisë,
- Zhvendosja/hedhja e objekteve të ndryshme (kontejnerë, serra, shkulja e drunjëve, etj),
- Çrregullimi i transportit (ajror, hekurudhor dhe rrugor),
- Vërshime dhe ndotje e ujërave sipërfaqësore si dhe nëntokësore

**Pasojat**

- Vdekje dhe lëndime nga goditjet,(objektet e ndryshme, kabllot dhe shtyllat elektrike, rënia e objekteve nga lartësitë),
- Aksidente të komunikacionit,
- Zvogëlim dhe ndërprerje e aktiviteteve socio-ekonomike,
- Përmbytje,
- Dëmtim dhe shkatërrimi i kulturave bujqësore, drunjëve dekorativ, etj.

**Masat parandaluese;**

Institucionet gjegjëse Komunale duhet të ndajnë një pjesë të konsiderueshme të mjeteve në ndërmmarrjen e masave parandaluese si:

- Koncentrimi i dioksid karbonit në atmosferë,
- menaxhimi i qendrueshëm i tokës bujqësore,
- adaptimi ndaj ndikimeve të parashikuara të ndryshimeve klimatike,
- menaxhimi i duhur i mbetjeve,
- rigjenerimi i pyjeve

Të gjitha këto masa kontribuojnë në uljen e ndotjes së lartë të ajrit dhe në uljen e emisioneve të gazrave serë në vend, dhe përmasimin e klimës për të minimizuar pasojat që vijnë nga fatkeqësitë natyrore.

**Harta e rreziqeve**;




**Harta 41:** Drejtimi i erërave (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)

## 6.12. THATËSIRAT

### 6.12.1. Treguesit statistikor për mungesën e theksuar e të reshurave atmosferike

Ky fenomen ndodh kur reshjet e dimrit janë jashtëzakonisht të dobëta, kur burimet nëntokësore të ujit janë të pakta, rezervarët sipërfaqësorë janë po ashtu nën nivelin e tyre minimal të mbushjes.
Furnizimi i popullatës me ujë bëhet nga burimet të cilët varen nga reshjet atmosferike.
Gjatë sezonës verore temperaturat e larta çrregullojë në masë të madhe komoditetin e jetës normale në komunën e Kaçanikut, e në veçanti pjesën urbane.
Në muajin mars 2014 komunën e Kaçanikut e ka përfshirë, moti i thatë i pazakonshëm në këtë kohë dimri, që ka ulur shumë nivelin e ujit të pijshëm në rezervarët prej nga furnizohet qyteti me rrethinë. Aktualisht mbi 13000 mijë qytetarë po përballen me shkurtime të furnizimit me ujë, ndërsa autoritetet kanë shfrytëzuar burimet alternative për furnizim me ujë e njëkohësisht po u bëjnë thirrje qytetarëve për kursim të ujit.
Në fund të muajit gusht 2022 dhe muaji Korrik -Gusht 2024 Komuna e Kaçanikut është përballur me thatësira si pasojë e mungesës së reshjeve të shiut, por edhe e valëve të nxehtit.

### 6.12.2. Dëmet dhe pasojat

Temperaturat e larta dhe thatësirat, që kanë përfshirë komunën e Kaçanikut në muajin korrik dhe gusht të vitit 2022, 2024 kanë shkaktuar dëme të mëdha në rendimentet e kulturave bujqësore. Ndikim negativ më tepër presim te ato kultura bujqësore që janë duke u kultivuar dhe nuk janë në sistemin e ujitjes. Ndikimi i temperaturave të larta në përgjithësi, redukton prodhimin bujqësor, në veçanti kulturat pranverore, siç është misri, kultura të cilat domosdoshmërish gjatë korrikut dhe gushtit kërkojnë ujitje.



**Foto**: Liqeni i tharë në Kotlinë 20.11.2024

“Thatësira është armiku numër një i reduktimit të prodhimit bujqësor dhe kjo u manifestua pjesërisht edhe te kulturat e grurit, ku u paraqit vala e të nxehtit, e cila në masë diku prej 20 deri në 30 për qind reduktoi prodhimin e grurit, dukuri kjo që u manifestua edhe në prodhimin përfundimtar të kësaj kulture” dëme poashtu ka pasur edhe në pemë, perime dhe kultura tjera bujqësore.
Sipas të dhënave të Institutit Hidrometeorologjik, temperaturat në komunën e Kaçanikut kanë arritur deri në 39°C.




**Foto 38:** Pasojat nga thatësirat

### 6.12.3. Pasqyra e vendbanimeve/zonave të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve

Tereni dhe konfiguracioni i terrenit në komunën e Kaçanikut mundëson që shumica e fshatrave të komunës sonë të furnizohen me ujë nga burimet alternative që gjenden në masivin e malit Sharr. Vendbanimet më të rrezikuara janë pjesët fushore pasi që gjatë sezonit veror ka pak të reshura atmosferike dhe ka mungesë të ujit si në pellgun e lumit Lepenc e poashtu edhe në rrjedhat tjera ujore. Fshatrat më të rrezikuara nga thatësirat janë: Begraca, Koxhaj, Kaçanik i Vjetër, Duraj dhe Glloboçicë me 6.365 banorë.

### 6.12.4.. Rezervat ujore ( mbitokësore dhe nëntokësore)

Territori i komunës së Kaçanikut ka rrjet hidrografik i cili i drenon ujërat në pjesën më të madhe në drejtim të pellgut të Detit Egje dhe një pjesë më e vogël në drejtim te Detit të Zi. Nëpër këtë komunë kalon lumi Lepenc i rëndësishëm jo vetëm për Komunën e Kaçanikut por për tërë Kosovën. buron në shpatiet veriore të malit Sharr te Oshlaku me lartësi mbidetare 2212m.
Në territorin e komunës së Kaçanikut lumi Lepenc ka gjatësi rreth 18 km, hynë në fshatin Bajnicë (610 m lartësi mbidetare) dhe rrjedh në drejtim lindje-perëndim. Në fshatin Soponicë merr drejtim jugor dhe e lëshon territorin komunal në fshatin Gjurgjedell (710 m lartësi mbidetare).
Ky lum vetëm me një sektor i takon kësaj komune pjesa tjetër më e madhe rrjedh nëpër komunat dhe shtetet fqinje. Në komunë Lepenci ka rënie të tërësishme 214m ose rënje mesatare 11,8m/km.
Gjerësia e lumit sillet 11m deri 20m me thellësi mesatare 40cm deri 60 cm, maksimale sillet rreth 2m.

Prurja mesatare e ujit të Lepencit sillet rreth 10,1 m3/s në Hani i Elezit që paraqet diku 8,2% të ujërave të Kosovës.
Me rëndësi është se lumi i Lepencit për shkak të burimit në lartësitë e mëdha mbidetare që mbulohen me borë i sigurojnë ushqim stabil me ujë. Bora qëndron deri në fillim të qershorit. Ushqimi i tij është nivalo-pluvial (bora dhe shiu).
Niveli maksimal i prurjeve është në muajin maj atëherë kur procesi i shkrirjes së borës është më intensiv. Niveli më i ulët është në muajin gusht dhe shtator (3,26 m3), ndërsa nga muaji tetor fillon ngritja e nivelit deri në muajin mars që paraqet maksimumin e dytë.
Lepencit i bashkangjiten edhe shumë degë tjera të shkurta që rrjedhin nga shpatiet e maleve. Degë e rëndësishme është lumi i Kotlinës që buron afër majës së Lypetenit. Dega më e rëndësishme e lumit Lepenc është Nerodimja e cila buron nga malet me këtë emër dhe në qytetin e Kaçanikut bashkohen. Nerodimja ka gjatësi 8,5 km në territorin komunal me rënie të tërësishme 53m dhe rënje mesatare 6,2 m/km që është dukshëm më e ulët se e lumit Lepenc.
Nga komuna e Kaçanikut e ka burimin lumi i Moravës së Binçës përkatësisht lumi i Korbliqit i cili derdhet në Detin e Zi. Ky lum dhe vendbanim kanë pozitë periferike ndaj qendrës komunale dhe lidhje të kufizuar, gjatësia e tij është 6,5 km që buron nga malet e Karadakut. Sipërfaqja e pellgut të këtij lumi që i takon kësaj komune përfshinë 20 km2. Është i gjerë 4-5m në kushte normale thellësi 20 deri 30 cm dhe sasia e ujit nuk i kalon 200 l/s.
Shtrirja e lumenjëve në raport me territorin komunal konsiderohet e mirë ngase e përshkojnë pothuajse në mes territorin, përveç lumit të Korbliqit. Degët tjera për shkak të relievit të theksuar kanë rrjedhje të shpejtë dhe shumica janë rrjedhje të përkohshme.

Ujërat nëntokësorë kanë përhapje të kufizuar. Nga analiza e hartës hidrogjeologjike shihet se ka ujëra nëntokësorë rreth aluvioneve lumore si është Lepenci dhe lumi Nerodime. Diçka me të theksuara janë sedimentet ujëlëshues në hapësirën e Kaçanikut të Vjetër, Koxhaj Doganaj, Elezaj. Ekzistojnë burime që kanë prurje të vogla siq është “Kroni i Bardhë” me sasi uji 20-40 l/s por është kaptuar dhe përdoret për furnizim me ujë për qytetin e Kaçanikut. Burimet tjera janë edhe më të vogla por ka mjaftë për shkak sasisë së reshjeve dhe terrenit malor.

**Masat parandaluese;**

Të bëhet kujdes me burime ujore, me rezervarët, bazenet e ndryshme ujore, liqenet dhe sidomos me ujin e pijshëm. Për çdo rast të ketë kontroll të shtuar nga organet përgjegjëse për konsumin e ujit në përshtatje me nevojat e komunitetit dhe të fermerëve për problemet e bujqësisë.

Të bëhet zgjerimi i rrjetit të ujitjes së tokave bujqësore nga institucionet kompetente, ose krijimi i një pende në pjesën e përshtatshme të komunës së Kaçanikut, i cili pastaj do ta mundësojë zbutjen e problemeve që shkaktohen nga thatësirat e tokave bujqësore.

**Harta e rreziqeve**




**Harta 42 :** Zonat e rrezikuara nga thatësirat

**Skenari -1**

| Emri i skenarit: | **Rreziku nga Thatësirat** |
|---|---|
| *Frekuenca e ndodhjes:* | |
| ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>**X** E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>☐ Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| ☐ E papërfillshme (më pak se 10%) **X**☐ E kufizuar( 10 deri 25%)<br>☐Kritike: 25 deri 50% . ☐ Katastrofike: Më shumë se 50% | |
| Lloji i skenarit: | |
| **X ☐ Skenari 1;** ☐ Skenari 2; ☐ Skenari 3; | |
| Ndikimi: | |
| ☐ I papërfillshëm; **X** ☐ I vogël ; ☐ I mesëm ; ☐ Katastrofike; | |
| Data e vlerësimit: | |
| **26/08/2022** | |

**Konteksti**

| Parametrat | Përmbajtja |
|---|---|
| **Vendi i ngjarjes (Lokacioni)** | Hapësirat e ekspozuara nga thatësirat në komunën e Kaçanikut kapin sipërfaqe prej 2460 /ha. Shtrirje më të madhe ka në lokalitetet, Begracë, Koxhaj, Duraj, Elezaj, Stagovë dhe Glloboçicë.<br><br><br>Zonat e rrezikuara nga thatësirat |
| **Kushtet meteorologjike** | Për tri ditë rresht, nga: 21.07.2022, në komunën e Kaçanik, ka pasur temperatura të larta.<br>Sipas analizave meteorologjike, temperaturat e larta dhe mungesa e reshjeve të deritanishme janë të krahasueshme me ato të para 10 viteve më parë. |
| **Periudha e vitit** | **21-24 Korrik 2022** |
| **Lloji i ditës** | Ditë pune |
| **Analiza meteorologjike për kohën** | Mundësia për thatësira në këtë vit kalendarik është e madhe në komunën e Kaçanikut. Për çdo 3 vite ka pasur thatësira kurse nëse e marrim 10 vjeçarin e fundit kemi pasur 3 apo 4 thatësira në zona të ndryshme të komunës së Kaçanikut, që dmth. se për çdo të tretin vit kemi pasur kërcënime nga thatësirat. Vitet që kanë ndodhur thatësira me temperatura të larta janë: viti 2008,2011,2016, 2018,2022, 2024.<br>Koha e paraqitjes së kësaj fatkeqësie është 23 Korrik 2022<br>Si pasojë e temperaturave të larta dhe mungesës së të reshurave atmosferike, thatësira ka shkaktuar dëme në bujqësi sidomos në fshatin Begracë dhe Kaçanik të Vjetër. Në datë 24 korrik 2022 janë ulur temperaturat dhe kanë filluar të reshurat e shiut. |
| **Sipërfaqet e prekura nga thatësirat** | Zona ku janë më të theksuara thatësirat është tokë bujqësore dhe banorët kryesishtë mirren me bujqësi dhe blektori.<br>Sipërfaqet e prekura nga thatësirat janë 93ha ,<br>Grurë- 80ha<br>Misër – 8ha<br>Perime - 2 ha<br>Pemë- 3ha |

| | |
|---|---|
| **Infrastruktura kritike egzistuese** | Në zonën e përfshirë nga thatësirat ka pasur infrastrukturë e cila ka pasur pasoja të vogla – minimale.<br>- Mungesa e ujitjes së tokave bujqësore,<br>- Reduktimi i prodhimit të grurit,<br>- Mungesa e ujit të pijes për këto banorë<br>- Mungesa e burimeve ujore në rezervoare, bazene dhe liqej. |
| **Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut)** | - Në pajtueshmëri të plotë me paralajmërimet e hershme nga IHMK për temperaturat e larta, QOER-112 ka lëshuar informacion urgjent sipas procedurave standarde operative për organnet kompetente, në nivel lokal si akter për ndërmarrjen e masave për mbrojtje nga temperaturat e larta, duke ngritur nivelin e gadishmërisë së Ekipeve të reagimit emergjent.<br>-Kryetari i komunës së Kaçanikut, urgjentisht duhet të ndërmerr masat dhe aktivitetet e nevojshme për sanimin e gjendjes nga thatësirat sipas Planit të Reagimit Emergjent lokal, ndër të tjera, duke bërë edhe informimin publik, paralajmërimin e hershëm dhe alarmimin si dhe udhëzimet e nevojshme publike për ndërmarrjen e masave për mbrojtje nga temperaturat e larta – thatësirat.<br>-Masat parandaluese për mbrojtje nga thatësirat nënkuptojnë të gjitha masat e nevojshme për zbutjen, zvogëlimin e rrezikut, duke filluar nga ato operacionale deri tek masat për sanimin e gjendjes.<br>-Mobilizimi i Ekipeve Reaguese Emergjente me të gjithë potencialin human dhe teknik duhet të jenë në gadishmëri të plotë për reagim në çdo kohë, duke u mbështetur edhe me resurse reaguese lokale, siq janë: ERE të SMShN, , OJQ për mbrojtjen e ambientit, etj. |
| **Shkaku dhe shkaktari** | Pas temperaturave të larta gjate periudhes 21 -24 korrik 2022 te cilat shkaktuan thatësira në disa zona të territorit të komunës, në këtë rast u aktivizuan institucionet lokale, u alarmuan dhe vepruan në bazë përgjegjësive ligjore për mbrojtje nga FNFT.<br>- Temperaturat e larta, të cilat po vazhdojnë, më shumë se 48h, duke përfshirë tërë territorin e komunës, me intensitet më të shprehur në pjesën perëndimore të sajë, ku gjatë kësaj kohe, duke shkaktuar thatësira, nëpër disa zona të komunës, si pasojë e ngritjes së temperaturave.<br>Gjendja më e rënduar paraqitet në fshatrat, Begracë, Kaçanik i Vjetër, dhe Glloboçicë. |
| **NGJARJA** | |
| **Kohëzgjatja e mundshme** | Kohëzgjatja e mundshme është 3 ditë |
| **Zona që ka gjasa të goditet më së shumti** | Zona perndimore e komunës së Kaçanikut, saktësishtënë në fshatrat, Glloboçicë, Koxhaj, Duraj dhe në pjesën lindore fshatrat, Kaçanik i Vjetër, Begracë. |
| **Ngjarja kryesore** | Me 23 korrik 2022 nga temperaturat e larta, të cilat po vazhdojnë kanë rrezikuar sipërfaqet e mbjellura me kultura bujqësore afër 93 ha, duke rrezikuar edhe furnizimi me ujë banorët e këtyre lokaliteteve.<br>Janë ndërmarrë masat për zvogëlimin e rrezikut duke furnizuar banorët me ujë të pijshëm, dhe masat prentive për mbrojtje nga zjarri .<br>Për sanimin e gjendjes gjatë dhe pas temperaturave të larta janë angazhuar edhe mekanizma institucional dhe publik, siq janë: NjPZSh, |

| | |
|---|---|
| | Drejtoria komunale e Shërbimeve Publike dhe kompanitë e kontraktuara nga komuna për raste emergjente etj. |
| **Pasojat primare dhe efektet anësore** | - Sipërfaqe e tokave bujqësore (kulturave bujqësore të dëmtuara), 9ha<br>- Dëmtimi i bizneseve, |
| **Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti** | - Paraqitja e thatësirave në sipërfaqeprej 93ha;<br>-Mungesë e ujit të pijes si pasojë e temperaturave të larta në fshatin Begracë dhe Kaçanik të Vjetër, Koxhaj dhe Duraj;<br>- Mungesë e ushqimit për kafshë,<br>- Kërcënimi për mundësinë e çfaqjes së ndonjë epidemije( si pasojë e mungesës së ujit)<br>- Pasojat e thatësirave në ambient dhe tokë pjellore; |
| **Ndikimi- Indikatorët tregues** | |
| **Rastet me fatalitet** | Nuk ka persona me fatalitet |
| **Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar** | -Bazuar në të dhënat e komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve si pasojë e thatësirave të 23 korrikut 2022 nuk ka pasur të lënduar, por mungesa e ujit, mund të paraqet rrezikpër shpërthimin e ndonjë sëmundje epidemiologjike. |
| **Mungesë e nevojave elementare** | -Si pasojë e thatësirave kemi dëmtime të kulturave bujqësore<br>-Mungesë e ujit të pijshëm |
| **Ndikimi i përgjithshëm ekonomik** | -Dëmet e shkaktuara sipas kulturave bujqësore të përllogaritura në Euro:<br>-Dëmet e sipërfaqeve të mbjellura me grurë - 80ha =24,000.00€<br>-Dëmet e sipërfaqeve të mbjellura me misër - 8ha = 5.120.00€<br>-Dëmet e sipërfaqeve të mbjellura me perime - 2 ha=16,516.80€<br>-Dëmet e sipërfaqeve të mbjellura me pemë - 3ha = 8,000.00€<br>- Vlera e përafërt e dëmeve të përllogaritura është**: 53,636.80€;** |
| **Implikime politike** | - Nuk ka |
| **Koordinimi** | -Instituti meteorologjik i Kosovës dërgon njoftimin mbi parashikimin e motit në QOE -112 të AME-së për temperaturat e larta për ditët në vijim, sipas PSO njoftohen organet kompetente, vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe strukturat për M&Sh për menaxhimin e situatës së pritshme emergjente, bazuar në PRE;<br>Duhet të bëhet aktivizimi i Komisionit lokal për mbledhjen e të dhënave mbi vlerësimin e dëmeve në terren të shkaktuara nga fatkeqësia /thatësirat, të përcaktojë gjendjen aktuale faktike në terren, duke bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportimin në komisionin qeveritar; |
| **Probabiliteti** | Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësor, dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të vogël të mundshëm. |

| Probabiliteti / frekuenca | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kategorizimi** | **Cilësia** | **Probabiliteti/gjasat** | **Frekuenca** | **Përcaktimi** |
| 1 | E papërfillshme/<br>E pa mundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | |
| 2 | E vogël/<br>E pa besueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në<br>20 deri 100 vjet | X |
| 3 | Mesatare/<br>E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në<br>2 deri 20 vjet | |
| 4 | **E madhe /<br>Gati e mundur** | **51-98 %** | **1 ngjarje në<br>1 deri 2 vjet** | |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe /<br>E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

## Vlerësimi i pasojës:

**Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut**
-Të dhënat për dëmet nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, nga thatësirat përllogariten si të vogla-minimale.

*Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut*

| Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi:* | *Pasojat:* | *Kriteret:* | *I përcaktuar:* |
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | X |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | |
| 4 | Kritike | 501-1500 | |
| 5 | **Katastrofike** | **> 500** | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**
- Dëmet materiale të vogla minimale

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

| Pasojat ekonomike | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | X |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike***

*Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social- infrastruktura kritike*

| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
|---|---|---|---|
| 1 | Të papërfillshme | < 1% GDP | |
| 2 | Të vogla | 1 - 3% GDP | X |
| 3 | Mesatare | 5 - 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 5 - 10% GDP | |
| 5 | Katastrofike | >10% GDP | |

**Matrica 1**: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*



**Matrica 2:** ***Rreziku për pasojat në ekonomi:***




**Matrica 3:** ***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:***



## 6.13. RREZIQET NGA EPIDEMITË DHE PANDEMITË

### 6.13.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonat potenciale

Rrezikun e mundshëm që bazohet në vlerësimin e shërbimeve kompetente të shëndetësisë sanitare, veterinare, agronomike dhe shërbimeve tjera si dhe institucioneve të cilat në sistemin unik për mbrojtje dhe shpëtim paraqesin bartësit themelor të cilët në kuadër të veprimtarive të rregullta duhet të reagojnë në rastet e rrezikshmërisë epidemiologjike dhe sanitare.[10]

Zonat më të rrezikuara janë fshatrat pran lumenjve si: fshati Doganaj, Soponicë, Trimorë, Kaçanik i Vjetër, Stagovë, Runjevë dhe qendra e qytetit.

### 6.13.2. Pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve

Në komunën e Kaçanikut si vatër aktive e mundshme e etheve hemoragjike ka qenë fshati Doganaj, i cili ka qenë nën mbikëqyrje të stafit mjekësorë. Vlen të theksohet se dezinfektimi dhe deratizimi është kryer në të gjitha shkollat e komunës së Kaçanikut.

Në laboratorin e mikrobiologjisë pranë DSHPA – Ferizaj, bëhet analiza bakteriologjike e ujit të pijshëm, mostrat e ujit merren në mënyrë të rregullt nga ekipa profesionale e përbërë nga specialisti i ekologjisë humane, kimisti sanitar dhe teknikët e trajnuar për marrje të mostrës së ujit.

Vërshimet te një pjesë e territorit shkakton ndotjen e objekteve individuale për furnizim me ujë(bunarët dhe burimet) me ç'rast për pasoj ka sëmundjet e zorrëve me mundësi të përhapjes në formë epidemike.

### 6.13.3.Shkaktarët e paraqitjes së epidemisë, endemisë dhe pandemisë

Kushtet e nevojshme për shfaqjen dhe zhvillimin e sëmundjes ngjitëse – infektimit janë:

1. Njerëzit e sëmurë, kafshët, bartësit e bakterieve dhe viruseve, si dhe kufomat e njerëzve dhe të kafshëve.
2. Rrugët e bartjes: janë mënyrat e bartjes së agjensëve biologjik, prej burimit të infektimit, deri në organizmin pranues. Të shumtën janë personat e infektuar, uji, ajri, ushqimi, toka, si dhe faktorë të tjerë, si brejtësi dhe insektet.
3. Dyert e hyrjes janë: lëkura, mykoza, organet e frymarrjes dhe organet e tretjes.
4. Numri dhe virulentshmërija: është aftësija e bakterjeve dhe virusëve për të depërtuar në organizëm, të i përshtaten ambientit të ri, të fillojnë të shmëzohen dhe të shkaktojnë sëmundjen ngjitëse. Pas virulentshmërisë edhe numri i bakterieve dhe virusëve luan rol të caktuar në mekanizmin e lindjes së sëmundjes ngjitëse.
5. Dispozita dhe imuniteti: Dispozita është prirja e organizmit për ndonjë infektim. Në këtë ndikojnë: vjetërsija , gjinia, profesioni, kushtet sociale-ekonomike, kondicioni fizik, stina dhe kushtet tjera jetësore. Imuniteti është rezistenca e organizmit ndaj sëmundjes së caktuar ngjitëse.
    - Sëmundjet infektuese shfaqen në formë:
      endemije: përfshinë një lokalitet të caktuar, epidemia: përhapja e shpejtë e infektimit të popullatës në një zonë të caktuar dhe
    - Pandemia; kur popullatën e një ose më shumë kontinenteve e pëfshinë smundja ngjitëse. Shembull tipik të pandemisë kemi në dhetëvjeçarin e këtij mileniumi "Gripin e Shpezëve" Gripin e Derrave" dhe CVID19.

[10] Udhëzim Administrative Nr.19/2008- Neni 12 - 1.5.rreziku epidemiologjik dhe sanitarë

### 6.13.4. Sëmundjet ngjitëse

Sëmundjet ngjitëse në komunën e Kaçanikut vazhdimisht sillen në formë endemiko – epidemike, të cilat kërkojnë një sistem funksional për identifikimin e zonave të prioritetit për strategji efektive të kontrollit të DSHPA (Dapartamenti për Shëbime Publike dhe Ambient).

Numri më i madh i rasteve është si diare acute kurse më i i vogël është paraqitja e sëmundjeve Pneumonite dhe Varicella.

| Sëmundjet ngjitëse | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Komuna Kaçanik** | Pneomonia &ARI | SARI | Influenca sezonale | Diarea Akute | Variçela | Gjithsej |
| | 23 | 1 | 1284 | 1473 | 99 | 2880 |

**Tabela 94 :** Rastet e sëmundjeve ngjitëse në komunën e Kaçanikut -2022

*Burimi : ASK " Statistikat e Shëndetësisë 2022"*

| Komuna | Numri i pacientëve 2015 | Nr. Pacientëve 2016 | Nr. Pacientëve 2017 | Nr. Pacientëve 2018 | Nr. Pacientëve 2019 | Nr. Pacientëve 2020 | Nr. Pacientëve 2021 | Nr. Pacientëve 2022 | Nr. Pacientëve 2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kaaçanik** | 19 | 18 | 14 | 14 | 10 | 10 | 10 | 13 | 13 |

**Tabela 95:** Rastet me TBC sipas viteve në komunën e Kaçanikut

| Komuna | Pneomonia & ARI | SARI | ILI | Diarea akute | Variçela | Gjithësej |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kaçanik** | 60 | 3 | 2783 | 1035 | 133 | 4014 |

**Tabela 96:** Rastet e sëmundjeve ngjitëse në komunën e Kaçanikut

*Burimi : ASK " Statistikat e Shëndetësisë 2023"*

Sëmundjet infektive që prekin çdo vit një numër të popullatës, janë: **ethet hemoragjike, taularemia, tuberkulozi, gripet sezonale, fruthi, hepatiti B dhe C**.

Sëmundjet ngjitëse përcillen me shkallë të konsiderueshme të vdekshmërisë.

### 6.13.5. Pasojat nga epidemitë dhe pandemitë

Sëmundjet infektive apo ngjitëse përbëjnë shakun kryesor të sëmundjeve dhe vdekshmërisë së popullatës në rang botëror. Këto sëmundjet mund të kenë pasoja të rënda për shëndetin dhe jetën e personit apo popullatës së prekur. Për shkak të mundësisë së përhapjes së shpejtë në një komunitet apo popullatë, këto sëmundje paraqesin rrezik për shpërthime epidemish me pasoja të rënda. Sëmundjet ngjitëse mund të jenë vdekjeprurëse siç janë: infeksioni HIV/AIDS, tërbimi, ethet e verdha, ethet hemoragjike, botulizmi, tërbimi me pasoja mjaft të rënda edhe fatale siç janë: infeksioni i trurit apo cipave të trurit (encefaliti dhe meningiti), infeksioni i valvulave të zemrës, helmimet e rënda ushqimore, hepatiti (verdhëza) e rëndë që çon në vdekje apo në cirozë dhe kancer të mëlqisë etj.

Në pranverën e vitit 2020, vlerësoi se deri në 1,000 njerëz në Komunën e Kaçanikut ranë në varfëri për shkak të pandemisë COVID-19. Vlerësimet e shpejta të ndikimit social të shpërthimit të epidemisë së COVID-19 në komunën e Kaçanikut, të kryera në 2020 dhe 2021, tregojnë se ka pasur një rritje të varfërisë në komunën tonë gjatë pandemisë.

Pothuajse gjysma e të gjithë banorëve kanë parë një rënie të të ardhurave në gjashtë muajt e fundit krahasuar me situatën para epidemisë së COVID-19.
Një e treta thonë se të ardhurat e tyre kanë rënë me 30% ose më shumë. Më të prekurit janë fëmijët më të cenueshëm, si ata që kanë jetuar tashmë në varfëri para pandemisë fëmijët me aftësi të kufizuara, si dhe fëmijët që rriten në familje me një prind.
Arsimi është një tjetër sektor ku pandemia ka shkaktuar probleme.
Pasojat e paraqitura gjatë pandemisë COVID-19 në komunën e Kaçanikut janë;
-Ndërprerja e orëve të mësimit,
-mbyllja e shkollave
-Pandemia ka reduktuar ndjeshëm mundësitë që fëmijët të përfshihen në aktivitete jashtëshkollore, si sporti dhe kultura
-Më shumë kohë e kaluar në internet etj.

### 6.13.6. Epidemitë dhe pandemitë e bazuara në vlerësimet dhe analizat e shërbimeve kompetente

**Epidemia: Vetëm në një rajon**
Për një epidemi flitet atëherë, kur një sëmundje shfaqet në mënyrë të pazakontë e shpeshtuar në një rajon në një kohë të caktuar. <u>**Kurse pandemia është një epidemi që kapërcen kufijtë e një vendi apo edhe një kontinenti.**</u> Kjo do të thotë para së gjithash, që kontrolli i suksesshëm i sëmundjes varet nga bashkëpunimi i sistemeve shëndetësore të vendeve të ndryshme. E kundërta gjeografike e një pandemie është endemia.
Nëse numri i sëmundjeve në një rajon të caktuar ngrihet mbi nivelin normal të pritshëm endemik, atëherë flitet për epidemi. Por nëse rastet e sëmundjeve janë të lokalizuarra vetëm në një vend, flitet për vatër shpërthimi.
<u>**Organizata Botërore e Shëndetësisë, OBSH ishte e mendimit që në maj 2020, virusi i Coronës mund të bëhet një virus endemik.**</u> Variantet Omikron dhe Delta treguan, se virusi përshtatet si gripi. Që do të thotë ai është tani mes njerëzimit, dhe në rajone të caktuara do duhet të mësojmë të jetojmë me këtë, sepse ai nuk do të zhduket më.

**Pandemia: Përhapje botërore**

Kurse kur një sëmundje përhapet përtej vendeve e kontinenteve flitet për një pandemi. Sipas OBSH pandemitë shkaktohen kryesisht nga tipa të rinjë virusesh e patogjenësh të tjerë. Këto mund të jenë zoonozat, pra sëmundje që kalojnë nga kafshët tek njeriu. Nëse një sëmundje është e re për njeriun, shumë pak vetë mund jenë imun ndaj saj. Kjo bën që shumë njerëz sëmuren njëkohësisht. Se sa e rrezikshme apo vdekjeprurëse është ecuria e sëmundjes, varet nga virusi specifik apo gjendja shëndetësore e njeriut.

Një sëmundje tipike që merr përmasa pandemike herë pas here është gripi. Gripi spanjoll në vitin 1918 ka shkaktuar 25-50 milionë viktima, më shumë se në Luftën e Parë Botërore.

Nocionet epidemi dhe pandemi lidhet në rast normal me sëmundjet ngjitëse. Por për shkak se këto sinjalizojnë emergjencë dhe duhet të veprohet shpejt, përcaktimet përdoren edhe për sëmundje të tjera jo ngjitëse, si për shembull epidemia e diabetit.

**Sëmundja e Koronavirusit**
Që nga shfaqja në vitin 2019, sëmundja e koronavirusit është përhapur me shpejtësi në të gjitha kontinentet. COVID-19 transmetohet përmes ajrit kur një person i infektuar me virusin SARS-CoV-2 transmeton virusin duke folur, teshtitur ose kollitur. Ndërsa disa pacientë nuk tregojnë shenja të sëmundjes, të tjerët përjetojnë simptomat më të zakonshme të etheve, kollë, dhe lodhje. Të tjerë ende mund të vuajnë nga komplikime të shumta nga sëmundja e koronavirusit, duke përfshirë disa që mund të rezultojnë në vdekje.
Shumë shpresojnë, që virusi i Coronës të zhduket sa më shpejt të jetë e mundur. Disa virologë janë të mendimit, se ky virus mund të bëhet endemik, pas shfaqjes së Omikronit. Që do të thotë: Ne duhet të jetojmë me të.

### 6.13.7. Bartësit dhe përgjegjësit e aktiviteteve të rregullta dhe masat parandaluese

Pas paraqitjes së pandemisë Corona Virus – **COVID -19** në Kosovë, Kryetari i komunës me datë **13.03.2020** ka ngritur nivelin e gatishmërisë duke i aktivizuar mekanizmat komunal për menaxhimin e Emergjencave Civile duke aktivizuar Komitetin për M&SH si dhe funksionalizimin e QOEL që qytetarëve të Kaçanikut t'iu ofrohet ndihma, mbështetja, kujdesi dhe shërbimet tjera të nevojshme .

Komuna e Kaçanikut që nga paraqitja e rastit të parë në Kosovë me iniciativen e Kryetarit të komunës është angazhuar në parandalimin dhe menaxhimin e situatës pandemike në komunë.
Bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve me institucionet qendrore, rajonale si dhe me komunat tjera në rajonin e Kaçanikut për luftimin e pandemisë do të vazhdohet me parandalimin e rreziqeve nga virusi në fjalë.
Duke u mbështetur në statutin e komunës, Ligjin për mbrojtje nga FNFT, PRK, SIME si dhe PRE Komunal, Kryetari i Komunës nxjerr vendim për themelimin e Komitetit për M&SH (Shtabi Emergjent) si dhe aktivizimin e QOEL(qendra operative emergjente lokale).

Komuna përmes shtabit emergjent komunal ka përcjellë situatën me seriozitetin më të lartë duke i respektuar në tërësi masat e propozuar nga qeveria e Republikës së Kosovës, duke operuar me të gjitha resurset humane dhe materiale të cilat i posedon.

Për përballimin e pandemisë COVID-19 komuna e Kaçanikut ka angazhuar personelin dhe shërbimet përkatës për ballafaqimin me sëmundjen infektive koronavirusin COVID-19 , zyrtarët nga Drejtoritë Komunale janë të vendosur në disa objekte mirëpo për menaxhimin e situatës me COVID-19. Kryetari i Komunës ka urdhëruar që QOEL si dhe KM&SH të vendosen në objektin e Komunës prej nga do të menaxhohej me rastet e paraqitura me COVID-19.

Shtabi ka organizuar takime në vazhdimësi për ta menaxhuar situatën e paraqitur në komunë.

**Gjatë këtyre takimeve janë marrë këto masa:**

- Është bërë aktivizimi i Qendrës Operative Emergjente Lokale – QOEL**.**
- Furnizimi i qytetarëve me pako ushqimore,
- Dezinfektimi i vazhdueshëm i objekteve publike,
- Subvencionimi i QKMF-së me mjete mbrojtëse,
- Mbështetja financiare e ndërmarrjeve publike,
- Përkrahja e administratorëve te fshatrave dhe Kryqit të Kuq (me derivate dhe automjete).




**Foto 39:** Takimi i Shtabit Emergjent Komunal për parandalimin e virusit COVID- 19

**Masat e rëndësishme për parandalim**

- Kur kolliteni ose teshtini, gojën dhe hundën mbylleni me një shami.(shaminë që përdoret hidheni),
- Praktikoni higjienën e duarve dhe shmangni kontaktet e afërta,
- Mos prekni me duar të palara hundën ose gojën,
- Maskë me mbrojtëse për sytë apo fytyrën
- Në qoftë se sëmureni, 7 ditët e para qëndroni në shtrat
- Qëndroni larg njerëzve që dyshoni,
- Ajroseni shpesh ambientitn ku qëndroni,
- Ushqimi i shëndetshëm me shumë lëngje kryesisht vitamina që janë të rëndësishëm.

Masa të tjera parandaluese me specifike për llojin e transmetimit.

Infeksionet nga ajri ku partikulat infektuese kanë një diametër më të vogël se 5micron, si psh tuberkulozi,lia e dhenve, fruthi, etj

Për këto infeksione nevojitet të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Të përdoren dhoma të veçanta ku të ketë një ventilim sipas parametrave të duhur.
- I gjithë stafi që hyn në dhomë duhet të mbajë maska të posaçme.
- Pacientët duhet të qëndrojnë në dhomë.

Harta e rreziqeve;




**Harta 43:** Fshatrat e rrezikuara nga sëmundjet ngjitëse në Komunën e Kaçanikut

**Skenari - 1**

| | |
|---|---|
| Emri i skenarit: | Rreziku nga Epidemitë dhe Pandemitë |
| *Frekuenca e ndodhjes:* | |
| ☐ Shumë e mundshme (gjasat 100% në vitin e ardhshëm );<br>☐E mundshme( gjasat 10-100% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 10 vitet e ardhshme);<br>**X** ☐ Ka gjasa (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme);<br>☐ I pa mundshëm (gjasat: 1-10% në vitin e ardhshëm, ose së paku 1 rast në 100 vitet e ardhshme); | |
| Madhësia e mundshme: | |
| ☐ E papërfillshme (më pak se 10%) **X**☐ E kufizuar( 10 deri 25%)<br>☐Kritike: 25 deri 50% . ☐ Katastrofike: Më shumë se 50% | |
| Lloji i skenarit: | |
| ☐ Skenari 1**;** **X** ☐ **Skenari 2;** ☐ Skenari 3; | |
| Ndikimi: | |
| ☐ I papërfillshëm; **X** ☐ I vogël ; ☐ I mesëm ; ☐ Katastrofike; | |
| Data e vlerësimit: | |
| **24/03/2022** | |

| **Parametrat** | **Përmbajtja** |
|---|---|
| **Vendi i ngjarjes (Lokacioni)** | Vendet më të rrezikuara nga sëmundjet ngjitëse janë fshatrat; Doganaj, Soponicë, Stagovë, Biçecë, Kovaçecë, Runjevë, Kukaj dhe pjesa urbane e qytetit.<br><br><br>Fshatrave të rrezikuara nga sëmundjet ngjitëse në Komunën e Kaçaniku |
| **Kushtet meteorologjike** | Muaji shkurt dhe mars 2022 është karakterizuar me temperatura të ulëta deri në -10°C. Sipas analizave meteorologjike temperaturat e deritanishme minimale të evidentuara janë të krahasueshme me ato të para 10 viteve më parë. |
| **Periudha e vitit** | Shkurt – mars 2022 |
| **Lloji i ditës** | Ditë pune dhe vikendi |
| **Analiza meteorologjike për kohën** | Temperaturat e ulëta në këtë periudhë të vitit kalendarik ndikojnë në përhapjen e sëmundjeve ngjitëse si pasojë e ambienteve të mbylluar që banorët i frekuentojnë. Nëse e marrim 100 vjeçarin e fundit kemi pasur më shumë se1 rast sëmundje ngjitëse në zona të ndryshme, që d.m.th. se për çdo 100 vite kemi pasur kërcënime nga sëmundjet ngjitëse. Zakonisht, koha e paraqitjes së sëmundjeve ngjitëse është periudha kohore e temperaturave të ulëta gjatë muajve shkurt - mars.<br>Vatrat potenciale janë kryesisht në fshatrat e zonave të thella të territorit të Komunës së Kaçanikut.<br>Sëmundjet ngjitëse me përmasa më të mëdha janë paraqitur në fshatit, Doganaj, Soponicë, Stagovë, Runjevë, Kovaçecë, dhe zonën urbane të qytetit., |

| | |
|---|---|
| | Shkaqet më të shpeshta të të infektimeve janë, grumbullimi, qëndrimi i banorëve në ambiente të mbyllura dhe kushtet higjienike. |
| **Popullata** | Numri i familjeve të prekura nga sëmundjet ngjitëse në fshatin Runjevë12 familje me 72 anëtarë dhe në Stagovë 6 familje me 36 anëtarë. Gjithësej të infektuar janë 18 familje, me 108 anëtar, prej tyre:<br>- Fëmijë -51;<br>- Të moshuar - 8;<br>- Invalid- 4;<br>- Gra- 21;<br>- Meshkuj-24; |
| **Gadishmëria (masat parand. për menaxh. e rrezikut)** | -Në pajtueshmëri të plotë me paralajmërimin e hershëm të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK-së) për përhapjen e shpejtë dhe numrin e madh e të infektuarve me Coronavirus Covid -19 QOER -112 ka lëshuar informacion urgjent sipas procedurave standarde operative për organet kompetente në nivel lokal si akter për ndërmarrjen e masave për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse, duke ngritur nivelin e gadishmërisë së Ekipeve për Reagim Emergjent.<br>- Kryetari i Komunës së Kaçanikut urgjentisht ka ndërmarrë masat dhe aktivitetet e nevojshme për sëmundjet ngjitëse (COVID-19) sipas Planit të Reagimit Emergjent lokal duke shpallur gjendjen emergjente dhe aktivizuar Qendrën Operaive Emergjente lokale (QOEL) ndër të tjera, duke bërë edhe informimin publik dhe udhëzimet e nevojshme për familjet dëmtuara nga COVID-19.<br>- Masat parandaluese për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse nënkuptojnë të gjitha masat e nevojshme për zbutjen, zvogëlimin e rrezikut, duke filluar nga ato operacionale deri tek masat për sanimin e gjendjes.<br>- Mobilizimi i Ekipeve Reaguese Emergjente me të gjithë potencialin human dhe teknik duhet të jenë në gadishmëri të plotë për reagim në çdo kohë, duke u mbështetur edhe me resurse reaguese lokale, siq janë: Emergjencat shëndetësore, Kryqi i Kuq Komunal(KKK), Policia e Kosovës, SMShN, Dhuruesit e gjakut, etj. |
| **INCIDENTI - NGJARJA** | |
| **Shkaku dhe shkaktari** | Pas përhapjes së sëmundjes ngjitëse 2022 COVID-19 gjatë periudhës shkurt-mars 2022 që përfshinë tërë territorin e komunës së Kaçanikut, në këtë rast të gjitha institucionet lokale u alarmuan dhe vepruan në bazë të përgjegjësive ligjore për mbrojtje nga FNFT.<br>Më të rrezikuara janë fshatrat Stagovë dhe Runjevë.<br>Sipas parashikimit të Institutit Kombëtarë të Shëndetësisë Publike pritet që në ditët nëvazhdim infektimi me virus Covidë-19 të përhapet edhe në lokacione tjera që do ta rëndojë edhe më shumë situatën.<br>Vlen të theksohet se gjatë kësajë periudhë është regjistruar niveli i lartë i infektimit. |
| **Ngjarja kryesore** | -Me datë:13.03. 2022, Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik i Kosovës (IKSHPK) lëshoi njoftim - komunikatë përmes web faqes të sajë për informim të institucionevedhe publikut në lidhje me mundësinë e përhapjes së Covid -19 në zona të caktuiara të Kosovës.<br>-Sëmundja ka filluar me shpejtësi të përhapet në disa fshatra të komunës mirëpo gjendja mëe rëndë paraqitet në fshatin Runjevë dhe Stagovë. |

| | |
|---|---|
| | IKSHPK varësisht nga zhvillimet e përhapjes së Covid-19 do të ofrojë njoftime me qëllim që të mbahen të informuar qytetarët për masat mbrojtëse.<br>-Janë ndërmarrë masat për zvogëlimin e rreziqeve, vërja në punë e një ekipi mobil shëndetësor për vizita shtëpiake, patrollimi i policisë, izolimi i hapësirave dhe personave me Covid-19 etj.<br>-Operacionet e ekipeve emergjente kanë intervenuar te familjet e prekura nga Covid-19, duke bërë kontrolle të herë pas hershme të familjarëve të infektuar nga Covid-19 të cilët janë në shtëpitë e tyre të izoluara, ndërsa familjet me raste më të rënda janë vendosur përkohësisht në Qendrën Kryesore Familjare(QKMF) në Kaçanik.<br>Për sanimin e gjendjes gjatë dhe pas Covid 19 janë angazhuar edhe mekanizma institucional dhe publik, siq janë: Ekipi shëndetësor emergjent, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Kryqi i Kuq Komunal, Policia e Kosovës, NjPZSh dhe OJQ-të e ndryshme që veprojnë në Komunë. |
| **Lokacioni** | Runjevë |
| **Lloji i ditës** | Ditë pune |
| **Shkaku** | |
| **Pasojat primare dhe efektet anësore** | -Dëmtimi i i shëndetit publik;<br>-Humbja e jetëve;<br>-Dëmtimi i infrastrukturës kritike (Kontaminimi i objektit të QKMF-së);<br>-Dëmtimi i bizneseve;<br>-Vlera e përgjithshme e dëmeve (dëmet janëtë pa evidentuara). |
| **Pasojat sekondare të shkaktuara nga domino-efekti** | -Vështirësi për qarkullim në trafik;<br>- Mungesë e ushqimit si pasojë e ndalim qarkullimit të automjeteve;<br>- Kërcënimi për mundësinë e zgjerimit të infektimit në familjet e painfektuarat;<br>- Pasojat e virusit Covid 19 në komunitet dhe ambient; |
| **NDIKIMI- INDIKATORËT TREGUES** | |
| **Rastet me fatalitet** | 6 persona me fatalitet |
| **Persona të lënduar, të sëmurë, të rrezikuar** | -Bazuar në të dhënat statistikore të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, nga pasojat e virusit Covid 19 të marsit 2022 janë prekur rreth 108 banorë;<br>-Situata e krijuar pas covid 19 është shqetësuese dhe paraqet rrezik të përhapjes edhe në lokacione tjera të Komunës. |
| **Mungesë e nevojave elementare** | - Si pasojë e epidemisë punëtorët nuk mund të shkojnë në punë, fëmijët në shkolla e kopshte;<br>- Kujdesi i ofruar shëndetësorë jo i duhuri;<br>- Furnizimet e nevojave themelore: ushqimit, veshë-mbathjes, shtrojë e mbulojë, mjeteve higjienike, energjia, etj/të pa mjaftueshme;<br>- Mungesa e ujit të pijshëm, etj. |
| **Të evakuarit** | Më shumë se 40 banorë janë evakuuar dhe janë izoluar përkohësisht në vend të sigurt deri në kalim të rrezikut. |
| **Ndikimi i përgjithshëm ekonomik** | - Humbje e jetës së njeriut<br>- Dëmet shëndetësore: fizike, traumatike, psikologjike, etj.);<br>- Dëmet e shkaktuara në: Infrastrukturë kritike, shuma të mëdha por të pa përllogaritura |

| | |
|---|---|
| **Ndërprerjet në jetën e përgjithshme** | - Ndërprerja e mësimit në objektin shkollor;<br>- Ndërprerja e punës për punëtorët publik;<br>- Ndërprerja e punëve në objektet e biznesit;<br>- Ndërprerja e qarkullimit rrugor;<br>- Ndërprerja e përkohëshme e furnizimit me ushqim të bizneseve të vogla; |
| **Humbje në trashëgimi kulturore** | Nuk ka pasur |
| **Implikime politike** | Nuk ka pasur |
| **Ndikimi i përgjithshëm** | Rrezik i mesëm |
| **PROBABILITETI-GJASAT** | |
| **Probabiliteti** | Ngjarja e përshkruar në aspektin cilësorë dëshmon të dhëna për një shkallë të nivelit të mesëm të mundshëm, duke marrë për bazë të dhënat historike dhe pasojave, |
| **Paralajmërimi i hershëm** | - Fatkeqësia ishte pjesërisht e pritshme (bazuar në parashikimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik) por pastaj gjërat u përkeqësuan dhe rëndoi në masë të madhe ngjarjen kryesore;<br>-Informimi publik për Covid -19 ishte me kohë, sipas njoftimit të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, me paralajmërime për mundësi të përhapjes së sëmundjes dhe probabilitetit për cenueshmëri;<br>- Informimi i publikut bëhet në përputhje me PRK ose planin komunal për reagim emergjent(PRE) përmes: mediave të shkruara dhe elektronike, njoftimet e shkruara, mesazhe SMS, rrjete sociale, web-faqe interneti, etj. |
| **Masat parand. gjatë periudhës së paralajmërimit të hershëm** | Pas marrjes së Paralajmërimit nga IKSHP për parashikimin e përhapjes së virusit Covid -19, ngritet gatishmëria e lartë për të papriturat dhe aktivizohet Planifikimi Kontigjent për sëmundjet ngjitëse si dhe ngritet gatishmëria e kapaciteteve humane dhe teknike të strukturave për mbrojtje dhe shpëtim;<br>-Të sigurohen të dhënat dhe numri i të infektuarve me Covid-19;<br>- Të bëhet sigurimi autoambulancave për transportin e të sëmurëve;<br>-Në bazë të vlerësimit të gjendjes, të përforcohen patrullimet dhe vizitat në terren, të përgjegjësisë; |
| **Kohëzgjatja e pritshme e ngjarjes** | Faza akute e ngjarjes zgjati 60 ditë.<br>-Koha e parashikuar e nevojshme për sanim të gjendjes deri 12 muaj |
| **Koordinimi** | -Instituti Kombëtar të Shëndetit Publik i Kosovës dërgon njoftimin për shpejtësinë e përhapjen dhe rrezikun për ditët në vijim të Covid -19 në QOE -112 të AME-së. Sipas Procedurave standarde operative, njoftohen organet kompetente vendimmarrëse të qeverisjes lokale dhe strukturat për M&Sh për menaxhimin e situatës së pritshme emergjente, bazuar në PRE lokal;<br>-Bazuar në informacionet nga tereni për shpejtësinë e përhapjes së virusit Covid - 19 është aktivizuar QOE komunale dhe Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili kryesohet nga Kryetari i Komunës apo i deleguari i tij.<br>-Koordinimi i aktiviteteve nga niveli qëndror deri tek ai lokal dhe anasjelltas bëhet përmes QOE -112 në nivel rajonal; |

| Probabiliteti / frekuenca | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kategorizimi** | **Cilësia** | **Probabiliteti/gjasat** | **Frekuenca** | **Përcaktimi** |
| 1 | E papërfillshme/ E pa mundur | < 1 % | 1 ngjarje në 100 e më shumë vjet; | |
| 2 | E vogël/ E pa besueshme | 1 - 5 % | 1 ngjarje në 20 deri 100 vjet | **X** |
| 3 | Mesatare/ E mundur | 6-50 % | 1 ngjarje në 2 deri 20 vjet | |
| 4 | **E madhe / Gati e mundur** | **51-98 %** | **1 ngjarje në 1 deri 2 vjet** | |
| 5 | Jashtëzakonisht e madhe / E mundur | >98 % | 1 ngjarje në vit apo më shpesh | |

| | |
|---|---|
| | Mbledhja e të dhënave mbi numrin e të infektuarve, të sëmurëve rëndë, të vdekurve (nga Covid-19) bëhet nga komisioni lokal, dhe këtë raport ia dorzon qeverisë për shqyrtim dhe evidentim. |

## Vlerësimi i pasojës:

**Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut**

-Të dhënat për numrin e banorëve me fatalitet, të sëmurë, të izoluar janë marrë në bazë të të dhënave të mbledhura nga terreni nga Komisioni i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia, për fat të keqë ka pasur viktima, por duke pasur parasysh numrin e banorëve në nevojë, rrezikun dhe pasojat nga, pandemia Covid -19 dëmet përllogariten si kritike.

-Përveç kërcënimit të drejtpërdrejtë virusi Covid-19, vlerësohet si një përkeqësim afatgjatë i standardit jetësor në zonën e prekur.

*Pasqyrimi i pasojave për jetën dhe shëndetin e njeriut:*

| Pasojat për jetën dhe shëndetin e njeriut | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi:* | *Pasojat:* | *Kriteret:* | *I përcaktuar:* |
| 1 | Të vogla/ minimale | < 50% | |
| 2 | Të vogla | 50 - 200 | |
| 3 | Mesatare | 201 - 500 | |
| 4 | Kritike | 501-1500 | **X** |
| 5 | **Katastrofike** | **> 500** | |

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

- Dëmet materiale në ekonomi familjare dhe biznese janë vlerësuar në bazë të raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve **.**

**Pasqyrimi i pasojave në ekonomi**

| Pasojat ekonomike | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 3% GDP | |
| 2 | Të vogla | 3 - 5% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5- 10% GDP | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 4 | Kritike | 10-15% GDP | X |
| 5 | Katastrofike | >15% GDP | |

***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social – dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike***

- Vlera e dëmeve materiale në infrastrukturë janë përllogaritur në bazë të raportit të komisionit lokal për vlerësimin e dëmeve;

***Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike***

| *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social- infrastruktura kritike* | | | |
|---|---|---|---|
| *Kategorizimi* | *Pasojat* | *Kriteret* | *Përcaktimi* |
| 1 | Të papërfillshme | < 1% GDP | |
| 2 | Të vogla | 1 - 3% GDP | |
| 3 | Mesatare | 5 - 10% GDP | |
| 4 | Kritike | 5 - 10% GDP | X |
| 5 | Katastrofike | >10% GDP | |

Matrica e gjasës:

Matrica 1: *Rreziku për jetën dhe shëndetin e njeriut:*



Matrica 2: *Rreziku për pasojat në ekonomi:*




Matrica 3: *Pasqyrimi i pasojave për stabilitetin social–dëmet e përgjithshme materiale në infrastrukturën kritike:*



## KREU VII-të

# 7.0. FATKEQËSITË TJERA

## 7.1. Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë tjera

Rreziku për paraqitjen e fatkeqësive natyrore, tekniko- teknologjike apo nga dora e njeriut, ka gjasa reale të ndodhë sidomos në rrugën magjistrale dhe vijën hekurudhore Kaçanik - Hani i Elezit gjatë transportit të materieve të rrezikshme. Faktorët e përkeqësimit që mund të paraqiten në këtë pjesë janë: kushtet klimatike të pasuara me mjegull, shi, borë, ngrica , shtrëngata, erëra të forta, temperature të larta etj.

### 7.1.1. Numrin, llojin dhe madhësinë e objekteve në të cilat deponohen, përdoren apo prodhohen materiet e rrezikshme;

Në komunën e Kaçanikut, veprimtarinë e tyre e zhvillojnë 12 pika karburanti (aktive) dhe 9 rezervarë GLN (aktivë).

Në Bubeari petrol prodhohet poashtu edhe $CO_2$ ( rreth 40 ton rezervuari, acetileni e të ngjajshme).

| Nr. ren. | Emri i kompanisë (personi fizik apo juridik) | Adresa dhe Komuna | Lokacioni i objektit | Kapaciteti i derivateve | | | Sipërfaqja |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Naftë | Benzin | GLN | |
| 1 | IP – KOS | Kaçanik<br>Hyrje - dalje | Pran varrezave<br>të qytetit Kaçanik | 100.000 | 50.000 | 5000 | 300m² |
| 2 | NTSH “Bujari” | Nikaj<br>Kaçanik | Rruga magjistrale Kaçanik – Ferizaj, kilometri i 3-të | 50.000 | 30.000 | Jo aktiv | 269m² |
| 3 | Liria Petrol | Duraj (rruga për Shtërpc) Kaçanik | Kaçanik – Shtërpc Kilometri i 10-të | 60.000 | 60.000 | 7000 | 217m² |
| 4 | AL Blero SHPK | Dubravë<br>Kaçanik | Fashati Dubravë | 30499 | 30496 | 5000 | 290m² |
| 5 | Bubeari Petrol 1 | Nikaj<br>Kaçanik | Rruga magj: Kaç. Feri., kilometri i 4 | 174.221 | 57.022 | 15000 | Prodhim. 1250m²<br>Deponim 490m² |
| 6 | Shkëndija SHPK | Fushë e Pajtimit<br>Kaçanik | Fush e Pajtimit – Shtërpc, kilometri. i 1-rë | 150.000 | 50.000 | 7500 | 1196m² |
| 7 | Vata Petrol | Dubravë<br>Kaçanik | Rruga magj. Kaç. Glloboqic, km. 15-të | 60.000 | 60.000 | 15.000<br>jo aktiv | 98m² |
| 8 | Inex Petrol 1 | Dushkajë<br>Kaçanik | Rruga magj. Kaça. - Ferizaj, kilometri. i 3-të | 30.000 | 30.000 | 7000 | 200m² |
| 9 | Inex Petrol 2 | Rruga A. Bajrami<br>Kaçanik | Rruga “Agim Bajrami” p.n. | 10.000 | 10.000 | 7000 | 220m² |
| 10 | UDA SHPK | Doganaj<br>Kaçanik | Rruga Kaçanik – Tetovë. | 80.000 | 40.000 | S’ka | 270m² |
| 11 | Ballkan Petrol | Kaçanik i Vjetër<br>Kaçanik | Magjist. Kaçanik – Prishtinë, kilometri i 10-të | 12.000 | 60.000 | 10000 | 575m² |
| 12 | Bubeari Petrol 2 | Nikaj<br>Kaçanik | Nikaj | 30.000 | 30.000 | 7000 | 315m² |

**Tabela 97:** Pikat e karburanteve në komunën e Kaçanikut

### 7.1.2. Numrin, llojin dhe cenueshmërinë e trafikut rrugor, hekurudhor dhe ajror;

Transportimi i materieve të rrezikshme në vendin tonë kryesisht zhvillohet nëpër rrugën magjistrale dhe Autostradën “Arbër Xhaferi”që lidhen me vendet fqinjë.
Shkalla e goditjes gjatë kohës së transportit të materieve të rrezikshme, në vendin e incidentit është e ashpër për shkak të ndeshjeve, rrokullisjeve, kontaminimit dhe zjarreve.
Burimet kryesore të rrezikut janë: kamionët cisternë, kamionët e rrafshët, kontejnerët transportues dhe transporti hekurudhor.
Aksidenti i një mjeti transportues me materie të rrezikshme, ka si efekt primar të menjëhershëm dhe që vërehet lehtë (zjarrin, eksplodimin, derdhjen) dhe efektet sekondare (përhapjen ajrore të avujve toksik ndotjen e ujërave dhe të tokës).



**Foto 40:** Rrokullisja e trenit me mjete të rrezikshme (amoniak të dehidruar)

Aksidente të mëdha në trafikun rrugorë dhe hekurudhorë në komunën tonë nuk ka pasur, aksidentet zakonisht kanë ndodhur nga moskujdesi i shoferëve të automjeteve gjatë kalimit të vijës hekurudhore. Karakteristikë në komunën tonë është edhe kullotja e kafshëve rreth rrugëve dhe vijës hekurudhore, ku si pasojë kanë ndodhur shumë aksidente me dëme të vogla materiale dhe dëmtim të kafshëve. Të dhënat zyrtare të shërbimeve përkatëse komunale dhe Policisë së Kosovës, pikat kritike në komunikacion, janë identifikuar në udhëkryqet e fshatrave dhe rrugën magjistrale, që lidhet me Autostradën “Arbër Xhaferi”, rrugët dytësore që lidhen me rrugën magjistrale, si dhe kalimi mbi vijën hekurudhore.

### 7.1.3. Llojin dhe sasinë e materieve të rrezikshme;

Si materie të rrezikshme konsiderohen ato materie të cilat gjatë prodhimit, trajtimit, transportit, shpërndarjes apo përdorimit mund të shkaktojë rrezik ndaj shëndetit të njerëzve, të mirave materiale ose ta ndotin ambientin.
Në të gjitha pikat e grumbullimit të karburanteve në komunën e Kaçanikut janë të deponuara: naftë 630.000L benzin 410.000L dhe GLN 85.500L

*Mund të dallojmë dy lloje të aksidenteve të transportit rrugor të materive të rrezikshme:*

- Aksidente të llojit ''C'' janë aksidente gjatë të cilave materia e rrezikshme ka mbetur neutrale;
- Aksidente të llojit''M'' janë aksidente të karakterizuara qoftë me ndryshime të pa riparueshme të materies së rrezikshme qoftë me plehërimin e materies ose të humbjes së ngarkesës ose në fund qoftë edhe me eksplodimin ose djegien e materies së rrezikshme.

Gjatë aksidentit të trenit me materie të rrezikshme mund të vie deri te shkatërrimi i trenave, hekurudhës, rrugëve, automjeteve, pasurisë, infrastrukturës vitale dhe infrastrukturës teknike.



**Foto 41:** Treni me materie të rrezikshme në Kaçanik

Materiet e rrezikshme, amoniaku i dehidruar, nafta, benzina, gazrat, siq janë propan butan etj. transportohen në gjendjen e lëngët nën presion përmes vijës hekurudhore dhe rrugore, kalojnë përmes qendrës së Kaçanikut duke rrezikuar banorët dhe të mirat materiale të komunitetit.
Katastrofat tekniko – teknologjike dhe fatkeqësitë e mëdha që shkaktohen në komunikacionin rrugor, hekurudhor dhe ajror që përfshinë**:**

### 7.1.4. Distanca nga zonat e banuara;

Në territorin e komunës së Kaçanikut kalon vija hekurudhore, rruga automobilistike (Magjistralja) dhe Autostrada "Arbën Xhaferi" me rëndësi strategjike që lidhë Kosovën me Maqedoninë e Veriut, prandaj rreziku më i madh vjen nga shkaqet e ndryshme, por faktori njeri është më i shpeshtë pasi që nuk janë duke u respektuar rregullat e përgjithshme në trafik.Vija hekurudhore kalon përmes qendrës së qytetit e cila është zonë e banuar dhe paraqet rrezik gjatë transportit të materieve të rrezikshme. Distanca e vijës hekurudhore dhe rrugës magjistrale nga vendbanimet është shumë e vogël dhe paraqet rrezik për banorët e zonës urbane.

| Nr. | Venbanimi | Numri i popullsisë | Largësia në Km |
|---|---|---|---|

| | | | |
|---|---|---|---|
| **1** | Kaçanik | 10.393 | 0.5 |
| **2** | Bob | 1.606 | 1.0 |
| **3** | Gjyrgjedell (Kashan) | 436 | 7.5 |
| **4** | Gajre | 574 | 4.7 |
| **5** | Runjevë | 698 | 3.3 |
| **6** | Stagovë | 1.160 | 6.6 |
| **7** | Kaçanik i Vjetër | 1840 | 8.9 |

**Tabela 98:** Pjesëmarrja e popullsisë në rrjetin hekurudhor

### 7.1.5. Përqëndrimi e materieve të rrezikshme dhe të dëmshme

Në territorin e komunës së Kaçanikut qarkullojnë mjete transportuese që bartin mjete të rrezikshme si në rrjetin rrugor poashtu edhe në atë hekurudhorë. Përqëndrimi i këtyre materieve është në deponitë e pikave të karburanteve dhe në deponitë e kompanive të cilat si lëndë i përdoren këto materie.

### 7.1.6. Llojin dhe sasinë reale të materieve të rrezikshme dhe të dëmshme në qarkullim,

Vetë pozita e komunës së Kaçanikut si vend kufitar ia mundëson që transpoti i sasive më të mëdha të materieve të rrezikshme të nevoshme për Kosovën të kalojnë nëpër këtë zonë.
Dihet se në këtë vijë transportohen edhe materie lehtë ndezëse **(benzina, nafta, mazuti, gazrat e derivateve të naftës siç janë: propani, butani etj.**) dhe materie të rrezikshme helmuese të cilat në kontakt me ajrin mund të rrezikojnë ambientin dhe shëndetin e njeriut. Prandaj ne si komunë duhet të jemi vigjilent dhe të përgatitur për të reaguar në mënyrë sa ma të shpejtë dhe efikase për një avari të tillë duke marrë masa që një gjë e tillë mos të ndodhë, nëqoftëse ndodh të jemi të përgatitur për të reaguar në mënyrë sa ma të shpejtë dhe sa më efikase.

### 7.1.7. Rrjedhjen e materieve të rrezikshme dhe të dëmshme në vendet me rrezikshmëri të lartë/tubacionet, rrugët të cilat kalojnë nëpër vendet me specifika të veçanta,

Fluksi i madh i qarkullimit i autojeteve që qarkullojnë nga pika kufitare e Hanit të Elezit drejtë grykës së Kaçanikut ku konfiguracioni i terrenit është i ashpër dhe qarkullimi i dendur i automjeteve, ekziston rreziku i aksidenteve që mund të sjellin rrjedhjen e materieve të rrezikshme dhe mund të sjellin pasoja të pa parashikuara.
Rrjedhja e materieve të rrezikshme dhe të dëmshme paraqet rrezik të madh për shkak se të gjitha pikat e karburanteve gjenden skaj rrugëve dhe pranë vendbanimeve.
Ky rrezik paraqitet kryesisht në akset e përdorura nga linjat e rregullta, nga fluksi i madh i qarkullimit, posaçërisht në vijën hekurudhore, autostradën "Arbën Xhaferi" dhe magjistralen Hani i Elezit – Ferizaj dhe në akset e rrugëve rajonale të Komunës.

## 7.2. VLERËSIMI PËR FATKEQËSITË NUKLEARE, RADIOLOGJIKE, KIMIKE DHE BIOLOGJIKE

Hartohet eksklizivishtnë nivelin qendror, ndërsa autoritetet e nivelit lokal planifikojnë zbatimin e obligimeve, që dalin nga planet dhe programet qendrore të kësaj fushe.

## 7.3. VLERËSIMI PËR RREZIQET NGA VEPRIMET LUFTARAKE DHE TERRORISTE

Vlerësimi i rreziqeve nga veprimet luftarake dhe terroriste hartohet në bazë të dokumenteve strategjike të Republikës së Kosovës, të dokumenteve publike që i harton Ministria e Mbrojtjes apo Ministria e Punëve të Mbrendshme, bazuar në strukturën e përcaktuar, madhësinë dhe veprimet e forcave operative për veprime në fatkeqësi.

Terrorizmi është i definuar si përdorim i forcës dhe dhunës kundër individëve (civilëve) apo pronës për qëllime kërcënimi shpërndarjes së frikës, detyrimit (shtrëngimit) në mënyrë që të arrihen qëllimet politike, religjioze ose ideologjike

Në rast të ndodhjes së një akti terrorist mbi objekte ose mbi njerëzit, atëherë janë mekanizmat e përballimit të emergjencave, siç janë specialistët e menaxhimit të emergjencave dhe forcat e emergjencave, të cilat duhet të përgjigjen në të njëjtën mënyrë si në rastet e fatkeqësive natyrore.

Në mjaft situata kërcënuese terroriste, janë dashur evakuime të shpejta e masive të njerëzve për ti siguruar ata nga kërcënimet e mundshm, madje dhe nga një paralajmërim provokimi.

Duke u nisur nga natyra e tyre, sulmet terroriste zakonisht ndodhin pa paralajmërim, ose me një lajmërim në momentin e fundi, por mund të pasohen nga një numër ngjarjesh të lidhura dhe ndonjëherë të koordinuara që shkaktojnë panik dhe strese të mëdha.

Kaçaniku si vend strategjik me grykën e sajë dhe dy lumenj, ura, tunele dhe kufiri që lidhë Kosovën me Maqedoninë e Veriut mund të jetë i rrezikuar nga aktet terroriste të grupacioneve, apo individëve të ndryshëm.

Rreziku mund të jetë shembja e urave, apo tuneleve të cilat do ta vështirësonin apo ta ndërpresin qarkullimin e transportit rrugor dhe hekurudhorë mes Kosovës dhe Maqedonisë.së Veriut.

Pasojat nga këto akte do të ishin të mëdha duke ditur se furnizimi më i madhë i Kosovës me karburante dhe gjëra tjera ushqimore bëhet përmes këtyre dy lidhjeve, rrugore dhe hekurudhore.

## 7.4. VLERËSIMI DHE PASOJAT E INFRASTRUKTURËS KRITIKE

Infrastrukturë kritike ngërthen në vete kapacitetet energjetike, përpunimin e naftës dhe derivateve të saj, transportin dhe shpërndarjen, komunikimin dhe teknologjinë informative (telekomunikimin, mediet elektronike, softuerët, harduerët dhe rrjetin, sidomos internetin), financat, (bankat, sigurimet dhe investimet), objektet shëndetësore (spitalet, entet për transfuzionin e gjakut, laboratorët dhe farmacitë, hulumtimin dhe zhvillimin, shërbimet emergjente).

Ushqimin ( prodhimin, shpërndarjen dhe industrinë ushqimore), ujin: (pendët, basenet, përpunimin dhe rrjetin).

Portet ajrore, transportin rrugor dhe hekurudhor, prodhimin, deponimin dhe transportin e materieve të rrezikshme, (kimike, biologjike, radiologjike dhe nukleare) qeverisjen administrata, shërbimet kritike, objektet, rrjetet informative, lokacionet, dhe resurset kombëtare qenësore, si dhe objektet).

Infrastruktura kritike është pronë e shtetit, njësive lokale dhe regjionale, personave juridik të cilët janë themelues të njësive lokale apo regjionale të qeverisjes, si dhe pronë private.

Rrjetet dhe sistemet të cilat përbëjnë infrastrukturën kritike, janë të lidhura me vendin ku janë të vendosura, kështu që i nënshtrohen rreziqeve te nyejt që kërcënojnë atë vend, gjegjësisht lokalitetin e qytetit, komunës, në përgjithësi.

Për arsye të ndërlikueshmërisë së vlerësimit të rreziqeve për Infrastrukturën kritike, duhet të obligohen institucionet që secila veç e veç për llojin e infrastrukturës dhe rreziqeve sipas përgjegjësive të tyre emergjente, të bëjë vlerësimin e rreziqeve në këtë infrastrukturë. Në këtë vlerësim duhet planifikuar aktivitetet e preventivës, evitimin ose zvogëlimin e rreziqeve të cilat mund të cenojnë infrastrukturën kritike ose ndërprenë veprimtarinë dhe shërbimet e kësaj infrastrukture.

Sektorët e infrastrukturës kritike
1. Infrastruktura kritike kombëtare e Republikës së Kosovës do të ndahet në sektorë, duke u bazuar në fushat e përbashkëta të interesit për të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet partnerëve dhe akterëve të sektorit.
2. Sektorët e infrastrukturës kritike kombëtare të Republikës së Kosovës përfshijnë si në vijim, por nuk kufizohen vetëm në këto:
2.1. mallrat e rrezikshme (prodhimi dhe ruajtja/përpunimi i materialeve kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore);
2.2. energjia (prodhimi, transmisioni, shpërndarja, ruajtja);
2.3. shërbimet financiare (sistemet bankare, bursa, sistemet e pagesave dhe sigurimit);
2.4. ushqimi dhe bujqësia (prodhimit, përpunimi, ruajtja);
2.5. objektet dhe hapësirat qeveritare;
2.6. kujdesi shëndetësor dhe shëndeti publik (shëndetësia, prodhimi i produkteve mjekësore);
2.7. teknologjia e informacionit dhe komunikimit (komunikimi elektronik, video dhe audio transmetimi, sistemet e informacionit, telekomunikacioni, transmetimi i të dhënave);
2.8. vlerat kombëtare;
2.9. shërbimet publike (shërbimet emergjente, mbrojtja dhe shpëtimi, shërbimet e administratës civile, funksionet qeveritare, shërbimet postare dhe korrier, rendi publik, drejtësia dhe shërbimi korrektues, forcat e armatosura);
2.10. transporti (rrugor, hekurudhor, ajror); dhe
2.11. furnizimi me ujë dhe ujërat e zeza (furnizimi, rezervuarët dhe digat).[11]

## 7.5. STRUKTURAT PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE NDIHMË / SMShN

### 7.5.1. Kapacitetet forca dhe shërbimet e/ERE

Në komunën e Kaçanikut nuk ka Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, andaj këtë nivel e mbulon sektori i emergjencave që është në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.
Strukturat për Mbrojtje Shpëtim dhe Ndihmë (SMSHN)- personat fizik dhe juridik të cilët me resurset e tyre njerëzore dhe materiale në dispozicion, të destinuara për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera;
Sektori i emergjencave është organ i cili merret me çështjet emergjente në komunë dhe si i tillë bënë planifikimin dhe marrjen e masave për parandalimin, zbutjen dhe eliminimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore, teknologjike e të tjera.
Në rast të situatave emergjente ky sektor përgatit plane mbrojtëse që mundësojnë mbulimin e të gjitha segmenteve me të cilat ballafaqohet shoqëria civile dhe strukturat shtetërore në komunë.
Ky sektor iu përgjigjet Kryetarit të Komunës dhe asamblesë Komunale në Kaçanik, e sipas resorëve edhe nivelit Qendrorë-Agjencionit për Menaxhim të Emergjencave, ndërsa me shpalljen e emergjencave civile, i përgjigjet edhe është komplet me tërë potencialin e sajë në shërbim të Komitetit Komunal për Menaxhimin e Emergjencave.
Kur jemi te gjendja aktuale në teren, në rast të ndonjë fatkeqësie më të madhe natyrore, komuna e Kaçanikut nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore, logjistike dhe operacionale, trajnime dhe ushtrime të mjaftueshme, si dhe pajisje dhe mjete të duhura për të reaguar në këso lloj situata. Prandaj është e domosdoshme ngritja dhe zhvillimi i këtyre kapaciteteve, ndarje e mjeteve financiare për investime, si dhe janë më së të nevojshme trajnime, plane dhe përgatitje në vazhdimësi, ndërsa ushtrimet praktike të koordinuara nga institucionet kompetente, janë mënyra më e mirë për të qenë sa

[11] Ligji nr. 06/l-014 për Infrastrukturën kritike - neni 5

më të gatshëm dhe më të përgatitur për ti përballuar fatkeqësitë e mundshme natyrore. Në bazë të vlerësimeve të gjithanshme profesionale dhe konstatimeve faktike në terren dhe duke marrë për bazë kompetencat dhe funksionet që ushtron ky sektor i jep propozim Komitetit Komunal për Menaxhimin e emergjencave shpalljen e emergjencës civile në një pjesë apo në tërë territorin e komunës.
Komiteti Komunal për Menaxhimin e Emergjencave do të ngritë gjendjen e gatishmërisë sipas niveleve me vendim, kurdoherë që kërcënimi apo dukuria aktuale e fatkeqësisë është apo kërcënon të jetë e ashpërsisë dhe madhësisë së atillë e cila kërkon shpenzime domethënëse dhe reagim të koordinuar me qëllim të parandalimit apo lehtësimit të dëmit, humbjeve, mjerimit apo vuajtjeve. Niveli i gatishmërisë mund të shpallet nga Kryetari apo Drejtori i DSHPE-së-se në pajtim me bordin e qeverisjes lokale. Nëse trupi qeveritar nuk mund të mblidhet për shkak të fatkeqësisë apo rrethanave tjera urgjente, drejtori apo në mungesë të tij zëvendës drejtori duhet ta shpallë ekzistencën e një emergjence.

**Qendrat Operative Emergjente Lokale.**[12]

- Qendrat operative emergjente lokale mirëmbahen nga Kuvendet Komunale, dhe janë aktive dhe operative vetëm në rastet fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera apo në gjendje të jashtëzakonshme.
- Vendimi për aktivizimin e Qendrës Operative Emergjente lokale merret nga Kryetari i Komunës me kërkesën e menaxherit emergjent lokal apo komandantit të incidentit.

**Aktivizimi i Qendrës Operative Emergjente (QOE)**

Kryetari i Komunës apo koordinatori mund ta aktivizon QOE nëse ekzistojnë rrethanat në vijim:

- Kur ekziston kërcënim i pashmangshëm ndaj sigurisë apo shëndetit publik në shkallë të gjerë;
- Kur është i nevojshëm një reagim dhe koordinim i gjerë i shumë agjencionev/juridiksioneve për zgjidhjen e një ngjarje emergjente/fatkeqësie apo rimëkëmbjen nga ajo;
- Kur fatkeqësia godet shumë nën ndarje politike brenda komunave apo qyteteve, të cilët varen nga po të njëjtat resurse për zgjidhjen e ngjarjeve të mëdha emergjente; dhe/apo
- Kur për kontrollin e ngjarjeve të mëdha emergjente apo fatkeqësie implementohen direktivat emergjente lokale.

Disponueshmëria e stafit dhe nevojave operacionale mund të lejojnë apo kërkojnë që të kombinohen/bashkohen, apo të mos plotësohen pozitat (përgjegjësitë barten nga pozicioni tjetër i lartë).
Komunikimi, Alarmimi dhe Paralajmërimi do të sigurohet për publikun përmes Sistemit të Alarmimit Emergjent (SAE). Sistemet tjera do të përdoren sipas mundësisë.
Në kuadër të drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës – sektori i emergjencave veprojnë:

a) Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit (NJPZSH);
b) Zyra e alarmimit dhe koordinimit emergjent

**a) Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit (NJPZSH)**

Detyrat dhe përgjegjësitë: Gjatë fatkeqësive- aksidenteve me përmasa të mëdha, Njësia e Zjarrfikësve, së bashku me subjektet tjera përkatëse të involvuara në raste emergjente do t`í kryejnë këto veprime:
Zjarrëfikje dhe kërkim shpëtim si dhe detyrat tjera në rast zjarri;

- Do të pozicionojnë dhe të ndalin zjarret përgjatë rrugëve të trupave(njësive) dhe përgjatë rrugëve ku zhvillohen operacionet e shpëtimit;.
- Do të sigurojnë hyrje për shpëtimtarët për në lokacionet me tym;

[12] **Ligji nr. 04/-l-027** Për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera- neni 54

- Misione shpëtuese lidhur me aksidente dhe katastrofat natyrore,( eksplodimet, rrjedhat e vajrave, rrjedhjet e gazit apo lëngjeve, incidentet me ujë, vërshimet dhe shirat e mëdha, shembje dheu, aksidentet në komunikacion,etj,);
- Do të sigurojnë operacione të shpëtimit në pyje;
- Ekzekutimin e evakuimit dhe shpëtimit në rast zjarri;
- Kryen edhe shërbime tjera tënatyrës medikale në vendin e incidentitdhe bartjen e të lënduarve në qendrën spitalore, si dhe detyra tjera sipas nevojës dhe situatës emergjente.

Për momentin Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit (NJPZSH) ka :

- 16 zjarrfikës,
- Komandantin e Njësisë dhe
- Inspektorin për preventivë ndaj zjarrit

**Tabela 99:** Mjetet dhe pajisjet motorike në Njësinë Profesionale të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit në Komunën e Kaçanikut

| Nr. | Tipi i automjetit | Nr.i tabelave | Lloj i motorrit | Viti i prodhimit | Sasia e ujit | Gjendja teknike |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **BMC** | **112 – 100 - 07** | DIZELL | 2001 | 5000 | E rregullt |
| 2 | **Mercedes** | **112 – 127 - 07** | DIZELL | 1974 | 2400 | E rregullt |
| 3 | **Renault** | **112 – 126 - 07** | DIZELL | 1984 | 1500 | E rregullt |
| 4 | **Iveco** | **112 – 112 - 07** | DIZELL | 2014 | 1000 | E rregullt |
| 5 | **Toyota - LC** | **112 – 133- 07** | DIZELL | 1994 | Automjet për terrene të vështira | Jasht përdorimit |
| 6 | **Toyota Hilux** | **05Z -09 - 07** | DIZELL | 2000 | Automjet për terrene të vështira | E rregullt |

**b) Zyra për alarmim dhe koordinim emergjent (ZAKE)**

Roli dhe rëndësia:

- Grumbullon informacion për fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si dhe dukurit dhe ngjarjet tjera të rëndësishme për mbrojtje nga këto rreziqe;
- Sigurimi me kohë i të dhënave kualitative për të ndërmarrë vendime dhe aksione drejtuese për ti përballuar situatat emergjente në komunë e më gjerë;
- Bënë grumbullimin, ruajtjen dhe distribuimin e të gjitha informacioneve që kanë të bëjnë me të gjitha llojete rreziqeve për jetën e njerëzve, qenieve të gjalla, pronës dhe ambientit;
- Koordinojnë aktivitetet e strukturave komunale të mbrojtjes, shpëtimit dhe pajisjeve emergjente;
- Bashkëpunon me të gjitha subjektet, ekipet dhe personelin tjetër të involvuar në situate emergjente;
- Ofron mbështetje komunikimi dhe informimi për strukturat komunale të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
- Kryejnë detyra tjera sipas vendimeve përkatës të strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.
- Lidhjet dhe qasjet e ZAKE-së janë përmes:
  Telefonisë fikse dhe dhe asaj mobile të PTk-së
  Rrjetit të radiovalëve
  Rrjtit të internetit

**c) Policia e Kosovës**

Policia e Kosovës në raste të aksidenteve të mëdha (katastrofave) do të kryejnë:

- Rrethimin e perimitrit të sigurisë në vend- incident;
- Veprimet e hetuesisë në vendngjarje;
- Sigurimi i kontrollit në vend të ngjarjes.
- Sigurimin e lëvizjes së trafikut në vendin e ngjarjes dhe përreth.
- Mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave me subjektet tjera të involvuara në situata emeregjente
- Ekzekutimin i evakuimit të banorëve në rast shpërthimi- eksplodimit
- Parandalimi i dukurive negative dhe vënien nën kontroll të situatës (vjedhjet, kaosi, anarkia, etj.)
- Mbështetje në sigurinë fizike të personelit komandues të incidentit

**d) Shërbimet Medikale Emergjente**

Njësitë profesionale të Shërbimeve Emergjente Mjekësore ( ekipet mobile ) në raste të aksidenteve të mëdha duhet të kryejnë shërbime mjekësore emergjente dhe të ndihmojnë në zhvendosjen e popullatës nga zonat e goditura dhe të koordinojnë aktivitetet me institucionet relevante. Ekipet e ndihmës së parë i bashkëngjiten shërbimit mjekësorë emergjent dhe i nënshtrohen urdhrave të zyrtarit të këtij shërbimi Struktura organizative e shërbimeve medikale, të cilat veprojnë në teritorin e komunës së Kaçanikut, mundëson që në situata emergjente, të ofrojë shërbime cilësore si në teren ashtu edhe në mjekimin stacionar.

Në kuadër të Qendrës kryesore të mjekësisë familjare janë;

6 - Qendra të mjekësisë familjare dhe

6 - Ambulanca familjare, të cilat janë të shpërndara në bashkësi lokale të komunës.

**Detyrat e e ekipeve për shërbime medikale në situata emergjente** ;

- Ofrimi i ndihmës së parë medicinale në vendin e incidentit,
    - të siguroj vendin për dhënien e ndihmës së parë,
    - të afrojë dhënien e ndihmës së parë emergjente të personave të lënduar.
    - të zvogëloj dhimbjen dhe të minimizoj pasojat e lëndimeve për deri sa të arrin ekipet profesionale.
- Triazhimi i personave të aksidentuar, plotësimi i kartonit të trijazhës së pacijentit dhe mbajtja e evidencës,
- Evakuimi dhe bartja adekuate e personave të lënduar nga zona e fatkeqësisë në qendrat spitalore dhe repartet tjera të specijalizuara medicinale,
- Marrja e masave preventive anti-epidemiologjike si dhe luftimi i vatrave të mundshme të paraqitjes së tyre,
- Aplikimi i sistemit të mbrojtjes karantinë me rastin e shfaqjes së sëmundjeve të ndryshme infektive e të tjera,
- Informimi i popullatës lidhur me gjendjen sanitare në teren dhe dhënia e udhëzimeve-këshillave adekuate medicinale për veprim në situata të caktuara emergjente,
- Sanimi i terenit-lokacionit të aksidentuar,
- Planifikimi dhe krijimi i rezervave kritike në medikamente dhe produkte tjera farmaceutike dhe detyra tjera sipas specifikave dhe nevojave,

**e) Forcat e Kosovës (KFOR-i)**

KFOR-i do të ndaj mjete për reagimin ndaj emergjencës për ndonjë rast varësisht nëse ka mjete ose ka kufizime kombëtare. KFOR-i gjithmonë do të përpiqet të sigurojë ndihmë emergjente në rast se ka gjasa të humbet jeta ose të shkaktohen rreziqe serioze të ambientit.

Sidoqoftë, kjo mundësi nuk duhet të konsiderohet si priotitet i parë i shërbimeve të emergjencës lokale.

**Detyrat.**

- Sigurimi i forcave civile (përcjellja dhe mbrojtja)
- Misione shpëtuese lidhur me aksidentet ose katastrofat natyrore ( eksplodimi, derdhja e naftës, rrjedhje e gazit ose e gjërave të lëngëta, incidente të ujit, vërshime dhe shira të mëdha, rrëshqitje e tokës, aksidente rrugore, etj)
- Fikje zjarri dhe detyra tjera në rast zjarri
- Shërbime emergjente mjekësorë
- Mbështetja e sistemit të komunikimit
- Ndihma për zbatimin e evakuimeve

**f) Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK)**

Forcat e Sigurisë së Kosovës në raste të nevojave emergjente do t'i kryej këto detyra:

- Të sigurojnë shërbime në raste të fatkeqësive,
- Të kryejnë kërkim dhe shpëtim,
- Të siguroi asistencën humanitare në regjionet e izoluara,
- Të kryejnë shërbime emergjente mjekësore,
- Zbatimin e detyrave të transportit sipas kërkesës,
- Ndihmë për zbatimin e evakuimit.

## Shërbimet Publike

Shërbimet Publike Komunale në situata emergjente civile japin kontribut tejet të rëndësishëm në organizimin dhe shkallën e tyre të gatishmërisë vepruese dhe ndikojnë direkt në kualitetin e menaxhimit të emergjencave. Ndërmarrjet të cilat janë kryesisht të angazhuara në infrastrukturën publike të komunës së Kaçanikut janë: KEDS-i, PTK, Ndërmarrja KRU- Bifurkacioni, Ndërmarrja KR –Pastërtia, dhe disa kompani nga sektori privat , që kryesisht merren me veprimtari shërbyese, furnizuese, transportuese, rrugore – ndërtimore dhe të pastrimit. Në situata emergjente secila nga fushveprimtaria e saj.:

- Zbaton vendimet e Komitetit Komunal për Menaxhimin Emergjent dhe për aktivitetet e saja i përgjigjet këtij organi;
- Merr pjesë aktive në punë këtij Komiteti dhe jep propozime konkrete për tejkalimin e gjenjes emergjente, duke u bazuar në profesionalizmin dhe përvojat nga fushveprimtaria e tyre;
- Me kohë bëjnë planifikimin e resurseve njerëzore dhe teknike për funksionim normal në situata emergjente dhe lidhur me këtë njofton KKME–në mbi mundësitë reale të tyre;
- Caktojnë prioritetet në kryerjen e shërbimeve të tyre, dhe me pëlqim të KKME-së vendos disciplinimin e vet të kryerjes së shërbimeve.

**Organizatat Joqeveritare**

OJQ-të bashkëpunojnë me reaguesit e parë, pushtetin e të dyja niveleve, agjencitë dhe organizatat tjera që ofrojnë shërbime ndihmash për mbështetjen jetësore, zvogëlimin e dhimbjeve fizike dhe emocionale dhe përkrahin rimëkëmbjen e viktimave të fatkeqësisë, kur ndihma nuk është e mundshme nga burimet tjera.

Për shembull, KKK është një OJQ e cila ofron ndihma në nivelin lokal dhe gjithashtu koordinon elementin e kujdesit masiv (asistencë emergjente, strehim nga fatkeqësitë, dhe shërbime humane) të funksionit mbështetës emergjent (FME 6).

Në situata emergjente organizatat joqeveritare bëjnë:

- Senzibilizimin e opinionit të brendshëm dhe të jashtëm lidhur me situatën emergjente;
- Informimin e drejtë lidhur me masat dhe veprimet, të cilat subjektet involvuese, në situata emergjente ndërmarrin për tejkalimin e gjendjes së krijuar;
- Parandalojnë panikun dhe shpërndarjen e dezinformatave te qytetarët;
- Hartimi i projekteve të cilat janë në funksion të përballimit të situatave emergjente në komunë;
- Krijimi i fondeve emergjente dhe thithja e donacioneve të ndryshme për plotësimin e nevojave akute;
- Pjesëmarrja aktive në furnizimin e qytetarëve nga zonat e aksidentuara me artikuj dhe gjëra të tjera elementare për jetesë;
- Pjesëmarrja aktive në lëmin e evakuimit dhe të strehimit;
- Bashkëpunimi i ngushtë reciprok i tyre me të gjitha subjektet involvuese në emergjenca;

| Nr. | Emri dhe mbiemri | Vendi i punës | Telefoni | e-mail - Adresa |
|---|---|---|---|---|
| **1.** | **Besim Ilazi** | Kryetar i Komunës | 044-116-133 | besim.q.ilazi@rks-gov.net |
| **2.** | **Sabedin Vishi** | Nënkryetar i Komunës | 044/814-756 | sabedin.vishi@rks-gov.net |
| **3** | **Kemal Murseli** | Kryetar i Kuvendit | 044/323-947 | kemajl.murseli@rks-gov.net |
| **4** | **Ramadush Osmani** | Drejtor i DESHP - së | 044/414-303 | ramadush.osmani@rks-gov.net |
| **5** | **Sali Malsiu** | Drejtor i DSHMS-së | 044/224-865 | sali.malsiu@rks-gov.net |
| **6** | **Bahri Selimi** | Drejtor i Financave | 044/143-377 | bahri.selimi@rks-gov.net |
| **7** | **Qamil Stagova** | Drejtor i Urbanizmit | 044/195-876 | qamil.stagova@rks-gov.net |
| **8** | **Dardana Dauti** | Drejtor i Administratës | 044/526-987 | dardana.dauti@rks-gov.net |
| **9** | **Pranvera Zharku** | Drejtoreshë e zhvillimit ekonomik dhe turizmit | 045/465-778 | pranvera.zharku@rks-gov.net |
| **10** | **Zahir Doda** | Drejtor për Arsim dhe Kulturë | 044/225-351 | **zahir.doda@rks-gov.net** |
| **11** | **Suhad Dullovi** | Drejtor i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural | 045/400-082 | suhad.dullovi@rks-gov.net |
| **12** | **Hafize sallahu** | Drejtoreshë për Rini, Kulkturë dhe Sport | 044/379-419 | hafize.sallahu@rks-gov.net |
| **13** | **Bujar Bajra** | Zyrtar i lartë për emergjenca | 044/183-217 | bujar.bajra@rks-gov.net |
| **14** | **Ylber Shehu** | Shef i NJPZSH | 044-224-812 | Ylber.shehu@rks-gov.net |
| **15** | **Policia**<br>**Emrush Lalonovci** | Stacioni i Policisë<br>Komandant i Policisë | 0290/380- 834<br>044/285-950 | emrush.lalino@kosovopolice.com |
| **16** | **Shërbimi emergjent Medikal** | QKMF<br>Drejtor i QKMF- së | 0290/380-222 | sinan.zeneli@rks-gov.net |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Sinan Zeneli** | | 044/149-640 | |
| **17** | **Kryqi i Kuq**<br>**Naim Hysa** | Sekretarë i Kryqit të Kuq dega Kaçanik | 044/224-881 | >kacanik@redcross-ks.org< |
| **18** | **Ylber Tusha** | Përfaqësues i bizneseve | 044/227-825 | |
| **19** | **KEDS** | Kujdestaria | 0290/380-435 | |
| **20** | **KRU Bifurkacioni** | Kujdestaria | 0290/380-113 | |
| **21** | **Stacioni hekurudhor** | Kujdestaria | 038/550-550-146 | |

**Tabela 100:** Regjistri i autoritetit lokal të Komunës së Kaçanikut për drejtimin e Komitetit Komunal për Menaxhimin e Emergjencave

# KREU VIII-të

## 8. VLERËSIMET PËRFUNDIMTARE – SPECIFIKE

### 8.1. Vlerësimet pëfundimtare

Vlerësimet pëfundimtare bëhen për secilën masë të mbrojtjes dhe shpëtimit në raport me mundësitë reale për mbrojtje dhe shpëtim, si dhe vlerësimin e resurseve njerëzore dhe materiale të nevojshme, për tu përballur me pasojat e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

Ekipet e reagimit emergjent me resurset humane dhe teknike, si forcë reaguese për mbrojtje dhe shpëtim, përmes trajnimeve profesionale, testimeve të nivelit të gatishmërisë me anë të ushtrimeve të ndryshme si dhe bashkëpunimit rajonal do të rrisin efikasitetin dhe profesionalitetin reagues ndaj Fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

Ky dokument i vlerësimit të rreziqeve në të ardhmen do të shërbejë si pikë referente për Planin e Reagimit Emergjent lokal, Planin Komunal për Mbrojtjes nga Zjarri, Planin e Zhvillimit Komunal (PZHK), Planifikimin hapësinor, etj.

### 8.1.2. Vlerësimet për strukturën dhe madhësinë e forcave për reagim emergjent,

Trajnimin dhe aftësimin e tyre, përcaktimin e resurseve materiale të nevojshme, prioriteteve dhe drejtimeve të zhvillimit, si dhe definimin e procedurave standarde të operimit dhe monitorimit.

Rregullimi i shtretërve dhe argjinaturat e lumenjve, kanalet e kullimit, kapacitetet humane, teknike, financiare, nevoja për mobilizimin e ekipeve reaguese emergjente sipas rregullores për SMSHN, trajnimin dhe qertifikimin, krijimin e ekipeve reaguese emergjente (ERE).

## 8.2. KOSTOJA FINANCIARE E DOKUMENTIT TË VLERËSIMIT

Dokumenti i Vlerësimit të Rreziqeve synon realizimin e projekteve me qëllim të ndërmarrjes së masave parandaluese dhe Zvogëlim të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera.

Komuna e Kaçanikut për rregullimin i shtretërve të lumenjve dhe përroskave, hapjen e kanaleve, pastrimin e shtretërve të lumenjve dhe përroskave, largimin e dheut dhe gurëve nga rrëshqitjet ka ndarë mjete si më poshtë;

Mirëmbajtja verore, dimërore e rrugëve 2024-2026 (pastrimi i rrugëve lokale nga rrëshqitja e dheut dhe gurëve 475,000.00€

Ndërtimi i shtretërve të lumenjëve dhe përroskave për periudhën e vitit 2024 janë ndarë 150,00.00€

Ndërtimi i shtretërve të lumenjëve dhe përroskave (Stagovë, Kaçanik i Vjetër, Bob, Kovaçec, Biçec) për periudhën e vitit 2025 Komuna e Kaçanikut ka ndarë 100,000.00€

Për periudhën e vitit 2026 Komuna e Kaçanikut ka planifikuar 200,000.00€
Për periudhën e vitit 2027 Komuna e Kaçanikut ka planifikuar 250,000.00€
Të gjitha strukturat të cilat kanë përgjegjësi dhe detyrime për situatat emergjente civile, duhet të jen të pa varur nëveprime, në mënyrë që të jenë në gjendje të veprojnë menjëherë dhe në çdo kohë. Është më se e nevojshme që strukturat të kenë mundësi për të siguruar mjete financiare të mjaftueshme për veprim.
Duhet të merren të gjitha masat që pajisjet, mjetet e transportit, nafta, kostot e komunikimit që parashikohen të nevojshme, të jenë në dispozicion dhe të bëhen paraprakisht të përdorshme nga të gjitha strukturat e përfshira në situata emergjente, në mënyrë që të filloj menjëherë veprimi.

**Kostot financiare për rimëkëmbje:**

Në të shumtën e rasteve, janë të lidhura me përpjekjet për stabilizimin e situatës para rikthimit të fazës në gjendjen normale. Këto mund të përfshijnë kostot për:

- Riparimin e ndërtesave,
- Të infrastrukturës,
- Të energjisë elektrike,
- Të strehimit.

Për të gjithë ata të cilët për një përiudhë më të gjatë kohore nuk mund të kthehen në shtëpitë e tyre, këto burime financiare buxhetore duhet të garantohen nëpërmjet procedurave të brendshme, duke krijuar mekanizma lehtësues për përdorim në mënyrë sa ma të efektshme në situata emergjente.

### 8.2.1. Identifikimi dhe analizim i rreziqeve nga FNFT (ekipe hulumtuese profesionale)

Bazuar në historikun e të dhënave për fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Komuna e Kaçanikut më shpesh iu është ekspozuar rrezikut nga **vërshimet** dhe **rrëshqitja e dheut** me përmasa të mëdha, që nënkupton se komuna jonë edhe në të ardhmen do të parballet me fatkeqësi të natyrave të tilla, marrë për bazë ndryshimet klimatike në botë dhe zhvillimin e hovshëm tekniko-teknologjik, të cilat mund të jenë indikator të rreziqeve dhe kërcënimeve të shumëllojshme.
Gjatë një fatkeqësie natyrore aktivizohen ekipet profesionale të përgaditura për raste emergjente siç janë:

- Njesia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit,(NJPZSH)
- Kompanitë publike,
- Shërbimi medikal emergjent,
- Policia,
- Kryqi i kuq,
- Organizatat joqeveritare.

### 8.2.2. Identifikimi i nevojave për resurset humane dhe teknike

Derisa caktohen prioritetet, përcaktohen nevojat dhe porositen, përdoren sistemet e menaxhimit të resurseve për të bërë përpunimin e kërkesave për resurse.
Gjatë zhvillimit të situatës emergjente, problemet financiare rritën dhe bëhen afatgjata. Këtu përfshihen kostot për sigurimin dhe vënien në funksion të pajisjeve të specializuara dhe mjeteve të transportit si dhe kostot për sigurimin e vendstrehimeve, asistencën mjekësore dhe ato humanitare në përgjithësi për ata që janë të prekur nga situata emergjente. Këto shpenzime përbëjnë probleme afat gjata buxhetore dhe duhet të planifikohen.
Në fazat e para të një incidenti, shumica e resurseve të kërkuara adresohen në nivel lokal apo nëpëmjet marrëveshjeve për ndihmë reciproke dhe marrëveshjeve për asistencë.

- Ekipi Profesional afër 45 persona
- Vullnetarët nga shoqata e zjarrfikësve (sipas rastit dhe nevojës);

- Identifikimi i kapaciteteve për nevoja elementare (shtretër, tenda, batanije, pako higjienike, pako ushqimore, stufa për nxemje etj;
- Memorandum bashkëpunimime me kompanitë vendore për aktivizimin e resurseve teknike në raste emergjente (për hapjen e rrugëve, kanaleve etj.);
- Makineritë tjera të nevojshme – afër 25( kamionë, eskavatorë, autobusë dhe mjete tjera për transportin e njerëzve).
-

**8.2.3. Identifikimi i nevojave për trajnim dhe aftësim profesional**

Agjencioni Menaxhimit Emergjent në çdo fundvit e përcjellë planin e trajnimeve në komuna sipas identifikimit të nevojave për trajnim dhe aftësim profesional.

Pas formimit të ekipit për reagim emergjent (ERE) komuna e Kaçanikut ban kërkesë për trajnim dhe çertifikim profesional në AME.

**8.2.4. Zbatimi i akteve ligjore, nënligjore dhe monitorimi i tyre**

Për organizimin e Njësive të Strukturave për Mbrojtje Shpëtim dhe Ndihmë Komuna e Kaçanikut bazohet në rregulloren (QRK) 18/2015 për formimin e SMSHN.

**8.2.5. Masat parandaluese për zvogëlimin e efekteve nga FNFT**

Rregulimi i shtretërve të lumenjve dhe përroskave;
Ritja e kapaciteteve humane dhe teknike;
Ritja e kapaciteteve në shëndetësi me resurse humane dhe teknike;
Aktivizimi i ekipeve reaguese emergjente në periudhën e thatësirave;
Realizimi i projekteve që ndikojnë në zvogëlimin e rreziqeve.

# 9. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Bazuar në dispozitat përfundimtare të rregullores nr 25/2020 për metodologjinë e hartimit të dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë, rishikimi pasues i dokumentit të vlerësimit për komunën e Kaçanikut do të bëhet çdo tre vjet, në raste specifike, sipas nevojës edhe më herët.[13]

## 10. REKOMANDIME:

Në kuadër të Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë nga FNFT për komunën e Kaçanikut, grupi punues rekomandon, të:

1. Dokumenti i Vlerësimit të merret në konsideratë dhe për bazë gjatë hartimit të planeve të reagimit emergjent, planeve operative dhe planeve tjera sipas legjislacionit përkatës në fuqi;
2. Hartojë programin (edukimin, trajnimin dhe vetëdijsimin qytetar) si dhe masat parandaluese për tri vitet e ardhshme;
3. Merret si bazë për analizimin e nevojave dhe fuqizimin e kapaciteteve reaguese;
4. Të hartojë skenarët dhe ushtrimin e tyre me qëllim të testimit të kapaciteteve reaguese humane dhe teknike;
5. Ndajë një fond për reagim emergjent bazuar në historikun e fatkeqësive për komunën e Kaçanikut dhe vlerësimin e dëmeve dhe pasojave;

[13] Rregullore nr 25/2020 për metodologjinë e hartimit të dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë Neni 19 paragrafi 2

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**
*Kuvendi Komunal Kaçanik*
*Skupština Opština Kaçanik - Municipality Assambly of Kaçanik*

ANEKSI 2 - HARTAT

# VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA PËR KOMUNËN E KAÇANIKUT

**Kaçanik, 2025**



**Harta 1:** Pozita e Komunës së Kaçanikut në Kosovë




**Harta 2:** Harta morfologjike e Kosovës




**Harta 3:** Kufizimi dhe gjatësia e vijës kufitare me komunat fqinje dhe RMV (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 4;** Zonat kadastrale në Komunën e Kaçanikut dhe gjatësia e vijës kufitare (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 5:** Identifikimi i përroskave që mund të paraqesin rrezik për vërshime – përmbytje (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 6:** Rrjeti hidrografik i komunës së Kaçanikut (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 7.** Vendbanimet dhe dendësia e popullsisë në komunën e Kaçanikut (Burim i të dhënave: Komuna e Kaçanikut)




**Harta 8:**Harta turistike e Komunës së Kaçanikut (Burimi i të dhënave: Komuna e Kaçanikut)




**Harta:9** Sipërfaqja e Parkut Kombëtar e Malit Sharr (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 10:** Shtrirja e pyjeve në Komunën e Kaçanikut




**Harta 11.** Struktura dhe shpërndarja e tokave në komunën e Kaçanikut (Burimi i të dhënave: Komuna e Kaçanikut)




**Harta 12:** Trashigimia kulturore në Komunën e Kaçanikut




**Harta 13:** Harta turistike e qytetit (Burimi i të dhënave: Komuna e Kaçanikut)




**Harta 14** :Objektet shkollore dhe shëndetësore në komunën e Kaçanikut (Burimi i të dhënave: Komuna e Kaçanikut)




**Harta 15:** Infrastruktura e transportit (Burimi i të dhënave: Draft Plani i PZHK-së 2023-2031 Komuna e Kaçanikut)




**Harta 16.** Rrjeti hekurudhor i Kosovës – kalimi në  territorin e komunës së Kaçanikut




**Harta 17:** Tunelet dhe Urat në vijën hekurudhore Kaçanik – Hani i Elezit (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 18 :** Rrjeti transmetues që kalon përmes Komunës së Kaçanikut(




**Harta 19 :** Shtrirja e antenave të telefonisë mobile në Komunën e Kaçanikut




**Harta 20 :**Burimet e ujit, kapacitetet dhe rezervoarët (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Ortofoto 21.** Skema e sistemit të furnizimit me ujë për qytetin e Kaçanikut (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 22.** Pikat e karburantit në Komunën e Kaçanikut (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 23**: Zonat e rrezikuara nga vërshimet në komunën e Kaçanikut (Burimi i të dhënave DESHP-Sektori i Emergjencave)




**Harta 24:** Zonat e vërshuara- përmbytura në komunën e Kaçanikut (Burimi i të dhënave DESHP-Sektori i Emergjencave)




**Harta 25 : Skenari 1** i vërshimeve nga lumi Nerodime (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 26 : Skenari 2** - Zonat e rrezikuara nga vërshimet (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 27 : Skenari 3** i vërshimeve në Komunën e Kaçanikut (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 28:** Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarret pyjore në malin Sharr dhe në malin e Karadakut (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 29: Skenari i dytë-** Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarret pyjore në masivin e malit Sharr (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 30 : Skenari -3** Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarret pyjore në masivin e malit Sharr (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 31:** Vendbanimet e rrezikuara, numri dhe struktura e banorëve, Kaçanikut, (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 32:** Harta e sizmicitetit për territorin e Kosovës, Epiqendrat e tërmeteve me magnitutë>3.5, Periudha 1456-2021




**Harta 33:** Epiqendrat e tërmeteve nga viti 1456 deri 31.12.2014




**Harta 34:** Epiqendra e tërmetit në fshatin Begracë – **skenari** (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 35:** Erozioni në Komunën e Kaçanikut




**Harta 36:** Lokacionet e rrezikuara nga shembja e dheut (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 37:** Rrëshqitja e dheut në fshatin, Kovaçec- lagja Burrnik, gjat punimeve të Autostradës "Arbën Xhaferi" (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 38:** Rrugët e rrezikuara nga bora dhe ngricat në Komunën e Kaçanikut (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)

**Harta:** Sipërfaqet e rrezikuara nga Breshëri në fshatrat e Komunës e Kaçanikut




**Harta 39:** Sipërfaqet e rrezikuara nga Breshëri në Komunën e Kaçanikut (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 40:** Sipërfaqet e rrezikuara nga Orteqet në Komunën e Kaçanikut (Burimi i të dhënave DESHP-Sektori i Emergjencave)




**Harta 41:** Drejtimi i erërave në komunën e Kaçanikut (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 42 :** Zonat e rrezikuara nga thatësirat (Burimi i të dhënave DESHP- Sektori i Emergjencave)




**Harta 43:** Zonat e fshatrave të rrezikuara nga sëmundjet ngjitëse (Burimi i të dhënave DESHP-Sektori i Emergjencave)